

RAPORTI **I ZHVILLIMIT NJERËZOR** **NË KOSOVË 2012**

Sektori privat dhe punësimi



*Empowered lives.
Resilient nations.*



Këndvështrimet e paraqitura në këtë raport janë të autorëve dhe jo domosdo përfaqësojnë ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) apo Zyrës Zvicrane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC).

Gjatë kohës kur është hulumtuar dhe shkruar ky raport, Kosova ka qenë zyrtarisht nën administrimin e KB-së nën Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së. Më 17 Shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës deklaroi pavarësinë dhe zotimin e saj për të implementuar propozimin e marrëveshjes së Emisarit Special të KB-së Martti Ahtisaari.

Deklarimi ka pasuar dy vite të negociatave të cilat rezultuan në marrëveshje jo të qartë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbi statusin e Kosovës. Megjithatë, në pritje të udhëzimeve nga Këshilli i Sigurimit, KB-ja në Kosovë do të vazhdojë të merr parasysh Rezolutën 1244 të KS të KB (1999) si kornizë ligjore për implementimin e mandatit të saj duke konsideruar rrethanat evoluese.

Raporti mbi Zhvillimin Njerëzor të Kosovës 2012 nuk do të publikohet pa ndihmën bujare të Zyrës Zvicrane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Zyrës Ndërlidhëse të Zvicrës në Prishtinë.

Përkthyesi në gjuhën Shqipe: Vegim Vinca (Prishtinë, Kosovë)

Përkthyesi në gjuhën Serbe: Besmir Fidahic (Prishtinë, Kosovë)

Editimi Shqip – Shqip: Edita Malazogu (Prishtinë, Kosovë)

Dizajni: "Studio D-Line" (Prishtinë, Kosovë)

Shtypi: "Grafika Rezniki" (Prishtinë, Kosovë)



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

Parathënie

Dekada e dytë e paskonfliktit të Kosovës sot është në rrugë të mirë. Me vëmendjen që vazhdon të fokusohet në shumë çështje të pazgjidhura politike, për banorët e Kosovës, janë sfidat ekonomike dhe sociale që gjithnjë e më shumë dominojnë brengat e tyre në jetët e tyre të përditshme.

Ky raport adreson një nga sfidat më të thella të paskonfliktit në Kosovë – kapaciteti i ekonomisë për të ofruar vende pune dhe rritje. Dëshira për punë të denjë është njëra nga më kryesoret e të gjitha nevojave njerëzore. Te një familje mesatare kosovare, puna e denjë do të thotë më shumë ushqim kalorik në tavolinë, shtëpi më e mirë për banim, shëndet më i mirë dhe më shumë liri. Përtej këtyre thelbësoreve, do të thotë dinjitet dhe fuqizim, mundësi për të ndërtuar dhe shkëmbyer dituri, për t'u bërë më të aftë dhe për të transferuar ato aftësi tek të tjerët – në veçanti tek fëmijët. Më shumë njerëz me punë të denjë do të thotë më shumë të ardhura që qarkullojnë në komunitete, më shumë për të shpenzuar në shërbime thelbësore, më pak pakënaqësi dhe varfëri dhe më shumë optimizëm për një të nesërme më të ndritshme dhe të sigurtë.

Me Kosovën që nxiton drejt një ekonomie të lirë të tregut, udhëheqësit dhe bizneset e ngajshme janë ende duke luftuar për të balancuar prioritetet e dyfishta të rritjes së shpejtë të sektorit privat dhe zhvillimit të barabartë social. Kjo përpjekje pranon se ndjekja e pasurisë personale nuk mund të ndahet nga mirëqenia më e gjërë sociale. Ndërmarrjet individuale dhe komunitetet mund të lulëzojnë vetëm së bashku kur liritë janë të balancuara me masa mbrojtëse. Rritja e sektorit privat është një mjet për avansimin njerëzor, vetëm atëherë kur sjell përfitime e jo vetëm të ardhura. Ajo duhet të punojë edhe me njerëzit për krijimin e shoqërive më të forta dhe më të drejta.

Ky është thelbi i qasjes së zhvillimit njerëzor. Një koncept radikal i cili është paraqitur për herë të parë në vitin 1990, përmes Raporteve Globale të UNDP-së mbi Zhvillimin Njerëzor, kjo paradigmë është pranuar në përgjithësi si pikë referimi përkundrejt sëcilës mat progresin njerëzor. Thënë thjesht, ajo thotë se secila jetë e njeriut ka vlerë të njëjtë dhe ka të drejtë për shkallë të barabartë të lirisë, mundësisë dhe sigurisë. Kombet bëhen të suksesshme jo përmes pasurisë, mirëpo duke iu dhënë qytetarëve të saj një mundësi të barabartë për të lulëzuar dhe përparuar. Të menduarit e tillë nuk është vetëm një idealizëm me synime mirëdashëse e me rezultate të pasuksesshme. Kjo është treguar të jetë e vërtetë në mënyrë të vazhdueshme, përmes shumë studimeve rigoroze socio-ekonomike nëpër shtetet në zhvillim dhe atyre të zhvilluara.

A mundet qasja e zhvillimit njerëzor të ndihmojë në krijimin e vendeve të punës dhe rritjes në Kosovë? Apo janë vetëm më shumë fjalë mbi letër? Ky raport arsyeton shumë fuqimisht se një strategji ekonomike e rimenduar dhe në favor të njerëzve mundet dhe do të ndihmojë Kosovën në krijimin e rritjes kryesuese të

qëndrueshme të sektorit privat. Ajo thërret që rritja të ristrukturohet me përfshirje të më shumë meshkujve dhe femrave të Kosovës, duke ç'likur bollëkun e potencialit. Në fund të fundit, ajo parasheh një rrugë të shtruar të rritjes së shpejtë drejt një të ardhme më të drejtë dhe të ndritshme të cilën kosovarët dëshpërimisht dëshirojnë t'a arrijnë.

Raporti përmban dy mesazhe qendrore:

Së pari, arsyeton se strategjitë për krijimin e pasurisë të sektorit privat kërkojnë menaxhim aktiv dhe pjesëmarrje të gjërë për t'u zbërthyer në më shumë vende të denja të punës dhe standarde më të mira të jetës. Rritja e ngushtë është një terren shumë për pakënaqësi, varfëri dhe jostabilitet. Por, kur përshpejtimi i fuqisë së rritjes private është i zgjeruar për të prekur ata të përjashtuarit dhe të rrezikuarit, mund të ndezet një reaksion i jashtëzakonshëm zingjiror në përhapjen e të ardhurave dhe fuqizimit tek shtresat më të largëta të shoqërisë.

Së dyti, thuhet se krijimi i këtij reaksioni zingjiror është një përgjegjësi e përbashkët. Administrata e Kosovës luan një rol vendimtar në vendosjen e mjedisit për një sektor privat lulëzues dhe gjithëpërfshirës. Kjo do të thotë vendime të rrepta, zbatim i drejtë i ligjeve, dhe gatishmëri për të vendosur një vizion afatgjatë mbi zgjidhjet e shpejta rregulluese. Megjithatë, në fund zgjidhjet individuale do të definojnë përfundimisht se si bizneset do të rriten dhe se çfarë përfitimesh do të sjellin në komunitetet e tyre. A do të respektohen ligjet? A do të punësohen femrat ashtu sikur meshkujt? A do të jetë konkurrenca e drejtë? A do të jenë ata që nuk janë në gjendje të gjejnë vend pune të ndershem, të zgjohen çdo ditë nga shtrati dhe të provojnë prap? Vetëm njerëzit, që mendojnë për vetvetën dhe për të mirën e tyre të rëndomtë, mund t'i përgjigjen këtyre pyetjeve.

Raporti më i fundit Global mbi Zhvillimin Njerëzor i emëruar Qëndrueshmëria dhe Barazia – shqyrton se si mosbalancimet e fuqisë në qeverisje, nëpër shoqëri dhe në mesin e interesave publike dhe private, gërryejnë shumë të mira të ekonomive në lulëzim. Kjo sjell së bashku vitet e hulumtimit duke dëshmuar se e vetmja rritje që zgjat është e rrënjësuar në drejtësi – e cila kërkon të ç'likojë potencialin njerëzor, për- derisa arrihet një balancë më e shëndoshë ndërmjet rritjes ekonomike dhe ruajtjes së mjedisit për gjeneratat e ardhshme.

Anëtarët e Ekipit të Kombeve të Bashkuara për Kosovë (UNKT) kanë qëndruar përkrah kosovarëve për gati dy dekada, duke luftuar për të drejtën e mosbalancimeve të tyre vetjake serioze të fuqisë. Ne jemi thellësisht të zotuar ndaj një të ardhme në të cilën të gjithë kosovarët kanë mundësinë që të eksplorojnë mundësitë e tyre. Plani ynë i Përbashkët Zhvillimor i Kosovës 2010 – 2015 përqëndron të gjitha përpjekjet tona në sfidat kyçe të cilat frenojnë atë potencial – mungesa e llogaridhënies qeveritare, varfëria dhe shfuqizimi, dhe mbrojtja e mjedisit të brishtë të Kosovës.

Ky plan bazohet në sigurinë se drejtësia, rritja dhe mundësia shkojnë dorë për dorë. Kosovarët në mënyrë instiktive e kuptojnë se kjo është e vërtetë. Ata kanë energjinë dhe vullnetin e mirë për të marr rrugën në të cilën rrallë shkohet drejt një forme më gjithëpërfshirëse të përparimit. Ecuria mund të bëhet e vështirë nganjëherë, mirëpo UNKT premton se do të ec së bashku me ta, në çdo hap të rrugës.

Osnat Lubrani

**Koordinatorë e KB-së për Zhvillim
Përfaqësuese e Përhershme e UNDP-së**

Mirënjohjet

Ekipi i Projektit:

Mytaher Haskuka (Udhëheqës i Ekipit PRGC), Denis Nushi (Menaxher i Projektit KHDR), Iris Duri (Ekspert për Statistika PRGC)

Ekipi i Autorëve:

Konsulentja kryesuese ndërkombëtare: Claire Hajaj

Konsulenti kryesues vendor: Levent Koro

Ekipi i Institutit RIINVEST: Lumir Abdixhiku, Alban Hashani, Alban Zogaj dhe Artane Rizvanolli

Zyra Zvicrane për Bashkëpunim Kosovë Grupi Harmonizues i Shqyrtimit:

Markus Baechler, Drejtor Vendi; Nils Rosemann, Zëvendës-Drejtor Vendi; Arjeta Byci Lleshi, Zyrtare Nacionale e Programit

(Persona në vijim janë të renditur sipas rregullit alfabetik)

Kontrolli i cilësisë: Amie Gaye, Elena Danilova-Cross, Guido Beltrani, Paola Pagliani, Stephan Schmitt-Degenhardt

Grupi Drejtues Vendor: Arbër Domi, Avdullah Hoti, Dardan Sejdiu, Levent Koro, Selim Thaqi, Valentin Toçi, Safet Gërxhaliu

Kontributi nga Qeveria: Hafiz Leka (Ministria e Punës dhe Mirëqenies) dhe Naser Grajçevci (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë)

Korrektura dhe redaktimi: Jonathan Sedgwick

Korrektues gjuhësor: Danijela Mitic

Bashkëpunëtorë të mëtejshëm: Artan Loxha, Atdhe Hetemi, Brikena Sylejmani, Erëblina Elezaj

Shkurtesat

AKB	Aleanca Kosovare e Bizneseve
OEA	Oda Ekonomike Amerikane
MBSPN	Mjedisi Biznesor dhe Studimi i Performancës së Ndërmarrjeve
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
IPK	Indeksi i Përceptimit të Korrupsionit
EAQ	Evropa dhe Azia Qendore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
SHP	Sistemi i Hershëm Paralajmërues
IDH	Investimet Direkte të Huaja
GAP	Instituti GAP Prishtinë
PVB	Prodhimi Vendor Bruto
ABSH	Të Ardhurat Bruto Shtetërore
TIK	Teknologjia Informative dhe Komunikimi
KFN	Korporata Financiare Ndërkombëtare
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
FMN	Fondi Ndërkombëtar Monetar
DPI	Të Drejtat e Pronës Intelektuale
SFP	Studimi i Fuqisë Punëtore
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
RZHNJK	Raporti mbi Zhvillimin Njerëzor në Kosovë
MeF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Republikës së Kosovës
QZHM	Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit
RZHNJ	Raporti mbi Zhvillimin Njerëzor
KEAE	Klasifikimi Evropian i Aktiviteteve Ekonomike
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
RNZHNJ	Raporti Nacional mbi Zhvillimin Njerëzor
OBZHE	Organizat për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
SP	Sektori Privat
ZHSP	Zhvillimi i Sektorit Privat
RAE	Romë, Ashkali dhe Egjiptianë
RIINVEST	Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim i Kosovës Riinvest
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
EJL	Evropa JugLindore
NP	Ndërmarrjet Publike
ASK	Agjencia e statistikave të Kosovës

ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ET	Ekonomitë Tranzicionale
TI	Transparenca Internazionale
KB	Kombet e Bashkuara
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
BB	Banka Botërore

Përmbajtja

Parathënie	v
Mirënjohjet	vii
Shkurtesat	ix
Përmbajtja	xi
Përmbledhje ekzekutive	1
Hyrje: SEKTORI PRIVAT DHE ZHVILLIMI NJERËZOR NË KOSOVË	9
Kapitulli 1: ANALIZA E TREGUT PËRMES KËNDVËSHTRIMIT TË PAANSHËM	23
Kapitulli 2: BARRIERAT NDAJ RRIJES GJITHËPËRFSHIRËSE	43
Kapitulli 3: NDIKIMI MBI TREGUN NË FAVOR TË NJERËZVE	63
Kapitulli 4: RRIJJA PRIVATE NË KONTEKSTIN SOCIAL	89
Përfundimi: QË RRIJJA TË PUNOJË PËR NJERËZIT	107
Shtojca statistike: SHËNIM TEKNIK.....	117
Kutiat: 0.1 Si është e lidhur konkurrenca e drejtë me rritjen ekonomike, produktivitetin e shtuar, investime më të mëdha dhe, më e rëndësishmja, me standardet më të mira të jetesës.....	19
A. Sektori financiar në Kosovë.....	47
A1. Huamarrjet e ndërmarrjeve sipas sektorëve	48
B. Pjesëmarrja në asociacionet e biznesit	55
B1. Antarësia e asociacioneve të biznesit	55
C. Shembull i sektorit primar: Bujqësia.....	82
D. Shembulli i sektorit sekondar: Përpunimi i Ushqimit	84
E. Shembull i sektorit terciar: Teknologjia Informatike dhe e Komunikimit (TIK)	86

Figurat:

0.1 Kontributi i sektorit privat për katër shtyllat e zhvillimit njerëzor, definuar nga UNDP-ja.....	15
1.1 Shkalla e papunësisë sipas grupmoshës.....	26
1.2 Shkalla e papunësisë sipas përkatësisë etnike.....	27
1.3 Shkalla e punësimit sipas nivelit të arsimit.....	28
1.4 Shkalla e punësimit sipas gjinisë.....	28
1.5 Kontributi i sektorëve të ndryshëm në punësim.....	30
1.6 Pagat mesatare mujore (në EURO) në Ballkan dhe vendet e Evropës qendrore.....	31
1.7 Paga mesatare sipas nivelit të kualifikimeve akademike.....	31
1.8 Rritja e punësimit në firma sipas sektorit.....	32
1.9 Shpërndarja e bizneseve sipas sektorit në Kosovë.....	34
1.10 Shpërndarja rajonale e ndërmarrjeve.....	35
1.11 Shpërndarja sipas sektorëve dhe rajoneve, e bizneseve të regjistruara në Kosovë (numri i ndërmarrjeve për 1000 banorë).....	36
1.12 Shpërndarja e formës juridike të kompanive të regjistruara në Kosovë.....	37
1.13 Statuti i ndërmarrësve para fillimit të biznesit.....	38
1.14 Krijimi i ndërmarrjeve 2006 - 2010 (për 1,000 banorë).....	39
1.15 Shuarja e ndërmarrjeve 2006 - 2011 (për 1,000 banorë).....	39
2.1 Përceptimi mbi intensitetin e barrierave të bizneseve në Kosovë.....	44
2.2 Burimet e financave të raportuara për krijimin e bizneseve në Kosovë.....	46
2.3 Përceptimi i intensitetit të korrupsionit nga bizneset sipas burimeve.....	52
2.4 Evazioni fiskal dhe informaliteti i punës sipas sektorëve.....	54
2.5 Besimi në grupe të entiteteve (intenziteti).....	59
2.6 Besimi në institucione (intenziteti).....	59
3.1 Intensiteti i barrierave, i përceptuar prej bizneseve të sapo formuara në Kosovë krahasuar me bizneset në përgjithësi (ku 20 është intensiteti më i ulët dhe 100 më i larti).....	67
3.2 Barrierat e identifikuar prej përfaqësuesve të bizneseve.....	68
3.3 Shpërndarja e bizneseve në pronësi të grave sipas datës së themelimit.....	72
3.4 Bizneset në pronësi të grave në tërë botën (përqindja e totalit të bizneseve të regjistruara të cilat kanë pronare femra).....	72
3.5 Shpërndarja e gjinisë së pronësisë së bizneseve përgjatë sektorëve.....	74
4.1 Kualifikimi akademik i punonjësve (Shpërndarja e të punësuarëve të rregullt sipas nivelit arsimor).....	90
4.2 Burimi primar i punësimit të personelit (përqindja e firmave të intervistuar).....	91
4.3 Faktorët kyç të përceptuar prej të rinjëve, për punëkërkim të suksesshëm.....	92
4.4 Përqindja e të rinjve të cilët mendojnë se institucionet e mësipërme aplikojnë punësim të drejtë.....	92
4.5 Përqindja e amvisërive të cilat marrin remitanca sipas përkatësisë etnike.....	97
4.6 Ndryshimi i përqindjes së GDP-së dhe shpenzimet e ndihmës sociale në Kosovë.....	99
4.7 Sëmundjet e lidhura me ndotjen mjedisore.....	101
5.1 Cikli i rritjes në Kosovë.....	109

Tabelat:

0.1 Krahasimi rajonal - Indeksi i Zhvillimit Njerëzor të Kosovës.....	10
0.2 Gruaja në pozitat e pushtetit politik.....	12
1.1 Indikatorët kyç të tregut të punës.....	26
1.2 Proporcioni i punësimit të rinisë sipas etnicitetit.....	27
1.3 Ndarja e kompanive të regjistruara në bazë të klasifikimit sipas madhësisë.....	37
3.1 Barrierat e bizneseve sipas madhësisë së bizneseve në Kosovë.....	64
3.2 Intenziteti i barrierave të perceptuar prej bizneseve në Kosovë sipas rajoneve.....	70
3.3 Intenziteti i barrierave të perceptuar prej bizneseve në Kosovë sipas gjinisë.....	71
3.4 Intenziteti i barrierave të perceptuar prej bizneseve në Kosovë sipas sektorëve primar, sekondar dhe terciar.....	76

Shënimet.....	119
---------------	-----

Përmbledhje ekzekutive

Para një viti, qasja globale ndaj avancimit njerëzor e njohur si koncepti i Zhvillimit Njerëzor kishte arritur një Etapë të rëndësishme zhvillimi. Dy dekada kanë kaluar që nga paraqitja e saj e parë në vitin 1990, e nisur nga një ekip i ekonomistëve, filozofëve dhe mendjeve tjera të shkëlqyeshme të cilët patën guximin të sfidojnë mendimet e rrënjësura thellë mbi atë se si të matet suksesi i kombeve. Pjesa më e madhe e vlerës, gjatë dy dekadave të fundit, ka dal nga kjo qasje, përfshirë Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit dhe të marrëveshjes së parë globale mbi synimet mjedisore. Këto qëllime kërkojnë më shumë udhëheqës dhe njerëz të tillë të ngjashëm, duke i ftuar ata që të llogarisin në gjendjen e përvojës njerëzore. Raporti i parë global mbi Zhvillimin Njerëzor i publikuar pas etapës zhvillimore prej dy dekadave, ka qenë, ashtu siç duhet, i emëruar Qëndrueshmëria dhe Barazia. Ka parashtuar pyetjen: Si mund të ruhen përfitimet dhe të ndërtohet mbi to? Dhe se si mund të përhapen më gjerësisht, për të prekur më shumë jetëra?

Së fundi, Kosova ka kaluar një etapë zhvillimi të rëndësishme. Para tri viteve, ka shënuar fundin e dekadës së parë që nga fundi i armiqësive. Tani, dekada e dytë e stabilitetit relativ dhe sigurisë është duke ecur mirë. Dhe ende, këtu përfitimet janë duke ardhur më ngadalë. Edhe në Kosovën e lirë nga represioni dhe dhuna, jetërat e njerëzve janë ende të ngulfatura nga

varfëria dhe mungesa e mundësive. Atëherë nuk është për t'u habitur, që parimet e larta njerëzore ndonjëherë mund të shihen si lukse të papërbalueshme, në një kërkim të etur për rritje ekonomike dhe njohje politike.

Ky raport vie në kohën e duhur duke e bërë të thjeshtë një rast brenda një çështjeje goxha komplekse. Raporti tregon se parimet e zhvillimit njerëzor – larg të qenurit shtesa plotësuese të shtrenjta ndaj strategjive të drejtëpërdrejta ekonomike – janë rrugët më të zbatueshme drejt krijimit të qëndrueshëm të pasurisë brenda një konteksti të shëndoshë social.

I titulluar Sektori Privat dhe Punësimi, Raporti i shtatë mbi Zhvillimin Njerëzor i Kosovës fokusohet në ndërlidhjet ndërmjet zhvillimit njerëzor dhe zgjerimit të sektorit privat. Rritja e sektorit privat është shpresa më e mirë e Kosovës për gjenerimin e punës dhe të ardhurave. Këtu, ekziston një logjikë e qartë. Sektori publik i Kosovës, deri tani, ka qenë punëdhënësi i vetëm më i madh në Kosovë. Trashëgimia e gjatë e politikave socialiste ka rritur përgjegjësitë publike dhe ka ngulfatur ndërmarrjet private. I ngadalshëm ka qenë ndërrimi i këtij modeli – mirëpo, nuk është i qëndrueshëm në afat të gjatë. Gjatë viteve pasuese, qeveria e Kosovës duhet që lehtësisht të shkallëzohet prapa derisa të jetë proporcionale me përgjegjësinë e saj administrative të më pak se 2 milionë njerëzve. Sektori privat duhet të ketë hapësirë

për të marr frymë dhe të jetë i stimuluar që të rritet – duke ofruar punë, të ardhura dhe shpresë tek masa e popullatës.

Kjo rritje duhet të ndodh brenda një konteksti thellësisht sfidues social. Kosova është duke u përballur me shumë sfida të thella dhe të ngulitura njerëzore. Disa janë të ndërlidhura thjesht me varfërinë dhe mungesën e mundësive – shkallët e varfërisë, papunësisë dhe mungesën e qasjes në shërbime bazike. Megjithatë, disa burojnë nga dekadat e thyerjeve shoqërore, repressioinit dhe joekuilibrit të fuqisë. Ato përfshijnë diskriminimin gjinor, enklavat etnike, korrupsionin dhe nepotizmin, pabarazitë në të ardhura dhe ndasive të thella rurale-urbane.

Është thënë se rritja në vete mund të zgjidh problemet e Kosovës. Poqëse, bizneset mund të bëhen konkurruese dhe të zgjerohen, atëherë paraja do të rrjedh në shoqëri dhe secili do të jetë më mirë. Duke i devijuar burimet aq të nevojshme nga planet stimuluese ekonomike, komponenta e zhvillimit “njerëzor” është gjithnjë e fundit për t’u marr parasysh dhe lehtësisht e hequr. A mban ky problem analiza më të hollësishme? Ky raport mundohet t’i përgjigjet kësaj pyetjeje për hir të të gjithë Kosovarëve. Poashtu, drejtohet nga një alternativë, dhe mbase rrugë më të shpejtë drejt një të ardhme brenda kontekstit të prosperitetit Evropian të cilën shumë Kosovarë endërrojnë t’a përfjethojnë.

Metodologjia: Ky raport është zhvilluar në mënyrë të organizuar përmes një procesi të gjatë këshillues me udhëheqës Kosovarë, meshkuj dhe femra biznesi, grupe të rrezikuara, organizata jo-qeveritare (OJQ) dhe me disa mendimtarë udhëheqës dhe akademikë të Kosovës. Konturat janë formësuar përgjatë kursit katërmujor në një seri të tryezave të rrumbullakta. Vetë raporti është prodhuar nga UNDP

dhe Riinvest, si grup ekspertësh, të parët në fushën e ekonomisë në Kosovë. Studimi i ri mbi Barrierat e Ndërmarrjes është përgatitur dhe drejtuar përmes Riinvest-it me një mostër përfaqësimi prej 600 pronarëve të biznesit përgjatë tërë Kosovës, dhe rezultatet janë testuar përmes fokus grupeve të një audience të gjerë. Ky studim formon bazat e shumë rezultateve. Analizat dalin nga krahasimi i këtyre rezultateve të reja me kërkimin më se dhjetëvjeçar të gjërë socio-ekonomik mbi rritjen ekonomike, shëndetin, pjesëmarrjen politike dhe tendencat e qëndrueshmërisë mjedisore nga brenda sistemit të Kombeve të Bashkuara si dhe nga autoritetet e Kosovës dhe partnerëve ndërkombëtarë. Ekipi hulumtues dhe përgatitës gjithashtu ka studiuar bollëkun e literaturës ekzistuese globale mbi zhvillimin njerëzor dhe paradigmat e rritjes. Gjatë 20 viteve të fundit, shumë është mësuar rreth lidhjes ndërmjet krijimit të pasurisë dhe indikatorëve tjerë të mirëqenies njerëzore – përfshirë edukimin, shkallët e varfërisë, shkallët e krimit dhe barazisë sociale. Në nxjerrjen e mësimëve globale drejt kontekstit të Kosovës, është bërë secila përpjekje që analizat të mbahën praktike dhe të fokusuar në zgjidhje.

Parimet kyçe analitike: raporti përqendrohet në potencialin e rritjes së sektorit privat në ofrimin e vendeve të punës, dhe të ardhurave nga pikëvështrimi i barazisë; p.sh., a mundet rritja private të ngushtojë ndasitë e thella që thejnë shoqërinë Kosovare? Dhe a do të ishte më e shpejtë dhe më e drejt nëse i qasemi nga ky drejtim?

Ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të marr këtë qasje. Konteksti i zhvillimit njerëzor në Kosovë sigurisht është njëri nga më të dobët në Evropë. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor 2011 e rendit Kosovën mëposhtë se nga të gjithë fqinjët rajonal në aspektin e jetëgjatësisë,

shkallës të të mësuarit dhe të Ardhurave Bruto Shtetërore për frymë banori – indikatorë të jashtëzakonshëm të varfërisë dhe potencialit të mohuar në vetë prapësinë e Evropës. Sot, ekzistojnë shumë, nëse jo tepër, njerëz të varfër në Kosovë se sa në momentin kur janë ndalur armiqësitë në vitin 1999. Përafërsisht, gjysma e të gjithë Kosovarëve jetojnë në apo poshtë vijës së varfërisë, dhe një në katër nuk është në gjendje të arrijë nevojat bazike ditore të veta. Të jetuarit sa për të mbijetuar dhe nivelet e kualifikimeve të ulëta janë normë. Përafërsisht, dy të tretat e llogaritura të të rriturve kosovarë kanë vetëm nivel bazik të arsimimit në rajon, ku veturat e reja të shtrenjta dhe shtëpitë pallate mund të shihen në shumë qytete kryesore. Ekzistojnë edhe ndasi tjera, gjithashtu, edhe më shqetësuese sesa varfëria. Kosova ende ushqen në mendje ndarje të thella etnike pas viteve të represionit dhe diskriminimit. Çdo ditë, ata përjashtojnë shumë grupe nga pjesëmarrja e plotë në edukim, punë dhe jetën politike të Kosovës. Mentalitetet enklavore janë të përhapura. Përveç kësaj, gratë – në veçanti ato të reja – përballen me një jetë me potencial të kufizuar. Vetëm një pjesë e tyre merr pjesë në fuqinë punëtore, dhe, shumë më pak në jetën publike. Ato janë të frenuara nga një trashëgimi e paragjykimave kulturore dhe mungesë e gjërë e mundësive, deri më tani e pasfduar nga zbatimi i pabarabartë i legjislacionit përputhës me BE-në.

Rritja e sektorit privat do të ketë një rol kyç për të luajtur në adresimin – apo përkeqësimin – e kësaj pamjeje, varësisht mbi strategjitë e shfrytëzuara në promovimin e saj. Rritja e sektorit privat mund të gjenerojë një sërë përfitimesh të fuqishme direkte dhe jodirekte – mirëpo, ekzistojnë edhe shumë të meta ndaj rritjes të sektorit privat në kontekstet e brishta të tranzicionit. Përfitimet direkte në Kosovë mund të

përfshijnë krijimin e pasurisë/bollëkut për familje dhe komunitete, stimulimin e ndërmarrjeve që ofrojnë më shumë vende pune dhe fuqizim, efekte pozitive mbi çmimin dhe cilësinë, paraqitjen e inovacioneve dhe të më shumë programeve të Përgjegjësisë Sociale të Koorporatës. Përfitimet jodirekte mund të përfshijnë kapacitete më të mëdha për rishpërndarjen e të ardhurave, përforcimit të sistemeve të arsimimit, partneritete publiko-private më efektive dhe më shumë mundësi për kohezion social. Megjithatë të metat qëndrojnë në potencialin për mjedise biznesore të dobëta dhe të parregulluara që mundësojnë praktikë korruptive biznesore, në zgjerimin e ndasive në të ardhura dhe shpesh në ndikimin shkatërrues mjedisor të industrive të parregulluara. Banorët e Kosovës nuk mund të përballojnë moskalimin e strategjive të rritjes të Kosovës përmes filterit të drejtësisë dhe përgjegjësisë, në mënyrë që të sigurohet përparësia maksimale ndaj kontekstit të saj të rrezikuar njerëzor.

Rezultatet kryesore: raporti sugjeron se modeli i strategjisë së sotshme ekonomike të Kosovës, përballë rritjes private dhe krijimit të vendeve të punës, ka funksionuar mirë në ofrimin e ndihmës rreth krijimit të ndërmarrjeve të llojit të caktuar – kryesisht mikro-firma të drejtuara nga Kosovarët dhe të cilët kanë punësuar meshkuj Kosovarë me shkathtësi mesatare dhe të ulëta. Për të transformuar këtë model mjaft të ngushtë të rritjes në një sektor privat shumë më dinamik dhe gjithpërfshirës do të nevojitet një rregullim konceptual dhe strukturor i strategjive të rritjes, Rezultatet kryesore të këtij raporti janë:

• **Tregu i Kosovës është i paekulibruar – si në aspektin e përbërjes së fuqisë së saj punëtore e poashtu edhe në madhësinë dhe shpërndarjen e bizneseve të saj.** Dy dobësitë kyçe brenda tregut të Kosovës janë (i)

normat e ulëta të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore kombinuar me normat e ulëta të punësimit – më pak se një e katërta e Kosovareve me moshë të punës kanë vend pune; (ii) dhe theksi i lartë në krijimin e ndërmarrjes në një mjedis tashmë të ngopur me firma të sektorit terciar që sjellin vlera të ulëta të shtuara. Së bashku këto dy rezultate tregojnë një mungesë të besimit në rritje – veçanërisht në mesin e grave – dhe kulturës së ndërmarrjes mbi parimin “familja së pari” e cila thellësisht ka nevojë për më shumë shkathtësi dhe vizion për rritje.

• **Siç është e strukturuar aktualisht, investimet në rritjen private nuk janë duke ndikuar në zvogëlimin e varfërisë.** Kjo është për shkak se ato në përgjithësi janë vende pune me vlerë të ulët, që ofrojnë pasiguri, punë me pagë të ulët në një treg të destinuar shumë drejt joformalitetit. Një e treta e ekonomive familjare që nuk arrijnë të përmbushin nevojat e veta bazike kanë një anëtar të punësuar. Kufizimi ndaj gruas në fuqinë punëtore aktivisht përjetëson varfërinë në nivel të ekonomisë familjare.

• **Barrierat institucionale & kulturore ndaj biznesit janë duke e kufizuar shtrirjen dhe dividendet sociale të rritjes.** Shumica e barrierave kryesore ndaj rritjes, siç janë perceptuar nga bizneset, janë institucionale dhe kulturore, dhe jo rregullative apo të ndërlidhura me statusin. Korrupsioni, evazioni fiskal dhe strategjitë kundërkonkuruese – këto praktika të padrejta biznesore janë të gjitha të përjetësuar nga zbatimi i dobët apo diskrecional i rregullave, dhe nga një sektor publik që duket i pandjeshëm ndaj përpjekjeve të bizneseve. Intenziteti i këtyre barrierave ngritet me rritjen e biznesit dhe bëhet më i ekspozuar. Shumica e sipërmarrjeve janë të vetë-financuara. Megjithatë, ato ndërmarrje pa kapital rezervë e shohin punën me banka një sfidë të madhe – që punon kundër

inovatorëve, grave apo të varfërve. Si rezultat, shumë kompani mbesin të vogla dhe joformale, pa stimulim për t’u bërë konkurrese ndërkombëtare, pa integrim në sistemet financiare shtetërore, pa aplikim të ligjeve të punës, pa respekt për të drejtat e punonjësit, pa pagesa të taksave dhe pa e përkrahur zhvillimin shoqëror.

• **Pro-ritja dhe legjislacioni i të drejtave të fuqisë punëtore ka nevojë të stimulohet brenda kulturës së ndërmarrjes të Kosovës, e cila prek dinjitetin njerëzor dhe konkurrencën ndërkombëtare.** Kosova ka një numër të madh të legjislacioneve të përputhshme me BE-në në librat e saj e cila mbron të drejtat e punonjësve e gjithashtu kërkon transparencën, përputhshmërinë dhe drejtësinë në praktikën biznesore (për shembull, mbitatimin). Megjithatë, qasja e saj pakburimore dhe e mbi-mundimshme për shpërndarjen dhe implementimin e këtyre ligjeve është duke iu kushtuar kompanive të Kosovës, të punësuarve dhe atyre që shpresojnë t’i bashkangjiten fuqisë punëtore. Dialogu mungon në bashkëveprimin publiko-privat. Vetëm interesat e veçanta dëgjohen, duke rritur stimulimin për të mbajtur larg, për të shmangur dhe për të kufizuar fushëveprimin për zgjerim konkurrues, përgjegjës dhe domethënës.

• **Nën-performimi duhet të adresohet në sferën publike për të ndaluar lënien pas të rritjes private.** Modeli i zhvillimit të ndërmarrjes në Kosovë ashpër nënvlerëson shkathtësitë. Shumë biznese ndihen se një klimë e shkathtësive të ulëta është e mjaftueshme për nevojat e tyre. Ata poashtu vënë në dyshim faktin se pse duhet të përputhen me obligime të vështira mbi punën, mjedisin dhe taksat kur performanca qeveritare për të ofruar shërbime publike dhe mbështetje biznesore është e pasigurtë. Kompanitë dhe komunitetet në të cilat veprojnë duhet të jenë

në gjendje që të presin një standard minimal të shërbimeve nga autoritetet e tyre komunale, dhe një bashkëveprim më transparent me ta gjatë cikleve planifikuese komunale.

• **Strategjitë për krijimin e vendeve të punës kanë nevojë të synojnë që të integrojnë më shumë gra dhe burra me punë të denjë, të zëvendsohen me femra dhe meshkuj.**

Tregu i vendeve të punës në Kosovë është tashmë i ngopur me burra, zakonisht me diplomë të mesme apo më pak. Sfida, për integrimin e tjerëve me fuqinë punëtore, veçanërisht grave dhe minoriteteve etnike, ka nevojë për planifikim të kujdesshëm. Më pak se tri në dhjetë gra në Kosovë aktualisht marrin pjesë në fuqinë punëtore, dhe vetëm një në dhjetë është në punë. Sa më e madhe kompania të bëhet, duket se punësojnë më pak gra – kështu që krijimi i vendeve të punës vetvetiu nuk është përgjigje ndaj punës së denjë dhe punës së balancuar gjinore. Gratë përballen me barriera të veçanta për të hyr në fuqinë punëtore, siç janë lidhjet kulturore me familjen, apo mungesa e kolateralit mbi të cilën i qaset financave. Derisa këto të adresohen përmes strategjive të synuara, potenciali i fuqisë punëtore nuk mund të rritet në ritëm të plotë.

• **Strategjitë me shënjestër të lartë sektoriale dhe sociale mund të ri-ekuilibrojnë sektorët dhe profilin e tregut.**

Kosova ka përjetu një dis balancim të madh të tregtisë për hir të grumbullimit të lehtë të të ardhurave nga taksat e importit. Nga brenda, ka parë një lulëzim të hov-shëm të ndërtimit – tani të përfunduar – dhe ka preokupuar vetën me privatizimin dhe stimulimin e ish Ndërmarrjeve në Posedim Shtetëror. Kjo ende nuk ka ndihmuar që të ri-ekuilibrojë ekonominë private të Kosovës – pjesërisht për shkak se barrierat për rritje të drejtë dhe të qëndrueshme biznesore dallo-

jnë shumë përgjatë sektorëve. Mungesa e energjisë elektrike dhe rregullorëve kundër-konkurruese doganore ndikojnë shumë më shumë në sektorin e bujqësisë (e vendosur në zonat e varfra, rurale) se sa në industrinë dhe shërbimet me bazë në qytet.

Kosova ka kapacitetin për të zhvilluar biznese konkurruese, të standardizuara me rininë e saj dhe me fuqi punëtore të ardhshme relativisht më të aftësuar. Megjithatë, ka nevojë të fokusohet në stimulimin e një portfolio të balancuar dhe të qëndrueshme të sektorëve të cilat janë ndërkombëtarisht të tregtueshëm, me intenzitet të lartë të punës dhe vlerë të shtuar.

Raporti poashtu merr parasysh se si Kosova mund të mobilizojë disa nga përfitimet jodirekte të rritjes private – sisteme të përforcuara të arsimimit, rishpërndarje të të ardhurave dhe investime në qëndrueshmërinë mjedisore. Gjithashtu, këtu ka shumë mësim për t'u nxjerr, nëse tregu i punës i Kosovës është për t'u fuqizuar dhe për të thyer ciklet shtruese të varshmërisë. Kultura e nepotizmit, vlera e ulët për të mësuar në mesin e punëdhënësve dhe dritarja e ngushtë e mundësive është duke e ul angazhimin e rinisë ndaj të mësuarit si rrugë për avansim personal. Vetëm një e treta e të rinjve mendojnë se shkolla është duke i përgatitur mirë për jetë – megjithatë, pozitivisht, shumica ndihen se të mësuarit ende ka një vlerë të qenësishme. Ata të pafat që kanë humbur edukimin luftojnë që t'i qasen skemave trajnuese profesionale dhe skemave lehtësuese për lexim – në veçanti gratë rurale, në mesin e më të varfërve nga të varfërit.

Ligji me buxhet neutral i Kosovës mbi Familjen dhe Ndihmën Sociale është poashtu një çelës drejtues i cikleve të varshmërisë – duke kufizuar ndikimin e rritjes private mbi varfërinë dhe pabarazinë. Duke mbetur statik për vite, pavarësisht ngritjes së GDP-së, ky ligj

nxjerr jashtë familjet e varfëra nga skema e ndihmës sociale, atëherë kur fëmija më i ri mbush pesë vjet poqëse nuk ka të varur tjerë në ekonominë familjare. Kosova ende nuk e ka konsideruar vlerën afatgjatë mbi ndërlidhjen e një programi më të shënjuar të mirëqenies sociale me pjesëmarrjen në arsimim, punë-kërkim, dhe skema tjera profesionale. Potenciali për rishpërndarjen efektive të të ardhurave dhe hapësirës më të thellë për aftësitë njerëzore është i kufizuar, si tani ashtu edhe për të ardhmen.

Përfundimisht, mjedisi i Kosovës dhe legjislacioni për energjinë efikase i hartuar për të mbështetur ndërmarrjen private, tani është duke hyrë në fuqi në një arenë të injorancës së vërtetë rreth vlerës së përputhshmërisë mjedisore. Fati i legjislacionit varet në mënyrë absolute në një përpjekje gjithëpërfshirëse të shpejtë dhe të ndershme për bizneset në mënyrë që të ndërtohet një kulturë e vullnetshme, ekologjike miqësore, veçanërisht në nivelin komunal. Deri më tani, bizneset e Kosovës nuk kanë marr ndonjë lajmërim për obligimet mjedisore, por edhe nuk kanë investuar në mënyrë të konsiderueshme në programet “e vendeve ekologjike/të gjelbërta të punës” me përjashtim minimal të mënyrave – të nxitura shpesh nga partnerët ndërkombëtarë.

Rekomandimet:

Ky raport tregon se rritja private është në mënyrë komplekse e ndërlidhur me kontekstin social të Kosovës. Ajo duhet të ndërtohet nga një bazë më e gjërë dhe më e drejtë se nga ajo që është momentalisht, të çlirojë potencialin e vërtetë të tregut të Kosovës. Ndërmarrja e kësaj sfide nuk është vetëm përgjegjësi e qeverisë, apo e bizneseve private. Është prioritet i madh i Kosovës - lidhur me ata që janë në pushtet, me ata në treg dhe me ata që momentalisht janë të përjashtuar nga ai. Dialogu dhe transparenca paraqitet si instru-

ment qendror për të zgjidhur disa çështje të mëdha të rritjes. Këtu autoritetet komunale kanë një rol më të madh nga ai që janë duke e ndërmarr aktualisht.

Tri fushat kyresore për fokus, nëse Kosova dëshiron që rritja të funksionojë për njerëzit e saj janë:

1. NDËRTOJE NJË VIZION PËR RRIJTJE GJITHËPËRFSHIRËSE DHE GJENERIM INTENZIV TË PUNËS

Kosova ka nevojë për një strategji ndërqeveritare për rritje gjithëpërfshirëse e lidhur me procesin e KASh-es (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve). Kjo strategji duhet të kërkojë zvogëlimin e barrierave ndaj bizneseve përmes një portfolio të balancuar të sektorëve të tregtueshëm, punës intenzive dhe me vlerë të shtuar, e poashtu të bashkojë më shumë gra dhe burra me fuqinë punëtore si dhe të ndërlidh rritjen për së afërmi me zhvillimin në shërbimet publike dhe mbrojtjen sociale. Implementimi i kësaj strategjie duhet për së afërmi të angazhojë pronarët e bizneseve, pjesëmarrësit në fuqinë punëtore (të tanishëm dhe potencial) dhe autoriteteve publike në dialog për të siguruar transparencë dhe stimulim ndërtues për përputhshmëri. Autoritetet komunale duhet të fuqizohen për drejtimin e procesit aktiv të dialogut.

2. KRIJO KLIMËN E DUHUR PËR NDËRMARRJE TË DREJTË DHE TË QËNDRUESHME

Kosova duhet të caktojë synime kyçe në dy fushat kryesore: (i) kalimi nga bizneset me madhësi të vogël në ato të mëdha (përfshirë qasjen në financa për bizneset e reja dhe zgjeruese – veçanërisht ato të drejtuara nga gratë dhe të rinjtë – dhe përkrahjes për përputhshmëri me standardet e BE-së); dhe (ii) ngritje në formalitet për sektorët primar (bujqësi) dhe terciar (shërbime).

Këto synime mund të mbështeten nga një fushatë e gjërë e Kosovës kundër praktikave të padrejta biznesore, përfshirë korrupsionin, praktikat kundërkonkurruese dhe evazionin fiskal. Kjo fushatë duhet poashtu të përfshijë planet e hollësishme për të lehtësuar ngarkesën e përputhshmërisë mbi bizneset në sferën e tatimit (përfshirë përpjekjen për të ulur TVSH-në dhe përvetësimin e mbledhjes së saj), financimin dhe ligjet e punës.

Poashtu, duhet të ekzistojë fokus i ripërtërirë mbi zbatimin e përgjegjshëm dhe të drejtë të legjislationit, mbrojtjeve të punës, mjedisit dhe energjisë. Kjo në fakt do të thotë (i) sigurimi i zbatimit adekuat përmes kapacitetit të të dhënave, sistemit të gjyqësisë dhe inspektorëve në terren; (ii) ndëshkimi i shpejtë i zbatimit diskrecional; dhe (iii) stimulimi i përputhshmërisë përmes gjithëpërfshirjes, përkrahja praktike dhe arsimore – duke i sjell punonjësit dhe punëdhënësit së bashku në krijimin e një kulture të përputhshmërisë dhe fitimit të dyanshëm.

Gjithashtu është thelbësor krijimi i standardeve minimale për shërbime cilësore publike në fushat me nivelet më të ulëta të ndërmarrjeve të formalizuara, pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, përvetësimit të njohurive dhe barazisë gjinore.

3. INTEGRO MË SHUMË MESHKUJ DHE FEMRA NË NJË TREG TË PAANSHËM

Kosova mund të lëviz drejt një fuqie punëtore më të balancuar, kualifikuar dhe produktive, duke (i) vendosur shënjestra të graduara/shkallëzuara dhe strategjive për ngritjen e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në mesin e burrave dhe grave nga të gjitha etnicitetet; (ii) përkrahja e rinisë në treg, përmes partneriteteve, vendosjes së punës dhe sponsorimit me bizneset

lokale përmes programeve PSK; (iii) krijimi i një programi “mbi të mësuarit për tërë jetën” që ndërlidh aftësitë e punës në kurrikulumin e shkollës me zhvillimin e aftësive në moshën e rritur, e shenjuar në ata të cilët në mënyrë tradicionale mbesin jashtë (gratë rurale dhe grupet RAE, në veçanti); dhe (iv) krijimi i një rezerve financiare publiko-private për popullatën urbane dhe rurale për të bashkëpunuar në inovacionet që i shërbejnë interesit publik për qëndrueshmëri mjedisore.

Është kritike të rimendohet kryqëzimi ndërmjet strategjive rishpërndarëse të të ardhurave dhe rritjes. Ligji i Familjes në Kosovë duhet të jetë i ndërlidhur me rritjen e GDP-së, dhe kategorizimi i fëmijëve vartës të “moshës nën 5 vjet” duhet të bie. Përfitimet mund të jenë, në mënyrë më efektive, të ndërlidhura me iniciativat e thyerjes së varshmërisë, siç janë pjesëmarrja në arsimim, skema të punëkërkimit dhe programeve tjera lehtësuese për lexim. Gjithashtu, udhëheqësit komunal mund të nxisin popullatën lokale që të krijojnë vlerë më të qëndrueshme nga rrjedha e remitan-cave, duke i drejtuar ato drejt mundësive forcuese të ndërmarrjeve.

Nuk ekziston formula e përsosur në Kosovë apo gjetiu për gjenerimin e rritjes së qëndrueshme dhe të barabartë të sektorit privat. Megjithatë, këto rekomandime mund të ndihmojnë Kosovën që të gjej më shumë burime brenda vetës, të thyej varshmërinë e saj nga ndihma ndërkombëtare dhe të lëviz me vetbesim drejt një mirë-sërdhjeje të plotë në BE. Nëse Kosova dëshiron që rritja të rezultojë në jetë më të mirë për të gjithë, do të zbulojë se njerëzit e saj janë pafundësisht më të vlefshëm se çfarëdo pasurie tjetër në miniera dhe minerale. Ata mbajnë çelësin për një të ardhme më të begatshme dhe më të lumtur. Ata meritojnë një mundësi për të kontribuar me tërë fuqinë e tyre, dhe t’a shohin të ç’liruar fuqinë e pashfrytëzuar të tyre.

Sektori privat dhe zhvillimi njerëzor në Kosovë

“Vepra si për të trajtuar njerëzimin, qoftë në vetveten apo në tjetrin, si një fund për t’u marr në konsideratë, dhe asnjëherë vetëm si mjet.”

Immanuel Kant (filozof dhe etnolog)

Ndërmarrja private është pjesë fundamentale e historisë njerëzore dhe pothuajse aq e vjetër sa dhe vetë shoqëria. Pronësia private dhe tregtia e mallrave dhe shërbimeve, për fitimprurje të individëve, familjeve dhe komuniteteve, ka evoluar përgjatë kulturës njerëzore. Ajo daton shtetin komb, formalizimin e sistemeve ekonomike kapitaliste dhe socialiste dhe industrializimin e shoqërive moderne. Historianët kanë datuar ndërmarrjet private në agimin e sistemeve të hershme të komunikimit njerëzor. Kjo sugjeron që mund të jetë njëra nga impulset sociale më së shumti të rrënjësura - e lidhur thelbësisht me funksionin e shëndoshë të shoqërive.

Në të gjithë botën, në pothuajse secilën shoqëri, ndërmarrja private është bërë mjaft e ndjeshme dhe e ndërlikuar, po jo më pak e domosdoshme, mekanizëm për zhvillimin socio-ekonomik. Në të vërtetë, ky sektor është zakonisht motori parësor i rritjes – veçanërisht në shtetet në zhvillim, në të cilat tenton të gjenerojë përqindje më të madhe të GDP-së vjetore.

Në një botë gjithnjë e më shumë të ndërlidhur dhe të ndërvarur, gjetja e modelit të duhur për progresin njerëzor shihet të jetë shumë e kërkuar. Në këtë drejtim, është argumentuar se rritja e sektorit privat dhe zhvillimi njerëzor janë paradigma të kundërta. Sektori privat fokusohet mbi krijimin e pasurisë dhe fitimprurjes, zhvillimi njerëzor mbi mirëqenien e njerëzve.

Rritja e sektorit privat është e përqendruar në të ardhura monetare, zhvillimi njerëzor është i përqendruar në potencialin dhe liritë njerëzore. Sektori privat kërkon dorë të lirë për të bërë investime aty ku rritja duket më e mundshme. Zhvillimi njerëzor bën thirrje për veprim pozitiv për të investuar në ata tek të cilët të drejtat dhe kapacitetet janë më së shumti të mohuara, pavarësisht ndikimit të tyre të mundshëm mbi ekonominë e “fitimeve neto”.

Ky raport pyet nëse, në Kosovë, ndarja boshlore në mes zhvillimit njerëzor – rritjes private mund të tregohet dritë-shkurtër. Kërkon të tregojë që këtu, si çdoku tjetër, rritja e sektorit privat dhe zhvillimi njerëzor janë qëllime të pajtueshme njëra me tjetrën – për më tej, rritja e përgjegjshme e sektorit privat është pjesë qendrore e konceptit të zhvillimit njerëzor ashtu siç është menduar të aplikohet.

Duke vepruar kështu, raporti kërkon që të kuptojë se çfarë rregullimesh të politikave ka nevojë të bëhen për të mundësuar krijimin e pasurisë për rritjen e potencialit njerëzor. Në efektshmërinë e saj, ndërmarrja private nxit rritjen, aftësinë dhe mundësinë për qindra milionë njerëz anëmbanë botës. Në anën tjetër, mund të luaj poashtu një rol të dukshëm në zgjerimin e boshllëqeve të zhvillimit njerëzor – provokimin e pabarazive, duke kontribuar në degradimin mjedisor dhe duke minuar sistemet e bri-

	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (IZHN)	Jetëgjatësia në lindje (vite)	Mesatarja e viteve të shkollimit	Vitet e pritshme të shkollimit	Të ardhurat bruto shtetërore (ABSH) për frymë banori
Sllovenia	0.884	79.3	11.6	16.9	24,914
Kroacia	0.796	76.6	9.8	13.9	15,729
Mali i zi	0.771	74.6	10.6	13.7	10,361
Bullgaria	0.771	73.4	10.6	13.7	11,412
Serbia	0.766	74.5	10.2	13.7	10,236
Shqipëria	0.739	76.9	10.4	11.3	7,803
Bosnia dhe Hercegovina	0.733	75.7	8.7	13.6	7,664
Maqedonia (ish Republika Jugosllave)	0.728	74.8	8.2	13.3	8,804
Kosova	0.713	70.0	11.2	11.3	7,410

Indeksi i zhvillimit njerëzor ka tri komponente: shëndetin, arsimimin, dhe standardet e jetesës. Kalkulohet bazuar në një metodologji që ndërtohet mbi katër indikatorët primar si në Fig. 0.1 më lartë: Jetëgjatësia në lindje (vite), mesatarja e viteve të shkollimit, vitet e pritshme të shkollimit, të ardhurat bruto shtetërore (ABSH) për frymë banori. Indikatorët për shtetet në rajon të marra nga Raporti i UNDP-së mbi Zhvillimin Njerëzor 2011. Indikatorët për Kosovë të llogaritura nga Njësia e Kërkimit dhe Politikave, UNDP Kosovë.¹

shta të qeverisjes. Pa angazhim depërtues dhe të ndjeshëm të qeverive dhe vetë individëve, të metat lehtë mund të peshojnë më shumë se të mirat. Gjithashtu varet shumë, në atë se sa afër rritja e sektorit privat është e vendosur ndaj sfidave ndryshuese të zhvillimit njerëzor të shoqërisë kosovare.

0.1 Konteksti i zhvillimit njerëzor në Kosovë

Potenciali për bashkëveprim pozitiv dhe negativ ndërmjet sektorit privat dhe zhvillimit njerëzor nuk është askund më qartë i ekuilibruar se sa në kontekstet zhvillimore me të ardhura mesatare. Këto mund të jenë të kërkuara urgjentisht dhe poashtu të gatshme për përparim ekonomik, por shpesh ende bartin barra të dukshme të varfërisë dhe pabarazisë sociale. Në Evropë, Kosova ndoshta është shembulli më i habitshëm i një situate të tillë – një regjion që kërkon të nxisë një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe rritje ekonomike, mirëpo në gjurmë paralele dhe ende jo reciprokisht përforcuese.

Sot, për të nxjerr një pamje të qartë të zhvillimit njerëzor të Kosovës është jashtëzakonisht sfiduese. Statusi “sui generis” i Kosovës si dhe sfidat dhe administrimi i pas-konfliktit të saj i ka bërë të dhënat e besueshme vështirë të gjenden. Fatkeqësisht, vargu i të dhënave të disponueshme sugjeron se Kosovarët jetojnë në kontekstin më sfidues të zhvillimit njerëzor në Evropë. Sipas Indexit të UNDP-së mbi Zhvillimin Njerëzor (IZHN), Kosova renditet e 87-ta në botë, mbrapa pjesës tjetër të Evropës. IZHN-ja është instrumenti më gjithëpërfshirës në dispozicion për vlerësimin e kapacitetit të administrimit për të zgjeruar zgjedhjet dhe për të ngritur në mënyrë të barabartë mundësitë e të gjithë aksionarëve të saj. Kjo mat gjendjen e përvojës njerëzore në tri kategori fundamentale: një jetë e gjatë dhe e shëndoshë, qasje në edukim dhe një standard i dinjitetshëm i të jetuarit. Përkundër këtyre masave, Kosovarët mesatarisht, do të kenë predispozita të kenë një jetëgjatësi më të shkurtër, me më pak vite të pritura të shkollimit dhe

një ekzistencë më të varfër se të gjithë homologët tjerë evropian.

Duke vështuar për së afërmi shoqërinë kosovare ajo paraqitet me thyerje të thella përgjatë tri ndasive: 1) ndërmjet të pasurve dhe të varfërve; 2) ndërmjet grupeve etnike; dhe 3) ndërmjet gjinive, veçanërisht që prekin rininë. Pabarazia është temë e zakonshme që kalon nëpër këto thyerje, të reflektuara në dimensionet ekonomike, socio-politike dhe gjinore.

Përrjashtimi ekonomik dhe i varfërisë është i përhapur në tërë Kosovën, pavarësisht nga investimet e rëndësishme në infrastrukturë dhe ndërmarrje nga partnerët ndërkombëtarë - dhe pavarësisht nga rritja e GDP-së. Shkallët e varfërisë janë kundërtshënës; llogaritjet sillen ndërmjet 34 dhe 48 përqind për varfëri absolute dhe nga 12 deri 18 përqind për varfëri ekstreme – këta njerëz kanë të pamundur arritjen e nevojave të tyre esenciale për mbijetesë.² Studimi i 2006-tës ka sugjeruar se varfëria absolute është duke u rritur më ashpër në zonat rurale.³ Të gjitha të dhënat tregojnë se shkallët e varfërisë nuk janë duke u zvogëluar, si në kontekstet tjera evropiane të tranzicionit. Shkallët e varfërisë, në mënyrë joproporcionale janë të larta në mesin e grupeve të caktuara – me theks të veçantë në fëmijë, familje me kryefamiljarin grua dhe anëtarët e minoritetit etnik Romë, Ashkali dhe Egjiptianë (RAE). Niveli i varfërisë konsiderohet të jetë i ngushtë, me shumë njerëz që jetojnë rreth vijës së varfërisë. Një ngritje a zbritje e lehtë në të ardhura tërheq apo shtyen një numër të konsiderueshëm njerëzish nga varfëria apo në varfëri.

Varfëria në Kosovë është një prodhim i dalë nga përrjashtimi ekonomik me të cilën përballen shumë kosovarë duke iu mohuar atyre qasjen në burime të të ardhurave të cilat ofrojnë

mbrojtje nga varfëria/nevoja. Shkallët e papunësisë janë më të lartat në Evropë me 43 përqind, duke u ngritur në 73 përqind në mesin e të rinjëve.⁴ Në rajonin ku përfaqësohet gjysma e popullatës duhet të mbështetet në format e vetë-gjenerimit të të ardhurave, 8 përqind e llogaritur e Kosovarëve varet në mënyrë absolute në sistemin mbrojtës social e që dështon të shenjojë ata më të varfërit dhe aktualisht ia ndal familjeve disa përfitime të rëndësishme sapo fëmija më i ri arrin moshën 5 vjeçare. Madje edhe aty ku burimet e të ardhurave janë të disponueshme përmes punës, tokës së punueshme apo qeradhënies, ato shpesh janë të pamjaftueshme për të ngritur familjet jashtë varfërisë. Një 30 përqind tronditës i këtyre ekonomive familjare që nuk mund të arrijnë nevojat e tyre bazike kanë një anëtar të punësuar.⁵ Si rezultat, shumë familje kosovare shikojnë jashtë Kosovës për jetesë, me një në çdo të pesët të varur në remitanca për më shumë se një të katërtën e të ardhurave të tyre.⁶

Varfëria në Kosova paraqet një cikël të mohimit dhe potencialit ngulfatës njerëzor. Shkatërrimi i industrisë së rëndë të Kosovës gjatë viteve 1990-ta së bashku me efektet e represionit dhe konfliktit kanë shtyer mijëra vetë jashtë shkollës, jashtë punës dhe në varfëri. Studimi i 2007-tës tregon se përfaqësohet 62 përqind të popullatës së rritur të Kosovës ka nivele të ulëta të edukimit, me një minimale 1 përqind që kanë shkallë universitare.⁷ Nuk ka arsye të supozohet se kushtet janë përmirësuar në mënyrë dramatike brenda pesë viteve të fundit. Mes kaq shumë presioneve, shumë Kosovarë luftojnë që të parashikojnë të ardhmen në të cilën kanë më shumë zgjedhje ekonomike, njohuri më të mëdha dhe më shumë liri për të përmbushur aspiratat e tyre. Pritja nga ta që të ndërtojnë një të ardhme të tillë pa vizion dhe optimizëm është një hap shumë i largët.

Përrjashtimi socio-politik është po-ashtu i thellë në ndasitë etnike e gjithashtu edhe urbane/rurale si dhe ndasitë e moshës, duke shkatërruar kështu kapitalin njerëzor me bllokimin e pjesëmarrjes së barabartë në arsimim, punë, aktivizëm social dhe politikë. Kushtet për komunitetet RAE dhe banorët rural të të gjitha etniciteteve janë në veçanti sfiduese. Deri në një e treta e RAE nuk janë të regjistruar në lindje dhe 70 përqind lënë shkollën në moshën 12 vjeçare apo nën të.⁸ Vetë-përrjashtimi është faktor tjetër i pejsazhit ndër-etnik pas-konfliktuoz të Kosovës. Deri në 86 përqind të Serbëve të Kosovës nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet elektorale të 2007-tës,⁹ dhe përderisa kjo shifër ka rënë në vitin 2009, mentalitetet e enklavave vazhdojnë të dominojnë në sferat politike, arsimore dhe të ndërmarrësisë. Zonat rurale përballen me shkallë të rritura të përrjashtimit socio-politik; anëtarët e tregut rural të punës kanë më pak gjasa sesa homologët e tyre urban apo nën-urban për të pas qasje në burimet jo-tokësore të të ardhurave, shkallët e analfabetizmit janë më të lartat në mesin e grave dhe fëmijëve të fshatit – veçanërisht vajzat, të cilat kanë me pak gjasa për të vijuar mësimin. Folur në përgjithësi, rinia në Kosovë përrjeket të fitojë çfarëdo lloji të pikëmbështetjes kuptimplotë në shoqëri. Kosova është e zotuar në letër që të nxis dhe edukojë talentët në fëmijëri, përgatit fëmijët për punë të denjë në adoleshencë dhe të krijojë vende për zërat e rinjë në shoqëri – në praktikë, pak është bërë për të mbështetur ata. Të rinjët me nevoja speciale janë më të përrjashtuarit nga të gjithë – vetëm një pjesë e tyre janë në shkollë (më pak se 24 përqind, sipas një studimi¹⁰) dhe se shumica e tyre nuk do të luajnë asnjë rol në jetën e gjërë socio-politike të Kosovës.

Përrjashtimi bazuar në gjini është dukshëm i njëjtë në tërë shoqërinë Kosovare.

Dëshmia e mohimit të të drejtave dhe mundësive është e pranishme kudo – nga të dhënat e punësimit (tri nga çdo katër gra të reja aktive në tregun e punës janë pa vende pune), deri tek pjesëmarrja e kufizuar e gruas në jetën politike. Kosova ka një kuotë të shëndoshë për gratë në qeverisje dhe ka parë një rritje në numrin e grave që mbajnë pozita të larta politike në Prishtinë. Megjithatë, jashtë kryeqytetit, pamja është më pak premtuese. Ky numër grash ka mbajtur rreth 22 dhe 28 përqind të vendeve ulëse në secilin kuvend komunal, më 2009 është parë kryesisht për shkak të përrforcimit të kuotës, sesa të një pasqyrimi të vërtetë fuqizues.

Asnjë kuvend komunal nuk është drejtuar nga një grua. Në mesin e komuniteteve minoritare, asnjë pozitë e lartë politike nuk është mbajtur nga një grua.¹¹

TABELA

0.2

Gruaja në pozitat e pushtetit politik

	Gjithësej	Femra	Meshkuj
Ministra	18	2	16
Sekretarë të Përhershëm	18	2	16
Anëtarë të Parlamentit	120	40	80
Kryesuesë të Komiteteve Parlamentare	13	2	11
Kryetarë Komunash	36	0	36

Parlamenti i Kosovës 2010

Në përgjithësi, në Kosovë, gratë janë të fundit në përrfundimin e shkollimit, në angazhimin në ekonominë private, zotërimin e tokës dhe bizneseve dhe të kandidimit për zyre politike. Anëtarët e gjinisë femërore të komunitetit rural, të varfër dhe minoritarë janë të prekur më së keqi. Një 14 përqind i shquar i femrave rurale janë analfabete, krahasuar me 4 përqind të meshkujve ruralë.¹² Në një klimë kulturore konzervatorike dhe ekonomikisht të sforcuar, gratë e varfëra të Kosovës më gjasë më shumë përceptohen se kanë detyra se sa të drejta. Aftësitë e saj janë të çmuara vetëm atëherë sa ato përkrahin burrin e tyre dhe fëmijët e

tyre në rolet tradicionale, dhe potenciali i saj për të zgjeruar njohuritë, të marr pjesë në fuqinë punëtore dhe të kontribuojë me zërin e saj ndaj vendimmarrjes politike është e një rëndësie sekondare - nëse veç ekziston.

Pamja e zhvillimit njerëzor të Kosovës është e ndërlikuar. Për më pak se një orë fluturim larg janë disa nga shtetet evropiane më të sofistikuar botërore. Suksesi dhe organizimi i tyre hedh hije mbi Kosovën, e cila në të vërtetë duket e zymtë në bazë të këtij krahasimi. Megjithatë, te një vështrues mesatar, rajoni në të cilin shumica e njerëzve duket se kanë shtëpi, ushqehen dhe kanë qasje në teknologjitë siç janë veturat, telefonat mobilë dhe televizioni, nuk përputhet me pamjet tradicionale të varfërisë dhe nën-zhvillimit. Megjithatë, janë dy paralajmërime që ja vlejné të merren parasysh. Së pari, xhepat e shoqërisë kosovare – veçanërisht të komuniteteve RAE dhe atyre në varfëri të jashtëzakonshme – bien në një varg tregues e cila nuk do të dukej jashtë Afrikës nën-Sahariane. Kjo nënvizon pabarazi të thella sociale. Së dyti, pjesa më e madhe e varfërisë së Kosovës dhe mungesa e mundësive fshehet prapa dyerve të mbyllura. Përrashtimi politik, social dhe ekonomik i provuar nga një gamë e tillë e gjërë e njerëzve ka pasoja kërcënuese për jetën në shumë raste. Kombinimi vdekjeprurës në Kosovë i ndotjes ekstreme dhe degradimit mjedisor (përfshirë kontaminimin më të keq të metaleve të rënda të shënuar ndonjëherë në histori), përhapja e sjelljeve me rrezik të lartë – sidomos pirja e duhanit, përfshirë gjatë shtatzënisë, mbrojtje sociale e shenjuar keq dhe sisteme të dobëta shëndetësore, me padyshim që kanë kontribuar në shumë sëmundje kronike dhe vdekje të parandalueshme – megjithëse të paregjistruara. Çdo familje kosovare që jeton afër vijës së varfërisë do të vendoste sëmundjen para të gjitha frikave tjera. Çdo ditë në Kosovë, sëmundjet që lehtë trajtohen në shtetet fqinje shtojnë një barrë tashmë të rëndë të

varfërisë, gërryerjes së potencialit njerëzor dhe brishtësisë sociale.

0.2 Sektori privat si instrument për zhvillimin njerëzor

Udhëheqësit e Kosovës, të vetëdijshëm për sfidat me të cilat përballen, kanë lidhur vizionin e tyre për të ardhmen në Strategjinë 2020 të Bashkimit Evropian (BE) për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Ky vendim është menduar me mençuri që të përgatitet për kohën kur mosmarrëveshjet e statusit të Kosovës të jenë zgjidhur dhe kosovarët të mund të marrin vendin e tyre eventual si anëtarë të plotë të Kombeve të Bashkuara (KB) dhe familjes së BE-së.

Strategjia 2020 e BE-së (e cila vendos shënjestra ambicioze të dekadës për shtetet anëtare në punësim, inovacion, arsim, gjithëpërfshirje sociale dhe ndryshime klimatike/energjisë), vetë tregon se si gjuha e rritjes/zhvillimit është gradualisht duke u ri-kornizuar nga terminologjia e zhvillimit njerëzor. Strategjia natyrisht evoluon nga Dokumenti i Samitit Botëror i 2005-tës dhe përshkrimi të tij mbi tri elementet fundamentale të zhvillimit të qëndrueshëm: mbrojtja ekonomike, sociale dhe mjedisore (përveç kësaj, zhvillimi kulturor, që nga atëherë është propozuar si element i katërt). Te dy dokumentet burojnë nga rishikimi revolucionar në mënyrën se si progresi njerëzor është matur globalisht – kalimi nga qasja utilitare duke shfrytëzuar matjet sasiore ekonomike tek përqëndrimi mbi **kapacitetin njerëzor** – shkalla në të cilën njerëzit janë në gjendje **të zgjerojnë zgjedhjet e tyre dhe të rrisin mundësitë dhe lirinë e tyre**.

Qasja e zhvillimit njerëzor paraqet një zhvendosje të paradigmës në të menduar. Ajo synon drejt një mjedisi në të cilin njerëzit mund të

zgjerojnë zgjedhjet që kanë, zhvillojnë potencialin e tyre të plotë dhe drejtojnë jetë produktive dhe kreative në përputhje me nevojat dhe interesimet e tyre. Barazia qëndron në zemrën e këtij vizioni të progresit njerëzor. Në vend të **shpejtësisë** së progresit, ajo mat **gjerësinë** dhe **drejtësinë** e progresit në të gjitha shoqëritë dhe shtetet – duke filluar me ato shtete për të cilat liritë, kapacitetet dhe zgjedhjet janë më të kufizuara. Ndërtimi i aftësive njerëzore është mjeti kyç dhe shenja dalluese e qasjeve të zhvillimit njerëzor, pikërisht aty ku ka më së shumti nevojë. Pa të, shumë zgjedhje thjeshtë do mbesin të padisponueshme, dhe shumë mundësi të paarritshme.

Kjo qasje ka shumë elemente të papritura të përbashkëta me vlerat që përforcojnë ndërmarrjet private. Te dyjat centralizojnë veprimin njerëzor dhe lirinë - për të bërë zgjedhje, eksplorojnë mundësitë dhe zhvillojnë potencialin. Te dyjat e vendosin këtë veprim brenda kontratës sociale, e cila përshkruan natyrën e përgjegjësisë individuale kundrejt të tjerëve dhe së mirës së shoqërisë në tërësi. Te dyjat varen, në një masë më të madhe apo më të vogël, mbi rolin rregullativ dhe mbështetës të qeverisjes për interesin publik.

Sensi praktik poashtu dikton se rritja ekonomike është parakusht kritik për zgjerimin e zgjedhjeve të njerëzve. Pa rritje të qëndrueshme ekonomike, shtrirja e mëtutjeshme e këtyre zgjedhjeve dhe mundësive është e kufizuar. Kjo, në shkëmbim, përjashton një segment të rëndësishëm të shoqërisë nga të pasurit qasje në standard të denjë të jetesës, nga të pasurit jetë të gjatë dhe të shëndoshë dhe për të pasur qasje në arsimim.

Kosova, si shumë shtete tjera me të ardhura mesatare me shkallë të arsyeshme të edukimit dhe leximit,

e sheh rritjen përmes ndërmarrjeve private si faktor kyç në zgjidhjen e problemeve të ngulitura socio-ekonomike. Dhe megjithatë, ende ekzistojnë shumë barriera për të kapërcyer. Përpara dekadës së represionit dhe konfliktit që dërguan deri në intervenimin e NATO-së më 1999, Kosova ka qenë e administruar nga një sistem i lartë qendror, ideologjik socialist shtetëror e cila ka zotëruar të gjitha mjetet kryesore të prodhimit dhe i ka zbritur ndërmarrjet private në ndërmarrje të shkallës së vogël dhe joformale.¹³ Nuk ekziston tradita e industrisë së privatizuar të rregulluar mirë dhe me përgjegjësi shoqërore – qoftë për bizneset familjare, ndërmarrjet e shkallës së mesme apo asetet kryesore industriale të Kosovës. Pavarësisht nga përpjekja e pasperiudhës së 1999-tës për të kaluar në ekonomi të tregut, sektori publik ende dominon në tregun e punës në Kosovë. Sot, duke iu afruar shenjës së gjysmë-rrugës në dekadën e dytë që nga fundi i konfliktit aktiv, sektori i posalindur privat është parë me tepër se kurrë si një litar shpëtimi për aspiratat e saj të shtetësisë dhe si një pjesë thelbësore e vizionit të saj zhvillues.

0.3 Bashkëveprimi publik/privat në Kosovë – të mirat dhe të metat

Sfida me të cilën sot ballafaqohet Kosova përballë sektorit të saj privat është e shprehur thjeshtë, nëse jo thjeshtë e menaxhuar: se si të drejtohet dhe rregullohet rritja e sektorit privat në mënyrë që të mbledh shumë të mira potenciale të zhvillimit njerëzor, përderisa shmang të metat më të dukshme. Një sektor privat i fuqishëm dhe i përgjegjshëm paraqet më shumë dobi për vendin sesa krijimi i pasurisë për individët apo edhe shtetin. Ai ofron një linjë të duhur të të mirave direkte dhe jo-direkte tek shtetet me

Barazia	Produktiviteti	Qëndrueshmëria	Fuqizimi
- Mundësi të ardhurash për të varfërit - Bashkëpunimi social i vetqëndrueshëm - Nivelimi i gjinive, etnicitetit dhe aspekteve tjera - Mundësimi i rishpërndarjes gjithpërfshirëse të të ardhurave shtetërore - Pritëriteti me sektorin publik për shërbime më të gjëra dhe më të mira	- Ofrimi i dinjitetit përmes punës së denjë - Rritja e të ardhurave të komunitetit dhe shtetit - Promovimi i inovacionit dhe eksplorimit	- Promovimi i shfrytëzimit të mençur të burimeve njerëzore - Krijimi i vendeve të "gjelbërta" të punës - Kërkimi i teknologjive të ardhshme për efektshmëri të energjisë - Ofrimi i burimeve shtesë i investimeve dhe ekspertizës për mbrojtje mjedisore	- Promovimi i fuqisë vepruese të individit - Zgjerimi i mundësive dhe përvojave për më të përjashtuarit - gratë, minoritetet dhe të personave me aftësi të kufizuar. - Rritja e mundësive për aktivizim në mesin e të papërfqësuarve - Përforsimi i lidhjes ndërmjet të mësuarit, kapitalit njerëzor dhe mirëqenjes njerëzore.

sfida në lidhje me zhvillimin njerëzor të barabartë.

Të mirat direkte të një sektori privat në lulëzim përfshijnë:

- **Krijimin e pasurisë përmes fitimit dhe punësimit:** zhvillimi i sektorit privat gjeneron pasuri për pronarët e bizneseve dhe krijon vende pune. Si pasojë, sektori privat ngrit nivelet e të ardhurave për ekonomitë familjare, përfshirë ato me të ardhura të ulëta. Përmes kësaj, individët fitojnë më shumë aftësi dhe kanë më shumë të ardhura në dispozicion sesa pa të, dhe mund të sigurojnë një standard më të mirë të jetesës e që më pas transmetohet tek familja dhe komuniteti.¹⁴ Me sektorin publik që nuk mund të shtrihet më tutje për të akomoduar 36,000 njerëz të rinj të llogaritur që futen si fuqi punëtore çdo vit¹⁵, sektori privat është shpresa më e mirë e Kosovës për krijimin e punës së denjë në shkallë të gjërë;
- **Stimulimi i ndërmarrjeve në mesin e komuniteteve të përjashtuara:**

një sektor privat në rritje mund të krijojë më shumë mundësi për aktivitete biznesi në mesin e të varfërve (e cila në shumë shtete në zhvillim përfshin në masë të madhe aktivitete joformale dhe të parregulluara dhe përmban ofruesë të shkallës së vogël, fermerë dhe të vetë-punësuar). Kjo ndërlidh komunitete të përjashtuara dhe të varfëra me tregjet e përgjithshme, duke krijuar hapësira të reja për rritje dhe potencial për produktivitet më të madh dhe kthim për mallrat e shitura. Gjithashtu, ndjeshëm i shtohet dinjiteti njerëzor në disa nga segmentet e shoqërisë më të privuara nga të drejtat, kur komunitetet bëhen të afta që të organizojnë, financojnë dhe menaxhojnë bizneset e tyre të veta, duke përhapur shembullin e mundësisë dhe të mirave të punësimit në tërë komunitetin e tyre. Me papunësinë më të madhe në Kosovë në periudhë afatgjatë, dhe një përhapje të lartë të varshmërisë në remitanca dhe të jetuarit nga feramat, stimulimi i ndërmarrjeve mund të jetë

qendror ndaj zvogëlimit të varfërisë - veçanërisht për ata që jetojnë në apo afër vijës së varfërisë;

- **Konkurrenca që ndikon çmimin dhe cilësinë e mallrave dhe shërbimeve:** konkurrenca natyrale e ekonomisë së tregut të lirë mund, në një sistem mirë të rregulluar, të ul çmimet apo të shtyjë përpara cilësinë në mënyrë që të tërheq konsumatorët. Për njerëzit më të varfër, kjo do të thotë mallra dhe shërbime më të lira në komunitetet e tyre e gjithashtu edhe një gamë më e madhe zgjidhjesh. Liria për të zgjeruar zgjidhjet është shtyllë fundamentale e zhvillimi njerëzor, dhe, në kontekstin e përforsimit të sektorit publik, bizneset private gjithashtu kanë një rol në zgjerimin e zgjidhjeve rreth gjerave esencialeve siç janë shërbimet shëndetësore, ujë dhe shërbime për arsimim, me potencialin për të përmirësuar standardet e të jetuarit.¹⁶ Kjo është një çështje veçanërisht e ndjeshme në Kosovë, ku kujdesi shëndetësor është i ofruar në mënyrë private pa ndonjë instrument në dispozicion për sigurimin mbulues të orientuar nga klienti, për zvogëlimin e tro-nditjeve financiare kur ekonomitë e varfëra familjare hasin në kosto të larta përtej xhepit të tyre për kujdesin shëndetësor. Se a duhet që një sistem i tillë të paraqitet në Kosovë, përvoja gjetiu ka treguar se shfrytëzuesit janë të fuqizuar të kërkojnë shërbime të cilësisë së lartë nga ofruesit e kujdesit shëndetësor;
- **Inovacioni për teknologjitë sociale dhe mjedisin:** kërkimi për fitim i shtyen bizneset të investojnë në një gamë të gjërë të produkteve dhe në tregje të reja. Një investim i tillë vetë-gjenerues dhe eksplorimi janë zakonisht burimi parësor i inovacionit brenda ekonomive sociale shtetërore. Inovacionet e sektorit

privat nuk mund vetëm të forcojnë themelin e ekonomisë, mirëpo edhe të transformojnë qasjen me bazë të drejtë të qeverisjes. Në kontekstin e zhvillimit dhe tranzicionit, sektori privat është gjithashtu çelës për kërkimin dhe përshtatjen e teknologjive të reja nga jashtë në kontekstin lokal, dhe përdorimi i tyre në partneritet me sektorin publik për promovimin e efikasitetit të qeverisjes. Në kontekstet tjera, partneritete të tilla të bazuara në inovacion kanë lehtësuar sëmundje, kanë hapur dyer për arsimim dhe njohuri në mesin e popullatës së përjashtuar apo atyre që jetojnë në largësi, kanë shpikur zgjidhje ndaj problemeve të ndotjes dhe degradimit mjedisor dhe j'u kanë ofruar qeverive teknika të reja për mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave thelbësore të popullatës. Në Kosovë, sektori privat ka kapacitet unik që të udhëheq adoptimin dhe integrimin e teknologjive të reja në komunitete, me potencialin për të nxitur lidhje të forta ndër-sociale në një shoqëri historikisht të thyer;

- **Përgjegjësia Sociale e Korporatës:** rreshtimi ndërmjet interesave sociale dhe komerciale zbatohet gjithnjë e më shumë në sektorin privat si instrument për të rritur kontributin ndaj zhvillimit të qëndrueshëm dhe lehtësimit të varfërisë. Zhvillimi i kompanisë tërheq vëmendjen, jo vetëm për vlerën ekonomike që sjell, mirëpo edhe për shtimin e vlerës mjedisore dhe sociale. Përgjegjësia Sociale e Korporatës (PSK) mbërthen vlerat, çështjet dhe proceset të cilat kompanitë duhet të adresojnë për zvogëlimin e çfarëdo dëmtimi nga aktivitetet e tyre dhe të krijojnë vlera ekonomike, sociale dhe mjedisore. Menaxherët e sektorit privat janë

gjithashtu duke i kushtuar gjithnjë e më shumë vëmendje PSK-së, pasi që munden, në mënyrë direkte, të afektojnë – si në afat të shkurtër gjithashtu edhe në atë të gjatë – reputacionin e kompanisë dhe, në shkëmbim, fitimet e kompanisë. Kompanitë e zotuarra për PSK shqyrtojnë ndikimet pozitive dhe negative të aktiviteteve të tyre biznesore dhe përfshijnë çështje sociale (p.sh. standardet kryesore të punës), çështje mjedisore (p.sh. menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore siç janë pylli, peshkimi, mineralet), çështje të shëndetit dhe sigurisë si dhe çështje të korrupsionit në zotimet e tyre të korporatës.¹⁷ PSK poashtu inkurajon bashkëveprimin ndërmjet bizneseve dhe komuniteteve në të cilat operojnë - duke promovuar një cikël pozitiv të të mirave të zhvillimit në terren dhe të kulturës biznesore me përgjegjësi sociale.¹⁸ PSK-ja është në fillet e saj në Kosovë, e cila ende vuan nga një barrë e vështirë e ndihmës duke dobësuar vullnetin e lindur të banorëve për të përkrahur shoqëritë e tyre. Mungesa e ndërmarrjeve kuptimplote të shkallës së mesme, poashtu sfidon bizneset e vogla që t'i qasen PSK-së në mënyrë sistematike, duke shikuar përtej grupit apo familjes direkte. Megjithatë, nëse Kosova lëviz drejt rifo-rcimit të ndërmarrjeve të saj, në veçanti të pasurisë së saj minerale, PSK-ja duhet dhe mundet të luaj një rol të madh në mjedisin e saj të ardhshëm biznesor;

Të mirat indirekte të sektorit privat lulëzues përfshijnë:

- **Kapacitetin e rishpërndarjes së të ardhurave:** sektori privat është burimi kryesor i instrumentëve për rishpërndarjen e të ardhurave, drejt një gjithëpërfshirjeje më

të madhe dhe barazisë. Përmes tatimit, gjeneron të ardhura për të financuar shpenzime esenciale publike për shërbime thelbësore dhe mbrojtje sociale.

- **Përmirësimet e “ciklit virtuoz” në sistemet e arsimimit:** perspektiva e bazuar në meritë, punë të denjë profesionale përforcojnë zotimin social ndaj arsimimit. Derisa jo gjithmonë puna e denjë ofrohet në sektorin privat, padyshim që ofron paga nxitëse më të rrjedhshme, fleksibile dhe shpërblyese për të aftët e sapohyrë në fuqinë punëtore. Në shoqërinë në rritje, të rinjtë të cilët janë të kualifikuar në mënyrë akademike apo profesionale duhet të jenë në pozitë të zgjedhin ndërmjet mundësive të punësimit publik apo privat. Pasi që ekziston një ndërlidhje ndërmjet edukimit të ngritur dhe nivelit të të ardhurave, pjesëmarrja më e madhe në edukim, në shkëmbim, shpie në standarde më të mira të jetesës dhe zhvillimit njerëzor.¹⁹ Studentët kosovarë mentalisht janë të dekurajuar thellësisht rreth perspektivave të tyre të punësimit, dhe shkallës me të cilën shkolla i përgatit ata për botën e punës përtej sektorit publik tashmë të tejmbushur. Sektori i lulëzuar privat do të ishte një shtysë e jashtëzakonshme për të përmirësuar cilësinë dhe rëndësinë në të mësuarit sekondar dhe të lartë;
- **Partneriteti Publiko-Privat:** aty ku të ardhurat e qeverisë dhe arritja është e kufizuar, sektori privat ka një rol të luaj në partneritet, për efektshmëri të ngritur të shërbimeve esenciale dhe të mallrave tjera publike (siç janë monitorimi dhe vlerësimi për të promovuar qeverisje të bazuar në të drejta). Sektori privat shpesh

ofron transportim, komunikim, teknologji, teknologji informative, mbështetje për burimet njerëzore dhe shërbime tjera për përforsimin e administrimit mbi ofrimin e shërbimeve në nivel lokal dhe nacional. Në këtë mënyrë, sektori privat përkrah si performancën e qeverisë poashtu edhe përpjekjen për të ndërtuar kapital njerëzor përmes shëndetësisë më të mirë, mbrojtjes dhe shërbimeve të arsimit. Pjesëmarrja e sektorit privat në arsimimin sekondar dhe të lartë është e dukshme në veçanti në nivel të komunitetit. Është ngritur gjatë dy dekadave të fundit, dhe tani i shërben një pjese të madhe të tregut të synuar – përfshirë në Kosovë, ku universitetet private shihen si rrugët më të zbatueshme për një titull/shkallë të vlefshme universitare. Kosova poashtu është duke eksploruar se si sektori privat mund të kapërcej boshllëqet e të dhënave të saj të zhvillimit, duke përdorur teknologji informative të menaxhuar privatisht për të mbledhur dhe analizuar të dhëna kritike për popullatën;

- **Kohezion i përforsuar social:** sektori privat ka një rrjedhshmeri unike, e cila sjell njerëzitë nga etnicitetet e ndryshme, religjione dhe gjini së bashku në bashkëveprim të përditshëm drejtuar nga interesat vetjake. Në shoqëritë e enklavizuara siç është Kosova, është një potencial i konsiderueshëm për njerëzit që përmes ndërmarrjes të menaxhojnë atë çka nuk mund t'a bëjnë përmes politikës - bashkë-ekzistimit paqësor dhe me prosperitet të dyanshëm. Prezenca e grave, njerëzve me aftësi të kufizuara dhe grupeve shumëetnike në kompanitë pri-

vate shërben si barometër për gjithëpërfshirje sociale. Derisa punësimi në sektorin publik mund të jetë i obliguar që t'i mbush kuotat për grupet në nevojë dhe ato të përjashtuara, ndërmarrjet private nuk kanë kufizim të tillë. Shumë grana në Kosovë, për shembull, ende e shohin ndërmarrjen private si të ndishme dhe si një vijë të "papërshtatshme" të punës - duke kërkuar vetëm punësim në sektorin publik ose asnjë fare. Kjo reflekton, deri në një shkallë, pozitën e gruas në komunitetin më të varfër në Kosovë, ku nuk shihet si e përshtatshme për gruan të konkurrojë me mashkullin në biznes mbi baza private. Drejtësia më e madhe gjinore në ndërmarrjet private mund kështu të shihet si mjet dhe si fund për vendosjen e drejtësisë gjinore në shoqëri;

Pavarësisht nga kontributet pozitive të lartëpërmendura, shumë shtete në zhvillim dhe tranzicion nuk janë në gjendje të shtien në dorë të mirat e sektorit privat në masë të plotë. Ekzistojnë të meta të shumta për një sektor privat efektiv dhe të përgjegjshëm në kontekstet e tranzicionit siç është Kosova. Këto përfshijnë:

- **Mjedis i dobët rregullator dhe operues:** kontekstet zhvillimore shpesh kanë mungesë të bazave të duhura për aktivitet të sektorit privat. Këto përfshijnë kornizë transparente dhe legjislative sistematike të zbatuar për ligjin komercial, dogana, prona dhe kontrata. Rregullat e parashikueshme me administrim të drejtë dhe zbatues, të përkrahura me mekanizma për zgjidhjen efikase të mosmarrëveshjeve, janë thelbësore për ndërmarrësit që të angazhohen në aranzhime afatgjate që i'u mundëson atyre të investojnë dhe të zhvillohen proporcionalisht, të

inovojnë dhe shpërndajnë njohuritë dhe të mirat e tyre. Rregullat jo-të drejta, korrupsioni, zbatimi arbitrar, kërkesat tjera të vështira dhe praktikat joefikase e kufizojnë ndërmarrjen private. Përveç kësaj, ndërmarrjet private kërkojnë një politikë stabile dhe mjedis institucional e cila krijon dhe mban "rregullat" e tregut, infrastrukturë efikase fizike (elektricitet, rrugë dhe telekomunikim) dhe infrastrukturë adekuate të tregut dhe shërbimeve. Megjithatë, në Kosovë si në shumë kontekste zhvillimore, "rregullat e operimit të tregut", përfshirë rregullat e hyrjes, operimit dhe rregullat e daljes, janë të rënda, përderisa institucionet e nevojshme juridike dhe rregullative funksionojnë në mënyrë të parregullt. Shumë shtete në zhvillim dhe në fazën tranzicionale kanë kërkesa të tepërta procedurale

për procedurat e regjistrimit të biznesit dhe licensimit, rregulla të ndërlikuara të punës si dhe taksave dhe rregullave jo-adekuate të falimentimit, të cilat krijojnë pengesa shtesë për aktivitetin e sektorit privat, duke kufizuar qasjen konkurruese në mundësitë e tregut dhe duke ngritur koston e hyrjes në sektorin formal. Ndërkohë, institucionet mund të mos jenë në pozitën për të përkrahur rregullat për shkak të kufizimeve të kapaciteteve apo për shkak se ato nuk ofrojnë paga të duhura nxitëse për zyrtarët qeveritarë, e cila përkundrazi dërgon në zbatim të dobët dhe shpesh arbitrar si dhe korrupsion. Të varfërit me gjasë do jenë viktimat e para të sektorit privat të parregulluar dhe të "pakontrollueshëm/pa ligje", e cila mund të ofrojë vende pune por jo punë të denjë (e cila sqaron

Kur një treg është konkurrues, firma të reja futen në të, ato më efektive kanë sukses, firmat nën-standarde dështojnë dhe dalin nga tregu. Studimet tregojnë se ekziston një ndërlidhje e fortë ndërmjet politikave efektive të konkurrencës dhe rritjes (OECD 2006). Në një treg konkurrues, firmat duhet të gjejnë mënyra inovative që të prodhojnë dhe shpërndajnë produktet dhe shërbimet e tyre në mënyrë që të arrijnë synimin në mënyrë më efikase. Efektet e konkurrencës së lulëzuar mbi zhvillimin njerëzor rrjedhin nga çmimet e ulëta, variacioneve në zgjidhje dhe cilësisë së përmirësuar. Përveç kësaj, tregjet konkurruese krijojnë mundësi punësimi dhe ngrisin pagat nxitëse për iniciativat ndërmarrëse. Nëse firmat arrijnë konkurrim të lartë në tregjet e tyre të vendit, atëherë ato mund të fillojnë të konkurrojnë ndërkombëtarisht, çka shton jo vetëm fitimet e kompanisë, por, gjithashtu edhe mirëqenien e të punësuarve dhe, në përgjithësi, të vendit. Fermerët përfitojnë nga tregjet konkurruese, dhe bujqësia është shumë e rëndësishme për lehtësimin e varfërisë. Statistikat tregojnë që 75 përqind të njerëzve që jetojnë në zonat rurale në më pak se 1\$ në ditë varen shumë në prodhimet bujqësore që prodhojnë ata vetë. Tregjet konkurruese i'u ofrojnë atyre një pozitë më të favorshme duke blerë inpute/të hyra, me arranzhimin e transportit të kulturave bujqësore dhe shitjen e produkteve finale, përfshirë edhe përpunimin me vlerë të shtuar (Komisioni mbi Zhvillimin Njerëzor 2004).

pjesërisht se pse një pjesë e madhe e të varfërve në Kosovë janë të punësuar).

- ***Theksi në rritjen e jashtëzakonshme:***

në mjediset ku ndërmarrja private është kryesisht joformale dhe lehtësisht e dominuar nga interesat e fuqishme speciale, dhe shpesh si rezultat është rritja përjashtuese sesa rritja gjithëpërfshirëse. Thënë thjeshtë, të pasurit më shumë bëhen të pasur dhe të varfërit bëhen më të izoluar. Një mbi-fokus në fundlinjë të GDP-së dhe promovimi i rritjes makro-ekonomike (ve-çanërisht kur vendi ka asete komoditeti siç janë nafta/vaji dhe mineralet, në rastin e Kosovës) do të thotë krijimi i pasurisë mund t'i huq ata të cilët kanë nevojë më së shumti. Vende pune janë të krijuara pa menduar se për ku janë duke u krijuar, për kënd kanë qasje dhe se a janë efektive për të ngritur të varfërin nga varfëria. Një balancë gjithëpërfshirëse makro-mikro ekonomike jo-miqësore është më e mundshme aty ku ndërmarrësit lokalë, përfshirë ata me të ardhura të kufizuara, të cilët përpjekjen me qasje të kufizuar për burime produktive, p.sh. shkathtësi dhe kapitali e cila në shkëmbim afekton aftësitë e tyre që të ngrisin suksesshëm biznesin. Përveç kësaj, ndërmarrjet e mëdha në pushtet, në vendet në zhvillim, shpeshherë i zënë frymën energjisë dhe iniciativës ndërmarrëse, duke përfituar nga mjediset e dobëta institucionale në ngritjen e barrierave kundër-konkurruese dhe duke mbrojtur pozitën e tyre dominuese. Rreziqe të larta të sho-qëruara, posaqërisht me mikro ndërmarrjet, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, qoftë e vërtetë apo e përceptuar, kufizon rritjen e qasjes në financa. Bankat në këto

vende përballen me mbrojtje të kufizuar në rast të vonesës dhe kanë kosto të lartë, apo nuk mund të marrin informata te besushme, veçanërisht pasi që shumë shteteve iu mungojnë rregullat për shkëmbimin e informacioneve të depozitës bankare/kreditit. Këta faktorë zakonisht krijojnë shkallë të larta interesi dhe zvogëlojnë vëllimet e huadhënies, duke vendosur barriera qoftë në çmim apo edhe sasi ndaj zhvillimit të ndërmarrjes. Atyku bizneset formale janë shumë të ndërlikuara apo të kushtueshme për t'u themeluar, rritet një ekonomi joformale në atë vend – duke krijuar edhe më tutje fushë të pabarabartë të lojës për biznese dhe duke iu ofruar zgjidhje me afat të kufizuar për reduktim të varfërisë. Produktiviteti i punës tenton të jetë më i ulët në sektorin joformal, përderisa të drejtat dhe mbrojtjet e punëtorit qëndrojnë dobët kur krahasohen me ato në sektorin formal. Poashtu, si rezultat i jo-formalitetit konsumatorëve iu mohohen garancionet e produktit dhe shpesh nuk kanë alternativa për blerje të mallrave të cilësisë jo të përshtatshme dhe standardeve të sigurisë. Më tej, shumica e ndërmarrjeve të reja në shtetet në zhvillim janë të krijuara thjeshtë për arsye se individët nuk mund të gjejnë punësim në sektorët formalë dhe vendosin të provojnë zotësinë e tyre si ndërmarrës. Ndërmarrjeve të tilla startuese në shumicën e rasteve iu mungon kapitali i konsiderueshëm fillestar dhe aftësitë e mjaftueshme për menaxhimin e biznesit si dhe të njohurive praktike teknike. Prandaj, ndërmarrje të tilla janë në gjendje të përparojnë vetëm në fushat e biznesit të cilat nuk

paraqesin kapital të lartë (startues dhe operacional) dhe pa barrierë të njohurive praktike teknike. Këto përfshijnë, për pjesën më të madhe, vlerë të ulët të shtuar dhe shpesh mallra dhe shërbime me cilësi të ulët. Për shkak të barrierave të ulta për hyrje në biznes, fusha të tilla të biznesit tërheqin fillestarë të shumtë të biznesit, duke krijuar situata të mbifurnizimit të përherëshëm. Si pasojë, margjinat e fitimit për këto ndërmarrje në Kosovë, e poashtu edhe të ardhurat e tyre dhe potenciali investiv mbesin të ulëta;

- **Implikimet mjedisore:** kur fitimi është prioritet mbi përgjegjësinë sociale, industria private është njëra nga faktorët më të këqinj në mbarë botën në shfrytëzimin e paqëndrueshëm të burimeve natyrore dhe dëmtimeve të vijueshme për mjedisin. Kosova tashmë e bart një trashëgimi të rëndë të ndotjes dhe shkatërrimit të mjedisit nga ditët e saj si zemra shtetërore e Jugosllavisë që drejton industrinë e rëndë. Përderisa shumica e fabrikave të saj bujqësore dhe industriale tani mbesin të përgjumura, mbetet pyetja se si të menaxhohen burimet e saj për gjenerimin e energjisë për shtëpi dhe tregti jashtë shtetit. Qymyri i kaftë dhe plumbi në minierat e Trepçës janë ende duke pritur për nxjerrje nga ndërmarrjet e reja të privatizuara. Bizneset e vogla të Kosovës janë poashtu duke dëmtuar pyjet e saj përmes prerjes së drunjëve, mbushjen e ujërave të saj me plehra dhe duke kontribuar në shkarkimin e mbeturinave kudo në zonat publike. Pajtueshmëria me ligjet për të zbutur dëmtimet mjedisore shihet të jetë e kush-tuëshme dhe e pazbatueshme - me

implikime të mëdha për standardet e jetesës në Kosovë në të ardhmen.

Si përfundim, roli i sektorit privat në zhvillimin njerëzor është shumë i rëndësishëm, në përgjithësi dhe veçanërisht thelbësor ndaj sfidave unike të Kosovës. Sektori privat është shtylla kryesore për tejkalimin e varfërisë duke ofruar rritje, inkurajuar iniciativa ndërmarrësie dhe duke krijuar vende pune dhe jetesa të qëndrueshme. Përveç kësaj, sektori privat mund të ngris efikasitetin e shërbimeve bazike, që fuqizon të varfërin duke përmirësuar infrastrukturën për dhe ofrimin e sistemeve shëndetësore dhe edukative. Në sektorin e zhvilluar privat, konkurrenca e drejtë lulëzon dhe efektet e saj mbi zhvillimin njerëzor paraqiten përmes çmimeve të ulëta, llojshmërisë së zgjidhjeve, çasjes më të lehtë dhe cilësisë së përmirësuar të mallrave dhe shërbimeve. Për më tepër, tejkalimi i barrierave që parandalon sektorin privat nga zgjerimi – apo që inkurajon të zgjerohet në drejtime të papërgjegjshme sociale – kërkon një përgjigje të menduar mirë dhe komplekse duke angazhuar qeverinë, bizneset dhe komunitetet në mënyrë të njëllojtë.

“Shtrirja e GNP-së (është) një mjet esencial për zgjerimin e shumë opsioneve njerëzore. Mirëpo, natyra dhe shpërndarja e rritjes ekonomike janë të matura përkundrejt një standardi matës për përmirësimin e jetëve të njerëzve”.

Mahbub Ul-Haq
(themeluesi i Raportit të
Zhvillimit Njerëzor, UNDP)

0.4 Drejt një partneriteti me përfitim të dyanshëm ndermjet sektorit privat dhe zhvillimit njerëzor në Kosovë

Ky raport fokusohet në lidhjen ndër-mjet zhvillimit të sektorit privat dhe punësimit si mënyrë e nxitjes së zhvillimit njerëzor në Kosovë. I qaset qëllimit të rritjes nga perspektiva e gjithëpërfshirjes duke besuar që kër-kesat e ngritura të punës të gjene-ruara nga rritja e sektorit privat, do të thotë që një pjesë më e madhe e popullatës aktive mund të gëzojnë më shumë të ardhura, ky është gurthemeli dhe dalja më e mirë jashtë varfërisë. Ndërmarrjet individuale dhe puna e denjë janë poashtu të eksploruara më shumë se gjeneratorët e të ardhurave. Ato janë fundamentale për dinjitetin njerëzor, një faktor qendror përbrenda kohezionit social dhe i lidhur me njohurinë, mirëqenien dhe mundësitë e jetës për gjeneratat e ardhshme.

Raporti është i organizuar në katër kapituj. Kapitulli i parë shikon në strukturën e sektorit privat dhe tregut të punës në Kosovë, përmes këndvështrimit të paanshmërisë. Kapitulli dy identifikon barrierat ndaj zhvillimit të sektorit privat nga perspektiva e rritjes gjithëpërfshirëse - duke eksploruar sesi faktorët strukturor, sektorial dhe socio-kulturor prekin aftësinë e sektorit publik për të ofruar përfitime të zhvillimit njerëzor. Kapitulli tre eksploron se si këto barriera prekin bizneset dhe komunitetet përreth tyre. Kapitulli katër fokusohet mbi sektorin privat brenda kontekstit social të Kosovës, dhe potencialit për një marrëdhënie më inovative, dinamike ndërmjet sektorit privat dhe potencialit njerëzor. Kapitulli i fundit jep përfundimet dhe ofron rekomandimet e politikës së veprimit për vitet e ardhshme kritike të Kosovës.

Analiza e tregut përmes këndvështrimit të paanshëm

“Paradigma e zhvillimit njerëzor ofron një shërbim të rëndësishëm dhe vë në pyetje lidhjen automatike mes rritjes së të ardhurave dhe zgjerimit të zgjidhjeve njerëzore”

Mahbub Ul-Haq (themeluesi i Raportit të Zhvillimit Njerëzor, UNDP)

1.1 Profili i tregut të Kosovës

Kosova është njëra ndër vendet e fundit në Evropë që ka kalur në ekonominë e tregut. Procesi i tranzicionit ka filluar nga një pikë startuese shumë e vështirë. Kosova ka një histori të gjatë të dominimit shtetëror të sistemeve ekonomike dhe financiare, gjë që solli deri tek një shkallë, vëllim dhe përvojë e kufizuar të ekonomisë private. Gjatë të nëntëdhjetave, ekonomia tanimë kishte pësuar vite të tëra të politikave të dobëta, mungesë të institucioneve vendore, lidhje të shkëputura të tregtisë së jashtme dhe atyre financiare, sanksione ndërkombëtare, mungesë të investimeve dhe ç’industrializimit. Pas 1999, përmes përpjekjeve të përbashkëta me komunitetin ndërkombëtar, janë arritur përmirësime të rëndësishme në aspektin e rindërtimit të paskonfliktit dhe krijimit të institucioneve të reja.

Pas përfundimit të konfliktit, rritja ekonomike kishte arritur numër dyshifror, kryesisht e drejtuar nga ndihmat ndërkombëtare. Megjithatë, kurri industrial i Kosovës ishte thyer. Shumë Ndërmarrje Shoqërore Publike (NSHP)²⁰ dolën nga biznesi atëherë kur iu ekspozuan kufizimeve të mëdha të buxhetit dhe konkurrencës. Të tjerat u reduktuan, duke zvogëluar rezervat dhe numrin e punëtorëve në mënyrë që të arrijnë një madhësi ekonomikisht

efikase. Që nga 2005, shkallët e rritjes, edhe pse të qëndrueshme, u bënë të ngadalta, me një mesatare rreth katër përqind në vitet pasuese.²¹ Kjo shkallë e rritjes varej në masë të madhe nga konsumi dhe shpenzimet publike të nxitura nga ndihmat e huaja (kjo e fundit posaqërisht në vitet e para të paskonfliktit) dhe remitancat. Ndërkohë, investimet, pavarësisht nga rritja e vazhdueshme, konsiderohen si të pamjaftueshme për të rritur prodhimin vendor. Ky model i rritjes nuk ka qenë në gjendje të përmbush nevojat e zhvillimit të shtetit dhe dështoi të zbërthehet në standard më të mirë të jetesës për qytetarët duke pas parasysh se as papunësia apo varfëria nuk janë ulur.²²

Tani, GDP-ja e Kosovës qëndron në rreth 4.7 miliardë EURO, pak më shumë se 2,000 EURO të ardhura për frymë banori (FMN 2011), gjysma e asaj të Bosnjës dhe Hercegovinës (BH), rreth një e treta e asaj të Maqedonisë dhe Shqipërisë dhe rreth një e katërta e asaj të Serbisë. Kriza globale dhe financiare ka ndikuar relativisht pak në ekonominë e Kosovës, që pasqyron nivelin e kufizuar të integritit në ekonomi më të mëdha. Kriza është ndjerë butë, përmes eksportit të ulur,²³ investimeve të huaja dhe remitancave, përderisa vendet tjera në rajon ishin shumë më të prekura. Sidoqoftë, Kosova ka nevojë të përshpejtojë në mënyrë të konsiderueshme rritjen e

Problemi kryesor i ekonomisë së Kosovës vazhdon të jetë mbështetja në burime të paqëndrueshme të rritjes

saj për të arritur nivelet rajonale në të ardhura. Sipas llogaritjeve të Bankës Botërore, në vitin 2010, ekonomia e Kosovës do duhej të kishte rritje prej 10 përqind në vit për një dekadë në mënyrë që të arrijë nivelin e të ardhurave të Shqipërisë (duke pretenduar që ekonomia e Shqipërisë vazhdon me rritje prej 5.5 përqind në baza vjetore gjatë kësaj periudhe). Kurse, për të arritur nivelin aktual të GDP-së për kokë banori të Malit të Zi prej 5700 EURO, ekonomia e Kosovës do duhej të rritej në 12 përqind për vit për një dekadë të tërë.

Inflacioni, i cili është mbajtur nën kontroll për një kohë të gjatë, kohët e fundit është kthyer dhe rritur deri në 8 përqind,²⁴ i nxitur nga rritja e çmimeve të ushqimit dhe energjisë, që janë kryesisht mallra të importuara. Bilanci i tregtisë së jashtme të Kosovës vazhdon të jetë dukshëm negativ, me deficit të llogarisë aktuale që arrin më shumë se 15 përqind të GDP-së, edhe pas të hyrave të mëdha të remitancave (e cila llogaritet për rreth 12 përqind të GDP-së) dhe ndihmës së huaj (9 përqind). Taksat e importit ende përbëjnë një sasi joproporcionale të GDP-së së Kosovës. Eksportet e mallrave mbulojnë vetëm rreth 14 përqind të importeve. Sipas Doganave të Kosovës, shifra totale e shënuar për eksporte në 2010-tën ishte rreth 293 milion EURO, 90 përqind nga e cila është regjistruar në tregjet e BE-së. Ndërkohë, importet e Kosovës me afërsisht 2.14 miliard EURO kanë origjinën kryesisht në tregjet Maqedone, Serbe dhe Gjermane.

Kosova ka arritur një progres të mirë në krijimin dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve tregtare. Administrata Tatimore dhe autoritetet doganore operojnë me sisteme të arsyeshme. Ngarkesat tatimore për kompanitë janë relativisht të ulta. Një kornizë ligjore, në përgjithësi e mirë është adoptuar (megjithëse me monitorim

të pamjaftueshëm dhe mbikëqyrje në implementim), dhe është krijuar një sektor relativisht dinamik bankar. Sistemet politike janë poashtu, në përgjithësi, të favorshme për ndërmarrjet private. Në nivel politik, Freedom House (Një OJQ me bazë në SHBA që kryen hulumtime dhe avokim/mbrojtje në demokraci, liri politike dhe të drejta njerëzore) e ka vlerësuar Kosovën si vend pjesërisht të lirë, duke e rreshtuar përkrah shumicës së vendeve në rajon. Ngjajshëm, Kosova renditet afër me fqinjët e saj në aspektin e zhvillimit institucional dhe qeverisjes, dhe i është dhënë renditje e ngjajshme bazuar në indikatorët e qeverisjes nga Banka Botërore.²⁵

Megjithatë, probleme tjera serioze janë adresuar në mënyrë joadekuate dhe vazhdojnë të kufizojnë rritjen dhe krijimin e vendeve të punës. Në aspektin e mjedisit biznesor, Banka Botërore (2011) rendit Kosovën në vendin e 119 nga 183 vende, një nivel që është i pafavorshëm dhe paraqet një pengesë për bizneset vendore dhe dekurajon investorët e huaj. Niveli i ulët i krijimit të vendeve të punës dhe mungesa e mundësive rrisin hendekun e të ardhurave, dhe nivelet e papunësisë janë të larta, veçanërisht në mesin e të rinjve, krahasuar me rajonin: edhe pse relativisht e qëndrueshme, papunësia e raportuar mbetet në nivel jashtëzakonisht të lartë (e llogaritur në 43 përqind në vitin 2009, pak më poshtë nga 45 përqind në 2006-tën, me 73 përqind të të rinjve të papunë). Edhe pse, punësimi aktual është ndoshta më i lartë sesa të dhënat zyrtare (e cila korrespondon me shkallën e lartë të ekonomisë joformale në Kosovë), këto shifra janë ende alarmante.

Në përgjithësi, problemi kryesor për ekonominë e Kosovës mbetet mbështetja në burimet e paqëndrueshme të rritjes: ndër të tjera, stimulimit të huaj, importit të mallrave

që u shiten të huajve aktualisht me vendqëndrim në Kosovë, remitancat nga jashtë vendit dhe shpenzimet qeveritare. Ndërmarrja e tregut të zi poashtu luan një rol në gjenerimin e të ardhurave në Kosovë – edhe pse ka pak të dhëna mbi ndikimin e saj proporcional. Deri më sot, shitblerja e mallrave the tregtia kanë qenë shumë më të theksuara se sa zhvillimi i kapitalit dhe kapaciteteve njerëzore për të ndërtuar një sektor privat të balancuar dhe të integruar në shoqëri.

1.2 Profili i tregut të punës: qasja dhe trendet e përjashtimit

Cilësia e të dhënave për tregun e punës në Kosovën e pas-konfliktit është e kufizuar, pjesërisht për shkak të mungesës së të dhënave nga regjistrimi i popullsisë dhe kornizës së besueshme të mostrave. Megjithatë, pavarësisht mospërputhjeve në shifra të sakta të gjetura në të dhënat që vijnë nga burime të ndryshme në periudha kohore të ndryshme, ato në mënyrë të njëanshme paraqesin një pamje të zymtë të tregut Kosovar. Ky seksion bazohet në të dhënat sekondare nga agjensionet e ndryshme dhe nga studimet e mëhershme të ndërmarrjeve, në mënyrë që të ofrohet një pasqyrë e këtij tregu të punës. Masat sasiore të punësimit dhe papunësisë si dhe pjesëmarrja e fuqisë punëtore do të diskutohen poashtu, përkrah karakteristikave demografike dhe socio-ekonomike të kategorive të ndryshme të tregut të punës (jo-pjesëmarrësit, ku është e mundshme), dhe dimensionet “cilësore” të punësimit në aspektin e kushteve të punës dhe mbrojtjes sociale. Së fundi, ky seksion do të nxjerr në pah

çdo diferencë gjinore apo etnike që mund të jenë prezente për sa i përket rezultateve të lartëpërmendura të tregut të punës.

Dy burimet kryesore mbi të dhënat e punësimit në Kosovë janë Studimet e Fuqisë Punëtore (SFP) të bëra nga Agjencia e statistikave të Kosovës (ASK) dhe Raportet Vjetore mbi Punën dhe Punësimin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Të dhënat SFP janë ndoshta më të besueshme, sepse ato përfshijnë punësimin e peregjistruar e poashtu edhe atë të regjistruar (në krahasim me Raportin e Punës dhe Punësimit, MPMS 2010).²⁶

Të dhënat sugjerojnë që **shkalla e papunësisë për meshkuj dhe femra** në Kosovë në vitet e fundit është luhatur ndërmjet një përqindje alarmante prej 40-50. Kjo është disa herë më e lartë se çdo shifër tjetër e përfytyrueshme në një ekonomi të zhvilluar, mirëpo poashtu edhe ndjeshëm më e lartë se sa ato në ekonomitë në tranzicion të Evropës Juglindore (EJ) me shkallët më të larta të papunësisë të regjistruara në të njëjtin vit (Maqedoni 34 përqind, Bosnjë dhe Hercegovinë 23 përqind, Mali i Zi 17 përqind).²⁷ Ndarja e të dhënave sipas gjinisë zbulon që gratë kanë më shumë gjasa të jenë të papunë: niveli në mesin e grave është 57 përqind, 16 pikë të përqindjes më e lartë sesa shifrat e regjistruara për meshkuj.

“Shumica e vendeve të lira të punës kërkojnë përvojë pune, për të cilat shumica nga ne nuk e kanë. Gjithashtu është vështirë të gjenden pozita si praktikantë që mund të na ndihmojnë të gjejmë punë përfundimisht.”

(Fokus Grupi me Rininë)

	Shkalla e papunësisë (përqindje)	Shkalla e pjesëmarrjes (përqindje)	Proportioni i Punësimit (përqindje)
Të gjithë	45	48	26
Femra	57	29	12
Meshkuj	41	67	40


Adaptuar nga autorët, bazuar në të dhënat e ASK-së 2009

Niveli i pjesëmarrjes së fuqisë punëtore sipas gjinisë në Kosovë është njësoj dekurajues. Pjesëmarrja e ulët në fuqinë punëtore nënkupton një shkallë të pakënaqësisë me potencialin e tregut të punës. Shumica e atyre që janë të përjashtuar nga fuqia punëtore janë të gatshëm dhe në gjendje të punojnë, mirëpo thjeshtë janë dorëzuar së kërkuari vend pune²⁸. Hendeku i punësimit sipas gjinisë në Kosovë zgjerohet më tutje nëse merren parasysh nivelet e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore. Pjesëmarrja mes meshkujve është më shumë se dyfish se ajo e femrave (67 dhe 29 përqind, respektivisht, krahasuar me një mesatare të BE-së për pjesëmarrjen e gruas

si fuqi punëtore prej 64 përqind). Nga çdo 10 femra të moshës për punë, më pak se tri marrin pjesë në tregun e punës.²⁹ Kombinimi i të dhënave mbi pjesëmarrjen e fuqisë punëtore dhe punësimit jep proporcionin e punësimit për meshkuj e që është më shumë se trefish nga niveli në mesin e femrave (40 dhe 12 përqind, respektivisht). Në përgjithësi, vetëm një në katër individë me moshë të punës në Kosovë janë të punësuar.

Rezultatet e punësimit sipas moshës duken se ndryshojnë në thelb. Sipas ASK-së (2009), shkalla e papunësisë është veçanërisht e lartë në mesin e të rinjve (të moshës 15-24 vjet), në 73 përqind, duke u zvogëluar me rritjen e moshës, duke arritur 42 përqind për grupmoshën 25-54vjet dhe 26 përqind për 55-64 vjet (shiko Ilustrimin 1.1). Megjithatë, ASK-ja (2009) vëren se shifra më e favorshme për grupin e fundit ka gjasa të jetë thjeshtë për shkak të braktisjes së fuqisë punëtore, të pensionimit të hershëm apo apo për arsye se janë të dekurajuar.

Figura 1.1 Shkalla e papunësisë sipas grupmoshës



ASK 2009

"Të gjithë romët kanë vështirësi të gjejnë një vend të punës. Vetëm fakti i të qenurit rom i bënë gjërat të vështira. Në aspektin e punësimit në institucionet publike është vështirë pasi që duhet pasë lidhjet e duhura, të cilat Komuniteti Rom thjeshtë nuk i ka."

(Fokus Grupi me RAE)

Rezultatet e punësimit sipas etnicitetit sugjerojnë që grupe të caktuara janë ose të përjashtuara nga fuqia punëtore ose vendosin të mos marrin pjesë (vetë-përjashtimi – kombinim i vlerave të brendshme kulturore që kërkojnë të ruajnë kufinjtë, dhe perceptimit mbi të qenurit i padëshiruar nga fuqitë e jashtme

dominuuese). Komuniteti RAE është më i pafavorshmi në mesin e grupeve etnike me një proporcion të punësimit që është gjashtë dhe dymbëdhjetë pikë përqindjeje më e ulët se sa te Shqiptarët, përkatësisht Serbët.

Nuk është për t'u habitur, RAE është shumë larg për të gjetur punë sesa çdo grup tjetër etnik.

TABELA


1.2

Proporcioni i punësimit të rinisë sipas etnicitetit

	Proporcioni i Punësimit (%)
Të gjithë	28
K-Shqiptarët	29
K-Serbët	23
RAE	17


Corbanese and Rosas 2007

Figura 1.2 Shkalla e papunësisë sipas përkatësisë etnike



Studimi i Remitençave UNDP 2011


Niveli i arritur i arsimimit duket të jetë fuqimisht i lidhur me pjesëmarrjen si fuqi punëtore dhe rezultatet të punësimit. Individët ekonomikisht joaktiv kanë tendencë t'a kenë të papërfunduar arsimimin e mesëm të lartë (73 përqind nuk e kanë përfunduar dhe 24 përqind e kanë përfunduar). Për më tej, sa më të arsimuar individët gjasat janë më të mira që të jenë të punësuar. Siç shihet në Ilustrimin 1.3, shkalla e punësimit tek ata që e kanë përfunduar arsimimin e lartë është rreth 42 përqind më e lartë sesa për ata që kanë përfunduar jo më shumë se arsimimin e mesëm të lartë, dhe 66 pikë përqindjeje më lartë se sa ata që nuk e kanë përfunduar atë nivel të arsimimit.



ASK 2009

Arritja e edukimit terciar, veçanërisht, duket të jetë e lidhur jo vetëm me performancën e tregut të punës, mirëpo edhe me uljen e hendeqeve gjinore. Ilustrimi 1.4 tregon qartë se si hendeku gjinor prej 19-24 pikë përqindjeje që gjendet në nivelet e

ulëta të edukimit ulët në tetë pikë përqindjeje për individët që kanë përfunduar shkollimin e mesëm. Me pak fjalë, femrat që kanë përfunduar shkollimin e mesëm marrin pjesë dhe garojnë në mënyrë më të barabartë me meshkujt në tregun e punës.



ASK 2009

1.3 Burime të gatshme rritjeje të punës së denjë sipas sektorit


Ku mund të shikojë Kosova për të ndërtuar një kërkesë për punë të denjë? Krijimi i vendeve të punës dhe, në mënyrë specifike, krijimi i vendeve të denja të punës,³⁰ ka mbetur shumë prapa rritjes relativisht stabile ekonomike të paskonfliktit në Kosovë. Përveç kësaj, derisa vendim-marrësit e Kosovës dhe investitorët janë plotësisht të zotuar që të krijojnë vende pune, ata kanë qenë më pak të preokupuar me llojet e vendeve të punës që kanë krijuar, mundësinë e qasjes për të varfërit, potencialin e tyre për të ndërtuar grupe me aftësi dhe përmirsimin e kushteve të tyre të punës dhe mbrojtjes. Një studim i tregut të punës i vitit 2007³¹ ofron të dhëna në dimensionet cilësore të punësimit për rininë, të cilat mund të tregojnë kushtet e tregut të punës si tërësi. Rezultatet sugjerojnë se vetëm një pjesë e vogël e rinisë kanë punë të denjë kur gjykohet drejt masave të tilla si siguria, kushtet e punës dhe mbrojtja. Përafërsisht nga këto punë të denja (96 përqind) janë në sektorin publik.

Ndërkohë, popullata e Kosovës është duke u rritur shpejtë, me një llogaritje prej 25-35 mijë të rinjë që hyjnë në tregun e

punës çdo vit.³² Nëse Kosova dëshiron të ngris kapitalin në pjesëmarrjen e fuqisë punëtore dhe qasjen në treg (p.sh.: më shumë gra, të rinjë dhe minoritete etnike si fuqi punëtore dhe eventualisht si të punësuar), atëherë presionet në tregun e saj ekzistues vetëm do të rriten. Me një sektor publik tashmë të madh dhe joefikas, hyrjet e reja në tregun e punës do të duhet të absorbohen nga sektori privat. Kështu që sektori privat është në qendër të përpjekjes për të stimuluar burimet e gatshme të rritjes për punë të denjë e që promovon dinjitetin dhe jetesën.

Shkallët e punësimit sipas sektorit në Kosovë momentalisht tregojnë një theks të rëndë mbi shërbimet me aftësi të ulëta siç janë tregtia me shumicë dhe pakicë/riparimi i mjeteve të motorizuara dhe motoçikletave (sektori G - 17 përqind të fuqisë punëtore të sektorit privat) dhe sektori të industrisë përpunuese (sektori C - 15 përqind). Sektorët e akomodimit, ndërtimit, ujërave dhe menaxhimit të mbetieve dhe teknologjisë informative, kontribuojnë me vetëm rreth 8-10 përqind mesatarisht. Sektorët me aftësi të larta siç janë shërbimet financiare, aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike dhe shërbimet e edukimit dhe shëndetësisë kontribuojnë mesatarisht rreth 4 përqind për secilin për punësim.

Figura 1.5 Kontributi i sektorëve të ndryshëm në punësim



Administrata Tatimore e Kosovës, Fondi Pensional i Kosovës

Kategoritë e nivelit të lartë brenda sistemit NACE për klasifikimin e aktiviteteve ekonomike në Komunitetin Evropian.

Sektori	Pershkrimi	Sector	Description
A	Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	L	Aktivitetet e paluajtshmërive
B	Miniera dhe gurorë	M	Aktivitete profesionale shkencore dhe teknike
C	Prodhimtaria	N	Aktivitetet administrative dhe shërbyese përkrahëse
D	Furnizimi me rrymë, gas, avull dhe ventilim	O	Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social
E	Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhimi i mbeturinave dhe aktivitetet rregulluese	P	Edukimi
F	Ndërtimi	Q	Shëndeti njerëzor dhe aktivitetet e punës sociale
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve të motorizuara dhe motoçikletave	R	Artet, zbavitjet dhe rekreimi
H	Transportimi dhe deponimi	S	Aktivitetet tjera shërbyese
I	Akomodimi dhe aktivitetet shërbyese të ushqimit	T	Aktivitetet domestike si punëdhënës; mallra të padiferencuara dhe shërbime – që prodhojnë aktivitete për ekonominë familjare për shfrytëzim personal
J	Informacioni dhe komunikimi	U	Aktivitetet e organizatave dhe organeve jashtëterritoriale
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve		


Administrata Tatimore e Kosovës, Fondi Pensional i Kosovës

Shënim: të dhënat nga sektorët që janë kryesisht në pronësinë publike janë përjashtuar

Me sektorët me aftësi të ulët të cilat kontribuojnë në shumicën e vendeve të punës, paga mesatare mujore në sektorin privat në kompanitë kosovare është e ulët, në rreth 260 euro.³³ Ky nivel nuk është shumë i ndryshëm me atë në Shqipëri, mirëpo në mënyrë të konsiderueshme më i ulët sesa vendet

në rajon. Për shembull, paga mesatare në Kosovë është gjysma e asaj në Serbi dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, dhe një e treta e saj në Mal të Zi. Paga mesatare ngritet në ata me kualifikim pasuniversitar (shih Fig. 1.6 dhe 1.7).

Figura 1.6 Pagat mesatare mujore (në EURO) në Ballkan dhe vendet e Evropës qendrore




EuroStat 2010

Përkundër rritjes së përgjithshme të punësimit në Kosovë, **rritja e punësimit sipas sektorit** ndryshon në mënyrë të konsiderueshme. Në vitin 2010, sektori privat ka punësuar 12 përqind më shumë punëtorë me orar të plotë se sa gjatë vitit të shkuar. Sektorët të cilët kanë kontribuar më së shumti në ngritjen e punësimit përfshijnë ndërtimin (31


përqind rritje në punësim), bujqësinë (19 përqind ngritje) dhe sektorët e shërbimit siç janë hotelet, restorantet dhe baret (11 përqind) dhe shërbimet e shëndetësisë (7 përqind). Në anën tjetër, sektori i industrisë përpunuese ka rënë gjatë kësaj periudhe – 2 përqind rënie në numrin e punëtorëve me orar të plotë (shih Fig. 1.8).

Figura 1.7 Paga mesatare sipas nivelit të kualifikimeve akademike



Studimi i Barrierave të Ndërmarrjes Riinvest 2011

Figura 1.8 Rritja e punësimit në firma sipas sektorit



Studimi i Barrierave të Ndërmarrjes Riinvest 2011

Seksionet në vazhdim do të shqyrtojnë më hollësisht, numrin e sektorëve - ilustruar në fig. 1.8 - rritje të konsiderueshme ose rënie në vitet e fundit duke i kushtuar rëndësi të veçantë sektorëve të ndërtimit, bujqësisë dhe prodhimit.

Lulëzimi i **ndërtimit** në Kosovë ka qenë kryesisht për shkak të investimeve të mëdha publike kohëve të fundit dhe fazës së rindërtimit pas konfliktit të 1999-tës. Për tri vitet e fundit, shpenzimet qeveritare janë përqendruar mbi projektet infrastrukturore - për rrugë dhe shkolla. Këto ndërtime janë shpërndarë në tërë Kosovën, dhe kanë prekur një numër të madh firmash. Për më tepër, më 2010, Kosova është angazhuar në marrëveshjen kontraktuale për ndërtimin e autoudhës ndërmjet Vërmicës dhe Merdarit (72 km e gjatë) me kosto prej rreth 25 përqind të GDP së vendit. Të dhënat nga Ministria e Financave (MF) tregojnë që investimet kapitale nga qeveria e Kosovës kanë ndryshuar nga 154 milionë euro në vitin 2007 deri në 510 milionë euro në vitin 2011, duke nxitur kërkesën për firma

ndërtimore, dhe kështu rritje punësimi në këtë sektor. Përveç kësaj, ndërtimi është në rritje për shkak të lëvizjeve të mëdha të emigrantëve në zonat urbane, në veçanti drejt Prishtinës, duke rritur kërkesën për banesa. Sipas të dhënave të disponueshme në Komunën e Prishtinës, për periudhën 2005 – 2010 kanë qenë 200 ndërtime të licensuara të ndërtesave të banimit. Numri i kateve në këto ndërtesa sillet nga tre deri në trembëdhjetë, me një mesatare të shtatë etazheve. Disa nga këto blloqe të banesave janë të ndërtuara si komplekse prej dy deri në katër ndërtesa për banim. Ndërkohë, tregu individual i banimit pothuajse është trefishuar gjatë dhjetë viteve të fundit.

Megjithatë, ndërtimi si një sektor është i paraprirë të lulëzojë dhe të dështojë. Kur punësimi arrin nivelin e varfërisë, shpesh ofrohet punë e pasigurtë, e paguar ulët dhe shpesh e rrezikshme. Ndërtimi është poashtu një sektor i dominuar shumë nga meshkujt në Kosovë, i cili femrave iu siguron relativisht pak mundësinë për pjesëmarrje të plotë.

Rritja në **bujqësi** ka qenë më premtuese pasi që është bërë nga një bazë jashtëzakonisht e ulët. Sektori bujqësor ka pësuar një periudhë të rënies dramatike gjatë viteve 1990 – duke rënë nga 25 përqind të GDP-së në vitet 1980 dhe vitet e hershme të 1990-tës deri në rreth 12 përqind. Kështu që, çdo rritje ofron numra mbresëlënës të përqindjes. Megjithatë, ky sektor konsiderohet të jetë shumë joformal në aspektin e punësimit – edhe pse një numër i firmave bujqësore të shkallës së mesme së fundi kanë zyrtarizuar operimet e tyre. Një pjesë e rritjes në punësim është për shkak të ndërrimit nga sektori joformal në atë formal. Është nxitur nga rritjet e konsiderueshme të subvencioneve nga disa organizata ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, e gjithashtu nga fondet qeveritare, kësioji duke shtyer firmat në bujqësi të regjistrojnë punëtorët e tyre. Pavarësisht, ofron mundësitë për një burim të qëndrueshëm të punësimit në sektorin privat me potencial të rritjes së tregtisë së brendshme, promovon jetesën dhe dinjitetin njerëzor në zonat e varfëra rurale dhe mundëson që edhe shoqëritë e vogla bujqësore dhe industritë rurale të përfitojnë nga ekonominë e shkallëzuara.

Një hendikep i vërtetë për ekonominë e Kosovës është rënia në punësim në sektorin e **industrisë përpunuese**, veçanërisht pasi është përgjegjëse për një pjesë relativisht të madhe të punësimit aktual të sektorit privat (sic shihet me lartë në ilustrimin 1.5). Mallrat Kosovare dështojnë kur vie deri te ballafaqimi me konkurrencën rajonale. Duke pasur parasysh deficitin e lartë tregtar, çdo trend që pengon eksportet e Kosovës është preokupues. Shumica e ndërmarrjeve (>86 përqind) në njërin sektor (përpunimi i ushqimit) raporton aktivitete zero të eksportit në tri vitet

e fundit. Prej atyre që eksportojnë, aktiviteti i tyre nuk është sistematik; më shumë janë të përkohshëm apo eksportuesë të bazuar në kontigjente. Rënia në industrinë përpunuese është një shembull i dorës së parë i modelit ekonomik që favorizon të ardhurat mbi rritjen gjithëpërfshirëse: një ekonomi e rëndë importi që i ofron qeverisë burime të ardhurash përmes taksave dhe iu ndihmon korporatave të mëdha që t’iu shesin klientëve të pasur artikuj me çmim më të lartë, përderisa industria lokale dhe vendet e punës bien.


Shpërndarja e biznesit sipas sektorit

në Kosovë zbulon një peshë të konsiderueshme drejt sektorit (shërbimit) terciar – duke shfrytëzuar sistemin e Klasifikimit Evropian për Aktivitetet Ekonomike (KEAE) (shih ilustrimin 1.5), në një nivel shifror të ndarjes.³⁴ Përafërsisht, 80 përqind të biznesit i takon këtij sektori, e që llogaritet për dy të tretat e GDP-së totale. Afërsisht 2 përqind të bizneseve janë të regjistruara në sektorin primar (bujqësi/nxjerrje) dhe 16 përqind në sektorin sekondar (industri përpunuese). Këto boshllëqe sektoriale mund të ngushtohen nëse merren parasysh bizneset joformale të bujqësisë; megjithatë, konkluzionet mbasin të konsiderueshme kur krahasohen më poshtë me Ilustrimin 1.9. Janë disa pika interesante që duhet theksuar nga ilustrimi, si p.sh. përafërsisht, një e treta e të gjitha bizneseve - 16,000 - janë të regjistruara në sektorin e shërbimeve që ofron vetëm një të dhjetën e vendeve të punës në sektorin privat të Kosovës. Bizneset e Kosovës janë të nën-përfaqësuar në sektorin e ujit, të rrymës dhe minierave. Kjo padyshim reflekton koston e lartë startuese të përfshirë në sektorin e kësaj të fundit, mirëpo mund gjithashtu të reflektojë kornizën e vështirë rregullatore për hyrjen në treg. Sektorët e aftësuar të shërbimeve të teknologjisë informative dhe financiare janë poa-

shtu të nën-përfaqësuar. Vetëm 2 përqind të të gjitha bizneseve të regjistruara në Kosovë janë bujqësore - edhe pse rritja e punësimit në këtë fushë ka qenë e lartë (19 përqind rritje në numrin e të punësuarëve me orar të plotë në periudhën 2009-2010, duke i'u referuar Ilustrimit 1.9). Kjo nuk duhet të tregojë se Kosova ka biznese të pakta bujqësore, mirëpo se ka biznese të pakta zyrtare bujqësore. Pronarët e paregjistruar të bizneseve në këtë mënyrë janë të mbyllur nga tregjet mbështetëse dhe shumë të

më pak mbresëlënëse sesa në këtë vit, me vetëm 6 përqind të firmave që planifikojnë të rrisin numrin e personelit. Nga këto, 81 përqind kanë nevojë për punëtorë me aftësi të ulëta, 10 përqind kërkojnë personel teknik dhe vetëm 8 përqind kanë nevojë për staf me aftësi menaxheriale. Rritja në punësim në të gjithë sektorët duhet të përputhet me më shumë zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e punësimit, për t'u siguruar që edhe këto vende të reja pune që arrijnë tregun të luajnë pjesën e tyre në uljen e varfërisë.

Figura 1.9 Shpërndarja e bizneseve sipas sektorit në Kosovë



Administrata Tatimore e Kosovës (shiko Ilustrimin 1.5 për përshkrime të sektorëve)

punësuar në mënyrë informale janë të përjashtuar nga mbrojtjet siç është pensioni. Ajo nxjerr në pah potencialin e pashfrytëzuar të këtij tregu për rritje dhe gjendjen aktuale të brishtë dhe të pasigurtë të këtij sektori kur vie deri te ofrimi i punës së denjë, të rregulluar dhe të qëndrueshme.

Në përmbledhje, Kosova ka burime të gatshme rritjeje për punë të denjë, mirëpo ato kanë nevojë të mbështeten dhe të priorizohen nga perspektiva pro-njerëzore. Projektionet e rritjes për vitin e ardhshëm duken

1.4 Krijimi i kërkesës për punë: kultura e ndërmarrjes në Kosovë


A janë kompanitë private të Kosovës të strukturuar të marrin sipër sfidën e zgjerimit gjithëpërfshirës të tregut të punës? Ky seksion shkurtimisht shqyrton karakteristikat fundamentale të bizneseve në Kosovë, duke shqyrtuar në shpërndarjen rajonale të kompanive, ndarjen e tyre në bazë të klasifikimit sipas madhësisë dhe ciklit jetësor të ndërmarrjes.

Profili gjeografik i kulturës së ndërmarrjes në Kosovë është shumë i pabarabartë, me përqëndrim të fortë në afërsi të qyteteve të mëdha dhe qyteteve.³⁵ Shumica dërmuese (më shumë se një e treta) e ndërmarrjeve formale operojnë në dhe rreth Prishtinës, e cila si qyteti më i populluar ka tregun më të madh, e gjithashtu edhe infrastrukturë relativisht më të mirë dhe mjete më të mira logjistike. Përqëndrimi i dytë më i madh i ndërmarrjeve është i vendosur në Prizren, i ndjekur nga Ferizaji, Peja dhe Gjilani me numër të ngjajshëm të ndërmarrjeve. Mitrovica ka pak më shumë se pesë mijë ndërmarrje, përderisa Gjakova ka më shumë se tremijë. Kryesisht, numri i ndërmarrjeve ndjek modelin e njëjtë siç është edhe madhësia e popullatës, me një mbi-përfaqësim të lehtë në rajonin e Prishtinës (ASK 2011). Megjithatë, duhet të vërehet se bizneset janë kryesisht në zonat urbane, duke theksuar dallimet ndër-rajonale në shkallët e rritjes dhe niveleve të zhvillimit. Mesatarisht, ek-

zistojnë 32.3 ndërmarrje për 1,000 banorë në Kosovë. Rajonet e Prishtinës (41.6), Gjakovës (35.7), Ferizajit (34.9) dhe Gjilanit (33.4) kanë nivele më të larta sesa mesatarja shtetërore, përderisa ato në Pejë (29.03), Mitrovicë (26.6) dhe Prizren (24.6) kanë numër nën mesatar të ndërmarrjeve për 1,000 banorë.

Modeli i shpërndarjes së bizneseve në Kosovë sugjeron se bizneset nuk kanë qenë në gjendje të përfitojnë nga përqëndrimet rajonale. Hulumtimi tregon (Bellandi 1989) se përqëndrimi gjeografik i aktiviteteve të biznesit e ngrit produktivitetin. Grumbullimi rajonal është parë të jetë thellësisht i vlefshëm për bizneset, klientët dhe punonjësit e tyre. Përqëndrimi rajonal i bizneseve mund të ngris ekonominë e shkallës, të ndërtojë shkathtësi specifike të punës dhe të lehtësojë mundësitë e punëtorit. Punëtorët që banojnë në afërsi kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në trajnime të

Figura 1.10 Shpërndarja rajonale e ndërmarrjeve




ASK; Administrata Tatimore e Kosovës

përbashkëta – e cila në shkëmbim mund të dërgojë në sisteme formale arsimore të mësimin të aftësive specifike të punës. Akumulimi i shkathtësive të tilla të nxitura nga përqëndrimi rajonal i bizneseve kontribuon mëtutje në krijimin e një mjedisi të riprodhueshëm biznesor, që është më tërheqës për investimet e huaja. Megjithatë, shpërndarja e kompanive në Kosovë ndjek një model të ngjajshëm përgjatë tërë rajoneve dhe sektorëve të njëjtë, duke sugjeruar që asnjë grumbullim rajonal i kompanive nuk ekziston këtu, dhe se nuk ka marrëdhënie të fortë në raportin: rajon-sektor. Prandaj, këto kompani nuk arrijnë (apo vetëm deri në një masë të kufizuar) të shfrytëzojnë të mirat e grumbullimit (organizimit

të bizneseve në grupe me interesa të ngjajshme).

Nga perspektiva e **profilin të klasifikimit sipas madhësisë**, pothuasje të gjitha bizneset në Kosovë janë mikro-ndërmarrje. Bizneset me një deri në nëntë punëtorë janë dominante në më shumë se 96 përqind. Ndërmarrjet e vogla qëndrojnë në rreth 2 përqind dhe pjesa e ndërmarrjeve të mesme është më pak se 1 përqind. Në total, janë vetëm 450 ndërmarrje të mëdha në Kosovë. Megjithatë, ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha ofrojnë një kontribut shumë më të madh në punësim në aspekte relative. Edhe pse së bashku përfaqësojnë rreth 1.7 përqind të ndërmarrjeve në Kosovë,



ASK; Administrata Tatimore e Kosovës 2011

ndërmarrjet mesatare dhe të mëdha, me më shumë se 50 punonjës secila, kontribuojnë me 33 përqind të punësimin total (ASK 2008).

Madhësia mesatare e vogël e bizneseve në Kosovë është e lidhur me profilin e tyre të pronësisë. Më shumë

se 80 përqind të ndërmarrjeve në Kosovë janë biznese individuale - që posedohen dhe menaxhohen nga një individ - ndërmarrje të rregullta me përgjegjësi të kufizuara në vetëm 13 përqind. Partneritetet dhe kompanitë e huaja së bashku llogariten për rreth

3 përqind të bizneseve në Kosovë (investimi i huaj në bizneset e Kosovës është tejte i kufizuar), me kompanitë aksionare që përfaqësojnë 8 përqind.

Cikli jetësor i ndërmarrjes në Kosovë përcakton, deri në një masë, kapacitetin e biznesit për rritje. Hyrja e bizneseve të reja në sektorë është treguar se stimulon konkurrencën dhe inovacionin.

Në aspektin statistikor, Kosova regjistron një rritje të qëndrueshme në numrin e lindjes së ndërmarrjeve: afërsisht 7,000 ndërmarrje janë të konceptuara/krijohen çdo vit, shumica e tyre në sektorin terciar dhe përkrah vijave të njëjta me ndërmarrjet ekzi-

TABELA

1.3


Ndarja e kompanive të regjistruara në bazë të klasifikimit sipas madhësisë

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punonjësve	Numri i ndërmarrjeve	Përqindja e totalit
Mikro	1–9	54,411	96.0
Të vogla	10–49	1,303	2.3
Mesatare	50–249	504	0.9
Të mëdha	> 250	448	0.8
Totali	-	56,666	100

Administrata Tatimore e Kosovës 2009

stuese.³⁶ Kjo është pavarësisht nga klima e re sfiduese e biznesit. Kostoja për të filluar një biznes në Kosovë (e shprehur si përqindje e GNI-së për frymë banori) është raportuar së fundi në 29 përqind më 2010-të (Raporti mbi të bërit Biznes

Figura 1.12 Shpërndarja e formës juridike të kompanive të regjistruara në Kosovë



ASK, pesë vitet e fundit (mesataret e të dhënave tremujore të Administratës Tatimore të Kosovës)

nga Banka Botërore 2011), derisa Kosova, për vitin 2012, është renditur në pozitën e 168 (3 vende më poshtë nga renditja në 2011-tën). Vëzhgimet kryesore nga Raporti i Bankës Botërore mbi të Bërit Biznes lidhen me praninë e shumë pikave të transaksionit, të cilat jo vetëm se e rrisin numrin e ditëve që kanë të bëjnë me licensa dhe

leje (dhe si pasojë kostot operative), mirëpo gjithashtu vë në dukje praninë e shumë procedurave byrokratike brenda administratës publike, shumica e të cilave prodhon, apo mund të jetë e lidhur me, korrupsionin. Këto barriera priren të dekurajojnë iniciativat e reja ndërmarrëse.

“Edhe nëse je i kualifikuar mirë nuk do të merresh parasysh për pozita të hapura pune. Dukja është shumë me rëndësi. Mënyra e vetme për punë për persona me aftësi të kufizuara është që të hapin biznesin e tyre dhe të bëhen të vetë-punësuar.”

(Fokus grupi me njerëz me aftësi të kufizuara)


Ky mund të jetë një shkak se pse ndërmarrësia pozitive në Kosovë nuk kontribuon në mënyrë të konsiderueshme qoftë në zhvillimin ekonomik apo punën e denjë. Tjetra është për shkak të shkaqeve prapa ndërmarrësisë në Kosovë. Shumë biznese të reja nuk hapen nga baza e zgjidhjeve që kanë, por nga nevoja e perceptuar; sipas të përgjigjurve nga fokus grupet, ndërmarrësia shpesh shikohet si e vetmja mënyrë për t’i ikur papunësisë. Implikimi është se njerëzit janë bërë ndërmarrës përmes mungesës së alternativave më të mira, e më pak për arsye që ata kanë identifikuar një mundësi të pashfrytëzuar apo nënshfrytëzuar të biznesit. Kjo është në veçanti e vërtetë për shoqërinë më të cënueshme Kosovare – të varfërit, personat me aftësi të kufizuara, gratë, rininë dhe RAE. Acs dhe Varga (2005) kanë gjetur se, në përgjithësi, efektet e ndërmarrësisë nga nevoja dhe ndërmarrësisë nga mundësia mbi rritjen ekonomike dhe zhvillimin janë shumë të ndryshme:

ndërmarrësia nga nevoja nuk ka efekt në zhvillimin ekonomik, përderisa ndërmarrësia nga mundësia ka efekt pozitiv dhe domethënës.

Ilustrimi 1.13 tregon se shumica e ndërmarrësve kanë qenë të papunë para fillimit të bizneseve të tyre: rreth 42.5 përqind të pronarëve të firmave që janë përgjigjur kanë qenë të papunë, 16 përqind kanë qenë të punësuar në sektorin publik, 29 përqind në sektorin privat, 8 përqind kanë qenë studentë, derisa vetëm 4.5 përqind kanë qenë nga diaspora.

Duke krahasuar numrin e shuarjeve të ndërmarrjeve në Kosovë me numrin e krijimit të tyre, bizneset në Kosovë janë në ngritje. Numri i ndërmarrjeve të shuara sillet mesatarisht rreth 1,200 çdo vit.³⁷ Megjithatë, ky numër mund të jetë i nën-raportuar³⁸ - duke ditur se shumë kompani dalin jashtë biznesit pa ç’regjistrim zyrtar. Modeli i shuarjes të ndërmarrjeve ekzistuese është ilustruar në Figurën 1.15 më poshtë.

Figura 1.13 Statusi i ndërmarrësve para fillimit të biznesit




ASK, pesë vitet e fundit (mesataret e të dhënave tremujore të Administratës Tatimore të Kosovës)

Në përmbljedhje, këto rezultate sugjerojnë se kultura e ndërmarrjes në Kosovë ka energji pa organizim. Bizneset rregullisht vijnë dhe shkojnë, pa përfituar nga çfarëdo grumbullimi rajonal apo sektorial. Shumica e këtyre


bizneseve janë me gjasë në posedim individual dhe cilat punësojnë më pak se dhjetë njerëz. Krijimi i kërkesës për punë - dhe punë të denjë - në një klimë të tillë kërkon të kuptuar të qartë e barrierave me të cilat ndërmarrjet

Figura 1.14 Krijimi i ndërmarrjeve 2006 - 2010 (për 1,000 banorë)



Studimi i Barrierave të Ndërmarrjes Riinvest 2011

Figura 1.15 Shuarja e ndërmarrjeve 2006 - 2011 (për 1,000 banorë)



Studimi i Barrierave të Ndërmarrjes Riinvest 2011

ballafaqohen në aspektin e stabilitetit dhe rritjes.

1.5 Tregu dhe implikimet e politikës së punës

Kosova aspirojnë një të ardhme në të cilën mund të gëzojë të drejtat e njëjta të tregtisë, konkurrencës dhe pjesëmarrjes në tregun ndërkombëtar si anëtarët e familjes Evropiane. Derisa statusi sui generis krijon një sërë barrierash unike për integrim ekonomik ndërkombëtar (ndërmjet tjerash kufizimi i qasjes në tregje, kufizimi i lirisë së udhëtimit biznesor dhe dekurajimi FDI) mund të bëhet shumë në frontin vendor për të sjell Kosovën afër ekonomisë nxitëse, nga perspektiva e zhvillimit njerëzor. Analiza e këtij kapitulli sugjeron se Kosovarët do të përfitonin si njerëz, si ndërmarrje dhe si shoqëri, më shumë nga politikat e tregut të punës në favor të njerëzve se sa nga politikat e pastërta makro-ekonomike të krijimit të pasurisë. Kjo, në shkëmbim, indikon drejtimet e rekomandimeve të politikave në vijim:

Në esencë, afër tri të katërtat e popullatës me moshë të punës në Kosovë aktualisht nuk janë të punësuar.

- **Rritja e GDP-së duhet të ndiqet në kuadër të kontekstit të politikave të tregut të punës.** Kosova nuk e ka përshtatur rritjen e GDP-së se saj me rritjen e punësimit, duke krijuar paparazi në të ardhura në tërë shoqërinë. Derisa paparazi të tilla nuk janë anormale në kontekstet e paskonfliktit, ato nuk duhet të zgjerohen ende pas 13 viteve të fundit të armiqësive aktive. Të hyrat dhe burimet e të ardhurave janë bërë të shtrembëruara nga modeli aktual i Kosovës, shportës së saj të madhe të ndihmës ndërkombëtare dhe burimeve jashtme që vijnë nga diaspora - të

cilat mundësojnë një deficit të madh tregtar për t'u shfaqur dhe për t'u dukur në mënyrë të gabuar e qëndrueshme. Rritja e GDP-së ka nevojë të planifikohet për së dyti përkundrejt standardeve të të jetuarit dhe krijimit të punësimit, dhe të shihet si një rezultat e një ekonomie më të qëndrueshme dhe kapitalit lulëzues njerëzor, sesa një qëllim i dëshiruar për hir të saj.

- **Pjesëmarrja në tregun e punës në Kosovë duhet të inkurajohet nga një perspektivë përjashtuese.** Kapitali njerëzor është duke shkuar dëm në Kosovë në shkallë dramatike. Të dhënat e papunësisë prej 43 përqind maskojnë një realitet tronditës kur i shtohet edhe shkalla e pjesëmarrjes së ulët e fuqisë punëtore: në esencë, afër tre të katërtat e popullatës me moshë pune në Kosovë nuk janë momentalisht të punësuar (shiko **shkallën e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore**, seksion 1.1. më lartë). Shumë prej tyre nuk janë duke kërkuar më punë si rezultat i përjashtimit afatgjatë dhe me sa duket të pakthyeshëm nga tregu i punës. Prandaj, vetëm krijimi i vendeve të punës nuk është përgjigje për ta. Ata kërkojnë përkrahje të veçantë për t'u kthyer në punëkërkim aktiv, posaqërisht ku kufizimet kulturore dhe praktike (fëmijë për të kujdesur, apo ndikimet gjinore) janë në lojë. Gratë janë siç duket më të përjashtuarat nga pjesëmarrja si fuqi punëtore, në shkallë që nuk gjendet përgjatë konteksteve tjera Evropiane. Pos kësaj, programet për të inkurajuar gratë në tregun e punës do të jenë vetë-mposhtëse nëse punë të denja nuk shfaqen të jenë të arritshme. Nga këndvështrimi bazë i punësimit, të rinjtë janë prioritet

i qartë i politikës. Derisa të rinjtë shpesh nuk janë mbajtës ("të fituarit e bukës") të familjeve, një person i ri i papunësuar për periudhë të gjatë mund të afektohet përjetë. Liria e tyre për të ndërtuar një jetë të dinjitetshme, për të përkrahur familjen dhe për të marr pjesë në trupin politik, janë të gjitha të pakësuara. Ata me gjasë do t'a lëshonin vendin, braktisin fuqinë punëtore apo të kalojnë në burime joformale apo edhe të paligjshme të të ardhurave. Nga perspektiva e stabilizimit të paskonfliktit, një grup i madh i të rinjve të papunë nxisin indinjatën dhe thellojnë thyerjet shoqërore. Kosova nuk mund të përballojë që kuadri i të rinjve të humb besimin në potencialin e shoqërisë së tyre.

- **Kërkesa për punë do të kërkojë përpjekje për të kapitalizuar sektorët me potencial rritës.**

Politikë-bërësit duhet të shikojnë përtej krijimit të biznesit drejt sektorëve të aftë për të ofruar ngritje intenzive të rritjes, siç janë industria përpunuese dhe bujqësia, apo zhvillimi i kapitalit njerëzor, siç është sektori i shërbimeve të kualifikuara. Rritja duhet të jetë e balancuar me pagat nxitëse për formalizimin e bizneseve, për të parandaluar numër të madh të vendeve informale, të parregulluara dhe të pambrojtura të punës të cilat shfaqen në treg, që tërheqin të varfërit dhe të dëshpëruarit. Për shembull, ky kapitull sugjeron se derisa pjesa e GDP-së për bujqësi është duke u ngushtuar që nga 1980-ta, pjesa e saj e tregut të punësimit nuk ka rënë në mënyrë korresponduese (shiko *rritjen e punësimit sipas sektorit, në 1.8* më lartë). Prandaj, punëtorët bujqësor janë duke u paguar nga një sasi e

shpejtë në rënie e të ardhurave, dhe vlera e punës në bujqësi – në aspektin e të ardhurave, sigurisë dhe dinjitetit njerëzor – është duke rënë. Krijimi i më shumë vendeve të punës në bujqësi nuk do të krijojë më shumë punë të denjë, përveç nëse gjenden rrugë për të ndihmuar këto biznese të bëhen më përfituese, më të mbrojtura dhe më bashkëpunuese. Njësoj, sektori i shërbimeve në Kosovë është i karakterizuar nga diferencime të mëdha në fitime dhe e përqendruar në aspektin e vendndodhjes vetëm në disa qytete të mëdha, duke rritur edhe më tej diferencat ndër-rajonale në shkallët e rritjes dhe niveleve të zhvillimit.

- **Një treg i drejtë kosovar do të thotë balancim më i mirë ndërmjet madhësive të biznesit dhe sektorëve të biznesit:**

Që nga 1999-ta, sektorët e shërbimit me vlerë të shtuar të ulët dhe me barrierë të ulët të hyrjes në treg kanë arritur në pikën e dominimit të klimës së ndërmarrjes në Kosovë (shiko *rritjen e punësimit sipas sektorit*, në seksionin 1.8 më lartë). Kjo përputhet shumë mirë me madhësitë mbizotëruese të biznesit - mikro dhe atyre të zotëruara individualisht. Megjithatë, në Kosovë si gjetiu tjetër, shërbimi apo sektori terciar nuk është duke gjeneruar punësim në proporcion me rritjen e saj të prodhimit. Në Kosovë, kjo është veçanërisht e vërtetë. Derisa shumë ekonomi të zhvilluara gjithashtu kanë sektorin mbizotërues të shërbimit, ato zakonisht i janë nënshtruar një periudhe të industrializimit e cila krijon qoftë infrastrukturën për të ofruar shërbime e poashtu edhe kërkesën për to. Kosova nuk ka

kaluar nëpër këtë fazë. Sektori i saj i shërbimit është me aftësi të ulta dhe veçse tejkalon kërkesën e brendshme për shërbime. Momentalisht, Kosova ka një boshllëk të madh të mallrave - një tepriçë e konsumit mbi prodhimin. Kosova importon një numër të madh të mallrave dhe shërbimeve nga jashtë, mirëpo momentalisht nuk është në gjendje të eksportojë apo gjej tregje të brendshme për të krijuar një balancë të qëndrueshme makroekonomike. Prandaj, çmimet e mallrave veç janë në rritje (kërkesë e lartë, furnizim i ulët), dhe shërbimet mbesin nën-çmim dhe të tej-mbushura. Kjo sugjeron se për të gjeneruar përfitime direkte dhe indirekte të sektorit privat për zhvillimin njerëzor, do të jetë esenciale të përqëndrohet në sektorët të cilët momentalisht nuk janë të mbi-furnizuar, të cilat mund të krijojnë vetë-mjaftueshmëri të brendshme dhe që kanë potencialin për të zgjeruar mundësitë njerëzore – siç janë industria, veçanërisht industria përpunuese, bujqësia dhe sektorë të shërbimeve të kualifikuara. Nga këto, industria përpunuese është kapaciteti më i madh për të gjeneruar punësim

dhe për të mbajtur kompanitë e mëdha formale (shiko **rritja e punësimit sipas sektorit**, seksioni 1.8 më lartë).

- **Stimulimi i ndërmarrjes nuk është sfidë primare:** Sektori i denjë privat në Kosovë, i cili korr përfitime të vërteta të zhvillimit njerëzor, nuk varet thjeshtë në inkurajimin e më shumë kompanive vetë-startuese. Kosova veçse ka një kulturë lulëzuese të ndërmarrjes (shiko **cikli i jetësor i ndërmarrjes**, seksioni 1.4). Megjithatë, këto biznese janë duke luftuar të zgjerohen dhe mbajnë vetën. Shumica janë duke u krijuar në sektorin terciar tashmë të ngopur. Dhe nuk është e qartë shkalla se deri në çfarë pike janë të arritshme tek të përjashtuarit nga tregu i punës, apo se si afektojnë standardet e të ardhurave, të drejtave dhe dinjitetit e më të varfërit. Sfidë është që të kuptohet më tërësisht konteksti nga i cili del biznesi i ri – si mund të gjejnë hapësirë për t'u rritur, si mund t'i arrijnë më të varfërit dhe se si mund të shtojnë dinjitet dhe vlerë sociale në nivel lokal dhe rajonal. Kapitujt tjerë do të shqyrtojnë këto çështje.

Barrierat ndaj rritjes gjithëpërfshirëse

“Qeveritë nuk mund të krijojnë pasuri, mirëpo mund të krijojnë kushte për lulëzimin e ndërmarrjes së lirë” Kongresmeni i SHBA-ve Bill Owens

Nuk ekziston lidhje automatike ndërmjet një ekonomie të suksesshme tregu dhe përfitimeve të dukshme të zhvillimit njerëzor. Formëzimi i kësaj lidhjeje është një përgjegjësi e përbashkët e qeverive dhe pjesëmarrësve të sektorit privat. Qeveritë janë përgjegjëse për vendosjen e kornizave institucionale, juridike dhe rregullative të cilat iu mundësojnë bizneseve të lulëzojnë brenda një konteksti shoqëror reagues. Pjesëmarrësit e sektorit privat duhet të përdorin iniciativën e tyre mbi atë se si i shfrytëzojnë burimet e tyre (prona si dhe kapitali njerëzor dhe financiar), dhe se si i qasen marrëdhënieve të tyre kontraktuale dhe obligimeve. Përfundimisht, këto dyja duhet të bashkëpunojnë për të prodhuar një mjedis në të cilin në njërin anë ka përputhshmëri transparente dhe nën anën tjetër zbatim të drejtë dhe sistematik - të një partneriteti të shëndoshë. Ky kapitull shqyrton mjedisin biznesor të Kosovës nga perspektiva e bashkëpunimit, derisa tjetri merret me ndikimet e saj mbi tregun e njerëzve profesionalë.

Në Qershor 2011, Riinvest-i ka kryer një studim prej 600 të anketuarve për të marrë një pamje të përgjithshme të barrierave kritike ndaj zhvillimit të sektorit privat. Për të plotësuar dhe

Nuk ekziston një lidhje automatike ndërmjet një ekonomie të suksesshme të tregut dhe përfitimeve të qarta të zhvillimit njerëzor.

forcuar këtë studim është organizuar një diskutim rreth-tryezës nga ndërmarrësit Kosovarë nga sektorë të ndryshëm dhe u kryen intervista me asociacionet e biznesit. (Oda Ekonomike e Kosovës – OTK, Aleanca e Bizneseve Kosovare – ABK; Oda Ekonomike Amerikane – OEK) për të forcuar studimin dhe gjetjet nga tryeza e punës. Rezultatet nga të dhënat parësore kanë ofruar përceptime mbi barrierat parësore institucionale dhe kulturore ndaj hyrjes dhe rritjes së sektorit privat në Kosovë.

Këto të dhëna përceptimi janë kritike – edhe aty ku, herë pas here, mund të ndryshojnë nga burime tjera të raportimit. Keto e përshkruajnë botën në të cilën pronarët e biznesit e operojnë, mjedisin që drejton praktikën e tyre dhe tregun gatishmërinë e tyre për t’u përputhur me obligimet e tyre më të gjëra. Gjithashtu, tregon se ku mund të ketë paragjykim dhe vetë-kufizim madje edhe brenda bizneseve aktuale, duke nënvizuar se ku mund të jetë në kundërshtim, drejtimi aktual i sektorit privat dhe strategjitë e zhvillimit njerëzor për Kosovën.


2.1 Barrierat e biznesit të renditura sipas intensitetit

Në mënyrë që të identifikohen barrierat kryesore të cilat afektojnë punën e bizneseve në Kosovë, 22 kategori të barrierave (siç janë klasifikuar në Studimet e Mjedisit Biznesor dhe Performancës së Ndërmarrjes, SMBPN³⁹) janë rreshtuar dhe është kërkuar nga bizneset të vlerësojnë çdo barrierë në aspektin e intensitetit.⁴⁰ Vlerësimi i barrierave është sjell nga numri një (intensiteti i

ulët) deri në pesë (intensiteti i lartë). Me këtë sistem të vlerësimit, pikët për secilën barrierë mund të sillen nga 20 minimum deri në 100 maksimum.

Sipas ilustrimit 2.1, kultura e pabarabartë e ndërmarrjes është një pengesë e madhe ndaj sektorit privat të Kosovës sesa kornizat rregullative. Katër nga pesë barrierat e para lidhen me realitetin e mjedisit në Kosovë: praktika jo të drejta të biznesit, zbatim i dobët, krimi dhe korrupsioni.

Figura 2.1 Përceptimi mbi intensitetin e barrierave të bizneseve në Kosovë



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

2.2 Shikimi i barrierave përmes perspektives së zhvillimit

Në seksionet në vijim, barrierat dhe pengesat e identifikuar në figurën 2.1 janë të grumbulluara rreth pesë temave kryesore: Barrierat e kulturës së ndërmarrjes, barrierat operacionale, barrierat infrastrukturore, barrierat rregullative, dhe barrierat e brendshme të shkathtësisë. Secila nga këto fusha tematike është diskutuar në hollësi të mëtejshme.

Barrierat e kulturës së ndërmarrjes kryesojnë listën e kufizimeve të përceptuara të sektorit privat, duke treguar një sfidë të madhe për kohezionin social në Kosovë. Barrierat e lidhura me pabarazinë - qoftë të përceptuara apo të vërteta - janë veçanërisht të dëmshme për bashkëveprimet e sektorit privat me zhvillimin njerëzor. Mjediset e padrejta, të pasigurta dhe të paparashikueshme të biznesit minojnë mirëbesimin në trupin politik dhe në drejtësinë e qeverisë. Në një klimë ku interesat e veçanta shihen se dominojnë, njerëzit janë të detyruar përsëri në besnikëri tradicionale ndaj familjes, klanit apo etnicitetit - sesa të shtyer drejt ndër-bashkëpunimit. Praktikët e pabarabarta të biznesit janë të përceptuara - shpesh me të drejtë - si një përpjekje për të rishpërndarë të ardhurat publike drejt anëtarëve të preferuar të shoqërisë. Në rastin e Kosovës, kjo shpesh vë për shkak të çështjeve të zbatimit josistematik dhe të dobët sesa për shkak të ligjeve **në vetvete** të padrejta.

Pabarazia në biznes në veçanti ka disa kosto të thella të zhvillimit njerëzor të cilat ndikojnë në komunitetet më të ndjeshme të Kosovës. Së pari, një mjedis i pabarabartë biznesor inkurajon firmat joefikase të mbesin në treg duke operuar me kosto nën-mesatare të një biznesi në përputhje - shpesh duke shenjuar familjet me të ardhura të ulëta me mallra

inferiore përderisa detyrojnë çmimet e përgjithshme të tregut të mbesin të larta. Së dyti, shumë firma të cilat operojnë në mënyrë joformale do të tentojnë të mbesin të vogla dhe "jashtë radarit", e kështu humbin mundësitë nga tregjet formale siç janë huadhëniet e bankave (shiko **barrierat operacionale**). Së treti, kompani të tilla bëhen efektivisht të padukshme në raport me monitorimin e pavarur të mbrojtjeve të punëtorit, duke zvogëluar rëndësinë e punës dhe ligjeve të pagave përgjatë tërë tregut. Së katërti, firmat kosovare tentojnë të kompenzohen për një pozitë të padrejtë nëpërmjet institucioneve përmes mospërputhjes me rregulloret - për shembull në taksa, duke shkaktuar efekt dramatik mbi të ardhurat publike dhe rishpërndarjen e të ardhurave. Në fund, në kontekstin e institucioneve të dobëta dhe joefikase, sjellje të tilla tentojnë të kenë efekte të njëjta mbi bizneset tjera, duke rrezikuar mundësinë e krijimit të normës së përgjithshme shoqërore të sjelljes së padrejtë. Për shkak të praktikave të tilla, ekonomia kosovare mund të ketë zvogëluar hyrjet e bizneseve në tregje, më pak vende pune të denja, konkurrencë më pak dhe çmime më të larta.

Mosbesimi i qeverisjes dhe zbatimit është poashtu i reflektuar në renditjet e larta të "barrierës" e dhënë për krimin dhe jostabilitetin politik. Këtu perceptimet janë në lojë; Kosova ka relativisht klimë stabile politike dhe me shkallë të krimit jo më të lartë sesa vendet tjera të zhvilluara. Megjithatë, pasiguria e shkaktuar nga mosmarrëveshja e statusit të Kosovës, nga pakoja konfuze (për një biznesmen mesatar) e legjislacionit mbi të qenurit i shtyer përtej për të siguruar përputhshmëri me standardet e BE-së dhe ndjenjës së të qenurit "vetëm në forcat e veta" kur vë në kushti i sigurisë dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes, dhe të gjitha këto kanë ndikim në koston e të bërit biznes. Ato mund të thajnë kapitalin dhe besimin, dhe të zvogëlojnë


Pabarazia në biznes ka disa kosto të thella të zhvillimit njerëzor të cilat në veçanti ndikojnë në komunitetet më të ndjeshme të Kosovës.

konkurrencën. Pronarët e biznesit shfaqen të prirur për t'iu trembur politikave të paparashikueshme dhe ndryshimeve rregullative, e gjithashtu edhe interpretimit diskrecional (të lënë në dorë të dikuj tjetër) dhe zbatimit të ligjit nga zyrtarët - përfshirë ngacmimet e shoqëruara me korrupsion dhe kërcënime. Në këtë mjedis, pronarët e biznesit kanë më pak gjasa të marrin rreziqe, të sigurojnë mbrojtje të puno-njësve, të investojnë në të mirat publike (apo të jenë më të vetëdijshëm për Përgjegjësinë Sociale të Korporatës së tyre - PSK-së më përgjithësisht), të përdorin praktika të drejta të punësimit apo të prodhojnë përfitime tjera të bashkëveprimeve të shëndetshme pri-vato-publike.

Barrierat operacionale përfshijnë qasjen në financim - e renditur mesatarisht në aspekt të ndikimit të saj negativ mbi biznesin. Megjithatë, analizat e mëtutjeshme sugjerojnë se qasja në financa sfidon dy palët që kanë nevojë më së shumti për përkrahje - ndërmarrjet mesatare që kërkojnë të rriten dhe nevojtarët e kapitalit që kërkojnë kostot për startim të biznesit, veçanërisht në

zonat rurale. Studimet e kryera për këtë analizë tregojnë se më pak se një në tri firma kanë qenë të suksesshme në marrjen e huasë nga banka në vitin 2010. Këto rezultate tregojnë që kompanitë e madhësisë mesatare kanë shkallë më të madhe të refuzimit. Analizat e sektorit dhe qasja në financa tregojnë që vetëm 1 përqind e sektorit parësor ka pasur qasje në huamarrje (duke nënvizuar ndjeshmërinë e madhe dhe informalitetin e sektorit të bujqësisë), 18 përqind të sektorit sekondar dhe rreth 81 përqind të sektorit terciar. Sipas studimit të tanishëm, firmat e Kosovës tentojnë të mbështeten shumë mbi fitimet e ruajtura dhe fondet e tyre të veta (74 përqind të firmave) për financimin e themelimit të tyre (Ilustrimi 2.2), derisa huadhënia bankare është shumë e ulët (rreth 11 përqind). Të dhënat më tutje sugjerojnë se boshllëku i informacionit për të punuar në mënyrë adekuate me bankat është duke i kufizuar bizneset më të varfëra nga qasja në financa. Vetëm një numër relativisht i vogël i firmave i qarkullojnë shitjet e tyre përmes sistemit bankar;⁴¹ nga të gjitha kompanitë e anketuara, vetëm rreth 44 përqind kanë

Figura 2.2 Burimet e financave të raportuara për krijimin e bizneseve në Kosovë



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

Sektori financiar në Kosovë mbulon industrinë bankare, industrinë e sigurimeve, fondet pensionale dhe institucione tjera financiare kryesisht të skemës të mikro-kredive. Sektori bankar është zhvilluar në mënyrë të suksesshme dhe shihet nga shumë si një storie suksesi (Raporti i Progresit të BE-së 2011). Vlera e aseteve dhe detyrimeve të sektorit bankar në Kosovë në muajin Shtator ka qenë 2.63 miliardë euro, apo rreth 48 përqind të GDP-së së vendit. Që nga fundi i vitit 2000, kur është themeluar banka e parë pas konfliktit, vlera e aseteve totale të sektorit bankar është rritur për rreth 26 fish. Kjo rritje mbresëlënëse eksponenciale nënvizon thellë krijimin e fortë të njërit nga sektorët më të rëndësishëm në vend. Sektori karakterizohet nga prezenca e madhe e kapitalit të huaj (89 përqind të aseteve të përgjithshme, p.sh. gjashtë nga tetë banka janë të kapitalizuara plotësisht apo në pjesën më të madhe me kapital të huaj).

Prezenca e institucioneve të huaja financiare në Kosovë ka kontribuar ndaj modernizimit të sistemit financiar duke sjellur praktika më të avancuara në financa deri në operimet menaxhuese bankare. Sektori bankar në Kosovë mbetet i përqendruar shumë me pjesën e tregut të tri bankave më të mëdha duke u llogaritur për rreth 74 përqind të aseteve totale të sektorit bankar, 74 përqind të depozitave dhe 72 përqind të huadhënies në fund të Shtatorit 2011. Një strukturë e tillë e përqendruar kufizon seriozisht mundësitë për të konkurruar përbrenda sektorit bankar.


Aktiviteti i huadhënies nga bankat komerciale të Kosovës paraqet njërin nga burimet kryesore të financimit për konsumim dhe investime në vend. Rigjenerimi i ngadaltë i tregjeve financiare në ekonominë e huaja dhe përmirësimet në përceptimet e bankave komerciale për mjedisin ekonomik në Kosovë ka rezultuar në mirëbesim më të madh për mjedisin e përgjithshëm ekonomik, nivel më të lartë të depozitave dhe si rrjedhojë, huadhënia nga sistemi bankar në Kosovë është rritur në mënyrë të shpejtë. Sipas të dhënave CBK, vlera totale e huadhënies të lëshuara nga sistemi bankar ka arritur në 1.6 miliardë euro në Qershor 2011 (rreth 34.3 përqind të GDP-së). Huadhëniet për ndërmarrje kanë regjistruar pjesën më të madhe të rritjes, në krahasim me huadhëniet për ekonominë familjare, e cila është ngadalësuar në vitin 2011. Ndarja e huadhënies për ndërmarrjet në Qershor të 2011-tës ka qëndruar në 69.2 përqind (përafërsisht 1.1 miliardë euro).

Kosova, në përgjithësi, posedon një portfolio të mirë cilësore. Pavarësisht rritjes së shpejtë të kreditit, në Shtator 2011, pjesa e huadhënies jo-performuese (HJP) ndaj huadhënies totale (përfshirë huadhëniet e klasifikuara si "të dyshimta" dhe "humbja") ka qenë vetëm 6 përqind, shumë më ulët se mesatarja e 15 përqindshit të regjistruar në vendet në rajon.

Struktura e huamarrjeve për ndërmarrjet në aspektin e aktivitetit ekonomik ka mbetur e ngjajshme për disa vite. Huamarrjet për sektorin e shërbimeve dominojnë strukturën e huamarrjeve totale për ndërmarrjet, me pjesën prej 71.3 përqind (Ilustrimi E1). Brenda huamarrjeve për shërbimet, sektori i tregut ka

absorbuar përpjesën më të madhe, duke i llogaritur për 52.5 përqind të huamarrjeve totale për ndërmarrjet në Qershor 2011. Një pjesë prej 25.1 përqind të huamarrjeve totale për ndërmarrjet është e paraqitur nga huamarrjet për sektorin e industrisë (përfshirë minierat, prodhimin, industrinë dhe ndërtimin).

Figura A1 Huamarrjet e ndërmarrjeve sipas sektorëve



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

Njëri nga sektorët me pjesën më të vogël të huamarrjeve totale mbetet sektori i bujqësisë, me vetëm 3.6 përqind në Qershor 2011 (4.0 përqind në Qershor 2010). Kjo sugjeron se qasja konzervatorike e huadhënies së sistemit bankar ndaj sektorit të bujqësisë dështon të lë shenjë të çfarëdo përmirësimi me kalimin e kohës. Huadhëniet e lëshuara për këtë sektor, në raport me vëllimin e ulët, janë të karakterizuara me shkallë të larta të interesit, të cilat reflektojnë pasigurinë e përceptuar të këtij sektori nga bankat. Niveli i lartë i shkallëve të interesit për huadhënie për bujqësinë mund të dekurajojë kërkesën për huadhënie dhe të kontribuojë drejt nivelit aktual të ulët të huadhënies në këtë sektor.

Struktura e huadhënies bankare në Kosovë është në një vijë me strukturën e përgjithshme të bizneseve në Kosovë dhe zhvillimeve brenda kësaj kornize. Ekonomia është në masë të madhe e drejtuar nga bizneset tregtare të cilat masivisht kontribuojnë në deficitin tregtar të vendit me rreth 2 miliardë euro në vitin 2011. Kosovarët janë më pak të orientuar drejt investimeve në aktivitetet e industrisë përpunuese/prodhuese dhe me kufizimet e imponuara nga sektori bankar për huadhënie për këtë sektor, joekuilibri tregtar është i destinuar të rritet edhe më tutje. Në anën tjetër, investime modeste në prodhim janë poashtu të lidhura me shuma të mëdha të kapitalit të nevojshme për të filluar apo operuar me biznese të tilla krahasuar me ato në sektorin e shërbimeve. Përsëri, duke pas parasysh konzervatorizmin e sektorit bankar për financimin e bizneseve jo-tregtare, cikli i regjenerimit ekonomik përmes aktiviteteve të prodhimit shihet si mjaft i mbyllur.

vepruar asisoi. Një vetëdijësim i lartë mbi rëndësinë për të punuar me bankat do të lehtësonte qasjen e tyre në financim, duke përmirësuar raportimin financiar që do të rriste besimin e bankave ndaj bizneseve.

Raporti i Bankës Botërore mbi të Bërit Biznes e vlerëson Kosovën si relativisht mirë në qasjen në financa, dhe bizneset në Kosovë, me kalimin e kohës, kanë dhënë një pamje të pabarabartë të vështirësive të tyre në këtë drejtim. Mund të ekzistojnë shumë shkaqe për këtë: jo së paku lloji i bizneseve të studiuar; perspektiva e përjashtuar e atyre që nuk janë konsideruar të vlefshëm për marrje kredish dhe natyra jostabile e ekonomisë së Kosovës që nga viti 1999. Pyetja relevante këtu është - a përjashton klima financiare e Kosovës të mirat e zhvillimit njerëzor që mund të përfitohen nga rritja e sektorit privat? Në këtë rast, përgjigjja është po - sepse financat janë më të vështirat për t'iu qasur nga ata që janë më së shumti në gjendje të ofrojnë punësim (ndërmarrjet e madhësisë mesatare) dhe për ata pa qasje në format tradicionale të kolateralit/lënies peng siç janë: të ardhurat, prona apo toka.

Barrierat infrastrukturore janë të kryesura nga furnizimi i rrymës (telekomunikimet, toka dhe transporti të cilat janë të renditura shumë më poshtë në listë) me një intenzitet prej 64 (shih ilustrimin 2.1). Gjatë këtyre 11 viteve, rryma ka qenë gjithnjë ndër barrierat kryesore. Edhe sot, kur vendoset në një tabelë me sektorin e industrisë përpunuese, rryma mbetet shumë afër kryesimit. Kostot e rritura të prodhimit për shkak të ndërprerjeve të shpeshta në furnizimin me rrymë janë ende duke shkaktuar disa kufizime konkurruese për firmat në Kosovë. Këto firma gjatë kalimit të kohës i janë përgjigjur me burime alternative të furnizimit me rrymë, me shumicën që kanë investuar në gjeneratorë të kushtueshëm të mëdhenj të rrymës.

Sot, pavarësisht reformave të reja në sektorin e energjisë, furnizimi me rrymë mbetet në përgjithësi i pasigurtë. Kosova kryesisht mbështetet në dy termocentrale,⁴² që të dyja të vjetra dhe nga të cilat njëra është 50 vite e vjetër në prag të kolapsit. Te dy termocentralet dështojnë të furnizojnë gjysmën e nevojave të rrymës për vendin gjatë periudhave të ftohta dhe dimrit, duke lënë vetëm një zgjidhje atë të importimit të rrymës. Kjo është edhe e kushtueshme dhe me mungesën e fondeve, shpesh e paarrtshme. Në vitin 2012, për shkak të mungesës së subvencioneve buxhetore për furnizim me energji (të nxitura nga kufizimet financiare dhe deficitet e larta buxhetore), pritet një rritje prej 25 përqind të kostos së rrymës në rajon. Kjo, në shkëmbim, do të afektojë kostot operative të biznesit. Derisa fabrikat e reja të energjisë (kapacitete prej 600 megavatë) janë duke u planifikuar, nuk është ofruar ndonjë kornizë e solucionit, përveç importimit të energjisë.

Mungesa e rrymës është një barrierë e gjërë e zhvillimit njerëzor në Kosovë, e cila afekton shërbimet në mënyrë të konsiderueshme sikurse bizneset. Mirëpo, nga perspektiva e lidhjes reciproke sektor privat/zhvillim njerëzor, në veçanti pengon krijimin e një industrie domethënëse e cila mund të zgjerojë punësimin dhe krijojë pasuri më të qëndrueshme. Vështirëson sektorët e gatshëm për rritje, siç është industria përpunuese/prodhuese, dhe pengon FDI-në. Pasi që rryma është dukshëm më e mirë në qytete, ajo poashtu përkeqëson të ardhurat urbane-rurale dhe ndarjet e produktivitetit. Një pamje më e mirë është e ofruar nga barrierat tjera infrastrukturore, me transportin, tokën dhe telekomunikimet të cilat mbesin krejt në fund të listës, me intenzitetet e 40, 36, dhe 34 respektivisht. Investimet

e Kosovës në telekomunikime janë dëshmuar të jenë stimuluese duke parë nevojën për përparime teknologjike – edhe pse përfitimet janë ende në masë të madhe të përjetuara në zonat urbane dhe ndër-urbane.

Barrierat rregullative janë të renditura mesatarisht, administrata tatimore dhe doganat në pozitat 12të, 13të, dhe 14të respektivisht. Këto barriera kanë tentuar të zvogëlohen me kalimin e kohës, një pikë pozitive për administrimin e Kosovës. Në 2002-tën, shkallët e taksave shkallët e taksave janë perceptuar si barrierat kryesuese për ndërmarrjet.⁴³ Reformat e implementuara në fund të 2009-tës, e përgjysmuan tatimin mbi fitimet, e cila është dëshmuar të jetë një drejtuese stimuluese e rëndësishme për biznese. Tani, kritika ndaj taksimit në Kosovë është e orientuar ndaj një administrimi joefikas të taksave, me referim të veçantë ndaj Taksës mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Siç është edhe rasti me shumë ekonomi në tranzicion, taksat janë shpesh padrejtësisht të larta për shkak të joefikasitetit në ofrimin e shërbimeve, kapacitetit të dobët të mbledhjes së taksave dhe bazës së ngushtë të tatimit, që rezultojnë kryesisht nga sektori i madh joformal. Intervistat me asociacionet e biznesit kanë ekspozuar disa nevoja për zvogëlimin e barrës tatimore nga mbledhja e TVSH-së, veçanërisht shkallëve të TVSH-së në industritë specifike (me e dukshmja në bujqësi). Asociacionet e biznesit poashtu janë ankuar për interpretimin arbitrar të rregulloreve të paqarta të taksave, zbatimit selektiv dhe zhvatjes së shoqëruar nga administrata tatimore. Këto praktika janë nënvizuar edhe më shumë në vitet e fundit duke parë nevojën e qeverisë për të përmbushur parashikimet e të ardhurave për shkak të përfshirjes së madhe në investimet

kapitale. Si e tillë, një administratë joefikase tatimore, karakteristikë e qeverisjes së dobët, kontribuon si në kosto poashtu edhe rreziqe me të cilat ballafaqohen firmat si dhe mund të afektojë vendimet e investimeve. Sipas asociacioneve të biznesit, administrata tatimore është sinonim për ngacmime byrokratike përmes inspektimeve tatimore përçarëse dhe të kushtueshme.

Tatimimi i drejtë, për më shumë, luan një rol kritik në rishpërndarjen e të ardhurave, si ai i përfitimeve indirekte te sektorit privat për zhvillimin njerëzor. Tatimimi i sektorit publik është në të folurit e zakonshëm, grabitje e Petrit për të paguar Pollin. Qeveria është thjeshtë duke e paguar vetveten për të tërhequr të ardhurat e veta. Baza tatimore e sektorit privat, megjithatë, ka potencial për të ofruar të ardhura shtesë për buxhetet e kapitalit dhe mund të ketë ndikime dramatike mbi buxhetimin social. Një qeveri e cila nuk mund apo nuk mbledh taksat në mënyrë të drejtë dhe efikase, derisa shtrydh buxhetet sociale është duke i shkaktuar të gjithë aksionarëve të saj një dëmtim.

Barrierat e brendshme të shkathtësisë nuk janë të vlerësuara shumë si barriera të perceptuara për bizneset. Standardet e prodhimit, shkathtësitë dhe edukimi i punonjësve në dispozicion, renditen në fund të listës (**Fig 2.1.**, më lartë). Kjo jep një pasqyrë fascinuuese, nëse jo brengosëse, mbi klimën biznesore të Kosovës dhe kontributit të saj ndaj potencialit njerëzor. Duke kombinuar këto të dhëna të perceptuara me të dhënat objektive mbi nivelet e ulëta të arsimimit dhe aftësive në mesin e të rriturve Kosovarë (shiko **Hyrje: konteksti i zhvillimit njerëzor në Kosovë**) dhe standardet e edukimit në mesin e të rinjve tregon edhe një herë se Kosova është duke shkuar për ndërmarrje me vlerë të ulët dhe me

shkathtësi të ulëta. Thjeshtë nuk ekziston asnjë kërkesë për llojin e shkathtësive të cilat mbizotërojnë në një ekonomi tregu modern dhe lulëzues. Poashtu, tregon mungesën e preokupimit për të investuar në kapacitetin dhe potencialin e punonjësve, drejt një modeli më produktiv të biznesit. Njerëzit e përfshirë në sektorin privat në Kosovë janë, më shpesh se sa që nuk janë, të përfshirë në punë me pagë të ulët e cila i mban ata brenda vijës së varfërisë dhe i'u jep atyre vetëm një potencial të kufizuar për zgjerimin e aftësive dhe shkathtësive të tyre.

Në përmbledhje, barrierat e identifikuar nga bizneset tregojnë sfidat dhe kufizimet e perceptimit me të cilat përballen punonjësit. Ata janë shumë të preokupuar me barazinë dhe më pak me kapacitetin. Ndoshta është natyrale, që pronarët e bizneseve duhet të jenë më të preokupuar me barrierat që dalin nga qeverisja e dobët dhe nga një kontratë e paqëndrueshme shoqërore se sa me vështirësitë që i dalin stafit të tyre. Megjithatë, të dyja janë fundamentale ndaj një klime progresive të biznesit, e poashtu ndaj një shoqërie të dinjitetshme me potencial të realizuar.

Nga të gjitha barrierat e identifikuar, e para – një kulturë e pabarabartë e ndërmarrjes – ka implikimet më të thella dhe më të gjëra për shoqërinë Kosovare. Kjo do të eksplorohet në më shumë hollësira në seksionin vijues.

2.3 Një fushë e pabarabartë e lojës – kostot ekonomike dhe njerëzore

Renditja e “konkurrencës jo të drejtë” si barrierë kryesuese është e re në mjedisin kosovar, e cila tejkalon furnizimin me energji si barrierën kryesuese gjatë viteve të kaluara (Studimet SME Riinvest


2001, 2002, 2004, 2006 dhe 2008). Për t’a elaboruar më tutje të kuptuarit e konkurrencës jo të drejtë, ekipi i Riinvestit ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me ndërmarrësit në Shtator 2011, si pjesë e Programit të Tryezës së Rrumbullakët për Zhvillimin e Sektorit Privat (e organizuar bashkërisht me Fondacionin Friedrich Ebert-Stiftung⁴⁴). Rreth 40 përfaqësues të biznesit nga sektorë të ndryshëm kanë marr pjesë në këtë ngjarje.

Shumica më e madhe e bizneseve kanë deklaruar konkurrencën e padrejtë si prodhim i dy fenomeneve të rëndomta – mungesën e integritetit në treg dhe zbatimin e dobët institucional të rregullave. Këto dyja janë të perceptuara si të ndërlidhura përgjatë ndarjes privato-publike, p.sh.: **mungesa e integritetit** është e përforcuar nga mungesa e **llogaridhënies** si nga bizneset private e poashtu edhe zyrtarët qeveritarë të preokupuar me përputhshmërinë. Ata nënvizojnë prezencën e një mjedisi të pabalancuar dhe të pabarabartë të biznesit në Kosovë, i ndërtuar sipas marrëdhënieve speciale, joformale sesa nga rregullat e konkurrencës së drejtë. Këta dy faktorë janë të analizuar më në hollësi mëposhtë, për ndikimin e tyre të dëmshëm mbi spektrin e zhvillimit njerëzor.

2.3.1 Mungesa e integritetit në treg: korrupsioni, evazioni dhe joformaliteti

Korrupsioni është një indikator i shkëlqyer i mungesës së integritetit në treg – i renditur në mesin e pesë barrierave kryesuese nga pronarët e bizneseve në Kosovë. Të dhënat e fundit nga Transparenca Internacionale⁴⁵ e vendosin Kosovën të parën në renditje në rajon për nivel të lartë të korrupsionit, me koeficient prej 2.8 (0–3 janë vendet ku niveli i korrupsionit është i përhapur). Gjithashtu, ka pas

Figura 2.3 Përceptimi i intensitetit të korrupsionit nga bizneset sipas burimeve



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

edhe një rritje në Indeksin e Përceptimit të Korrupsionit për Kosovë, pavarësisht rënies marxhinale në renditjen e përgjithshme (nga 110 në vitin 2011 deri 112 në vitin 2012). Sipas Barometrit Global të Korrupsionit (Transparency International, TI, 2010), 73 përqind e kosovarëve të anketuar besojnë se niveli i korrupsionit në vend është rritur gjatë pesë viteve të fundit.

Cilat fusha të biznesit janë më të prekura nga korrupsioni? Bizneset e anketuara për këtë kapitull janë pyetur që të vlerësojnë përvojën e tyre të korrupsionit përgjatë një sërë llojeve të bashkëveprimit - nga angazhimi në shërbimet publike deri tek funksionet e thjeshta tatimore dhe doganore të jetës së përditshme të biznesit.

Një intensitet i tillë i korrupsionit të përceptuar që afekton partneritetet publiko-private është një mjegull e errët e cila varet mbi potencialin e zhvillimit lokal të Kosovës. Shpenzimet e qeverisë paraqesin një sasi të pjesëve/aksioneve në rritjen ekonomike, anomalitë siç janë korrupsioni parandalojnë rrjedhën

normale të parasë drejt bizneseve efikase dhe atyre me potencial më të madh të rritjes, e në këtë mënyrë ndaj krijimit të vendeve të punës. Shërbimet publike duhet, në bashkëveprim të shëndoshë, të nënkontraktajnë funksione që ngrisin efikasitetin ndaj kontraktuesit më të mirë privat përreth (shiko **Hyrje**) - e kështu duke zvogëluar koston e ngarkesës së shpërndarjes/ofrimit, duke fuqizuar kompanitë lokale dhe përfitime për njerëzit lokalë. Kur kontratat janë të dorëzuara nga çfarëdo mase tjetër përveç me meritë, punë dhe shërbime me cilësi përkrah çmimeve në ngritje atëherë ky është rezultat i rëndomtë. Në rastet kur ofrimi thelbësor i shërbimeve është vetvetiu i nënkontraktuar tek një prodhues tregtar pa proces transparent, kostoja për të varfërin dhe të përjashtuarin është edhe më e ashpër. Duke u përballuar me çmimet e larta dhe, zakonisht, cilësinë e ulët të shërbimeve mbi të cilat varen, të ardhurat, kapacitetet dhe zgjidhjet e tyre – të gjitha tkurren.

Derisa shërbimet e cilësisë janë të prekura nga kontraktimet e korruptuara

qeveritare, puna e denjë është e prekur nga korrupsioni në sferat private të taksave, licensimit dhe kontratave. Kostot e korrupsionit, globalisht e vlerësuar të shtojë 10 përqind për koston e të bërit biznes (Lambsdorff, 2003) ka goditur rëndë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të Kosovës. Kjo vlen për 99 përqind të të gjitha firmave në Kosovë. Me rrjedha të ulëta të parasë dhe margjinave të shtrënguara të fitimit, ato bartin një barrë të rëndë kur vije deri te pagesa e ryshfeteve në tregjet e korrupsionit siç janë ato me bazike si zhdoganimi apo licensat e punës. Gjithashtu, kanë gjasë më pak për të përfituar nga investimet, përfshirë FDI-në, ku korrupsioni shihet si një taksë jozyrtare mbi operimin e biznesit. Kështu, korrupsioni mund të ndikojë negativisht në produktivitetin e Kosovës dhe perspektivën e saj për të krijuar punë të denjë. Llogaritjet nga Lambsdorff (2003) sugjerojnë se një rritje në korrupsion në CPI për një pikë e ul produktivitetin me 4 përqind të GDP-së.

Njerëzit kanë rol të fuqishëm në luftën kundër korrupsionit. Në Kosovë, kjo betejë duhet të përkufizohet si një luftë për shëndetin e shoqërisë, për punë të denjë dhe shërbime më të mira. Si në çdo betejë tjetër, korrupsioni është vështirë të luftohet i vetëm. Rreth 15 përqind të të anketuar kanë deklaruar se ata apo dikush i lidhur me ta i kanë dhënë ryshfete institucioneve në formë të ndryshme. Sipas Barometrit Global të Korrupsionit, 61 përqind e njerëzve të anketuar mendojnë se masat kundër korrupsionit nga ana e qeverisë nuk kanë efekt. Këta njerëz ndjehen vetëm në trajtimin e korrupsionit. Sidoqoftë kur pyetën të anketuarit nëse janë të gatshëm të marrin pjesë në luftën kundër korrupsionit, 70 përqind kanë deklaruar veten të gatshëm t'a raportojnë çdo rast të korrupsionit. Megjithatë, vullneti i individit për të

luftuar korrupsionin është prezent, vetëm se do të duhej të shfrytëzohej në atë mënyrë që t'i bëjë njerëzit të ndihen të sigurtë.

Evazioni tatimor/fiskal në Kosovë është njëloj duke dëmtuar portfolion/mundësinë financiare publike, zgjerimin e tregut dhe kontratës kolektive. Kjo është kryesisht rezultat i dy faktorëve – kostoja e lartë financiare dhe psikologjike në përputhje me rregulla shumë të ndërlikuara, dhe një ekonomi e madhe joformale e cila operon sigurtë jashtë sistemit. Oda Ekonomike e Kosovës e konsideron evazionin fiskal të jetë njërin nga gjeneratorët e vetëm më të rëndësishëm të konkurrencës të padrejtë (Rukiqi 21011). Firmat e intervistuar poashtu raportojnë se ato përballen me konkurrencë shumë jo të drejtë nga konkurruesit të cilët nuk paguajnë taksat dhe të cilët, si rezultat, janë në gjendje të shesin produktet e tyre me çmime dukshëm më të ulëta.

Kosova nuk ka taksa të larta, mirëpo barra e vërtetë e taksave vije nga mënyra se si mbledhen ato taksa. Mesatarisht, bizneset duhet të alokojnë një kohë të konsiderueshme çdo ditë që të merren me rregullore, në interpretimin e ligjit dhe menaxhimin e përputhshmërisë së tyre me to. Kapacitetet e kufizuara brenda administratës tatimore ndonjëherë dërgojnë në dykuptimësi të interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të bazës tatimore, ku si rezultat i saj bizneset taksapaguese shpesh përfundojnë duke paguar dënime sepse nuk kanë mundur të llogarisin si duhet detyrimet e tyre tatimore.


Në mënyrë që të vlerësojmë nivelin e përputhshmërisë me taksa në Kosovë, ne kemi përdorur teknikën e zhvilluar nga Instituti për Zhvillimin e Menaxhimit (IZHM) **Librin Vjetor të Konkurrencës Botërore** dhe **Pikëpamjen** nga Forumi

Ekonomik Botëror, i cili i nivelizon përgjigjet mbi masat indirekte të përputhjes së taksave. Sipas kësaj, ne kemi nxjerrur nivelin e përputhshmërisë me taksa duke nivelizuar përgjigjet ndaj pyetjes anketuese në vijim:

P.51 Çfarë përqindje e shitjeve e një firme tipike në fushën e juaj të aktivitetit do t'a kishit vlerësuar se është e raportuar tek autoritetet tatimore, duke pas parasysh vështirësitë në përputhje me taksat dhe regulloret tjera?

Rezultatet e studimit tregojnë se niveli i evazionit fiskal në Kosovë është rreth 39

përqind – afërsisht njëjtë si vendet tjera, më të shumti në Shqipëri dhe Bosnjë gjatë periudhës 1999 -2005. Megjithatë, është në mënyrë të konsiderueshme përtej vendeve postranzicionale të ndërtuara mirë dhe me mesatare të tyre prej 12.4 përqind. Firmat të cilat në mënyrë të përgjithshme merren me transaksione më pak të dukshme, dhe të fokusuara në para (duke pas parasysh mungesën e kontrollit/auditit të mjaftueshëm dhe mekanizma për gjëritje në Kosovë) janë shpesh më të shpeshtë të taksave – dhe evazionit/ shmangia lidhet mirë me shkallën e joformalitetit në një sektor. Shkalla më




Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

e madhe e evazionit është në sektorin terciar (deri më tani sektori më i gjerë në Kosovë) dhe në atë parësor – duke

treguar përsëri sfidat me të cilat përballen rritja bujqësore dhe mbrojtja e punëtorit rural.

Sipas studimit mbi Barrierat e Ndërmarrjes nga Riinvesti 2011, vetëm 12.5 përqind të ndërmarrjeve të sektorit privat në Kosovë janë anëtarë të asociacioneve të biznesit. Nga këto, shumica (përreth 70 përqind) raportojnë se i takojnë Odës Ekonomike të Kosovës (70 përqind), e ndjekur pas nga Aleanca e Bizneseve Kosovare (16 përqind) dhe Oda Ekonomike Amerikane (8 përqind).

Figura B1 Antarësia e asociacioneve të biznesit



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

Shkalla e ulët e pjesëmarrjes duket të jetë kryesisht rezultat i mungesës së informacionit, siç është raportuar nga 60 përqind e firmave të intervistuar (dhe poashtu 60 përqind prej tyre të cilat nuk i takojnë ndonjë asociacioni). Nga firmat që janë të informuara rreth ekzistencës dhe aktiviteteve të asociacioneve të biznesit mirëpo që kanë vendosur për të mos iu bashkuar njërës nga to, një nga pesë përmend mungesën e besimit në këto asociacione, e kjo si motivim për vendimin e tyre. Për më tepër, shumica e firmave që janë të informuara rreth asociacioneve të biznesit (80 përqind) raportojnë që vendimi i tyre për të mos iu bashkuar është bazuar mbi perceptimin se ata nuk do të përfitonin asgjë nga ai bashkim, apo për shkaqe tjera siç është mungesa e kohës për t'u marr me këtë çështje, e cila, përsëri, duket se sinjalizon se ata nuk e shohin anëtarësimin të vlefshëm.

Shkalla e ulët e pjesëmarrjes dhe fakti se shumica e bizneseve nuk e shohin të vlefshme për t'u bashkuar asociacioneve të biznesit duket të jetë deri diku e justifikuar nëse marrim parasysh përvojën e raportuar të anëtarëve aktual në këto asociacione të biznesit. Në përputhje me perceptimet e jo-anëtarëve, më shumë se gjysma e anëtarëve aktual të asociacioneve të biznesit nuk duket të jenë në veçanti të kënaqur me aktivitetet e asociacioneve të tyre të biznesit, qoftë duke raportuar se ata nuk janë të kënaqur (20 përqind), apo se ata ndajnë një mendim neutral mbi këtë (60 përqind). Pjesa tjetër, 40 përqind, e anëtarëve të asociacioneve të biznesit raportojnë kënaqësi nga përfitimet që rrjedhin nga anëtarësia e tyre.

Rreth 9 përqind e bizneseve e konsiderojnë si gjithnjë të justifikueshëm evazionin fiskal vetëm duke pasur parasysh mjedisin ekonomik dhe biznesor.

Rezultatet poashtu tregojnë se përputhshmëria me taksat ka një marrëdhënie pozitive me madhësinë e firmave. Firmat e mëdha tentojnë të jenë më në përputhshmëri me taksat sesa firmat e vogla. Përveç kësaj, ndërmarrëset gra tentojnë të jenë më pak evazive krahasuar me homologët e tyre, bizneset me transaksione të larta të parasë shmangen më shumë, derisa korrupsioni tenton të afektojë si në mënyrë të konsiderueshme e poashtu edhe negativisht nivelet e përputhshmërisë me taksat.

Dobësia institucionale e minon përputhshmërinë me taksa. Mesatarisht, biznesi është i inspektuar për katër ditë në tërë vitin nga administrata tatimore, dy ditë nga doganat dhe afërsisht pesë ditë nga zyrtarët komunalë. Kosova ka numrin më të ulët të inspektorëve tatimor në 1,000 banorë në rajon. Vetëm 350 inspektorë punojnë në terren. Kosova, kohët e fundit ka hyrë në një proces të kushtueshëm dhe të ndërlikuar të fiskalizimit, me synimin për të pajisur secilin biznes me aparate për regjistrimin e parave – mjaft e kundërshtuar nga pronarët e bizneseve dhe ende është më pak se një e katërta e rrugës përgjatë fazës së gjatë të implementimit.

Dështimi për të paguar taksat në mënyrë kritike afekton Kosovën mbi një numër të niveleve të zhvillimit njerëzor. E zvogëlon kapacitetin e qeverisë për të shpërndarë të hyrat në mënyrë efektive, dhe për të bërë investime kapitale. Krijon një përparësi të padrejtë për kompanitë jo-të-përputhshme, zgjeron stimulim investues për operim jashtë ligjit. Kjo ka një efekt sekondar të rastësishëm mbi mbrojtjet e punonjësit dhe krijimit të vendeve të denja të punës. Poashtu është një indikator i cilësisë së marrëdhënies ndërmjet sektorit privat, qeverisë dhe shoqërisë. Në Kosovë, 9 përqind e

taksapaguesve biznesor e konsiderojnë si gjithnjë evazionin fiskal vetëm duke pas parasysh mjedisin ekonomik dhe biznesor.⁴⁶ Këto biznese e shohin mos-përputhshmërinë si një formë deklarate të protestës kundër qeverisjes së padrejtë dhe joefektive. Megjithatë, më pak se 2 përqind të ndërmarrësve gra e konsiderojnë evazionin fiskal si gjithnjë të justifikueshëm. Veç kësaj, pronarët e bizneseve me nivele të larta arsimimi janë më të prirur për të paguar taksat. Si duket ata ishin më shumë për të lidhur taksat me përfitimet dhe shërbimet që i ofron shteti, duke nënvizuar përsëri rëndësinë kritike të edukimit dhe rritjes ekonomike në kontekstin e shëndoshë social. Veç kësaj, pronarët më të vjetër në Kosovë kanë shkallë më të larta të tatimit parimor (etika e tatimpaguesit) sesa pronarët e rinj, ndoshta për shkak se ata kanë marr më shumë kapital shoqëror dhe se shpesh janë të bashkangjitur fort me komunitetin.

Joformaliteti është drejtuesi qendror i praktikave të padrejta biznese, përfshirë korrupsionin dhe evazionin fiskal. Llogaritjet e Riinvestitit vlerësojnë joformalitetin të jetë 25 përqind e GDP-së së Kosovës.

Ekonomitë joformale nuk janë vetëm të dëmshme. Në shumë vende, një ekonomi joformale është burim thelbësor i punësimit për grupet e marginalizuara të shoqërisë. OECD (2006) tregon se ekonomia joformale përbën 42 përqind të ekonomisë në Afrikë, 41 përqind në Amerikën Latine dhe 35 përqind në ekonomitë e tranzicionit të Evropës dhe ish Bashkimit Sovjetik, krahasuar me 13.5 përqind në vendet e OECD-së. Ekonomia joformale siguron punësim dhe të ardhura për shumë individë të cilët humbasin apo nuk mund të gjejnë punë në ekonominë formale, dhe përfshin një numër joproporcional të grave, të rinjëve dhe tjerëve nga grupet e pafavorizuara.

Megjithatë, në fazën aktuale të zhvillimit të Kosovës, joformaliteti është bërë një formë e përjashtimit – duke mbajtur prapa zgjidhjet për barazi biznesore dhe zvogëlim të varfërisë. Në një klimë të të ardhurave të ulta për frymë banori, shumë ekonomi familjare drejtohen drejt ekonomisë joformale për zgjidhje afatshkurtra për të holla. Ata nuk e kuptojnë se krijimi i tregut me më shumë ndërmarrje formale dhe me më shumë vende pune formale dhe të denja është gjeja thelbësore në perspektivën e mirëqenies afatgjate, stabilitetit dhe zvogëlimit të varfërisë.

Ndërmarrjet joformale i kushtojnë shtetit shumë, mirëpo iu kushton edhe punëtorëve që angazhohen në punë joformale. Me gjasë ata do të jenë më të nën-punësuar dhe do të kenë shkallë proporcionale të pagës më të ulët sesa të njëjtët që janë të punësuar në mënyrë formale. Kështu, ata duhet të punojnë orë më të gjata për të arritur së paku pagën minimale. Ata dështojnë të përfitojnë nga kontributet pensionale për shkak të pagave të ulëta të raportuara, duke i lënë ata të pambrojtur në moshën e vjetër dhe duke bërë ngarkesë mbi familjen. Poashtu, ata me gjasë janë për të paguar më pak taksa personale - gjë që kontribuon në koston shoqërore të përputhshmërisë së ulët me taksa të sektorit privat. Të dhënat nga studimi ofrojnë shifra të ngjajshme mbi joformalitetin e punës me ato për evazionin fiskal, p.sh.: rreth 30-40 përqind e punës në Kosovë është joformale. Evazoni fiskal dhe zgjidhjet joformale të punësimit janë të lidhura; ato te dyjat prioritojnë mirëqenien personale dhe të familjes mbi përfitimet afatgjata shoqërore. Gjetje të ngjajshme në nivelet e evazionit fiskal dhe joformalitetit të punës, gjithashtu shërbejnë për kontrolle të fuqishme në vlefshmërinë e të dy rezultateve.

2.3.2 Zbatim i dobët institucional

Nëse praktikat e padrejta të biznesit minojnë besimin ndërmjet bizneseve, më pas zbatimi i dobët dhe i papërgjegjshëm e minon tërë trupin politik të Kosovës. Niveli i pakënaqshëm i zbatimit rregullativ në Kosovë është identifikuar nga studiues të pavarur si një nga sfidat kyçe me të cilën ballafaqohet rritja e sektorit privat (p.sh. Riinvest 2011; Raporti i Progresit të BE-së 2011). Studimi i kryer i përceptimeve për këtë raport përforcon këtë mesazh. Pronarët e biznesit përsëri potencojnë se ata ndihen të “vetmuar” në menaxhimin e mosmarrëveshjeve mbi obligimet kontraktuale; pasi autoritetet administrative të Kosovës janë joefikase, të ngadalta dhe të pasigurta dhe se rregulloret e hartuara për t’i mbrojtur ata në këtë mënyrë përfundojnë duke u bërë barrë pa ndonjë përfitim.

Mungesa e zbatimit rregullator të përgjegjshëm dhe në kohë të duhur, vështirëson zhvillimin e bizneseve në Kosovë në shumë drejtime. Së pari, bizneset përballen me humbje për shkak të dështimit të blerësve apo furnizuesve të tyre për të përmbushur obligimet kontraktuale, dhe për të cilët nuk ka pasojë. Një prodhues bylmeti i intervistuar, për shembull, raporton se ka marr një hua nga një institucion financiar ndërkombëtar për të blerë lopë të cilat janë shpërndarë tek fermerët. Këta të fundit, në shkëmbim, janë obliguar t’a rikthejnë një pjesë të huasë dhe të furnizojnë prodhuesin me qumësht, të cilët nuk e kanë bërë kurrë. Kompania raporton se padia e ngritur tetë vite më parë rreth kësaj çështjeje është ende e hapur. Fatkeqësisht, ashpërsia e pasojave të problemeve si kjo shtrihet përtej kostos së humbjeve direkte që pëson firma. Domethënë, pasiguria që paraqet mungesa e zbatimit të kontratës, është e mundshme të parandalojë firmat

që të hyjnë së bashku në transaksione biznesore. Dhe kjo me gjasë mund të jetë njëra nga arsyet se pse zgjatja e kredisë nga firmat për klientët dhe blerjet me kredi nga firmat të raportuara nga kompanitë Kosovare janë shumë më të ulëta sesa ato të raportuara nga ekonomitë tjera tranzicionale në rajon, e gjithashtu edhe ato në Evropë dhe Azi Qendrore (EAQ) në përgjithësi (Banka Botërore 2010). Ky ngurrim për të bërë pagesat duke përdorur kredinë, dhe të zgjerojë kreditin te klientët vepron duke bërë blerjet dhe shitjet e produkteve më të vështira për firmat Kosovare. Zbatimi i dobët është gjithashtu pjesërisht përgjegjës për një kulturë të mosndëshkimit rreth përputhshmërisë mjedisore, duke përkeqësuar ndotjen e tmerrshme dhe eksploatimin mjedisor të Kosovës.

Pamundësia për të zbatuar kontratat afekton nivelin e investimeve të firmave në aftësitë e punonjësve të tyre dhe në kapacitetet e tyre inovative. Firmat në disa sektorë raportojnë tërheqjen e punonjësve si një problem të madh. Për shkak të mungesës së mekanizmit për zbatimin e kontratave të punësimit, firmat që investojnë në trajnime të shtrenjta të punonjësve përfundojnë duke i humbur punonjësit e tyre tek konkurruesit. Si rezultat, firmat Kosovare si duket janë larg investimit në trajnimin e punonjësve krahasuar me ekonomitë tjera në tranzicion (Banka Botërore 2010). Kjo është në veçanti brengosëse sepse në mënyrë direkte prek konkurrencën e firmave Kosovare në treg dhe vështirëson zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve me vlerë të lartë të shtuar, të cilat janë relativisht intenzive në aspektin e shkathtësive.

Zbatimi është, së paku pjesërisht, përgjegjës për dobësinë e FDI-së së Kosovës. Për shembull, pamundësia e qartë për mbrojtje të suksesshme me

gjyq kundër shkeljeve të patentave, të drejtat e pronës intelektuale (DPI) apo të drejtat autoriale, është përceptuar si një pengesë nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (Musa 2011), dhe në veçanti nga kompanitë në sektorin ICT. Kosova shihet si një sprovë me rrezik të lartë për çdo ndërmarrje me aftësi të larta dhe që sjell vlera siç janë zhvilluesit e softuerëve - të cilët mund të joshin një brez të ri relativisht jo të shtrenjtë, të etur dhe me sens të lartë për teknologjinë informative, mirëpo të cilët nuk janë të gatshëm t'i transferojnë njohuritë dhe pronësinë intelektuale të tyre tek filialët (kompanitë e kontrolluara nga kompania që blen dhe posedon aksionet e kompanive tjera).

Si rezultat i zbatimit të dobët rreth korrupsionit dhe evazionit, mirëbesimi publik në Kosovë është duke u dobësuar. Studime të shumta kanë gjetur se në vendet në tranzicion, kapitali shoqëror në formë të pjesëmarrjes civile dhe besimit në institucionet publike ka një ndikim të konsiderueshëm në rritje (Putnam 1993; Fukuyama 1995; Knaack dhe Keefer 1997; Dasgupta dhe Sergaldin 2000; Zak dhe Knack 2001). Në sferën politike, besimi është treguar se kontribuon në zgjidhjet e problemeve të veprimit kolektiv⁴⁷ (Levi 1998; Uslaner 2002; Rothstein 2003b), në stabilitetin demografik (Inglehart 1999; Uslaner 2003) dhe në pjesëmarrjen politike dhe civile (Knack dhe Keefer 1997). Kësisoj, besimi i përgjithshëm shihet të ketë rëndësi për cilësinë e qeverisjes në atë mënyrë që është vështirë të ndahet nga rritja ekonomike. Kështu, korrupsioni minon legjitimitetin e shtetit dhe sundimit të ligjit, dhe mund të dobësojë aftësinë e shtetit për të mbrojtur sistemin e saj të vlerave. Njëherë që situata e qeverisjes përkeqësohet, atëherë bëhet jashtëzakonisht vështirë për të rikthyer sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë dhe


mirëbesimin ndërmjet qytetarëve dhe shtetit.

Si rrjedhim, Kosova është duke përjetuar mirëbesim relativisht të ulët në institucione krahasuar me mirëbesimin në biznese dhe njerëz në përgjithësi. Një vëzhgim interesant është se niveli i mirëbesimit në çfarëdo institucioni publik është më i ulët se ndonjë nga nivelet e mirëbesimit në çfarëdo kategori tjetër. Mesatarisht, institucionet publike kanë një rezultat të intenzitetit prej 65, krahasuar me besimin e përgjithshëm në njerëz (" shumica e njerëzve ") dhe kategoria e ndërlidhjeve të biznesit / personeli / konkurruesit, me rezultat prej 78, përkatësisht 92. Ky perceptim i matur deri në një masë kundërshton

gjetjet se praktikatat e padrejta të biznesit siç janë të implementuara nga bizneset vetë janë barrierat kryesore për rritje (shih Ilustrimin 2.1 me lartë). Ky paradoks ka një sqarim: në vështirimin e të anketuarve, është puna e qeverisë për të zhdukur praktikatat e padrejta – dhe derisa qeveria të veprojë, bizneset vetëm do të bashkëveprojnë në mënyrë shumë të kujdesshme me partnerë të besueshëm dhe të dëshmuar.


Ilustrimi 2.6 përmbledh nivelet e besimit në institucione të ndryshme publike siç është e matur nga përqindja e menaxherëve dhe pronarëve të bizneseve të cilët kanë raportuar se këtyre institucione janë të besueshme.

Figura 2.5 Besimi në grupe të entiteteve (intenziteti)



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

Figura 2.6 Besimi në institucione (intenziteti)



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

Fatkeqësisht, siç shihet në ilustrimin 2.6 më lartë, është saktësisht sistemi gjyqësor, i cili është dashur të vendos një nivel të fushës së lojës për bizneset dhe t'i mbrojë ato nga praktikatat e padrejta nga institucionet apo ndërlidhjet e tyre të biznesit, të cilat janë më së paku të besuara nga bizneset, në nivel prej vetëm 54 përqind. Në shikim të parë, kjo gjetje mund të duket kontradiktore me rezultatet e studimit BEEPS (Banka Botërore 2010), sipas së cilës përqindja e firmave që raportojnë se gjyqet nuk janë problem në bërjen e biznesit është 10 pikë të përqindjes më e lartë në Kosovë (në 56 përqind) krahasuar me ekonomitë mesatare në rajon të vendeve të Evropës Juglindore dhe me ekonomitë në tranzicion të vendeve të Evropës Qendrore. Megjithatë, leximi i kësaj shifre nën dritën e përfundimit, se vetëm tre përqind të firmave Kosovare (BEEPS 2010) kanë qenë në gjyq në tri vitet e shkuara krahasuar me mesataren prej 32 dhe 27 përqind në vendet e EJT, përkatësisht EQ-së, një konkludim më i duhur shihet të jetë se bizneset Kosovare nuk kanë besim në sistemin gjyqësor, dhe se nuk e marrin parasysh në vendim-marrjen e tyre.

Kosova ka potencialin për të përkthyer kulturën e saj të pabarabartë të ndërmarrjes në një model të rritjes me përfitime të gjëra në vend të përfitimeve të ngushta.

Prandaj, zbatimi i dobët është jashtë-zakonisht i kushtueshëm për kulturën e ndërmarrjes në Kosovë. Në fakt, është një sfidë fundamentale e zhvillimit njerëzor për Kosovën, më në përgjithësi, e cila përfshin të gjithë sektorët e qeverisjes. Do të ishte absurde të sugjerohet se zbatimi mund të fuqizohet për ndërmarrjet private përderisa mbetet e dobët gjithkund tjetër. Një kulturë e llogaridhënies ende mungon nga një sistem i qeverisë e cila prioritetizojnë nxjerrjen e ligjeve mbi implementimin. Poashtu, ekziston një mospërputhje ndërmjet barrës së rregullores dhe burimeve financiare si dhe kapaciteteve njerëzore të disponueshme për t'i operacionalizuar këto sisteme.⁴⁸

Si rezultat, mungesa e zbatimit në ndërmarrje i ofron Kosovarëve një dëmtim të dyfishtë: së pari, minon shërbimet, zgjidhjet dhe liritë që janë në dispozicion për ta në komunitetet e tyre; dhe së dyti, minon potencialin për një rritje ekonomike e cila mund të jetë e mundshme, jashtë qeverisë, për të zgjeruar zgjidhjet dhe liritë për të gjithë. Ky zbatim i dobët institucional është një faktor kritik në krijimin e fushës së "padrejtë" dhe të pabarabartë që shumë biznese ndjejnë se janë burimet më të mëdha të përpjekjeve të tyre. Ajo i nxë frymën impulsit **nxitës** për rritje dhe kufizon **zgjerimin** e rritjes, atëherë kur kjo ndodh, ndaj mbulimeve të privileguara të shoqërisë.

2.4 Implikimet e politikave si barriera të sektorit privat

Ekonomia e Kosovës është duke u rritur në "xhepa". Pjesë të favorizuara të shoqërisë, me lidhjet e duhura, kanë më shumë gjasa të depërtojnë në një klimë të madhe joformale aty ku rregullat nuk janë të zbatuara në mënyrë sistematike.

Rritja gjithëpërfshirëse, megjithatë, nuk është duke ndodhur. Rritja gjithëpërfshirëse do të thotë, në esencë, një model i rritjes që hap mundësi për të varfërit dhe të marginalizuarit, e cila hap dyertë e tregjeve kryesore për gratë, rininë dhe minoritetet etnike, e cila iu mundëson kompanive të konkurrojnë hapur bazuar në performancë dhe merita, e cila - me pak fjalë - ngrit dinjitetin, kohezionin social, të ardhurat dhe zgjidhje jetësore të përmirësuara që prek tërë shoqërinë.

Arsyeja për mungesën e rritjes gjithëpërfshirëse është e kapur në barrierat parësore me të cilat ballafaqohet

zhvillimi i sektorit privat: praktika të padrejta biznesi të nderlidhura me zbatime të dobëta. Megjithatë, aty qëndron mundësia e gjithashtu kufizimi. Kosova ka potencialin për të përkthyer kulturën e saj të pabarabartë të ndërmarrjes në një model të rritjes me përfitime të gjëra në vend të përfitimeve të ngushta. Nëse ky potencial do realizohej, do të ishin të nevojshme disa ndryshime thelbësore:

- **Ngritje e transparencës ndërmjet sektorëve publik dhe privat:**

Pjesa më e madhe e barrierave kritike të identifikuara nga pronarët e bizneseve kanë pasur të bëjnë me bashkëveprimin ndërmjet kulturës së ndërmarrjes dhe qeverisjes - çështjet e drejtësisë, barazisë, transparencës dhe llogaridhënies. Ata janë shumë më pak të lidhur me çështjet makro-ekonomike të barrierave tregtare, çështjet e vizave dhe investimeve direkte të huaja të cilat tentojnë të dominojnë dialogun mbi regjenerimin e sektorit privat të Kosovës. Vendim-marrësit e Kosovës duhet të fokusohen nga brenda, për të eksploruar dinamikën të cilat i bëjnë bizneset të mosbesueshme ndaj njëra-tjetrës dhe të drejtësisë administrative nga autoritetet regullative. Kërkohet një dialog më i hapur, i rrjedhshëm mbi çështjet, përgjatë sektorëve, përfshirë bizneset të cilat aktualisht janë jashtë ekonomisë formale. Transferimi i ekonomisë joformale të Kosovës në tregje kryesore do të arrinte shumë për të nxitur barazinë, përmirësuar alternativat për punë të denjë dhe për të nxitur zgjerimin e sektorëve të gatshëm rritës.

- **Sjell llogaridhënie më të madhe të qeverisjes nëpër sektorët publik dhe privat:** barrierat ndaj rritjes gjithë-përfshirëse janë

të lidhura shumë fuqimisht me barrierat më të gjëra të zhvillimit njerëzor të Kosovës - mungesa e llogaridhënies, mbrojtje të dobëta sociale dhe sensi i të qenurit "i pambrojtur" nga autoritetet. Kjo në shkëmbim hudh pronarët e bizneseve dhe punonjësit prapa në burimet e tyre të veta, shtrëngon mbështetjen e tyre mbi besnikëritë etnike dhe dërgon në mosgatishmërinë për të bashkëpunuar për të mirën publike. Gjatë viteve të ardhshme, Kosova ka nevojë për një fokus të përbashkët në implementimin e përgjegjshëm të politikave të saj, në sferat publike dhe private. Llogaridhënia në sektorin privat përfshin të qenurit në kohë të duhur; biznesi është duke lëvizuar shpejtë, dhe implementimi i ngadaltë, për shembull, zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kontra-tës përmes gjyqit, është më i pranueshëm (nëse jo më keq) se sa pa implementim fare - I kushton "xhepit" publik pa u ofruar ndonjë përfitim të qëndrueshëm të rritjes. Llogaridhënia forcon marrëdhënien ndërmjet individëve dhe qeverisjes, dhe ndërton mirëbesimin publik. Llogaridhënia poashtu nënkupton konsultim dhe dukshmëri, përfshirë edhe nivelin lokal, ku biznesmenët mund të përfitojnë nga një marrëdhënie më e afërt dhe sistematike me autoritetet komunale gjatë zhvillimit të cikleve të planifikimit. Kjo është në veçanti e vërtetë për sektorët e nënzhvilluar që mbesin shumë joformal - siç është bujqësia.

- **Përkrah edukimin dhe iniciativat për promovimin e aleancave sociale-biznesore:** mungesa e kohezionit social në Kosovë është e reflektuar në marrëdhëniet e saj biznesore, ku individët nuk ndjehen

rehat me heqjen e përparësisë së menjëhershme private për përfitime sociale afatgjata. Aty ku kolegët dëshirojnë të kontestojnë strategji të tilla siç janë evazioni fiskal apo korrupsioni, pronarët e bizneseve në Kosovë ndjehen të mbështetur apo të mbrojtur në mënyrë të pamjaftueshme për t'a bërë atë. Aty ka nevojë të jetë një sistem shumë më rigoroz që mbështet qasjen e frymës publike ndaj biznesit, edukimit të pronarëve mbi vlerat e kontributit të tyre për të ardhurat publike. Kjo përfshin të treguarit e vlerave në komunitetet lokale, ku pjesa më e madhe e ndërmarrjeve shoqërore publike të Kosovës e derdh rrjedhën e të ardhurave.

- **Nxit dëshirën për shkathtësi dhe inovacion:** prioritetet dhe perceptimet e pronarëve të bizneseve mund të ndryshojnë nga ato të atyre që i punësojnë. Megjithatë, punonjësit rrallë gjejnë forume që të shprehin pikëpamjet dhe preokupimet e tyre. Potenciali i tyre

është gjithashtu i nënvlerësuar në treg, aty ku ka kërkesë të kufizuar për shkathtësi, njohuri dhe aftësi më të larta përpos faktit që lidhja ndërmjet një fuqie punëtore më të edukuar dhe niveleve më të larta të drejtësisë dhe përputhshmërisë, është e dokumentuar mirë. Si pronarët e bizneseve poashtu edhe punonjësit kanë nevojë për më shumë informata mbi mundësitë që janë në dispozicion për ta dhe përgjegjësitë e tyre për njëri tjetrin. Duke pas parasysh nivelin e lartë të pronësisë individuale të biznesit dhe shifrave të mëdha të rinisë së papunë në Kosovë, edukimi në kontekstin social të ndërmarrësisë duhet të fillojë që në shkollë.

Barrierat e biznesit në Kosovë nuk janë njësoj të aplikuara nëpër të gjitha ndërmarrjet. Ato afektojnë klasa të ndryshme të biznesit në mënyra të ndryshme. Kapitulli tjetër do të shikojë se si ata që kanë më së shumti nevojë të përkrahjes për t'iu bashkuar tregut në Kosovë i përjetojnë ngritjet dhe uljet e kësaj klime të pasigurtë të biznesit.

Ndikimi mbi tregun në favor të njerëzve

“Të gjitha virtytet janë të përmbledhura për t’u trajtuar drejtësisht”
Aristoteli (filozof grek)

Ky kapitull eksploron se si barrierat e përgjithshme ndaj bizneseve të identifikuar në kapitullin e kaluar prekin lloje të ndryshme të bizneseve dhe segmenteve të shoqërisë. Parashtron pyetjen nëse barrierat e biznesit siç janë të përceptuara në Kosovë afektojnë vetëm bizneset, apo kanë implikime më të gjëra për strukturën socio-ekonomike të Kosovës. Së pari, shqyrton ndikimin e barrierave bazuar në madhësinë e biznesit dhe përgjatë ndasive urbane-rurale. Pastaj, shikon në ndikimin e gjërë mbi barazinë gjinore, kontratën sociale dhe ndërmarrësinë në shoqërinë Kosovare.

3.1 Ndikimi mbi zgjerimin gjithëpërfshirës dhe krijimin e vendeve të punës

Zgjerimi i ndërmarrjes është prioritet kritik biznesor i Kosovës. Mbi 96 përqind të bizneseve të Kosovës janë të vogla, të cilat kanë të punësuar më pak se dhjetë njerëz (shiko tabelën 1.3, Kapitulli 1). Prandaj, nuk është për t’u habitur se përjetimi i barrierave të biznesit bëhet më intensiv kur firma fillon të rritet. Kompanitë me 10 deri 50 punonjës kanë më shumë gjasa të vuajnë nga praktikatat e padrejta të biznesit sesa kompanitë me më pak se dhjetë punëtorë. Kompanitë e mëdha vuajnë më shumë sesa të voglat në aspektin e qasjes në pjesën vitale të zgjerimit të biznesit –

financimi, infrastruktura, procedurat administrative dhe shkathtësitë.

Qasja në financim për ndërmarrjet mesatare (punësimi i me shume se 50 personave) është një shembull i mirë i rastit. Një masë e madhe e literaturës sugjeron se qasja në financim është një përcaktues i rëndësishëm i investimeve të firmës. Cabral dhe Mata (2003) tregojnë se zgjerimi i firmave është i vështirësuar nga kufizimet financiare, dhe rezultojnë në shpërndarje më të ulët të madhësisë së firmës. Në të vërtetë, Tabela 3.1 tregon se ekziston një ndryshim i qartë dhe i dukshëm në koston e financimit dhe në qasjen në financim krahas rritjes së firmave. Kostoja e financimit rezulton me 83.3 për bizneset mesatare krahasuar me 59.4 për biznese të vogla dhe 57.8 për mikro-firma, ndërsa qasja në financim ka një intenzitet prej 75 për firmat mesatare, respektivisht 59.4 dhe 56.5 për firmat e vogla dhe mikro-firmat. Për më tej, një intenzitet i tillë e vendos koston e financimit në krye të barrierave për firmat mesatare (50 – 250 punonjës), duke tejkaluar konkurrencën e pandryshme, e cila mbeti e fuqishme nëpër integritet të ndryshme. Marrëdhënia pozitive ndërmjet madhësisë së firmës dhe koston për financim vë në qendër jo e befasishme. Së pari, firmat më të vogla tentojnë të kenë nevojë më të ulët të kapitalit dhe kështu janë më pak të përfshira në aplikimet për huadhënie, p.sh. janë të lira nga ngarkesat e rënda financiare (kostoja

Si një biznes që kërkon të zgjerohet dhe të rris grupin e shkathtësive të veta si dhe të integrohet me ekonominë më të gjëra të BE-së, vuan nga një sërë pengesash të renditura shumë më poshtë nga ndërmarrjet e vogla.

dhe qasja). Për më tepër, duke ditur shkallët aktuale të interesit, ngarkesa e borxhit është shumë më e vogël dhe më e përballueshme për këtë grup të firmave. Së dyti, firmat e mëdha jo vetëm që proporcionalisht kanë shkallë më të larta të interesit, mirëpo përkundrajt firmave të vogla, ato kanë më shumë nevoja kapitali, dhe janë më shumë të prirura të përceptojnë ngarkesën në aspektin e kostos për financim apo qasjes në financa. Së treti, në lidhje me qasjen në financa, firmat e vogla kanë më shumë alternativa në

janë të dizajnuara në mënyrë specifike që të financojnë shumën të vogla të kapitalit, siç është në rastin e mikro-ndërmarrjeve.

Një marrëdhënie lineare poashtu është vëzhguar ndërmjet korrupsionit dhe madhësisë së firmës. Firmat më të mëdha janë subjekt i tenderëve publikë të prokurimit dhe kështu përballen me korrupsion institucional shumë më shpesh se firmat e vogla apo mikro-firmat. Barrierat institucionale, lineare me madhësinë, janë poashtu prezente

TABELA

3.1

Barrierat e bizneseve sipas madhësisë së bizneseve në Kosovë (rezultati më i madh në secilën kategori është i theksuar me të zezë, ku 20 është intensiteti më i ulët dhe 100 më i larti)

		Mikro	E vogël	Mesatare
1	Qasja në shërbimet e biznesit dhe informatat	37.9	44.6	35.7
2	Qasja në financim	56.5	59.4	75
3	Qasja në shfrytëzimin e tokës	35.5	40.5	50
4	Praktikat kundër-konkurrese të konkurrentëve tjerë	67.8	76.8	75
5	Licensimi i biznesit dhe lejet	40.1	42.8	42.9
6	Shkelja e kontratës nga Konsumatorët dhe Furnizuesit	58.8	65.1	75
7	Korrupsioni	62.1	66.9	70.8
8	Kostoja e financimit	57.8	59.4	83.3
9	Doganat dhe rregulloret tregtare	47.6	55.6	53.6
10	Rryma	63.2	70.3	68.8
11	Funksionimi i sistemit gjyqësor	53.1	62.2	67.9
12	Rregulloret e punës	37.5	43.5	46.4
13	Krimi i organizuar dhe mafia	61.5	64.7	50
14	Jostabiliteti politik	58.5	68.4	70.8
15	Standardet e prodhimit	46.9	53.6	41.7
16	Shkathësitë dhe edukimi i punonjësve në dispozicion	37.4	46.7	60.7
17	Krimi në rrugë, vjedhja dhe ç'rregullimi	65.5	65.7	62.5
18	Administrata Tatimore	49.4	51.6	57.1
19	Normat e taksave	49.9	54.8	57.1
20	Telekomunikimi	34.9	36.2	39.3
21	Transportimi	39.5	45.8	60.7
22	Konkurrenca e padrejtë (evazioni dhe joformaliteti)	75.7	84.9	78.6

Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjeve Riinvest 2011

financimin e nevojave të tyre, se përveç bankave, Kosova ka disa institucione mikro-financiare të themeluara mirë, të cilat mbulojnë deri 20 përqind të huadhëniesve totale të ofruara brenda një viti (BQK 2011). Këto institucione

në çështjet e taksave. Firmat mesatare e shohin administratën tatimore dhe shkallët e taksave si barrierë konsiderueshme më të larta sesa që e shohin firmat e vogla dhe mikro-firmat. Kjo përforcon besimin e përgjithshëm

se administrata tatimore shënjestron kompanitë e mëdha për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore që kanë në dispozicion, me synimin e optimizimit të mbledhjes së të ardhurave më një kapacitet të caktuar. Intervista me asociacionet e biznesit në Kosovë zbuloj se kompanitë e mëdha ankohen shumë më shumë rreth trajtimit të pandershëm, inspektimeve të gjata apo dënimeve të padrejta nga inspektorët tatimor, përkundrejt firmave të vogla të cilët rrallëherë janë në kontakt direkt me mbledhësit e taksave. Në lidhje me kërkesat tatimore, kompanitë më të mëdha nënvizojnë rëndësinë e mbledhjes së TVSH-së si një barrierë për zgjerimin e tyre. Nën ligjet e TVSH-së së Kosovës, shumica e investimeve dhe materialet e papërpunuara janë të obliguara të mbajnë një barrë prej 16 përqind të TVSH-së në kufi, para se të ndodh ndonjë operim që investimi të jep rezultat. Sipas asociacioneve të biznesit, një barrë e tillë rrit vështirësitë me rrjedhjen e parasë në biznese dhe, si pasojë, nevoja për t'u futur në obligime të huamarrjes me shkallë të larta të interesit (14-16 përqind në mesatare). Kjo, në shkëmbim, pengon qëndrueshmërinë e rrjedhës së parasë, potencialit të rritjes dhe krijimit të vendeve të reja të punës. Një barrë e tillë, megjithatë, është më pak prezente në mesin e firmave të vogla, pasi që ato janë të obliguara me ligj të paguajnë një taksë fikse. Megjithatë, bizneset me qarkullim më pak se 50,000 euro nuk janë të obliguara të deklarojnë TVSH-në. Për këtë shkak, shkallët e taksave dhe administrata tatimore shfaqen në fundin e listës së barrierave për firmat e vogla, dhe kanë renditje më të lartë në mesin e firmave më të mëdha.

Një joproporcionalitet i madh, poashtu ekziston ndërmjet madhësisë së firmës dhe funksionimit të sistemit gjyqësor, me firmat mesatare që kësaj barriere i kanë dhënë rezultat me intenzitet prej 75, krahasuar me 59.4 dhe 56.5

për ndërmarrjet e vogla dhe mikro. Kuptohet, kontratat, të drejtat pronësore dhe çështjet tjera juridike janë më prezente më shumë në kompanitë më të mëdha sesa në firmat e vogla. Nga natyra, kompanitë më të mëdha kanë më shumë aksionarë (kontraktorët, punëdhënësit, blerësit) në operacionet e tyre, dhe kësajsoji kanë më shumë obligime juridike, të cilat në fund, duke marr parasysh pamjaftueshmërinë dhe paaftësinë e gjyqeve për të adresuar rastet e biznesit, mbesin të pazgjidhura. Shkeljet e kontratës nga konsumatorët dhe furnizuesit janë të vlerësuara saktësisht me rezultat të njëjtë (75) nga firmat më të mëdha, duke vepruar si një kontroll fuqie për gjetjet e mësipërme.

Një çështje shumë e dukshme duket të jetë ngritja e konsiderueshme e rëndësisë së shkathtësive dhe edukimit të punëtorëve në dispozicion me rritjen e madhësisë së firmës. Një rezultat prej 60.7 në mesin e firmave mesatare, krahasuar me 46.7 dhe 37.4 në firmat e vogla, përkatësisht mikro, tregon se me zgjerimin e bizneseve ekziston një nevojë e paplotësuar për fuqi punëtore të kualifikuar apo më të shkathtësuara. Për bizneset Kosovare mungesa e një fuqie punëtore të kualifikuar është po aq e kufizuar, madje edhe pak më shumë, sesa normat e taksave apo administrata tatimore. Në lidhje me këtë, Riinvest ka kontaktuar tetë kompani mesatare për të marr përceptimin e tyre mbi këtë çështje. Pothuasje të gjithë pronarët kanë deklaruar gatishmërinë e tyre për të ndarë pronësinë nga menaxhmenti për shkak të nevojave zgjeruese të biznesit të tyre, edhe pse asnjëri nga ta nuk ka qenë në gjendje të gjejë individë të besueshëm me shkathtësi të vërtetuara menaxheriale. Një gatishmëri e tillë është e re në traditën Kosovare të biznesit, pasi që shumica e bizneseve të mëdha janë ende të drejtuara nga rregullat familjare dhe hierarkia,

mirëpo mungesa e menaxhmentit të aftësuar dhe të kualifikuar nuk iu lejon pronarëve të kalojnë tërë kompetencat menaxheriale tek dikush jashtë rrethit të familjes. Firmat e njëjta poashtu kanë shënuar mungesën e fuqisë punëtore të shkathtësuar në nivel të mesëm hierarkik. Bazuar në përceptimet e tyre, prapavija edukative e punëtorëve potencial është shumë joproporcionale me nevojat aktuale të biznesit. Një pronar ka deklaruar “Nevojitet së paku një vit e gjysmë për ata që të kuptojnë natyrën e vërtetë të mjedisit biznesor, e cila në fund të fundit nuk është diçka me të cilën ata kanë ardhur përmes nivelit të cilësisë”. Për të tjerët, nëse fuqia punëtore e kualifikuar është në dispozicion, atëherë ajo është shumë e shtrenjtë.

Firmat mesatare poashtu përjetojnë pengesa më të mëdha infrastrukturore, përfshirë transportimin (e renditur me rezultat prej 60.7 për ndërmarrje të madhësisë mesatare, 45.8 për të voglat dhe 39.5 për mikro-ndërmarrjet). Bizneset më të mëdha në Kosovë kërkojnë integrim me tregjet Evropiane se sa që kërkojnë vetëm të shërbejnë klientët vendor. Shumica e importeve të mallrave dhe shërbimeve (në vlerë rreth 2.6 miliardë euro) në Kosovë janë të drejtuara nga ndërmarrjet mesatare. Ngjajshëm, rreth 900 milion euro vlerë e mallrave dhe shërbimeve të eksportuara janë të ndërmarrja nga ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha. Këtu, çështjet e zgjidhjes së statusit të Kosovës shkaktojnë vështirësi të konsiderueshme. Disa biznese të madhësisë mesatare të intervistuar iu është dashur të shfrytëzojnë dokumentacionin zyrtar nga vendet tjera (p.sh. leja e vozitjes, pasaporta, numrat e regjistrimit të automjetit), e cila në shkëmbim ka shtuar koston e tyre operative. Për periudhën e pas-pavarësisë (që nga 2008), këto kosto

kanë qenë edhe më të larta duke marr parasysh bllokadën e njëanshme të Serbisë dhe Bosnjës ndaj të gjitha produkteve që mbajnë Vulat e Doganave të Kosovës, një obligim për secilin eksportues.

Krijimi i biznesit të ri është poashtu një burim potencial i vendeve të reja të punës. Një mori në rritje të literaturës mbi performancën e tregut të punës potencon rolin e ndërmarrësisë dhe dinamikave të firmës. Në një mjedis të favorshëm për ndërmarrësi, dhe aty ku fillimi i një biznesi është i lehtë, rezultatet e tregut të punës, siç është raporti i punësimit, tenton të jetë dukshëm më i mirë sesa në mjedisin ku ka kufizime mbi ndërmarrësit dhe aty ku është vështirë të hapet një firmë (Krueger dhe Pischke 1997; Boeri dhe Martins 2000; Scarpetta et al. 2002; Lopez-Garcia 2003).

Krijimi i ndërmarrjes është i kufizuar vetëm për ata me kapital rezervë personal, duke përjashtuar ata të cilët mund jenë më të fuqizuarit nga pronësia e biznesit dhe pengimin e krijimit të vendeve të denja të punës.

Siç është diskutuar në Kapitullin 1, kultura e ndërmarrjes në Kosovë tashmë ka një shkallë të lartë të krijimit së bizneseve. Megjithatë, nëse krijimi mund të kombinohet me zgjerimin, atëherë ekzistojnë më shumë mundësi për punëtorët që të futen në treg, të rrisin shkathtësitë, të lëvizin në biznese më komplekse dhe me vlerë të lartë të shtuar. Për të hulumtuar më tutje barrierat për bizneset fillestare, raporti i tanishëm shikon më thellësisht në firmat të cilat janë themeluar gjatë dy viteve të shkuara. Këto firma llogariten për 14 përqind të firmave


të përgjithshme të anketuara dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për përfaqësim statistikor⁹⁹. Kur krahasohen barrierat për bizneset fillestare me barrierat e përgjithshme në Kosovë ne vërejmë një tendencë të gjërë të rënies në intensitet. Shumica e barrierave për bizneset fillestare janë më pak kufizuese sesa për firmat e themeluara – veçanërisht atyre që kërkojnë të zgjerohen. Funksionimi i sistemit gjyqësor dhe qasja në financa është e renditur relativisht lartë për bizneset fillestare. Ndërkohë, konkurrenca e padrejtë dhe kostoja e financimit

mbesin kryesisht në nivel të njëjtë për bizneset fillestare.

Financimi është i detyruar të jetë një preokupim i madh për ata që dëshirojnë që të bëjnë shpenzime kapitale fille-stare për të zhvilluar biznesin. Mungesa e të mbështeturit në banka paragjykon krijimin e bizneseve të reja përkundrejt atyre pa kapital të gatshëm – të varfërit, gratë dhe rinia. Përafërsisht tre nga çdo i katërti biznes fillestar ka shfrytëzuar kapitalin vetjak (shiko Kapitullin 2, ilustrimi 2.2) për të zhvilluar biznesin. Interesant është që financimi nga bankat është i

Figura 3.1

Intensiteti i barrierave, i perceptuar prej bizneseve të sapo formuara në Kosovë krahasuar me bizneset në përgjithësi (ku 20 është intensiteti më i ulët dhe 100 më i larti)




renditur me rezultat të shpeshtësisë së ngjajshme me financimin e dhënë nga shokët dhe familja (rreth 10 përqind). Remitancat përbëjnë vetëm 2 përqind të financimeve të bizneseve fillestare, duke sugjeruar që kjo pjesë e madhe e GDP-së së Kosovës nuk është duke u ri-investuar në rritje, mirëpo, është e shfrytëzuar për mbijetesë, kursime apo nevoja bazike.

Financimi duket se peshon proporcionalisht rëndë mbi paraqitjen e aktiviteteve të reja biznesore - qoftë prej të parës apo e inicuar nga kompanitë ekzistuese. Anketuesit e studimit kanë thënë se firmat në Kosovë janë duke operuar në kufirin e fitimeve të tyre, pa pasur alternativa të shumta (p.sh. fonde të brendshme) për t'u zgjeruar. Kjo ka një ndikim si mbi krijimin e biznesit e poashtu edhe në zgjerimin e biznesit. Krijimi i ndërmarrjes është i kufizuar vetëm tek ata me kapital rezervë personal, duke përjashtuar ata të cilët mund të jenë më të fuqizuarit nga pronësia e biznesit dhe pengimin e krijimit të punës së denjë.

Në përmbledhje, zgjerimi i bizneseve në Kosovë është jashtëzakonisht i kushtueshëm dhe një ushtrim i rrezikshëm. Si një biznes që kërkon të zgjerohet dhe të rris grupin e shkathtësive të veta si dhe të integrohet me ekonominë më të gjërë të BE-së, vuan nga një sërë pengesash të renditura shumë më poshtë nga ndërmarrjet e vogla. Nga perspektiva e kërkesës për punë, ky është lajm i keq. Ndërmarrjet mesatare janë thelbësore në ndërtimin e kërkesës për punë në Kosovë dhe të ngritjes së stimulimit për punëtorët e rinjë që të aftësohen më shumë për biznese më konkurruese. Kjo analizë e barrierave ndaj zgjerimit të bizneseve përforcon shkallën në të cilën kultura e ndërmarrjes së Kosovës favorizon bizneset e vogla dhe joformale, të drejtuara nga ata me kapital paraekzistues. Përderisa, këto lloje të bizneseve kanë përparësi, mbështetja në to për përjashtimin e ndërmarrjeve tjera i mbron Kosovës shumë përfitime direkte dhe jodirekte të rritjes private dhe zhvillimit njerëzor. Poashtu, kufizon pjesëmarrjen e atyre

Figura 3.2

Barrierat e identifikuar prej përfaqësuesve të bizneseve (përqindja e bizneseve, ku përfshihen si bizneset e sapo krijuara ashtu edhe ato ekzistuese)



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

të cilët veçse u janë mohuar mundësitë për t'u futur në tregun e Kosovës – edhe njëherë duke ndarë rritjen nga përfitimet e zhvillimit njerëzor.

3.2 Ndikimi mbi ndasitë gjeografike-sociale

Analizat se si përjetohej barrierat e biznesit në gjashtë rajonet e Kosovës (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan dhe Ferizaj) sugjerojnë se ato janë duke i thelluar ndasitë, në vend se të shtojnë koherencën e tregut. Në përgjithësi, intenziteti më i lartë i barrierave është vëzhguar në Prishtinë, me intenzitetin më të ulët në Prizren dhe Ferizaj (shiko Tabelën 3.5).

Kushtet e pabarabarta biznesore tentojnë të përqëndrojnë investimet në rajonin e Prishtinës, duke lënë kështu pjesët tjera të Kosovës potencialisht të pazhvilluara.

Rajonet me qendra të mëdha urbane dhe shumicë dominante të K-Shqiptarëve ndjekin trendet e përgjithshme të barrierave biznesore të Kosovës – duke përmendur praktikën e padrejta biznesore dhe korru-

psionin si një nga pengesat kryesore për ndërmarrjen. Megjithatë, dy lloje të zonave paraqiten me profil mjaft të ndryshëm (i) zonat rurale; dhe (ii) zonat me enklava etnike jo-Shqiptare të cilat përjetojnë më shumë sfida infrastrukturore. Rryma është një sfidë e madhe në rajonin shumë të kontestuar të Mitrovicës (81.8), me popullatën e madhe K-Serbe, si dhe në komunën shumë rurale të Pejës (75), një. Kjo është pjesërisht për shkak se furnizimi me energji në Kosovë është bërë mjaft selektiv, me zonat rurale që janë më të afektuara sesa rajonet urbane, dhe ku grupet e “favorizuara” marrin më shumë furnizime të sigurta. Ky proces përzgjedhës rrjedh pjesërisht nga pagesa e përqi-ndjes së faturave të rrymës, dhe si rezultat është krijuar sistemi me tri kategori të konsumatorëve (A,B dhe C). Kategoria A, e cila mbledh pagesit e rregullt ka prioritet me furnizim, ndërsa kategoria C ka disa restriksione serioze të furnizimit gjatë vitit. Prishtina perceptohet gjerësisht që bie nën Kategorinë A. Në aspektin e zhvillimit rajonal, restriksione të tilla janë përçarëse dhe krijojnë pabarazi zhvillimi. Mjedisi i pabarabartë biznesor tentonë të përqëndrojë investimet në rajonin e Prishtinës, duke lënë kështu pjesët tjera të Kosovës potencialisht të pazhvilluara.

		Prishtinë	Prizren	Pejë	Mitrovicë	Gjilan	Ferizaj
1	Qasja në shërbimet e biznesit dhe informatat	36.4	38.4	53.8	36.3	37.1	39.5
2	Qasja në financim	65.6	33.8	56.7	53.9	68.6	51.4
3	Qasja në shfrytëzimin e tokës	34.6	38.2	38.9	27.6	40.4	38.5
4	Praktikat kundër-konkurrese të konkurrentëve tjerë	86.4	61.9	54.6	46.9	65.1	40.7
5	Licensimi i biznesit dhe lejet	38.0	40.3	48.9	27.0	47.1	43.5
6	Shkelja e kontratës nga Konsumatorët dhe Furnizuesit	68.2	57.9	61.9	51.1	58.0	40.8
7	Korrupsioni	75.9	59.5	67.0	38.8	65.4	42.7
8	Kostoja e financimit	67.3	37.4	55.6	57.8	66.1	51.5
9	Doganat dhe rregulloret tregtare	49.2	49.7	60.7	34.8	46.4	42.9
10	Rryma	54.8	59.8	75.0	81.9	64.2	69.6
11	Funksionimi i sistemit gjyqësor	58.3	45.4	60.3	43.0	60.1	46.6
12	Rregulloret e punës	35.6	37.9	43.9	27.0	49.6	40.1
13	Krimi i organizuar dhe mafia	78.2	62.2	62.2	39.3	61.1	41.2
14	Jostabiliteti politik	67.2	54.8	77.6	58.8	41.2	45.4
15	Standardet e prodhimit	53.0	40.6	60.3	45.0	39.2	41.4
16	Shkathësitë dhe edukimi i punonjësve në dispozicion	37.2	32.4	52.2	27.0	46.5	41.7
17	Krimi në rrugë, vjedhja dhe ç'rregullimi	78.4	60.6	71.1	51.5	65.0	43.4
18	Administrata Tatimore	48.7	50.0	64.9	30.4	53.0	46.1
19	Normat e taksave	49.4	51.0	66.6	30.4	52.1	43.4
20	Telekomunikimi	33.5	31.7	39.1	30.0	38.5	41.5
21	Transportimi	37.8	39.7	45.1	38.5	39.8	45.6
22	Konkurrenca e padrejtë (evazioni dhe joformaliteti)	92.2	63.4	76.4	62.0	70.5	52.5

Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

Ekzistojnë një numër i pikave karakteristike për t'u theksuar nga Tabela 3.2 të cilat marrin në konsiderim perceptime të ndryshme të barrierave të bizneseve të ndryshme në regjionet e Kosovës. Marrim shembull, krimin e rrugës, vjedhjen, krimin e organizuar dhe mafien që janë të renditura lartë në rajonin e Prishtinës. Krimi është tregues i pabarazisë në pasuri dhe mundësisë⁵⁰ në tërë ndasitë gjeografike, klasore apo

ndasi tjera. Në rastin e Kosovës, nuk është e habitshme se krimi graviton drejt Prishtinës – ku më e mira e indikatorëve të bizneseve të Kosovës, infrastrukturës, të ardhurave dhe edukimit është e grumbulluar. Mungesa e mundësive në rajonet tjera, kur krahasohet me rajonin e Prishtinës, shton migrimin potencial të kriminelëve në zona urbane dhe më të zhvilluara, dhe kësaj shton nivelin e krimit.

3.3 Ndikimi mbi hendekun e barazisë gjinore

Si shtesë e variacionit në regjionet e ndryshme të Kosovës, barrierat e biznesit janë gjithashtu të përjetuara dhe perceptuara ndryshe nga ndërmarrësit meshkuj dhe femra të Kosovës. Në Kosovë, përafërsisht të gjithë pronarët gra (99.9) kanë mikro-ndërmarrje. Për ato, kostoja dhe qasja në financa mbetet në krye (intenziteti prej 60, përkatësisht 61), krahasuar me barrierat e përgjithshme të sektorit privat në Kosovës (56 dhe 57) dhe krahasuar me meshkujt (58 dhe 56). Prandaj, nuk është e habitshme që ndërmarrëset gra tentojnë të kenë

biznese më të vogla dhe të operojnë me nivele më të ulëta të kapitalizimit të përgjithshëm krahasuar me meshkujt.

Gratë janë njohur si një rezervat kryesisht i pashfrytëzuar i talentit ndërmarrës nga një numër i gjërë i agjensioneve rajonale, nacionale dhe ndërkombëtare të zhvillimit eko-nomik në Kosovë. Pavarësisht kësaj, rritja e shquar në numrin e ndërmarrësve femra që nga fundi i luftës është inkurajues. Kontributi i tyre në ekonominë e vendit demonstroi rën-dësinë ekonomike të këtij grupi shpesh të neglizhuar të ndërmarrësve. Gjysma e ndërmarrjeve aktuale në pronësi të grave janë themeluar gjatë katër viteve të fundit (shiko Ilustrimin 3.3).

TABELA

3.3

Intenziteti i barrierave të perceptuara prej biznesve në Kosovë sipas gjinisë (ku 20 është intenziteti më i ulët dhe 100 më i lartë)

		Meshkuj	Femra
1	Qasja në shërbimet e biznesit dhe informatat	38.6	33.8
2	Qasja në financim	56.5	60.3
3	Qasja në shfrytëzimin e tokës	36.0	33.3
4	Praktikat kundër-konkurrese të konkurrentëve tjerë	69.6	60.5
5	Licensimi i biznesit dhe lejet	40.7	35.1
6	Shkelja e kontratës nga Konsumatorët dhe Furnizuesit	60.5	50.5
7	Korrupsioni	63.4	52.8
8	Kostoja e financimit	58.0	61.1
9	Doganat dhe rregulloret tregtare	49.4	37.0
10	Rryma	64.4	59.1
11	Funksionimi i sistemit gjyqësor	54.5	48.2
12	Rregulloret e punës	38.3	33.6
13	Krimi i organizuar dhe mafia	62.3	50.7
14	Jostabiliteti politik	59.8	51.2
15	Standardet e prodhimit	47.4	41.0
16	Shkathësitë dhe edukimi i punonjësve në dispozicion	38.6	35.3
17	Krimi në rrugë, vjedhja dhe ç'rregullimi	66.0	57.6
18	Administrata Tatimore	50.2	43.4
19	Normat e taksave	50.8	45.8
20	Telekomunikimi	35.3	33.5
21	Transportimi	40.5	36.0
22	Konkurrenca e padrejtë (evazioni dhe joformaliteti)	77.2	70.3


Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

Në aspektet e përgjithshme, literatura hulumtuese gjen se ndërmarrëset gra tentojnë të kenë biznese më të vogla, operojnë me nivele më të ulëta të kapitalizimit të përgjithshëm, të fillojnë dhe menaxhojnë firma në industritë ndryshe nga ato që drejtohen nga meshkujt, ndërsa shkallët e rritjes së

konventat sociale, kornizat juridike dhe institucionale, mundësive të pabarabarta të punësimit dhe ekuilibrit punë-jetë. Pavarësisht kësaj, kur shikohet tutje në karakteristikat gjinore, dalin disa mangësi dhe pabarazi të konsiderueshme. Vetëm 11 përqind të firmave në Kosovë pronësohen nga femrat. Derisa kjo shifër mund të jetë në një nivel me shtetet tjera në zhvillim, tregon një situatë që – duke u përmirësuar nga vitet e mëparshme – është ende larg barazisë. Pronarët femra poashtu tentojnë të punësojnë më pak staf: numri mesatar i punonjësve në kompanitë në pronësi të femrave është tre, krahasuar me pesë në firmat me pronësi të meshkujve. Këto shifra theksojnë shkallën e vogël të pronësisë së femrave. Ilustrimi 3.8 ofron një krahasim të pronësisë së femrave në Kosovë me atë në vendet tjera në botë. Kosova renditet shumë më poshtë se mesatarja e OECD-së, edhe pse konsiderueshëm më lartë se në Federatën Ruse.

Pse femrat luftojnë që të konkurrojnë në mënyrë të barabartë në tregun e Kosovës? Për shkak se barrierat kulturore i parandalojnë ato që të


Figura 3.3 Shpërndarja e bizneseve në pronësi të grave sipas datës së themelimit



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

bizneseve të tyre tentojnë të jenë më të ulëta dhe gjithnjë në gjendje të ekzistencës së disa barrierave sociale, kulturore dhe mjedisore. Në Kosovë, aktivitetet ndërmarrëse të grave janë ende të penguar nga kufizimet specifike gjinore, përfshirë

Figura 3.4 Bizneset në pronësi të grave në tërë botën (përqindja e totalit të bizneseve të regjistruara të cilat kanë pronare femra)



Barazia Gjinore në Edukim, Punësim dhe Ndërmarrësi – Iniciativa Gjinore OECD 2011

marrin pikëmbështetje të mjaftueshme. 92 përqind e llogaritur e aseteve kolaterale të nevojshme për të startuar bizneset janë të regjistruara tek meshkujt (shpeshherë meshkuj të afërt me gratë ndërmarrëse, të cilët mund të fuqizohen për të filluar biznesin) - në kontrast të thellë me të drejtat e barazisë gjinore të mishëruara me ligjin e Kosovës. Pra, vetëm 3 përqind e huave bankare për themelet e biznesit shkojnë te gratë⁵¹. Edhe pse mikro-financimi pjesërisht ka kompenzuar paragjykimin e theksuar gjinor në qasjen e shërbimeve formale financiare, ato përjetësojnë mbizotërimin e grave brenda mikro-bizneseve. Pasi që bizneset në pronësi të grave operojnë në mënyrë të suksesshme, ato përjetojnë barrierat e shkallës së njëjtë sikurse homologët e tyre meshkuj.


Duke pas parasysh këtë nuk është e habitshme të shihet se dallimet gjinore ekzistojnë në punësim dhe menaxhment në bizneset Kosovare. Nën-përfaqësimi i grave në nivel menaxherial jo vetëm që iu ofron atyre më pak përvojë direkte në menaxhimin e bizneseve krahasuar me meshkujt, mirëpo, gjithashtu vështirëson gjasat e femrave kryefamiljare për biznese fillestare. Për më tepër, fitimet e ulëta mesatare të grave, i pajis ato me kurse më të pakta për fillimin e biznesit. Me rëndësi, nën-kapitalizimi në fillet e biznesit ndikon negativisht në normën e mbijetesës dhe perspektivën e rritjes së firmave.

Ndarja e profesionit poashtu përforcon përqëndrimin e ndërmarrjeve në pronësi të grave kryesisht në sektorë me vlerë të ulët të shtuar dhe rrezikon perspektivat e grave si ndërmarrëse në sektorët me rritje të lartë. Analizat e studimit ndër-tabelor në mesin e sektorëve sipas gjinisë tregojnë joproporcione të konsiderueshme ndërmjet meshkujve dhe femrave në sektorë të ndryshëm (shiko Ilustrimin 3.9). Për shembull, meshkujt dominojnë në industrinë përpunuese dhe sektorët e ndërtimit (të cilat ofrojnë një potencial të madh për punësim), derisa femrat dominojnë në sektorët shërbyes siç janë shëndeti i njeriut dhe punët sociale, edukative dhe aktivitete profesionale dhe shkencore.

Fatkeqësisht, për gratë kosovare, punësimi është po aq i kufizuar sa edhe ndërmarrësia. Norma e skajshme e pjesëmarrjes në tregun e punës të Kosovës për gratë, në përgjithësi (më pak se tri në dhjetë, shiko Kapitullin 1) është e përbërë nga mungesa e mundësive për ata më të varfërit, më pak të edukuarit dhe grave më të marginalizuara. Të jesh grua rurale apo e etnicitetit RAE në Kosovë do të thotë të jesh në fund të rreshtit për secilën pjesëmarrje apo mundësi punësimi. Pavarësisht nga barrierat e thella kulturore dhe të sjelljes të cilat peshojnë mbi supet e këtyre grave, ato janë gjithashtu të penguar nga mungesa e shkathtësive. Një studim i vitit 2004 nga UNICEF-i tregon se afërsisht një në katër gra rurale në Kosovë janë

Pse femrat luftojnë që të konkurrojnë në mënyrë të barbartë në tregun e Kosovës? Për shkak se barrierat kulturore i parandalojnë ato që të marrin pikëmbështetje të mjaftueshme.

Figura 3.5 Shpërndarja e gjinisë së pronësisë së bizneseve përgjatë sektorëve



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

Ekziston një korelacion i qartë ndërmjet madhësisë së biznesit dhe tendencës për të punësuar meshkuj.

funksionalisht analfabete⁵², dhe në këtë mënyrë nuk mund të konkurrojnë me meshkujt, për punë jashtë shtëpisë. Studimi i vitit 2006 i drejtuar në mesin e pronarëve femra të biznesit nga She-ERA, një Asociacion vendor i Biznesit të Grave, ka konfirmuar këto trende shqetësuese. Ka gjetur se varshmëria në mesin e anketuesve të grave rurale në biznes ka qenë jashtëzakonisht e lartë. Shumica kanë operuar me bizneset e tyre jashtë shtëpive të tyre, dhe më

pak se 5 përqind kanë udhëtuar jashtë fshatrave për të punuar⁵³. 77 përqind kanë lejuar që anëtarët meshkuj të familjes të marrin të gjitha vendimet e rëndësishme biznesore. Vetëm 13 përqind kanë jetuar kryesisht në të ardhurat e tyre personale.

Pavarësisht nevojave të qarta - kurseve mbi të mësuarit për lexim, trajnimeve profesionale dhe politikave pozitive - praktikave diskriminuese

të punësimit, ende nuk janë duke u shenjestruar këto gra të përjashtuara. Në fakt, ekziston një korelacion i qartë ndërmjet madhësisë së biznesit dhe tendencës për të punësuar meshkuj. Sa më i madh të jetë punëdhënësi, aq më i madh është pabarazia ndërmjet pjesës së meshkujve dhe femrave të punësuar⁵⁴. Bizneset e vogla janë deri më tani punëdhënësit më të mëdhenj të femrave; megjithatë, ato poashtu priren të jenë më pak të sigurta, më pak të rregulluara dhe ofrojnë mundësitë më të pakta për rritje të shkathtësive dhe zgjerimit.

Kjo analize është një pamje fillestare e sfidave me të cilat ballafaqohet barazia gjinore në mjedisin biznesor në Kosovë. Më tutje sqaron se të drejtat e femrave për të ndjekur ëndrrën e tyre jashtë vendit të punës, për të zgjeruar aftësitë dhe mundësitë e tyre dhe për të sjell njohuri dhe të ardhura prapa tek familjet është e brishtë. Përpjekjet për të adresuar këtë nevojë për të trajtuar problemin nga të dy anët duhet iniciuar, p.sh., për të ndihmuar gratë më të rrezikuara në përvetësimin e shkathtësive dhe lirive që duhet të futen në treg, e bëjnë atë treg më mirëseardhës për gratë që kërkojnë punë të denjë dhe ndërmarrje individuale.

3.4 Rritja mbi sektorët me potencial rritës

Barrierat e biznesit janë të përjetuara ndryshe përgjatë sektorëve primar, sekondar dhe terciar të Kosovës. Shkalla në të cilën këto barrierat janë të përjetuara jep disa tregues se pse sektori terciar me vlerë të ulët të shtuar i Kosovës është aktualisht më dominant.

Sektori i dytë, shumicën e barrierave e ndien më intensivisht - barriera të cilat reflektojnë sfidat e dukshme industriale të Kosovës. Megjithatë, sektori primar - punëtorët bujqësor të Kosovës - është në veçanti i vështirësuar nga rrymat, doganat dhe rregulloret tregtare (Ilustrimi 3.10). E përkthyer në jetën e përditshme, kjo do të thotë një betejë e vazhdueshme për të menaxhuar pa furnizime të sigurta të rrymës në zonat rurale, dhe të një sensi të trajtimit të padrejtë krahasuar me konkurruesit e huaj, e shkaktuar nga pabarazitë në marrëdhëniet tregtare ndërmjet shteteve. Vitin e kaluar, Preferencat Tregtare Evropiane⁵⁵ janë larguar nga prodhuesit Kosovarë, në mënyrë që të kthehen përsëri për vitin 2012, ndërsa paaftësia për të lëvizur lirshëm në Serbi dhe Bosnjë ka shtuar kostot e bizneseve. Në lidhje me doganat, kërkesat për pagesën e Taksës mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) në kufi, për materiale teknologjike dhe të papërpunuara janë pranuar si kufizime të ashpëra nga prodhuesit bujqësor. Kur shitësit me pakicë blejnë prodhime të freskëta nga prodhuesit e Kosovës, ata i blejnë ato pa TVSH (nëse është nën pragun juridik prej 50,000 eurove). Megjithatë, shitësi me pakicë është përgjegjës për mbledhjen e TVSH-së nga konsumatori final, atëherë kur produkti shitet. Në anën tjetër, kur prodhimi është i blerë nga shpërndarësi i cili e ka importuar dhe ka paguar tashmë disa nga ngarkesat e TVSH-së në kufi, shitësi me pakicë mban shumë më pak në supë ngarkesën e TVSH-së të cilën e kalon tek konsumatori. Kjo e bënë prodhimin e freskët të Kosovës jokonkurrues në aspektin e çmimeve krahasuar me prodhimet e freskëta të importuara të ushqimit.

Derisa bujqësia e Kosovës ka qenë në gjendje të shmang këto barrierat deri

në një masë duke vepruar në mënyrë joformale, sektori sekondar e gjen këtë mjaft të vështirë për t'u fshehur brenda joformalitetit. Ky sektor është më i kufizuari prej të gjithë sektorëve, çka sqaron dobësitë e thella dhe mesa duket të pazgjidhshme të bazës industriale të Kosovës dhe paaftësisë së saj për të rritur burimet e punës së denjë. Sektori terciar gjithashtu merr parasysh praktikën kundër-konkurruese dhe konkurrimin e padrejtë si barrierën më të rëndësishme për ekzistencën e tyre. Shumica e bizneseve në sektorin terciar merren me tregjet vendore dhe prandaj janë më pak të ballafaquara me mosbalancimet e tregtisë ndërkombëtare.

Kosova ka nevojë urgjentisht të kuptojë më mirë barrierat specifike të sektorit dhe marrëdhënies së tyre me barrierat e përgjithshme – në veçanti për ata sektorë që kanë potencial të konsiderueshëm për rritje gjithëpërfshirëse, krijim të vendeve të punës dhe zhvillim njerëzor. Identifikimi i barrierave specifike të sektorit mund të dërgojë drejt politikave specifike të sektorit. Një analizë e tregut në favor të njerëzve të sektorit të gatshëm të rritjes në Kosovë duhet – për të rritur përfitimet ekonomike dhe njerëzore – të fokusohet kryesisht mbi **tri kriteret** vijues: (i) tregtueshmëria; (ii) intenziteti i punës; dhe (iii) shtimi i vlerës. Pse janë këto kritere më kritiket për rritjen

TABELA

3.4

Intensiteti i barrierave të perceptuara nga bizneset në Kosovë sipas sektorëve primar, sekondar dhe terciar (ku 20 është intensiteti më i ulët dhe 100 më i lartë)

		Primar	Sekondar	Terciar
1	Qasja në shërbimet e biznesit dhe informatat	33.33	51.03	36.75
2	Qasja në financim	43.75	58.02	57.23
3	Qasja në shfrytëzimin e tokës	37.5	42.86	35.34
4	Praktikat kundër-konkurruese të konkurrentëve tjerë	43.75	66.9	69.07
5	Licensimi i biznesit dhe lejet	43.75	47.4	39.19
6	Shkelja e kontratës nga Konsumatorët dhe Furnizuesit	62.5	65.14	58.84
7	Korrupsioni	56.25	65.3	63.34
8	Kostoja e financimit	56.25	60.49	57.98
9	Doganat dhe rregulloret tregtare	75	60.67	46.57
10	Rryma	81.25	73.51	61.96
11	Funksionimi i sistemit gjyqësor	50	54.93	54.72
12	Rregulloret e punës	31.25	47.76	36.89
13	Krimi i organizuar dhe mafia	43.75	68.56	61.62
14	Jostabiliteti politik	62.5	67.39	59.87
15	Standardet e prodhimit	41.67	53.31	47.07
16	Shkathësitë dhe edukimi i punonjësve në dispozicion	31.25	43.75	38.06
17	Krimi në rrugë, vjedhja dhe ç'rregullimi	50	69.78	66.27
18	Administrata Tatimore	50	61.59	48.15
19	Normat e taksave	50	60.19	49.06
20	Telekomunikimi	37.5	37.35	34.51
21	Transportimi	37.5	46.95	39.14
22	Konkurrenca e padrejtë (evazioni dhe joformaliteti)	62.5	81.51	76.18

Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011

gjithëpërfshirëse të Kosovës, dhe cilat përfitime të zhvillimit njerëzor mund t'i shoqërojnë ato?

Tregtueshmëria e produkteve dhe shërbimeve është një konsideratë vitale për zgjerimin e biznesit në Kosovë, veçanërisht nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Mosbalancet e mëdha tregtare të Kosovës dhe ekonomia e saj e dominuar nga importi kanë shtypur stimulimin për rritje gjithëpërfshirëse (p.sh. prioritizimi i rrjedhjeve shtetërore të të ardhurave mbi intenzitetin e punës, rritjes së gjërë me bazë vendore). Kjo debaton përkundrejt, për shembull, një mbi-theksim mbi skemat e krijimit të vendeve të punës në Kosovë përmes sektorëve jo të tregtueshëm siç është ndërtimi, përveç nëse është i balancuar nga përkrahja e sektorëve të tregtueshëm.⁵⁶ Tregtueshmëria është nga afër e ndërlidhur me qëndrueshmërinë, mundësinë dhe zgjidhjen në treg; është më pak e varur në ciklet e lulëzimit të

Objektiva e krijimit të vendeve të punës duhet të jetë për krijimin e një portofolio të balancuar të punësimit duke respektuar dinjitetin dhe potencialin njerëzor – duke i'u mundësuar hyrje në treg atyre më të përjashtuarve përderisa ofron mundësi për rritje dhe avancim.

Zhvillo aftësitë njerëzore duke i'u mundësuar njerëzve të shkëmbejnë shkathtësitë, zbulimet dhe idetë.

hovshëm/dështimit, hap dyert për një gamë të gjërë të punëtorëve dhe përshpejton rritjen duke kërkuar që të hap tregje të reja. Procesimi i ushqimit në Kosovë, teknologjia informative dhe e komunikimit, tekstili, bujqësia

dhe sektorët e minierave/energjisë janë shumë të tregtueshëm dhe, për më tepër, mund të bashkojnë në treg segmente të ndryshme të komunitetit. Së bashku, ato përfaqësojnë një shportë të balancuar të ndërmarrjeve bazike, me shkathtësi mesatare dhe të larta të cilat prekin të varfërit rural, të varfërit urban dhe të kualifikuarit urban. Me përjashtim të minierave/energjisë, ato kanë një histori të arsyeshme më të ekspozuar ndaj konkurrencës globale, duke shtuar mundësitë për qëndrueshmëri dhe rritje të saj. Ekspozimi në tregjet tjera në mënyrë të konsiderueshme i shton aftësitë njerëzore në Kosovë duke i'u mundësuar njerëzve që të shkëmbejnë shkathtësitë, zbulimet dhe idetë, e gjithashtu për të shtuar njohjen me shoqëritë tjera.

Intenziteti i punës është faktor kritik në çdo strategji ekonomike gjithëpërfshirëse për Kosovën - e cila sipas përkufizimit duhet të kërkojë që të zgjerojë mundësitë e punës së denjë dhe pjesëmarrjes së fuqisë punëtore si rrugë primare drejt rritjes. Kosova ka burime të pasura të punës dhe vendosjes së presioneve të punësimit përmes popullatës së saj në rritje të punëkërkuesve të rinj. Këta të rinjë duhet të besojnë se punët do të jenë aty për ta, të jenë të nxitur për të përfunduar shkollën, përvetësojnë shkathtësitë dhe të konkurrojnë në treg. Pyetja për Kosovën është, cilët sektorë mund të gjenerojnë shumicën e vendeve të punës dhe si mund të lidhen punëkërkuesit me këto mundësi? Sektorët siç janë procesimi i ushqimit, tekstilit, ndërtimit dhe bujqësisë shfaqin zakonisht një raport të lartë punë-kapital.⁵⁷ Bazuar në të dhënat ketu, raporti më i lartë punë-kapital është në sektorin e tekstilit, i shoqëruar nga industria e ushqimit.

Bujqësia dhe ndërtimi janë poashtu të ndërlidhur me punë intenzive. Anasjelltas, mini-erat dhe energjia kanë një raport më të ulët punë-kapital, që nënkupton pronat kapitale intenzive në sektor. Si kusht – intensiteti i punës mat vetëm vëllimet e potencialit të punësimit në sektor, dhe jo cilësinë e vendeve të punës që krijohen. Objektiva e krijimit të vendeve të punës nuk duhet asnjëherë të mbush tregun me paga të ulëta, me vende të pasigurta pune, por, të krijojë një portfolio të punësimit e cila respekton dinjitetin njerëzor dhe potencialin – e cila mundëson hyrjen në treg të më të përjashtuarve në fundin më të ulët të spektrit, përderisa ofron mundësi për rritje dhe avansim.

Bizneset me vlerë të shtuar i thellojnë shkathtësitë dhe aftësitë e tregut. Fuqia punëtore e Kosovës është thellësisht e nën-kualifikuar dhe dëshpërimisht ka nevojë për inovacion rreth rritjes, qëndrueshmërisë mjedisore dhe qeverisjes. Si rezultat, bizneset që lulëzojnë këtu, kanë pak nevojë për aftësi. Është zhvilluar një situatë në të cilën nën-performanca është bërë normë dhe bizneset nuk i ngrisin më shkathtësitë që iu mungojnë të cilat mund të nxisin rritjen e tyre. Kjo reflekton në të ardhurat e ekonomisë familjare dhe kapaciteteve të saj, dhe në sistemet e dobësuar të edukimit, në pesimizëm në mesin e të rinjve dhe në pakënaqësi përkundrejt një qeverie që me sa duket është e paaftë për të trajtuar një cikël të gabueshëm. Sektorët që janë në gjendje për të ndërtuar shkathtësi dhe vlerë në fuqinë punëtore përfshijnë sektorin e teknologjisë informative dhe komunikimit, procesimit të ushqimit, dhe disa nën-sektorë në bujqësi. Anasjelltas, tekstili, ndërtimi dhe miniera/energjia janë aktivitete me vlerë të ulët të shtuar – të cilat

Është zhvilluar një situatë në të cilën nën-performanca është bërë normë dhe se bizneset nuk i ngrisin më shkathtësitë që iu mungojnë të cilat mund të nxisin rritjen e tyre.

kërkojnë shkathtësi vetëm në nivelet e larta të menaxhimit. Megjithatë, pa marr parasysh potencialin e ulët për aktivitete me vlerë të shtuar në sektorët e minierës, energjisë dhe ndërtimit, ato kanë potencialin që të sjellin të ardhura të mëdha nga iniciativa të vetmuara, dhe të ofrojnë faktorë fundamental të prodhimit për industri tjera pa të cilat, rritja nuk mund të ndodh.

Një indikator i fundit subjektiv pro-njerëzor, i rritjes ekonomike është **qëndrueshmëria**. Nga perspektiva makro-ekonomike, Kosova tashmë ka përjetuar një lulëzim të hovshëm dhe dështim që nga periudha e pas-konfliktit, thellësisht duke dëmtuar bizneset fillestare dhe besimin ndërkombëtar. Nga perspektiva e zgjerimit të zgjidhjes njerëzore, kapaciteteve dhe lirive – punëtori Kosovari, i cili nuk mund të mbështetet në një burim të ardhurash, i cili nuk mund të jetë pjesë e një modeli të qëndrueshëm, përmirësues të rritjes së të ardhurave dhe shkathtësive, jeton në pasiguri të përhershme. Kapaciteti i saj apo tij për të bërë investime – financiare dhe personale (siç është në edukim apo për shembull shkathtësi) – për të marr rreziqe për avansim personal dhe social, për t'u angazhuar në aktivitete jo-mbijetese siç është aktivizmi politik, është minimal. Në Kosovë, ushqimi, tekstili, teknologjia informative dhe e komunikimit dhe bujqësia, të gjitha kanë potencial të madh për të ofruar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse – sektorë të hapur ndaj një baze të gjërë të shoqërisë Kosovare dhe të gatshëm për të

zgjeruar pjesëmarrjen formale të fuqisë punëtore në mesin e të varfërve dhe atyre të përjashtuar. Në anën tjetër, dy sektorët aktual me prioritet të lartë të Kosovës - miniera/energja dhe ndërtimi - janë më pak të sigurtë. Si një shembull, sektori i ndërtimit vazhdon të ofrojë punësim intenziv dhe ka qenë kritik për të ofruar të ardhura të menjëhershme për meshkujt me aftësi të ulëta. Megjithatë, tregon shumë shenja dalluese të një mjedisi të përkohshëm dhe mjedisor operativ. Ndërtimet e papërfunduara dhe rrugët gjysmë të zhvilluara e bëjnë rrëmujë pejsazhin e Kosovës, që sinjalizon se lulëzimi i ndërtimit ka ardhur në një fund. Paanshmëria ekonomike e Kosovës duhet të rifokuset, dhe prioritetet e saj investive seriozisht të ri-vlerësohen për kontributin potencial ndaj qëndrueshmërisë dhe barazisë së tregut në tërësi.

Ky raport nuk ka vend për një analizë të hollësishme të vërtetë të barrierave me të cilat përballen sektorët të identifikuar këtu. Një pamje e përmbledhur në tre shembujt përgjatë sektorëve primar (bujqësia), sekondar (procesimi i ushqimit) dhe terciar (TIK) janë të përfshira në shtojca.

Analizat për këtë seksion, megjithatë, potencojnë nevojën për të parë në barrierat sektoriale dhe potencialin e sektorit përmes perspektives të zhvillimit njerëzor – pasi që sektorët dallojnë për nga ndikimi i tyre mbi segmentet e veçanta të shoqërisë, dhe përfitimet e zhvillimit njerëzor varen mbi rritjen e barabartë dhe të balancuar. Nëse Kosova është për të korrur përfitime direkte dhe jodirekte nga sektorët e saj me potencial rritës, ato duhet të trajtohen si një portfolio e jo si të ndara, me ato që ofrojnë përfitime të mëdha afatgjata dhe me të cilat përballen njerëzit, të

prioritizuara për përkrahje nga qeveria dhe partnerët ndërkombëtar.

3.5 Implikimet e politikës – një treg njerëzor

Analizat e koeficientëve të ndryshëm ndaj barrierave të biznesit sipas segmentëve të ndryshëm të shoqërisë Kosovare sugjerojnë se sektori privat në Kosovë është në gjendje të nxis rritjen, mirëpo në një mënyrë mjaft selektive. Sektorë të caktuar mund të gjejnë hapësirë për të përfituar, nëse kanë kushtet e duhura – mikro-ndërmarrjet, ndërmarrjet joformale dhe kompanitë e grumbulluara urbane kryesisht të sektorit terciar. Këto lloje të bizneseve kanë më pak vështirësi për të tejkaluar sfidat që paraqiten në rrugën e tyre.

Megjithatë, nuk është e strukturuar të promovojë rritjen **gjithëpërfshirëse** – e cila hap pjesëmarrjen, të ardhurat dhe fuqizimin ndaj një spektri të gjërë të shoqërisë, dhe e cila trajton varfërinë në rrënjë duke iu dhënë mundësi atyre që janë të përjashtuar në mënyrë tradicionale nga tregu. Krijimi i bizneseve të përbashkëta të reja të vogla dhe mikro-biznese është më pak sfidues sesa zgjerimi i atyre ekzistues – duke kufizuar fushëveprimin e tregut në krijimin e vendeve të punës së qëndrueshme dhe me vlerë të shtuar. Tërë sektorët e shoqërisë – të varfërit rural, gratë, përjetojnë shumë më shumë barrierë më të mëdha gjatë hyrjes në treg se sa kolegët e tyre meshkuj apo urban, duke kultivuar pabarazitë dhe duke përjetësuar varshmërinë. Sektorët lulëzues kanë qenë, deri tani, ose përjashtues nga natyra me qëndrueshmëri të afatshkurtë (p.sh.

ndërtimi), apo të prirura ndaj joformalitetit dhe intenzitetit të ulët të punës (p.sh. bizneset urbane që lidhen me shërbimin).

Për të krijuar një treg pro-njerëzor në Kosovë do të jenë të nevojshëm disa hapa të qartë të politikave të cilat prekin barrierat ndaj rritjes që afektojnë të përjashtuarit. Këto mund të implemtohen vetëm me përkrahjen e vetë bizneseve. Ato përfshijnë:

- **Fokuso kalimin nga e vogla**

në të mesme: analizat tregojnë se barrierat e biznesit janë të përjetësuar në një nivel më të lartë pasi që kompania të arrijë një nivel të caktuar të rritjes. Kjo është indikative për natyrën e vërtetë të barrierave në biznes. Sa më e madhe të jetë kompania, është më vështirë të fshehet brenda joformalitetit dhe është më e ekspozuar ndaj sfidave të rregulloreve, tatimit dhe financimit. Sidoqoftë, kompanitë mesatare janë mundësia më reale e Kosovës për të krijuar tre sektorët lulëzues të biznesit se sa vetëm sektori terciar që është prezent tani, dhe të lëviz nga një ekonomi e copëtuar në një ekonomi të integruar. Barrierat praktike dhe të politikave të cilat vështirësojnë zgjerimin e kompanisë prej madhësisë së vogël në atë të mesme, përfshirë aktivitetet e reja biznesore, duhet të adresohen, si dhe të përcaktohen caqe kohore për një balancë më të shëndetshme biznesore.

- **Ofro nxitje dhe infrastrukturë për formalizim, veçanërisht në zonat rurale:** nxitjet drejt joformalitetit janë një arsye e qartë pse sektorët primar dhe sekondar në Kosovë janë aq të dobët. Komplexitetet rregullative (brenda tatimit, licensimit dhe sistemeve të

financimit) nuk janë të vetmet arsye përkonominë madhe joformale të Kosovës. Arsyeja tjetër është kultura e lejueshmërisë e themeluar mbi besnikëritë ndër-fisnore, zbatimit të dobët, mosbesimit publiko-privat dhe përceptimit në mesin e ndërmarrësve mbi të "qenurit në forcat vetjake" kur vie deri te ngritja e kapitalit dhe zbatimi i kontratave. Nxitjet drejt formalizimit janë shumë të dobëta në zonat rurale, shtëpia e rritjes së sektorit privat, - ku mungesa e infrastrukturës, edukimit dhe shërbimeve bazë të qeverisë – të kombinuara me sistemet ndëshkuese TVSH – i bëjnë bizneset formale të duken praktikisht të paqëndrueshme. Si rezultat, pronarët e bizneseve, punonjësit e tyre dhe shoqëria e gjërë humbin shumë mundësi. Bizneset dështojnë të rriten përmes bashkëpunimit dhe ekonomive të shkallëzuara, puna ka më shumë gjasa të jetë joformale, e nën-paguar dhe e pambrojtur, derisa përfitimet sociale – qofshin direkte (rritja e të ardhurave të komunitetit) apo jodirekte (zgjidhjet më të mira në shërbime, më shumë nxitje për mësim) – mungojnë. Formalizimi i biznesit në zonat e varfëra duhet të prioritetizohet, e ndjekur përmes qasjeve pozitive sesa ndëshkuese – dhe përmes metodave të cilat edukojnë, fuqizojnë dhe mbështesin komunitetet e brishta të cilat mund të varen nga bizneset e tyre joformale për mbijetesë.

- **Cakto caqe për pjesëmarrje të ngritur të fuqisë punëtore të femrave, duke prioritetizuar qasjen në financa dhe shkathtësi për punësim:** femrat janë trefish të mohuara nga hyrja në tregun e Kosovës – së pari, përmes

një shkallë jashtëzakonisht të ulurtë fuqisë punëtore, së dyti përmes një norme të shenjuar joproporcionale të papunësisë dhe së treti përmes sfidave më të larta se mesatarja në themelimin e ndërmarrjes. Argumentet e zhvillimit njerëzor për shtimin e njohurisë së femrave, shkathtësive dhe lirive janë aq të shumta sa që këtu nuk ka nevojë të elaborohen. Megjithatë - argumentet ekonomike mund të jenë më pak të qarta për shumë udhëheqës të Kosovës, për biznese dhe kryefamiljarë të ekonomive familjare. Gjysma e popullatës së Kosovës janë në mënyrë efektive duke u shfrytëzuar nga gjenerimi i të ardhurave - duke kufizuar buxhetet e ekonomive familjare, duke mbajtur mbrapa rritjen e GDP-së dhe duke ndikuar perspektivat e gjeneratave të ardhshme. Është çmim që Kosova thjeshtë nuk mund t'a përballojë për t'a paguar nëse anëtarësia në BE është seriozisht në pamjet e saj në çfarëdo afati të arsyeshëm kohor. Një strategji e gjërë sektoriale është thelbësore për të trajtuar sfidat primare - pjesëmarrja e fuqisë punëtore - përderisa njëherësh përmirësohet punësimi i femrave përmes edukimit mbi punën sistematike, vendosjes së caqeve dhe trajnimeve profesionale. Jo të gjitha femrat duan të punojnë - dhe kjo është poashtu e drejta e tyre. Megjithatë, ato që janë të parandaluara qoftë nga të provuarit, për shkak të tregut të mbyllur apo qëndrimeve të mbyllura, meritojnë

politika dhe përkrahje të punës sistematike.

- **Zhvillo strategji të ndërlidhura për barrierat që vështirësojnë sektorët e gatshëm rritës, duke u fokusuar mbi tregtueshmërinë e qëndrueshme, intenzitetin e punës dhe shtimin e vlerës:** Sektori privat i Kosovës nuk mund të bëjë progres në të gjitha frontet, por as nuk është është i qëndrueshëm në mënyrë ekonomike për t'u përqëndruar vetëm në sektor pas sektori. Fuqizimi i NSHP-ve dhe ofrimi i "parave për programe të punës" janë një pjesë e rën-dësishe e çfarëdo vizioni ekonomik, dhe investimeve në të ardhura vjetore të tilla - dhe bizneseve që ofrojnë infrastrukturë si minierat/energji dhe ndërtimi janë me siguri thelbësore për rritje. Megjithatë, këto industri nuk mund të krijojnë si të vetme rritje private gjithëpërfshirëse, me gjenerimin e përfitimeve të gjëra të bazuara sociale. Strategjitë e ndërlidhura sektoriale mund të ndihmojnë ministrinë të bashkëpunojnë në zvogëlimin e barrierave që afektojnë disa sektorë të gatshëm rritës të cilët ofrojnë vlerë maksimale për vetë-qëndrueshmërinë Kosovare, kapacitetin rritës dhe ndërlidhjet me tregun ndërkombëtar. Strategji të tilla mund, gjithashtu, të përkrahin partnerët ndërkombëtarë të Kosovës në ve-ndimin se ku të alokojnë/shpër-ndajnë përkrahjen investive.

Bujqësia është njëri nga sektorët më të rëndësishëm në ekonominë Kosovare nga perspektiva e zhvillimit njerëzor. Kontribuon me rreth 12 përqind të GDP-së dhe ofron punë (megjithëse joformale) për rreth gjysmës së personave që jetojnë në zonat rurale (ASK 2009). Poashtu, ofron një rrjetë të sigurisë sociale për një numër të madh të njerëzve të varfër të cilët varen prej bujqësisë familjare për jetesën e tyre. Është llogaritur se më shumë se 50 përqind të prodhimit bujqësor në Kosovë është i konsumuar nga brenda, nga vetë ekonomia familjare, përderisa shpenzimet për ushqim mbesin pjesa më e madhe e shpenzimeve të përgjithshme të ekonomive familjare (ASK 2009)..

Formalizimi dhe përforsimi i këtij sektori mund t'i fuqizojë të varfërit rural të

Kosovës, të hap dyert për edukim, shërbime dhe mundësi zhvillimi, promovojë bashkëpunimin përgjatë ndasive etnike dhe të ndërtojë mundësitë dhe kapacitetin përgjatë tërë shoqërisë së Kosovës. Në mënyrë që të arrihet ky potencial, nevojiten përforsime të dukshme në konkurrencën e prodhimeve vendore, duke kërkuar investime të konsiderueshme në sektor, për të cilën nevojitet financimi. Sektori mund të jetë burim me potencial i rritjes, por fermat e vogla mesatare, prodhimtaria e ulët dhe cilësia e produkteve, së bashku me përdorimin e dobët të inputeve/të hyrave dhe teknologjisë dhe infrastrukturës së pazhvilluar, nuk e lejojnë sektorin të konkurrojë me prodhimtarinë e shteteve fqinje. Intervistat me firmat bujqësore kanë treguar se barrierat kryesore në sektorin e bujqësisë në Kosovë janë furnizimi dhe ato gjëra që ndërliken me prodhimin si dhe në vijim, paraqiten barrierat kyçe ndaj zhvillimit sektorial:

Barrierat e brendshme për firmën:

- madhësi e vogël mesatare e firmës dhe prodhim i fragmentuar bujqësor
- aplikim i kufizuar i teknologjive të reja dhe shkathtësive moderne të biznesit dhe marketingut
- bashkëpunim i pamjaftueshëm në mesin e prodhuesve të vegjël dhe një numri të vogël të asociacioneve
- numër i pamjaftueshëm i pikave grumbulluese.

Barrierat e jashtme për firmën:

- qasje e kufizuar në financa
- mungesa e tregtimit dhe stimulive fiskal
- mungesa e standardeve të cilësisë së ushqimit dhe kontrolli
- infrastrukturë e dobët rurale.

Në Kosovë, fermat e vogla llogariten për 98 përqind e tërë tokës bujqësore me fermat më të vogla, nën 1.5 hektarë, të llogaritura për 38 përqind (BAH 2010). Bujqësia e vogël ka disa jopërparësi, duke filluar nga kostoja e lartë fillestare për lansim, mungesa e ndarjes së tregut dhe shpërndarja e produkteve, të cilat nuk i mundësojnë fermave të vogla të konkurrojnë me prodhimet bujqësore nga shtetet fqinje. Shfrytëzimi i teknologjisë është poashtu një barrierë kyçe.

Ekziston një nivel i ulët i mekanizimit në faza të ndryshme në zingjirin e vlerës së prodhimit, disa kooperativave për të bërë blerjet e pajisjeve dhe mungesës së teknikëve të çertifikuar për riparim, në Kosovë.

Në shumë raste, sektori bujqësor është duke u përballur me mungesë të kapacitetit menaxhues në bizneset bujqësore, apo mungesës së dëshirës për të ndryshuar orientimin e mëparshëm të menaxhimit të prodhimit, apo mungesën e një qasjeje më të orientuar nga tregu. Në disa raste, ndihma teknike, në veçanti në trajnim dhe përkrahje për marketing, është mënyrë e mirë drejt zhvillimit. Mungesa e koordinimit në mesin e bujqëve të vegjël është edhe një pengesë tjetër. Kapaciteti i kooperativave ekzistuese është i dobët dhe shumë pak prej tyre fokusohen në zingjirin e plotë të vlerës së aktiviteteve. Aktualisht, ekziston një përgjegjësi organizative për sigurinë e ushqimit dhe për efektshmëri të laboratorëve privat në testimin e cilësisë së ushqimit.

Gjithashtu, një nga barrierat kyçe është mungesa e produkteve financiare aktualisht të disponueshme tek bujqët e vegjël të Kosovës. Ndërsa, sistemi i saj bankar me qasje të fuqishme ndaj huave bujqësore është shumë i kufizuar. Fermerët e vegjël me kolateral minimal nuk kanë qasje të mjaftueshme në kapitalin investiv. Produktet alternative financiare nuk janë në dispozicion, edhe pse disa përpunues të ushqimit ofrojnë disa qasje ndaj kredive për fermerët e tyre furnizues, mirëpo, investimi është i kufizuar nga mungesa e kapacitetit huamarrës. (BAH 2010). Qasja e lehtë në financa është një element kyç në zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë rurale në përgjithësi. Aktualisht, vështirësia kryesore është gjetja e një kolaterali të mirë për huatë në zonat rurale. Krediti/huaja është e dhënë në baza afatshkurtëra, në një shkallë të lartë të interesit. Përveç kësaj, në rastet ku qasja është më pak problematike, mungesa e planifikimit biznesor është faktor kryesor në refuzimin e aplikimit të tyre për huamarrje.

Ekziston një mungesë e koordinimit në mesin e donatorëve. Qeveria dhe donatorët janë duke ofruar 15-18 milionë euro në vit në përkrahjen e sektorit bujqësor. Me koordinim efektiv, ky financim mund të bëhet një burim i madh për përmirësimin e infrastrukturës së ndërlidhur bujqësore, cilësisë së inputeve, produktivitetit, shumëllojshmërisë së kulturave, cilësisë dhe promovimit të eksportit (BAH 2010).

Përfundimisht, mungesa e stimulimeve tregtare dhe fiskale shihet të jetë njëra nga barrierat kryesore në sektorin bujqësor. Zvogëlimi i mundësisë së evazionit fiskal dhe ekonomisë joformale është një nevojë urgjente në mënyrë që të futet sektori bujqësor brenda aktiviteteve juridike. Në lidhje me këtë, qeveria ka implementuar disa reforma në mënyrë që të shtojë produktivitetin në këtë sektor. Reforma e parë, e cila është implementuar më 2005, ka hequr dhjetë përqind të obligimeve doganore mbi të hyrat dhe mallrat kapitale për bujqësi. Megjithatë, shumë të hyra bujqësore kanë ardhur nga shtetet fqinje (Serbia, Mali i Zi, Shqipëria, Maqedonia), të cilat tashmë i kanë arranzhimet pa taksa doganore me Kosovën. Prandaj, kjo reformë e parë, e cila është marrëveshje për të mos ngarkuar TVSH-në mbi të hyrat kritike për bujqësinë, ka pasur më shumë ndikim mbi zhvillimin e sektorit duke zvogëluar kostot dhe duke përmirësuar konkurrencën.

Shembulli i sektorit sekondar: Përpunimi i Ushqimit

Ky sektor mbulon ushqimin e përpunuar dhe pijet, kërkesa lokale për të cilën aktualisht është kyesisht e mbuluar nga importet. Ky sektor ka ndërlidhje të dukshme të zhvillimit njerëzor: ka intenzitet të punës, dhe krijon vende pune – duke inkurajuar pjesëmarrjen e atyre të përjashtuar nga tregjet me aftësi të lartë. Ofron elasticitet të madh të çmimit se sa tregjet tjera dhe ka kontribut më të madh vendor në produktin final – duke përshpejtuar rritjen dhe fitimet e eksportit. Poashtu, ka edhe efektin sekondar të bashkimit të ekonomive rurale me tregun ndërkombëtar, për të zgjeruar zgjidhjen dhe mundësinë. Aktualisht, është llogaritur se rreth 70 përqind e kësaj kërkesë të sektorit në Kosovë është e mbuluar nga importet. Importet janë të llogaritura se mbulojnë 70 përqind të kërkesës lokale për kompanitë e produkteve të bylmetit dhe perimeve të përpunuara, 80 përqind për mishin e përpunuar dhe vetëm 10 përqind për frutat e përpunuar. Vetëm këto shifra drejojnë drejt një potenciali të madh të zëvendësimit të importit në pjesën e prodhuesve vendor, pa i konsideruar fare mundësitë e eksportit.

Për më tej, kërkesa për perimet e përpunuara siç është e treguar nga shifrat e prodhimit të përpunuar duket në mënyrë të qartë se do të nënvlerësojë kërkesën aktuale për ushqim të përpunuar, duke marr parasysh se një sasi e konsiderueshme e perimeve, frutave dhe deri në një masë, e mishit, janë të përpunuara nga ekonomitë familjare Kosovare për nevojat e tyre. Kjo tregon se kërkesa e mundshme për produktet bujqësore të përpunuara të kompanisë është në fakt më e madhe se sa që sugjerojnë statistikatat aktuale deh ka mundësi për t'u rritur edhe më shumë përderisa standardi i të jetuarit dhe punësimit (veçanërisht i femrave) në vend rritet, apo përderisa prodhuesit vendor janë në gjendje për të ofruar produkte cilësore me çmime konkurruese.

Pavarësisht jobalancit aktual të madh tregtar në këtë sektor, prodhimi i ushqimit dhe pijet shfaqin potencial, duke qenë nga të paktët sektorë të cilët kanë arritur të konkurrojnë me importet. Është sektori më i madh prodhues në aspektin e shitjeve dhe punësimit, duke punësuar më shumë se 23,000 punëtorë (Riinvest 2010). Për më tej, ka indikacione se ky sektor është duke u rritur, siç është treguar nga fakti se firmat në këtë sektor planifikojnë të rrisin punësimin për disa vite të ardhshme me shumicën që kanë ndërmarr investime kohët e fundit. Këto rezultate janë të përputhshme me gjetjet se firmat në prodhimin e ushqimit dhe pijeve raportojnë, mesatarisht, margjinat më të larta të fitimit në mesin e industrive përpunuese/prodhuese në Kosovë (Riinvest 2010), duke paguar punonjësit një pagë më të lartë sesa mesatarja në sektorin e prodhimit.

Pasi që vendet e punës në përpunimin e ushqimit dhe pijeve janë të para në mënyrë tradicionale si vende pune për femra, nga perspektiva sociale zhvillimi i saj është i dobishëm për shkak se priret të krijojë relativisht më shumë mundësi punësimi për femra, të cilat, siç është sqaruar më herët, kanë më pak mundësi të jenë të punësuar dhe të jenë aktive në tregun e punës. Përveç kësaj, ndoshta edhe më e rëndësishme, zhvillimi i këtij sektori mundet

që potencialisht të ketë efekte të larta shumëfishuese, kryesisht në bujqësi si furnizues të të hyrave për këtë sektor, mirëpo, gjithashtu mund të stimulojë paketimin dhe etiketimin e produkteve dhe shërbimeve, të cilat aktualisht janë pothuajse ekskluzivisht të importuara.

Në aspektin e kërkesës, duket se nuk ka barriera ndaj zhvillimit të këtij sektori. Megjithatë, suksesi i sektorit në masë të madhe varet nga mjedisi biznesor. Intervistat me firmat e këtij sektori identifikuan që barrierat kryesore ndaj zhvillimit të sektorit të përpunimit të ushqimit janë:

Barrierat e brendshme për firmën:

- niveli i shkathtësive të fuqisë punëtore
- niveli i investimeve në R&D, trajnim, çertifikimin e cilësisë dhe promovimin.

Barrierat e jashtme për firmën:

- furnizimi i energjisë
- konkurrenca e padrejtë
- korrupsioni
- qasja në financa.

Mungesa e furnizimit të sigurtë me rrymë është identifikuar si barriera me rëndësinë më të lartë nga firmat në prodhimin e ushqimit dhe pijeve.

Dy barrierat e ardhshme, konkurrenca e padrejtë dhe korrupsioni, rrisin kostot operative, rrisin rrezikun dhe vështirësojnë konkurrencën e bizneseve përpunuese të ushqimit.

Qasja në financa është edhe një faktor kyç i suksesit e cila aktualisht është e pamjaftueshme. Tri-të katërtat e vlerës së investimit të ndërmarrur në prodhimin e ushqimit dhe pijeve janë financuar nga fondet vetjake, derisa kushtet dhe kostoja e financimit janë aktualisht mjaft të pafavorshme.

Përfundimisht, dy barrierat e identifikuara në këtë studim si çelës për zhvillimin e këtij sektori janë niveli i ulët i fuqisë punëtore dhe mungesa e investimeve në R&D, trajnim dhe çertifikim të cilësisë. Një pamje më e afërt në nivelin e shkathtësive dhe nevojave të trajnimit të fuqisë punëtore në prodhimin e ushqimit dhe pijeve ka identifikuar mangësi të mëdha në shkathtësitë e kërkuara nga firmat, shpesh duke i bërë të nevojshme për firmat e mëdha në sektorë që të kërkojnë ekspertizë nga gjetiu në rajon, kështu duke shtuar kostot e tyre operative (UNDP 2011). Shoqëruar me paaftësinë e edukimit aktual dhe furnizimit me trajnime për të kompenzuar këto mangësi, kjo duket të jetë një burim kryesor i preokupimit për politikë-bërësit. Ngjajshëm, bizneset në sektorin e përpunimit të ushqimit dhe pijeve alokojnë më shumë se vetëm 5 përqind të investimeve të tyre në R&D, trajnim dhe çertifikim. Këta janë faktorët kyç në ngritjen e nivelit të cilësisë për produktet vendore dhe së bashku me promovimin efektiv, konkurrencën e tyre në tregun vendor, dhe në veçanti, për potencialin e tregjeve të eksportit.

Sektori i TIK-ut në Kosovë është i vogël mirëpo në rritje të shpejtë. Ka potencial të jashtëzakonshëm për gjeneratën e rinisë me shkathtësi të përgjithshme të larta të TI-së dhe perspektivave aktuale të ulëta të punësimit. Inkurajon edukimin mbi shkathtësitë dhe fokusin mbi inovacionin, dhe ka potencial gjenerues të jashtëzakonshëm të FDI të. Sipas USAID (2007), TIK ka qenë në rritje në një shkallë prej 20-25 përqind në baza vjetore. Ndërkohë, USAID (2011) tregon se ekziston një numër në rritje i vendeve të lira të punës për profesionistët e TIK-ut në Kosovë, duke reflektuar progresin rritës të industrisë në përgjithësi, dhe se ka pasur përmirësime në edukimin e specialistëve të TI-së në universitetet publike dhe private. Sipas këtij studimi, punësimi në sektorin TIK është në rritje, edhe pse me një shkallë më të ulët sesa shitjet, me një shkallë të llogaritur të rritjes së punësimit vjetor prej katër përqind gjatë 2010-tës.

Nga perspektiva sociale, zhvillimi i këtij sektori është i rëndësishëm, sepse ofron mundësi pune për rininë Kosovare, e cila siç është sqaruar më herët, është një grupmoshë e cila vuan në mënyrë joproporcionale nga papunësia. Megjithatë, siç është sqaruar më poshtë, këto mundësi potenciale të punësimit kërkojnë një fuqi punëtore me shkathtësi të larta, e që është një faktor kyç i suksesit për këtë sektor. Është e rëndësishme të theksojmë se krahasuar me mjedisin e përgjithshëm biznesor, aty ku shkathtësitë e stafit dhe edukimit renditen krejt në fund të barrierave, në sektorin e TIK renditen në mesin e barrierave kryesore. Krahasuar me përceptimet e sektorit privat në përgjithësi, dhe atyre të sektorëve tjerë të analizuar këtu, sektori i TIK-ut duket se përjeton një grup të pengesave të ndryshme. Në mënyrë që të marrim më shumë informata specifike mbi barrierat e veçanta të sektorit, është kryer një intervistë me Asociacionin Kosovar mbi Teknologjinë Informative dhe Komunikimit (AKTIK), e cila operon si pjesë e Odës Ekonomike të Kosovës.

Barrierat kryesore specifike të sektorit të identifikuar në sektorin TIK (sipas studimit me AKTIK) janë si në vijim:

Barrierat e brendshme për firmën:

- shkathtësi të pamjaftueshme në fuqinë punëtore.

Barrierat e jashtme për firmën:

- konkurrencë e padrejtë e cila del nga procedurat e prokurimit publik
- mungesës së mbrojtjes së të drejtave të pronës intelektuale
- trajtimit jokonkurrues nga tregtia, TVSH-ja dhe politikat doganore

Natyra e konkurrencës së padrejtë në këtë sektor të veçantë duket të jetë disi e ndryshme dhe më shumë e theksuar sesa në sektorët tjerë. Sipas AKTIK, blerësi kryesor i produkteve të TIK në Kosovë është qeveria, e cila përbën 90 përqind të pjesës totale. Ndërsa, kjo mund të thuhet se ndryshon me rritjen e sektorit privat, AKTIK dëshmon se duke marr parasysh rëndësinë e qeverisë ndaj firmave të TI-së, parregullësitë në prokurimin publik mbesin si barriera kryesore. Problemi kryesor del nga mungesa e kapaciteteve njerëzore në ministritë për të përpiluar termat e referencës për tenderët publikë. Kësisoji, mungesa e specifikacioneve të kërkesave imponon mundësi për një interpretim të gjerë nga trupat e prokurimit, të cilat shpesh përfundojnë me ofrimin e tenderëve tek firmat e lidhura për së afërmi me vendim-marrësit.

Kërkesat fiskale në Kosovë janë të konsideruara jokonkurruese me ato gjetiu në rajon, kryesisht për shkak politikave të pafavorshme tregtare, politikave doganore dhe TVSH-së. Shtetet tjera, për shembull, kanë zero përqind taksë importi mbi produktet teknologjike, siç janë kompjuterët dhe laptopët. Në Kosovë, aplikohet 10 përqind e taksës doganore për produkte teknologjike dhe një 16 përqind shtesë e TVSH-së, përderisa në shtetet tjera TVSH-ja është e caktuar në vetëm pesë përqind. Kjo i bënë tregjet e rajonit, siç është Maqedonia, shumë më tërheqëse për blerjen e mallrave të tilla, duke vështirësuar jashtëzakonisht tregun Kosovar.

Mungesa e të drejtave të pronës intelektuale (DPI) është perceptuar si një pengesë nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (Musa 2011), veçanërisht nga kompanitë në sektorin TIK. Në zhvillimin e softuerit, për shembull, është vështirë për firmat të parandalojnë (ish) punonjësit nga transferi i softuerëve të zhvilluar në firmë (apo versioni pak i modifikuar) tek konkurruesi, të cilët pastaj i shesin si me qenë të tyre (Çavolli 2011). Në këtë rast, megjithatë, problemi qëndron jo në zbatim, por, gjithashtu në pamundësinë e zhvilluesit origjinal të patentojë softuerin. Çështja e DPI-së, aktualisht, mund të afektojë relativisht disa biznese Kosovare, mirëpo është parakusht vendimtar për zhvillimin e aktiviteteve me vlerë të lartë të shtuar dhe faktor kyç (të tanishëm dhe potencial) në gatishmërinë e investitorëve të huaj për të transferuar njohuritë teknike tek filialet e tyre Kosovare.

Kompanitë e TIK-ut gjithashtu pengohen në atë se ato duhet të alokojnë më shumë burime drejt trajnimit të fuqisë së tyre punëtore për shkak të mangësive në sistemin formal të edukimit në Kosovë, e cila nuk ofron fuqi punëtore të kualifikuar për këtë sektor. Programet ekzistuese të edukimit nuk janë të përshtatura për zhvillimet konstante në sektorin e teknologjisë informative më shumë rëndësi duhet menduar në përmirësimin e kushteve për studentët në mënyrë që të stimulohet avancimi dhe inovacioni. Në të njëjtën kohë, ana pozitive e zhvillimit të shkathtësive duket të bie mbi trajnimet profesionale TIK, siç janë Cisco, Microsoft dhe Oracle.

Rritja Private në Kontekstin Social

"Të mirat që i sigurojmë për veten është e pabazuar dhe e pasigurtë derisa të jetë e siguruar për të gjithë ne dhe e përfshirë në jetën tonë të rëndomtë."

Jane Addams (aktiviste sociale dhe politike, themeluese e Lidhjes Ndërkombëtare së Gruas për Paqe dhe Liri - WILPF, dhe marrese e Çmimit Nobel Peace laureat 1931)

Ky kapitull përfundimtar kërkon të eksplorojë më në hollësi ndërlidhshmërinë kritike ndërmjet sektorit privat dhe kontekstit të saj social në Kosovë. Rritja e sektorit privat dhe fitimet e zhvillimit njerëzor janë reciprokisht duke u përforcuar. Nëse qëllimi kryesor i sektorit privat është një shoqëri më e shëndoshë, më e fuqizuar, e lumtur dhe që mbështetet në forcat e veta atëherë është relevante të shtrohet pyetja sesi rritja private i mundëson kapacitetet dhe të drejtat, të cilat thelbësisht përcaktojnë një gjendje të tillë. Në lidhje me këtë, janë tri çështje kyçe (i) ndërlidhshmëria e rritjes private dhe mundësive e shkathtësive njerëzore; (ii) marrëdhënia ndërmjet rritjes private dhe ofrimit të të drejtave fundamentale dhe mbrojtjes të fuqisë punëtore nga brenda dhe jashtë; dhe (iii) lidhja mes rritjes private dhe qëndrueshmërisë mjedisore në rajonin më të ndotur të Evropës.


4.1 Nxitja e aftësive njerëzore

Ky raport disa herë ka potencuar gjetjen paradoksale të mjaftueshmërisë së kënaqshme të aftësive të punonjësit në një klimë të shkathtësive të ulëta. Kjo mund të shihet si një indikator i tregut nën-performues. Kjo evidentohet në Fig. 2.1, ku identifikohet që shkathtësitë dhe arsimimi i fuqisë punëtore në

dispozicion është perceptuar të jetë si një barrierë e ulët për bizneset në Kosovë, me 38 pikë – duke i'u afruar kështu fundit të listës së barrierave kritike të bizneseve. Sidoqoftë është e rëndësishme të theksojmë që – ilustruar në Tabelën 3.1 – çështjet lidhur me shkathtësitë e fuqisë punëtore dhe arsimimin rriten, me rritjen e madhësisë së biznesit. 96 përqind e llogaritur e ndërmarrjeve janë mikro, me shumicën e tyre të përfshira në aktivitete me vlerë të ulët të shtuar. Kompanitë mikro kanë raportuar një intenzitet të barrierës së shkathtësive prej afërsisht 38 nga 100, kompanitë e madhësisë së vogël rreth 46 dhe kompanitë mesatare 61. Kjo do të thotë se mungesa e shkathtësive dhe e fuqisë punëtore të edukuar është më problematike për ndërmarrjet e mëdha (të madhësisë së mesme), firmat e sektorit sekondar dhe ato të sektorit terciar me vlerë më të shtuar. Bizneset poashtu kanë raportuar se marrin kohë dy herë më shumë për të plotësuar pozitat për të cilat kërkohen shkathtësi të larta, se sa të punësojnë për vende pune më poshtë zingjirit të shkathtësive.

Sa është e pakualifikuar fuqia punëtore e Kosovës? Siç është ilustruar në Fig. 4.1, duket se pjesa më e madhe e fuqisë punëtore të Kosovës e punësuar zyrtarisht është e edukuar me më së paku në nivel të shkollës së mesme, me një në pesë që mbajnë diplomë universitare.

Figura 4.1 Kualifikimi akademik i punonjësve (Shpërndarja e të punësuarëve të rregullt sipas nivelit arsimor)




Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjeve Riinvest 2011

Megjithatë, me një punësim më shumë joformal në Kosovë, dhe në përgjithësi të pjesëmarrjes së ulët të fuqisë punëtore, këto shifra paraqesin një pamje të shtrembëruar të shportës totale të shkathtësive në mesin e popullatës me moshë pune të Kosovës. Në 11.3 vite të pritura të edukimit, Kosova ka shkallën më të ulët të parashikuar për edukim në rajon. Veç kësaj, cilësia e të mësuarit është vënë nën dyshim serioz nga Raportet e mëhershme të Zhvillimit Njerëzor,⁵⁸ me mungesë të sinkronizimit ndërmjet lëndëve të mësuara në shkollë dhe shkathtësive që nevojiten për të marr pjesë në tregun e vendeve të punës. Nuk ka ndonjë raport më të ri, në përgjithësi, mbi shkathtësitë e moshës për punë se sa analizat nga Forumi Trajnues Evropian i vitit 2007, i referuar në Parathënien, i cili vlerëson se dy nga çdo i treti i rritur Kosovar ka nivele të ulëta të edukimit. Raporti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nga po i njëjti vit tregon se 76 përqind të grave të regjistruara si të papunësuar kanë qenë të pakualifikuara apo gjysmë-të kualifikuara.⁵⁹ Raporti poashtu tregon se afër 70 përqind e të gjithë të papunësuarve janë gjysmë të kualifikuar apo më poshtë.⁶⁰

Në mënyrë ironike, shkathtësitë në Kosovë shihen si më pak të rëndësishme sesa faktorët tjerë për të siguruar një vend të mirë pune. Ka dëshmi për të sugjeruar se punëdhënësit në Kosovë kanë më shumë mundësi të mbështeten mbi metodat joformale të rekrutimit/punësimit. Shumica e firmave të anketuara për këtë raport (rreth 45 përqind) i angazhojnë punonjësit përmes rekomandimeve nga shokët dhe partnerët, dhe 36 përqind nga familja (Ilustrimi 4.2.), vetëm 15 përqind angazhojnë personel përmes shpalljes publike, dhe vetëm disa firma, më pak se 4 përqind nga zyret publike për papunësi. Në aspektin e përgjithshëm, rreth 80 përqind të bizneseve shfrytëzojnë rrethet e brendshme të rekomandimeve për të angazhuar personel. Firmat e vogla - duke llogaritur për shumicën e punëdhënësve kosovarë - janë më të prirura për të bërë vendime të tilla të punësimit bazuar në lidhje.

Metodat joformale të rekrutimit si kjo i pafavorizojnë sektorët e vërtetë të shoqërisë që kanë nevojë më së shumti: të papunët, të marginalizuarit dhe rinia. Në zonat e fushave të larta të papunësisë dhe brenda komuniteteve

Figura 4.2 Burimi primar i punësimit të personelit (përqindja e firmave të intervistuar)



Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjeve Riinvest 2011

të privuara, rrjetet dhe kontaktet e nevojshme për të marr informatat rreth vendeve të lira të punës janë të dobëta. Të rinjtë janë të dekurajuar nga qëndrimi në shkollë, në përvetësimin e shkathtësive dhe konkurrimit. Të papunët për një kohë të gjatë, kanë më shumë gjasa të dalin së bashku jashtë pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, nëse ata besojnë se nuk janë në gjendje të gjejnë vend pune për shkak të lidhjeve të dobëta. Grupet dominante etnike, dhe ato me fuqi ekonomike dhe politike, janë duke përfituar nga kultura e nepotizmit në Kosovë.


Nepotizmi në mënyrë delikate ndryshon vlerat që mbajnë punonjësit në Kosovë - e treguar nga diskutimet e fokus grupeve të cilat shpesh kanë vënë në përparësi besnikëritë mbi shkathtësitë. Mungesa e tendencës për të përzgjedhur punëtorët në bazë të meritave rezulton në përzgjedhjen e një fuqie punëtore më pak të kualifikuar, e cila në shkëmbim ndikon në aftësinë e biznesit për të konkurruar dhe rritur.

Të rinjtë, në veçanti, janë shumë të vetëdijshëm se praktikatat e punësimit

në Kosovë mund t'i lënë ata jashtë. Nevojitet kohë më e gjatë për t'a lidhur një person të ri me tregun e punës në Kosovë se sa që duhet në disa nga vendet fqinje të Kosovës – një mesatare e dhjetë viteve për meshkuj të ri Kosovarë, për shembull, krahasuar me katër vite në Maqedoni.⁶¹ Punëkërkuesit nën 25 vjet, kur pyeten që të vlerësojnë rëndësinë e faktorëve të ndryshëm derisa kërkojnë punë, kanë përmendur jashtëzakonisht lidhjet si faktori kryesor (38 përqind), derisa vetëm 15 kanë përmendur edukimin si të rëndësishëm. Përderisa, ky studim është fokusuar mbi punësimin në sektorin publik, intervistat cilësore kanë treguar se përceptimi nuk dallon ndërmjet sektorëve publik dhe privat.

Në fakt, sektori privat në Kosovë qëndron më mirë se sa sektori publik në dhënien e një përshtypjeje të punësimit të drejtë bazuar në shkathtësi dhe merita. Përafërsisht gjysma e të rinjëve të intervistuar për këtë studim (54 përqind) kanë thënë se praktikatat e drejta të punësimit nuk mund të

Figura 4.3 Faktorët kyç të përceptuar prej të rinjve, për punëkërkim të suksesshëm



Pulsi i Publikut UNDP 2011


gjenden asgjëkundi në Kosovë. Vetëm 14 përqind kanë thënë se praktikat në sektorin privat janë të drejta.

Është e mundshme – në të vërtetë esenciale – për të ngritur potencialin njerëzor të popullatës së Kosovës me moshë të punës, dhe të inkurajoj të besuarit në mundësinë e avansimit përmes të mësuarit dhe shkathtësive. Kjo mund të arrihet në mënyrën më

efektive përmes harmonizimit të strategjive qeveritare për punësim dhe edukim, përfshirë trajnimet profesionale. Kosova ka nevojë për një kulturë të të mësuarit gjatë gjithë jetës, një besim se nxitja e potencialit personal dhe investimi në vete do të dërgojë në një standard më të mirë të të jetuarit.

Aktualisht, të rinjtë Kosovarë ndihen mjaft të ndarë në dysh rreth asaj

Figura 4.4 Përqindja e të rinjve të cilët mendojnë se institucionet e mësipërme aplikojnë punësim të drejtë



Pulsi i Publikut UNDP 2011

se a do t'i përgatit edukimi ata për jetë apo jo. Në një seri të studimeve të fokus grupeve të drejtuara nga UNICEF, mbi 40 përqind kanë thënë se edukimi nuk ka qenë i dobishëm në përgatitjen e tyre për fuqinë punëtore, 30 përqind kanë thënë se po dhe një 30 përqindësh tjetër kanë qenë të pasigurtë⁶². Raporti i njëjtë tregon se në tërë Kosovën, 36 përqind e 15-24 vjeçarëve në shkollë nuk kanë pasur laborator, 29 përqind nuk kanë pasur internet dhe 19 përqind nuk kanë pasur kompjuterë. Nuk është për t'u habitur pastaj se 48 përqind të këtyre të rinjve e kanë vendosur papunësimin në krye të listës së kërcënimeve ndaj të ardhmes së tyre dhe të Kosovës - e përcjellur nga varfëria me 30 përqind duke u rradhitur e dyta në listën e kërcënimeve më të mëdha.

Aktualisht, Trajnimet Profesionale nuk duket se takojnë nevojat e atyre që janë më të përjashtuar nga fuqia punëtore – analfabetët, të varfërit dhe gratë në pozita me varshmëri të lartë.

Aktualisht, programet trajnuese profesionale dhe programet lehtësuese të leximit (eng. catch-up: intervenim i strukturuar në sistemin një-me-një për nxënësit të cilët kanë vështirësi në lexim) nuk duket se takojnë nevojat e atyre më të përjashtuarve nga fuqia punëtore – analfabetëve, të varfërve dhe grave në pozita me varshmëri të lartë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka implementuar një program të quajtur **Dritare Jete**, e cila i jep grave pa çertifikatë të shkollës fillore mundësinë për t'i marr ato. Megjithatë, ky program që ende duhet të shkojë tutje në zonat më të varfëra, nuk merr parasysh sfidat me të cilat përballen gratë që kujdesen për fëmijë dhe prandaj është e një cilësie të pabarabartë⁶³.

Të dhënat nga 2003-ta, tregojnë se 55 përqind e të regjistruarëve në programet profesionale të financuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka përfunduar shkollën e mesme⁶⁴. Nga gratë që kanë marr pjesë, mbi 70 përqind kanë marr çertifikatë të shkollës së mesme. Duke marr parasysh hendeqet e mëdha të arsimimit ndërmjet burrave dhe grave, veçanërisht në zonat rurale, duket se ata më të privuarit kanë më së paku qasje në programet të cilat mund të transformojnë jetët e tyre. Transferet sociale siç janë përfitimet e ekonomive familjare, deri tani, nuk e lidhin të papunësuarin me skemat e të mësuarit për tërë jetën, me programet e gatishmërisë së punës, apo iniciativa tjera kreative të cilat mund të sjellin punëdhënësit dhe punëkërkuesit së bashku. Veç kësaj, programet e veçanta të trajnimit duhet të konsiderohen për ata të cilët me gjasë janë më pak në gjendje t'i qasen programeve tradicionale – gratë rurale, personat me aftësi të kufizuar dhe minoritetet e marginalizuara siç janë RAE.

Një standard minimal i shërbimeve sociale në komunitetet e varfëra është poashtu kritik për të ngritur pjesëmarrjen e fuqisë punëtore dhe për të thyer varshmërinë mbi remitancat dhe përfitimet. Pa shërbime shëndetësore, ujë, rrymë dhe edukim, familjet janë të reduktuara në strategji të mbijetesës. Punëkërkimi bart një kosto të mundësisë, poqëse obligimet që marrin shumë kohë përfshijnë bujqësinë si formë mbijetese apo të kujdesit për të afërmit e sëmurë. Investime të tilla paguajnë dividende afatgjata duke filluar me thyerjen e cikleve të privimit dhe përjashtimit (UNDP KHDR 2010).

Edukimi, të mësuarit, shkathtësitë, rritja gjithëpërfshirëse dhe fuqizimi politik shkojnë dorë për dorë. Dobitë e tyre ndaj ekonomisë dhe shëndetit

të shoqërisë janë të thella dhe reciprokisht përforcuese. Aftësitë e zgjeruara përmirësojnë vetëvlerësimin e gjithashtu edhe shkathhtësitë teknike si dhe një pjesëmarrje më të lartë në fuqinë punëtore dhe gjithashtu në mënyrë ideale në të ardhura më të larta. Të gjithë këta faktorë kontribuojnë në stimulim për zgjerimin e biznesit, të inspirojnë dhe të pajisin njerëzit për të bërë inovacione, të përfshihen në aktivitete biznesore dhe t'i sjellin ndërmarrësisë vlerë të shtuar në një treg i cili ka aq shumë nevojë për to.

4.2 Ndërlidhja e dinjitetit të fuqisë punëtore dhe mbrojtjes sociale

Lidhja ndërmjet punës, dinjitetit dhe mbrojtjes dëshmon klimën e të drejtave në kontekstin social dhe qeverisë. Dinjiteti dhe siguria në vendin e punës afekton jetën e tërë. Nëse puna nuk është e denjë, dhe nëse të drejtat e punëtorit nuk janë të mbrojtura, atëherë puna kontribuon në mjerim, pabarazi dhe pakënaqësi në vend të zgjerimit të lirive dhe zgjidhjeve. Veç kësaj, sektori privat ka një ndikim mbi kapacitetin e qeverisë për të siguruar mbrojtje të gjërë sociale, si një makinë për rishpërndarjen e të ardhurave. Ashtu siç rritet niveli i punës së denjë, formale, taksapaguese dhe që gjeneron të hyra, ashtu rritet edhe potenciali për mbështetjen krijuese të qeverisë për ata që nuk janë në fuqinë punëtore e drejtuar drejt heqjes së tyre nga varshmëria.

4.2.1 Dinjiteti i fuqisë punëtore

A e mbështet modeli i rritjes së sektorit privat të Kosovës dinjitetin e fuqisë punëtore? Kosova kohët e fundit ka paraqitur ndryshime fundamentale

në Ligjin e saj të Punës,⁶⁵ e cila afekton pagat, pushimin e lehonisë, mundësinë e barabartë për personat me aftësi të kufizuar dhe pensionet. Një nga këto është pushimi i lehonisë që zgjat deri në një vit. (2010). Në Gusht 2011, qeveria e Kosovës ka miratuar një vendim të Këshillit Socio-Ekonomik,⁶⁶ duke vendosur pagat minimale të para mujore të Kosovës në 170 euro për punonjës të moshës 35-65 vjet dhe 130 euro për ata nën 35 vjet. Këto ligje janë një përpjekje për të mbrojtur të drejtat e të varfërit dhe grave në vendin e punës. Megjithatë, implementimi i tyre në tregun e punës, dhe ndikimi i tyre mbi shoqërinë më të ndjeshme, mbetet i hapur për pyetje/dyshime.

Komentet e shkëmbyera kualitative tregojnë se bizneset janë duke luftuar që të kuptojnë dhe të pranojnë ligjet e reja. Në fakt, janë më të prirur me gjasë për t'i anashkaluar ato duke u angazhuar në punësim joformal dhe duke punësuar më pak gra.

Një 40 përqind i habitshëm i firmave të intervistuar kanë raportuar se ata nuk janë të vetëdijshëm me pagën minimale të paraqitur. Një shumicë absolute (91 përqind) të firmave të tilla janë mikro-ndërmarrje, me vetëm 9 përqind që kanë qenë firma të vogla. Firmat mesatare ishin të gjitha të vetëdijshme për kërkesat e pagës minimale, duke treguar kështu një tendencë të firmave më të mëdha që të jenë më të informuara lidhur me kërkesat juridike. Duke pretenduar se mbrojtja e pagës minimale kryesisht të edukimit, kompanive të anketuara ndikon në ata punëtorë me nivel të ulët i'u është kërkuar të identifikojnë nivelet e pagave për ata me edukim të shkollës fillore apo më pak. Rreth një e treta ka treguar se ata janë duke i paguar këta punëtorë me pak sesa paga minimale. Pasi që ky ligj është relativisht i ri, do të ishte me rëndësi të gjenden metodologji për vlerësimin

e implementimit të saj dhe ndikimit mbi shkallët e varfërisë në mesin e të punësuarve gjatë viteve të ardhshme.

Ndikimi i mbrojtjeve të pushimit të lehonisë mbi sigurinë e vendit të punës së grave është më preokupues. Gjatë një serie të tryezave të rrumbu-llakta, pjesëmarrësit vunë në dukje paraqitjen e praktikave të reja të kontratave afatshkurtra (një deri në dy muaj) për punëtorët gra për të ndihmuar kompanitë në shmangien e obligimeve të pushimit të lehonisë. Paraprakisht dispozitave të reja, nuk ka pasur dallim të dukshëm në kohëzgjatjen e kontratës në mes të burrave dhe grave. Disa gra janë ndjerë gjashtu se ligji ka punuar kundër interesave dhe pozitës së tyre në vendin e punës. E shumë janë ndier se tani do të jenë të shtyera për të pranuar kontrata joformale, afatshkurtra dhe të humbasin kontributet pensionale dhe siguritë tjera të punës. Gratë e reja janë në veçanti të rrezikuara, se sa gratë që tashmë e kanë kaluar fazën e jetës së tyre të lindjes së fëmijëve.

Ka pak të dhëna kuantitative mbi ndikimin e dispozitave të paaftësisë për punë në Ligjin e Punës - e cila potencon se për çdo pesëdhjetë punonjës, kompania duhet të punë-sojë së paku një person me aftësi të kufizuar⁶⁷. Të anketuarit në këtë studim kanë treguar se disa firma mesatare të vetëdijshme për këtë ligj kanë synuar të kenë vetëm 50 njerëz në librat e tyre, për t'u shmangur obligimeve në këtë drejtim.

Është absurde për një punonjës të jetë larg vendit të punës për një vit. Nëse ky ligj nuk ndryshon, ne nuk do të punësojmë më gra në firmat tona.

Janë sfida të qarta ato që dalin nga politikat e mbrojtjes së fuqisë punë-tore në Kosovë - edhe pse më shumë në rrafshin implementues se sa në rrafshin legjislativ. Këto politika kanë një efekt të pashmangshëm të rritjes së kostos së përgjithshme të punës dhe rritjes së kostos relative të punësimit të grave. Prandaj, këto ligje kërkojnë implementim dhe politika monitoruese të ndjeshme.

Në tërë botën, shoqëritë janë ende duke luftuar që të gjejnë ekuilibrin në mes të mbrojtjeve të vendit të punës dhe lirive rritëse përmirësuese të biznesit. Nuk ka arsye për të besuar se Kosova do të gjejë formulën e përsosur. Megjithatë, shumë mund të bëhet për të ndihmuar kompanitë që t'i shohin këto ligje si shoqërisht të dobishme dhe ofruese të mundësive për shembull, pushimi i lehonisë mund të mbulohet me nxitjen interne, duke ia shtuar grupeve të shkathtësive të punëtorëve. Një marrëdhënie pozitive punëtor-punëdhënës dhe programet e përbashkëta komunikuese të biznesit janë kritike për të siguruar sinergji ndërmjet ligjeve dhe praktikave, dhe të shikohet që mbrojtjet ngrisin dinjitetin pa i zvogëluar mundësitë.

4.2.2 Rrjeti i sigurisë sociale dhe ndërlidhja e rritjes me rishpërndarjen e të ardhurave

Rrjetat e sigurisë sociale (parandalimi i të varfërit apo atyre më të rrezikuarve ndaj fatkeqësive apo parandalimit të varfërisë në rënien më poshtë se një nivel i caktuar i varfërisë) dhe transferet, nganjëherë shihen si armik i rritjes së sektorit privat – e cila than burimet ekonomike kombëtare pa ofruar të mira për rritje. A është kjo e vërtetë apo e pavërtetë për Kosovën?

45 përqind të Kosovarëve më poshtë se vija e varfërisë shumica e të cilëve nuk janë as në fuqinë punëtore apo të punësuar varen prej kombinimit të mirëqenies sociale qeveritare dhe remitançave. Kjo ndërpret perspektivat e sektorit privat të Kosovës në disa mënyra.

Remitencat luajnë një rol të ndërlikuar në modelin e rritjes në Kosovë – për së miri dhe për së keqi. Ato mund të afektojnë pozitivisht rritjen ekonomike në disa mënyra. Njëra nga efektet kryesore është e gjeneruar përmes mekanizmit shumëfishues, p.sh. duke e rritur konsumin, prodhimin dhe investimin e përgjithshëm. Studimet tregojnë se ekziston një marrëdhënie pozitive ndërmjet rrjedhës së remitançave dhe zvogëlimit të varfërisë në shtetet në zhvillim (Brown 1994; Faini 2002; Mesnard 2004; Lucas 2005). Këto studime të njëta, gjithashtu kanë gjetur se remitancat bëjnë një kontribut të konsiderueshëm në kursime dhe investime në ekonomitë në zhvillim. Ekonomitë familjare të cilat kanë qasje të kufizuar në financa tentojnë të shfrytëzojnë remitancat për projektet e tyre investive.


Zhvillimet politike dhe socio-ekonomike gjatë tri dekadave të kaluara kanë dërguar tek një vërshim i rëndësishëm i popullatës së Kosovës. Në fund të

viteve 1980 dhe 1990, emigrimi është shpejtuar me përqendrimin e situatës politike drejt konfliktit të 1999-tës. Shumë emigrantë nuk janë kthyer në vendin paskonfliktuoz, në veçanti për shkak të mundësive të mëdha të të ardhurave ndërmjet Kosovës dhe shteteve të zhvilluara, e gjithashtu edhe nga mungesa e mundësive të punësimit në Kosovë (Riinvest 2008b). Është llogaritur që rreth 25 përqind të kosovarëve (të të gjitha etniciteteve) momentalisht jetojnë jashtë vendit. Rreth dy të treta e kësaj popullate e vizitojnë Kosovën çdo vit (Riinvest 2008b).

Sipas studimeve të fundit në Kosovë (UNDP 2010; Riinvest 2008b), rreth 20 përqind të ekonomive familjare Kosovare pranojnë remitanca nga familjet e tyre që jetojnë jashtë vendit. Rrjedhat e remitançave janë më të zakonshme në mesin e K-shqiptarëve: 27 përqind kanë përfituar nga remitancat në vitin 2010, krahasuar me 7 përqind të K-serbëve dhe 12 përqind të RAE, (Ilustrimi 4.5). Kësisoj, remitancat janë duke e zvogëluar numrin e Kosovarëve që jetojnë në varfëri (Banka Botërore 2011), mirëpo, jo gjithnjë të arrijnë më të varfërit në mesin e jo-shqiptarëve. Më 2009, një në çdo pesë ekonomi familjare janë varur nga remitancat për mbi një e katërta e të ardhurave të tyre, me një total të pranuar të remitançave që përbëjnë 11 përqind të GDP-së⁹⁸. Gjithashtu, fluksi i emigrantëve gjatë verës rrit konsumin e përgjithshëm gjatë qëndrimit të tyre.

Remitancat i ofrojnë dobi mjedisit biznesor të Kosovës në mënyrë direkte dhe jodirekte. Rreth 12 përqind të remitançave janë të përdorura direkt për investime të ndërmarrjes, me një 10 përqind tjetër për rikthimin e borxhit (të cilat disa nga to kanë lidhshmëri me ndërmarrjen)⁹⁹. Remitancat kanë zvogëluar kufizimin e depozitës ban-

Figura 4.5 Përqindja e amvisërive të cilat marrin remitanca sipas përkatësisë etnike



Studimi mbi Remitancat UNDP 2011 remitanca sipas përkatësisë etnike

kare të ekonomive familjare përfituese, kështu që aktiviteti biznesor dhe investimet private mund të rriten (Yang 2004; Woodruff dhe Zenteno 2004). Në mënyrë jodirekte, remitancat janë poashtu duke ndihmuar të përmirësojnë indikatorët social dhe të zhvillimit njerëzor si dhe të përkrahin një fuqi të shëndoshë dhe të kualifikuar punëtore. Rreth 12 përqind të remitancave janë të shfrytëzuara për investimet në njerëz (kryesisht edukim dhe trajnim).

Megjithatë, rrjedhat e remitancave në këtë shkallë heqen nga klima e ndërmarrjes. Pavarësisht shumëve mbresëlënëse të parave që futen në Kosovës përmes remitancave, efekti shumëfishues mbi gjenerimin e rritjes ekonomike dhe vendeve të reja të punës nuk është proporcional. Rrjedhat e remitancave janë kryesisht të shpenzuara në mallra të importuara

konsumuese, inputeve të importuara në ndërtimin e banimeve dhe për shërbimet e shëndetit (Riinvest 2008b). Remitancat poashtu zgjerojnë hendekun e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, stimulimin e punëkërkimit duke inkurajuar disa ekonomi familjare përfituese të punojnë më pak, zvogëlimin e furnizimit të punës dhe kështu duke zvogëluar prosperitetin dhe rritjen ekonomike. Në aspektin e zhvillimit njerëzoratorrisin varshmërinë dhe kufizojnë rritjen njerëzore dhe lirinë, duke i mbajtur njerëzit të lidhur me preferencat e vullnetit, përpjekjeve dhe investimeve të tjerëve. Ato poashtu zvogëlojnë stimulim qeveritar për të prekur rrënjët e varfërisë, duke shtuar hendekun ndërmjet interesit privat dhe të mirës publike.

A mund të paraqes Kosova strategji më të mira efektive për të drejtuar rrjedhën/fluksin e jashtëzakonshëm të

Pavarësisht nga shumtë impulsive të parave që futen në Kosovë përmes remitancave, efekti shumëfishues mbi gjenerimin e rritjes ekonomike dhe vendeve të reja të punës nuk është proporcional.

remitancave në mënyrë më efektive tek ndërmarrjet private, në një mënyrë që të nxit zhvillimin njerëzor? Aktualisht, vendit i mungojnë politikat e remitancave. Dy të cilat mund të jenë kyçe, janë: (1) një plan për të rritur pjesën e fluksit të remitancave të drejtuara përmes kanaleve formale. Ekziston dëshmia, nga studimi i fundit i UNDP-së (2010), se rreth 60 përqind të remitancave futen përmes kanaleve joformale; rrjeta të tilla të transferit të parave janë zakonisht më të lira sesa kanalet formale. Megjithatë, një numër i efekteve negative mund të dal nga operimet me kanale joformale të transferit, duke filluar nga kontrabandimi financiar dhe pastrimi i parave, deri tek pasojat makroekonomike për mbledhje të taksave; dhe (2) një strategji për stimulimin e një pjese të madhe të shfrytëzimit të remitancave për aktivitete produktive, si pjesë e planeve pjesëmarrëse zhvilluese komunale. Sipas Riinvestit (2008b), investimet fizike dhe kapitale njerëzore janë dy kanalet kyçe përmes të cilave remitancat mund të gjenerojnë efekte pozitive mbi zhvillimin ekonomik. Ekzistojnë praktikat më të mira mbi të cilat qeveritë kanë zhvilluar programe të duhura trajnimi në ndihmën e kthimit të emigrantëve apo që përfituesit e remitancave të marrin vendime efektive të investimeve. Përvoja e mëhershme e Kosovës mund të jetë një shembull shumë i mirë, ku emigrantët formojnë asociacione për të ngritur fonde në mënyrë që të ndihmojnë shoqërinë e Kosovës. Në kohët e sotme, asociacionet e tilla do të kishin një ndikim të madh mbi infrastrukturë, kujdesin shëndetësor dhe zhvillimin edukativ. Në një skemë të tillë, kontributet individuale mund të krahasohen/përputhen me fondet qeveritare.


Skemat e mirëqenies sociale paraqesin një pamje të njëjtë të ndërlidhur në aspektin e marrëdhënies së tyre me

rritjen private dhe zhvillimin njerëzor. Shpenzimi i Kosovës në ndihmën sociale ka mbetur në thelb statik për shumë vite – dhe është zvogëluar në kategoritë kyçe shenjuese të varfërisë siç janë ndihmat sociale. Përderisa, synimi i programeve ndihmëse të ekonomive familjare është relativisht efektiv (Banka Botërore vlerëson se vetëm 7 përqind të shpenzimeve të ndihmës i shkojnë ekonomive të pasura familjare), kategorizimi i skemave të ndihmës sociale do të thotë se një pjesë e konsiderueshme e të varfërve dhe atyre jashtëzakonisht të varfër nuk janë të shenjuar.

Ngritja e ngadaltë e GDP-së së Kosovës është përputhur me një ulje proporcionale në shpenzimet e ndihmës sociale. Nga viti 2006 – 2008, numri i familjeve përfituese ka rënë nga 40,569 në 34,307. Kjo përkthehet në 25,000 më pak njerëz të varfër që pranojnë nga qeveria ndihmë që lidhet me varfërinë⁷⁰. Gjithashtu, shpenzimet aktuale janë ulur (Ilustrimi 4.6.)

Me shkallët e varfërisë që mbesin relativisht të njëtrajtshme derisa shpenzimi bie (43 përqind në vitin 2003 dhe 45 përqind në vitin 2008, sipas Vlerësimit të Varfërisë së Bankës Botërore), duket evidente se vetëm pak njerëz të varfër janë duke u arritur nga ndihma sociale për çdo vit që kalon. Poashtu, nuk ekziston ndonjë indeksim që e lidh përfitimin e varfërisë së ekonomisë familjare me inflacionin – edhe pse madhësia e përfitimit të ekonomisë individuale familjare është ngritur së fundi nga 40 në 45 euro në muaj. Çështjet e kategorizimit përkeqësojnë problemin e synuar. Momentalisht, ekonomitë familjare që dëshirojnë të futen në skemë duhet të mos kenë vetëm nivel të ulët të të ardhurave, mirëpo gjithashtu të përmbushin një numër të kriterëve lidhur me numrin e vartësve në ekonominë familjare

Figura 4.6 Ndryshimi i përqindjes së GDP-së dhe shpenzimet e ndihmës sociale në Kosovë



Banka Botërore, Agjencia e statistikave të Kosovës, Ministria e Financave & Gassman dhe Roelen 2009 (raportuar në UNICEF Varfëria e Fëmijëve në Kosovë 2010)

(si përshembull penzionistët, njerëzit me aftësi të kufizuar apo fëmijët nën pesë vjet, për shembull). Shumë familje janë thjesht të refuzuara nga skema kur fëmija më i ri mbush gjashtë vjet, pavarësisht nivelit të tyre të të ardhurave. Si rezultat, Banka Botërore gjykon se vetëm 23 përqind të të varfërve dhe vetëm 34 përqind të jashtëzakonisht më të varfërve të Kosovës janë duke pranuar ndihmë Sociale⁷¹ – duke vendosur mijëra burra, gra dhe fëmijë në gjendje të një ankthi ekstrem.

Mundësitë të cilat ulin varfërinë në afat të shkurtër dhe inkurajojnë pjesëmarrjen e fuqisë punëtore në afat të gjatë dhe reduktojnë varshmërinë janë duke humbur. Strategjitë që synojnë të përkrahin më të varfërin me skema përmirësuese të pabarabarta të mirëqenies sociale dhe me të holla/para të përkrahura nga komuna për programet e punës, nuk ofrojnë “vlerë për para” qoftë në zvogëlimin e varfërisë e poashtu edhe në rritjen e saj. Në vend të kësaj, mund të ketë mundësi që ndërlidhin përfitimet me masat kritike e që nxisin zhvillimin e aftësive njerëzore, punë-kërkimin dhe ndërmarrjet private. Për shembull, anëtarët e papunë të ekonomive

familjare që pranojnë përfitimet mund të përkrahen për t’u angazhuar në programet punëkërkuese. Ata me probleme të të mësuarit apo leximit, në veçanti gratë, mund të shenjohen për skema për lehtësimin e leximit dhe të të mësuarit. Përfitimet mund të ndërlidhen me masa të tilla. Duke shikuar të ardhmen e Kosovës, është kritike që të eliminohet kufizimi i moshës mbi përfitimet, e cila shtyn familjet më tutje në varfëri, mu në kohën kur fëmijët e tyre i ofrohen moshës për shkollë. Paraqitja e përfitimeve për fëmijë përtej kësaj pike mund të ndërlidhet me vijimin e tyre të shkollës. Kjo do të nënkuptonte që fëmijët e të varfërve do të qëndronin më shumë në shkollë, duke zgjerur grupin e shkathtësive/horizontet, të një force të ardhshme të punës dhe duke zvogëluar rrezikun e varshmërisë ndër-gjenerata.

Rishpërndarja efektive e të ardhurave, gjithashtu, varet në planifikimin adekuat rreth fushave kyçe si shëndetësia dhe edukimi – përfshirë të mësuarit për lehtësimin e leximit për të rritur. Kështu, ofrimi i shërbimit të përmirësuar thelbësor duhet të integrohet në modelet strategjike për rritjen e gjërë dhe të qëndrueshme të sektorit. Si

Mund të ketë mundësi që ndërlidhin përfitimet me masat kritike e që nxisin zhvillimin e aftësive njerëzore, punë-kërkimit dhe ndërmarrjes private.

transferet direkte sociale poashtu edhe transferet jodirekte sociale (siç është shpenzimi në shërbime) janë treguar të ndikojnë në pabarazinë në vendet tranzicionale.⁷² Të shpenzuarit në edukim, për shembull, është treguar të ketë lidhje direkte me barazinë botërore mbi të ardhurat.⁷³

Rishpërndarja e të ardhurave, në shkëmbim, nxit fuqizimin. Njerëzit të ngritur së pari nga varfëria absolute dhe pastaj jashtë ciklit të varshmërisë kanë më shumë gjasa të ndihen të involvuar në proceset politike dhe më në gjendje që zëri i tyre të dëgjohet. Kjo është mënyra që Kosova mund të kalojë nga profili i dominuar i një grupi të privilegjuar apo serive të enklavave në një demokraci më gjithëpërfshirëse në të cilën idetë, jo etnicitetet, kanë fjalën e fundit në vendimet qeverisëse.


Sektori privat është çelësi për rishpërndarjen e të ardhurave në Kosovë, dhe në reduktimin e varfërisë dhe varshmërisë. Tatimimi i sektorit privat mund të ngris shportën e fondeve të disponueshme për transferet sociale. Rritja e sektorit privat sjell pasuri dhe mundësi në zonat e varfëra. Në mënyrë korresponduese, një fuqi më aktive dhe e edukuar e punës, e përkrahur për dalje nga varshmëria përmes shërbimeve thelbësore cilësore dhe transfereve tjera të sektorit publik, është fundamentale për rritjen e sektorit privat. Megjithatë, këto përparësi nuk shtohen në mënyrë automatike. Ato duhet të shtyhen/farkëtohen përmes politikave aktive që kërkojnë të thyejnë ciklet e varshmërisë dhe të lidhin të varfërit me rritjen e qëndrueshme. Kjo do të jetë sfida parësore ekonomike e Kosovës për vitet pasuese.

4.3 Mbështetja e qëndrueshmërisë mjedisore

Ka pak të dhëna konkrete në dispozicion mbi trendet mjedisore të Kosovës – përfshirë marrëdhënien e saj me ndërmarrjen dhe industrinë. Megjithatë, një hulumtim i drejtuar gjatë dekadës duke filluar menjëherë pas konfliktit 1999 ka pikturuar një tablo të tmerrshme të statusit mjedisor të Kosovës. Industria – në veçanti e ndërmarrjeve në posedim shtetëror – ka lënë një trashëgimi të dërrmuar në zonat e rrezikuara të Kosovës. Thënë thjesht, Kosova ka qenë qendra e formave më të ndotshme të industrisë së rëndë për dekada – veçanërisht nxjerrjes dhe përpunimit të parregulluar të metaleve të rënda toksike dhe djegies praktikisht të pafiltruar të thëngjellit të kaftë në stacionet nën-standard të energjisë. Deri 85 përqind e popullatës varet në djegien e drurit për nevojat e saj bazike të nxehtësisë dhe energjisë.

Sot, Kosova ka problemin më të keq të kontaminimit me metale të rënda në botë – në mënyrë specifike kontaminimi nga plumbi në komunat veriore të Leposaviqit, Zveqanit dhe Mitrovicës – dhe kontaminimin e ndotjes atmosferike me 74 herë më shumë se standardet Evropiane⁷⁴. Studimi i Organizatës për Shëndetësinë Botërore mbi fëmijët nën moshën trevjeçare në komunat e Mitrovicës dhe Zveqanit tregon se së paku një e katërta e tyre ka nivele të ngritura të plumbit në sistemin e qarkullimit të gjakut (e ngritur në 100 përqind tek fëmijët e studiuar RAE). Sëmundjet e

Figura 4.7 Sëmundjet e lidhura me ndotjen mjedisore



Gjendja e Mjedisit në Kosovë, Misioni Ndihmës i Kombeve të Bashkuara në Kosovë 2003

mushkërive janë shumë të përhapura në mesin e fëmijëve dhe popullatës së moshës për punë, e cila ul aftësitë njerëzore me kosto të pamatur të produktivitetit të gjërë të Kosovës.

Mungesa kronike e llogaridhënies qeveritare mbi mjedisin në mënyrë të dukshme ka infektuar qëndrimet dhe sjelljet e individëve dhe të bizneseve. Legjislacioni kundër-duhan nuk është i zbatuar në dyqanet e panumërta të kafeve dhe shitoreve të mëdha në Kosovë, pavarësisht prezencës së grave shtatëzëna, fëmijëve dhe foshnjave. Shpërndarja e parregullt e gjërave nga bizneset publike dhe lokaleve është shumë e përhapur. Në mungesë të rrjetit të fabrikave për trajtimin e mbeturinave, industritë e tilla janë më pak të stimuluar për të trajtuar vëllimet e mbetjeve të hudhura në rrugët/kanalet ujore të Kosovës.

Sot, në shumë vende në tranzicion dhe zhvillim të fokusuar nga rritja, Kosovarët dëshirojnë një dorë të lirë

që të përkthejë burimet e tyre natyrore të lakmueshme në të ardhura. Kosova ende është e pasur me minerale, thëngjill linjit, burime ujore dhe tokë të punueshme. Poashtu, është në proces të privatizimit të industrive të mëdha, për ngritjen e mundësive për rritje ekonomike dhe tregti ndërkombëtare. Ky drejtim i politikës tani paraqet disa enigma të rënda serioze për Kosovën, pasi që kërkon të ekuilibrojë interesat e ndërmarrjeve private dhe garës së dëshpëruar për rritje të GDP-së përkundrejt brishtësisë së burimeve të saj natyrore dhe shëndetit të popullatës së saj.

Lidhja ndërmjet qëndrueshmërisë mjedisore dhe rritjes së sektorit privat është e krijuar mirë (Pearce, Barbier dhe Markandya, 1989), derisa strategjitë për një "gjendje të artë" të cilat mishërojnë ekuilibrin ideal ndërmjet politikave efikase, rritjes dhe mirëqenies njerëzore janë përshkruar dhe poashtu janë provuar në kontekstet në zhvillim (Ayong le Kama, 2001, Endress et al.

Përfitimet e perceptuara të aktiviteteve të pandjeshme në aspektin mjedisor ende peshojnë me shumë se ato që potencialisht rrjedhin nga obligimet mjedisore.

2005). Ky raport nuk fokusohet në hollësi mbi të gjitha argumentet dhe lidhjet e mundshme.

Megjithatë, ekzistojnë tre faktorë kyç të cilët lidhen për së afërmi me çfarëdo perspektive për një "gjendje të artë" në Kosovë në një të ardhshme të parashikueshme: Efikasiteti i energjisë, përgjegjësia biznesore dhe përputhshmëria si dhe ndërmarrjet ekologjike/"e gjelbërta". Të gjitha këto do të trajtohen më detajisht në seksionet që vijojnë.

Politika mbi **efikasitetin e energjisë** është ndoshta më fundamentale nga këto. Kompanitë e sektorit parësor në Kosovë e kanë renditur energjinë në krye të listës së tyre të barrierave (Ndikimi mbi Sektorët e Gatshëm për Rritje, Kapitulli 3). Në zonat rurale, pamundësia për të arritur nevojat bazë për gjenerimin e rrymës dëmtojnë rritjen, përjetësojnë të jetuarit për mbijetesë dhe zgjeron ndasitë urbane-rurale në të ardhura, edukim dhe shëndet. Në zonat urbane, strategjitë për gjenerimin e energjisë momentalisht komplikojnë shëndetin dhe i shtohet goxha shumë preokupimeve të ndotjes. Veç kësaj, poqëse sektori sekondar i Kosovës shikon të ngritet, dhe shumë e më shumë kompani që kërkojnë të bëjnë një hap nga madhësia e vogël në të madhe, nevojat e energjisë për këtë sektor do të jenë më të larta. Ministria e Energjisë të Kosovës planifikon që pjesa e energjisë së konsumuar nga sektori sekondar do të rritet gjatë viteve pasuese, nga 25 përqind në vitin 2009 në 32 përqind deri më 2018.⁷⁵

Kosova ka të vendosur shumë Ligjje për Energji, dhe një strategji për efikasitet të energjisë e cila kërkon të trajtojë çështjet e saj përgjatë një numri të fronteve. kjo strategji arsyeton që kursimet e energjisë mund të bëhen vetëm në kontekstin e një furnizimi të

besueshëm/sigurtë. Ekzistojnë plane për të rritur prodhimin e përgjithshëm të rrymës përmes një centrali të ri për gjenerimin e rrymës, duke mundësuar ç'montimin e centralit të vjetëruar Kosova A përgjegjëse për një pjesë të madhe të ndotjes atmosferike me pluhur përmes ndezjes së thëngjillit linjit. Kapaciteti filtrues i këtij centrali momentalisht arrin në vetëm 50 përqind të prodhimit të tij⁷⁶. Veç kësaj, kërkon të shtrijë jo vetëm qasjen e rrymës, por edhe edukimin mbi strategjitë e efikasitetit të energjisë në zonat rurale. Aktualisht, teknikat e bujqësisë janë energjia intenzive dhe toka, duke kufizuar konkurrencën dhe rritjen e industrive bujqësore, ndërsa i kushton shumë tokës dhe banorëve të saj në aspektin e shëndetit dhe mirëqenies. Ndikimi i sistemeve të operuara dobët të faturimit të energjisë mund të zvogëlohet përmes shtimit të teknologjive të reja për matje/njehsim dhe të një sistemi më të drejtë për periudhat e kërkesës së lartë dhe kërkesës së ulët për rrymë. Përfundimisht, mundësitë për burime të energjisë së ripërtërishme janë duke u eksploruar. Potenciali i Kosovës për të filluar me energji të erës, biomasës dhe strategjive tjera të ripërtërishme të energjisë nuk është eksploruar plotësisht. Këto programe janë për t'u lavdëruar – mirëpo, ato kërkojnë implementim të hollësishëm, mirë të financuar dhe burime njerëzore.

Pajtueshmëria dhe përgjegjësia e biznesit është edhe një faktor tjetër kyç në zvogëlimin e trashëgimisë së Kosovës mbi dëmtimin mjedisor dhe krijimin e kushteve për rritje të përgjegjshme të ndërmarrjes private. Momentalisht, nuk ekzistojnë të dhëna për matje të trendeve, praktikisht, në zbatimin e obligimeve ligjore mjedisore të kompanive. Informatat anekdotike sugjerojnë se gjobat janë të shmangura lehtësisht dhe, nëse

ndodhin, ato janë shumë minimale (duke arritur përafërsisht 5,000 euro për një kompani të madhësisë së mesme). Përveç kësaj, as nuk është studiuar e as nuk është kuptuar nga bizneset kostoja e shkaktuar në mjedis nga praktikat e tilla siç janë praktikat e shpyllëzimit për qëllime të prerjes/transportimit së drunjve, shkarkimi i mbetjeve në lumenjë dhe eliminimi i produkteve nga proceset prodhuese/bujqësore. Të mirat e perceptuara e këtyre aktiviteteve jo të shëndosha ekologjike ende peshojnë më shumë se sa ato potencialisht të llogaritura që plotësojnë obligimet ekologjike. Përpjekjet aktuale për të mbrojtur Malet Kombëtare të Sharrit nga aktivitete private të prerje/transportim të drunjëve tregojnë sesi kompanitë ende luftojnë për interesat e tyre personale të shkujdesur nga dëmi që i bëjnë kushteve të jetesës së Kosovës dhe potencialit të saj ekonomik afatgjatë.

Ngjajshëm më progresin që është bërë në lidhje me efikasitetin energjisë, Kosova tashmë është duke ec përpara në rritjen e kulturës së përgjegjësisë dhe përputhshmërisë brenda sektorit privat. Përgjatë Agjensionit Kosovë për Privatizim, një numër i partnerëve të Kosovës janë aktivisht duke eksploruar se si kontaminimi i krijuar nga trashëgimia e minierave të Kosovës mund të zvogëlohet dhe se si mund të krijohet një sistem privat më konkurrues dhe i përputhshëm në aspektin mjedisor. Mirëpo, një qasje më pjesëmarrëse është e nevojshme me bizneset në mënyrë që të gjendet një balancë ndërmjet nxitjes së rritjes dhe përmbushjes së përgjegjësisë mjedisore. Aty ku obligimet mjedisore janë të tepërta e të qenurit në kundërshtim me interesat e ndërmarrjes pa përfitime sociale, ekziston rreziku më i madh i mospërputhjes - apo vendosjes së koston mbi punëtorët

dhe konsumatorët. Në rastet siç janë huthja e mbeturinave apo mbiprerja e

drunjëve, strategjitë alternative mund të eksplorojnë në nivel komunal së bashku me bizneset individuale, në mënyrë që të lëvizet drejt zgjidhjeve të përbashkëta. Qeveria poashtu ka një përgjegjësi për të caktuar një shkallë të lartë mbi përputhshmërinë mjedisore. Në zonat ku mbeturinat janë rregullisht të grumbulluara nga shërbimet komunale, aty ku rryma është stabile, ku uji i pastër është në dispozicion mbi baza të sigurta dhe kanalizimi është i menaxhuar në një mënyrë të përgjegjshme mjedisore - atëherë është shumë më lehtë që të binden bizneset se përputhshmëria mjedisore duhet të jetë normë se sa në fushat ku pritet të marrin rolin udhëheqës në mungesë të udhëheqësisë së qeverisë.

Ndërmarrja ekologjike/e gjelbërt është faktori i fundit qendror në ndërtimin e marrëdhënies së shëndoshë ndërmjet rritjes private dhe qëndrueshmërisë mjedisore në Kosovë. Aktualisht, kërkesa për ndërmarrje ekologjike tenton që në masë të madhe të jetë e stimuluar nga partnerët ndihmës ndërkombëtar të Kosovës. Nuk ka ndonjë treg vendor të rrënjësor thellë, në një klimë ku pjesa më e madhe e mikro-ndërmarrjeve gjenden në sektorë shumë tradicional të shërbimeve se sa në eksplorimin e fushave të reja dhe të paprovuara.

Megjithatë, ende ka kapacitet për të ndërtuar kërkesa për këtë lloj të ndërmarrjes në treg, dhe për të shtuar numrin e "vendeve të gjelbërta të punës" në zonat urbane dhe rurale. Është një argument i qartë i zhvillimit njerëzor për një strategji të tillë: zonat rurale kanë shkallët më të larta të varfërisë dhe shkallët më të ulëta të punësimit formal, derisa ndërgjegjësimi mjedisor është veçanërisht i lartë në mesin e popullatës së re, urbane të Kosovës. Do të kishte përparësi të dukshme

Do të kishte përparësi të dukshme të zhvillimit njerëzor në fuqizimin e popullatës rurale dhe urbane për të bashkëpunuar në iniciativë të gjelbërta/ ekologjike.

të zhvillimit njerëzor në fuqizimin e popullatës rurale dhe urbane për të bashkëpunuar rreth iniciativave/ndërmarrjeve të gjelbërta/ekologjike. Kapaciteti për të stimuluar apo zbuluar biznese të reja drejt qëndrueshmërisë mjedisore (përfshirë hulumtimin mjedisor, eko-turizmin, angazhimin e sektorit privat në menaxhimin e mbeturinave, pilot programeve për energjinë e ripërtërishme etj.) është potencialisht i lartë. Kosova, tani, është duke finalizuar një Strategji Mjedisore shumëvjeçare dhe një Plan Veprimi që mund të trajtojë këto çështje. Edhe njëherë, dinakëria do të qëndrojë në hollësisë. Strategjia shumë-sektoriale për stimulimin e ndërmarrjeve për të sjellë "vende të gjelbërta pune" në tregun e punës mund të paguajë dividende (shuma parash) afatgjate për tregun e Kosovës dhe standardin e jetesës.

4.4 Rritja private dhe konteksti social - implikimet e politikës

Rritja e sektorit privat në Kosovë është thellësisht e rrënjësuar në paradigmen e saj njerëzore. Ndërmarrja private si shpresa parësore e Kosovës për përhapje të gjërë të krijimit të pasurisë, por karakteri dhe cilësia e rritjes së saj – dhe ndikimi mbi profilin zhvillues njerëzor në Kosovë – varen mbi çështjet jashtë konsideratave ekonomike. Këto përfshijnë edukimin dhe sistemin mbrojtës të Kosovës dhe perspektivave të saja mjedisore. Pavarësisht se sa shpejtë zgjerohen bizneset, tregu i punës mund të vie në fuqinë e saj të plotë poqëse fuqia punëtore e kërkuar për t'i shërbyer asaj rritet proporcionalisht me shkathtësitë dhe energjinë. Vetëm kur zgjerimi i sektorit privat zë qendrën në kontekstin e rritjes së njohurive dhe gjithëpërfshirjes sociale në një komunitet më të gjerë, atëherë me të vërtetë mund të ndodh një zhvillim i

qëndrueshëm ekonomik dhe njerëzor. Kjo formulë është në qendër të drejtimit të mekanizmit të fuqisë dominuese – enklavor në Kosovë drejt një demokracie të vërtetë të bindjes dhe ideve, ku të gjithë anëtarët janë të fuqizuar për të marr pjesë.

Strategjitë kyçe për të shtyer lidhje më të zgjuara dhe më gjithëpërfshirëse ndërmjet sektorëve privat dhe social përfshijnë:

- **Ndërlidh edukimin me gatishmërinë për punë:** një fuqi punëtore e zgjuar, konkurruese mund të fillojë qysh në shkollë. Rinia e Kosovës ka nevojë të ndihet më e përgatitur për mjedisin e tyre të punës, dhe të besoj se shkathtësitë merren parasysh në tregun e punës. Në fund të fundit, zhvillimi afatgjatë i Kosovës mbështetet mbi energjinë dhe shkathtësitë e rinisë. Jo të gjitha asetet vendore të Kosovës duhet të eksportohen në kuti, arka dhe kartona – disa padyshim do të transferohen përmes tregjeve elektronike, të nxitura nga revolucioni i ardhshëm i teknologjisë informative nga rinia në Kosovë. Duke lidhur studentët kosovarë me programe mbi gatishmërinë e punës do të krijohen bashkëpunime në tërë qeverinë, përfshirë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe asociacionet e biznesit në tërë Kosovën.
- **Krijo një Strategji Mësimi për të Rriturit e cila shënjestron ata më të shkëputurit/ përja-shtuarit:** Programet, siç është Dritare Jete, janë jashtëzakonisht të vlefshëm, mirëpo për të arritur me të vërtetë ata që janë më të përjashtuarit nga tregu i punës duhet të integrohet një strategji gjithëpërfshirëse mbi

edukimin e të rriturve. Shumë kosovarë operojnë në mjedis të punës shumë më poshtë sesa potenciali i tyre – apo tjetra të përjashtuar nga mungesa e shkathtësive. Të mësuarit për të rriturit, e shënjestruar në gratë rurale, personat me aftësi të kufizuar, minoritetet etnike dhe të papunët me periudhë të gjatë mund të bëjnë shumë në hapjen e potencialit njerëzor të disa më të varfërve në Kosovë, stimulojnë të ardhurat dhe rritjen e ndërmarrjes.

- **Lanso skema investive - promovuese komunale të fokusuar në remitanca:** Flukset e mëdha të remitancave në Kosovë janë duke e zvogëluar varfërinë, mirëpo, ende nuk janë duke u shfrytëzuar maksimalisht për të përmirësuar rritjen dhe krijimin e vendeve të punës. Vetëm një pjesë e remitancave janë të shfrytëzuara për investim. Përpjekjet e bëra për këtë pjesë duhet të trajtohen me ndjeshmëri. Shumë përfitues të remitancave mezi ia dalin mbanë. Megjithatë, shumë mund të bëhet për të nxitur një shfrytëzim më të qëndrueshëm të remitancave dhe me fokus nga ndërmarrja. Nëse komunat angazhohen në planifikimin pjesëmarrës, duke i sjell bizneset dhe familjet loka-le së bashku për të diskutuar nevojat dhe mundësitë, mund të zhvillohen lloje të ndryshme të skemave investive të financuara nga remitancat. Secila komunë mund të ndërmarr një qasje e cila i përshtatet më së miri modeleve të ndërmarrjes që përputhen me profilin e tyre demografik. Për shembull, komunat rurale mund të inkurajojnë investimin në skemat e gjelbërta/ekologjike,

ndërsa zonat urbane mund të inkurajojnë zhvillimin e bizneseve bashkëpunuese të sektorit të shërbimeve të cilat përfitojnë nga ekonomitë e shkallëzuara.

- **Ndërlidh mirëqenien sociale më afër me strategjitë për reduktimin e varshmërisë:** Programi aktual i mirëqenies sociale në Kosovë ka nevojë të madhe të rimendimit përtej reformave që aktualisht janë duke u debatuar në Parlament. Kategorizimi i programeve për ndihmë sociale aktualisht kontri-buon në varfëri, në përgjithësi - në veçanti në varfërinë e fëmijëve pasi që fëmijët janë të larguar në mënyrë efektive nga mbështetja e programit menjëherë pasi t'i ofrohen moshës për shkollë. Duke hequr këtë barrierë në veçanti (kufiri i sipërm i moshës për fëmijët e varur) ka implikime të kostos të cilat mund të dalin përsëri përkundrejt synimeve më të mira të programeve të ndihmës sociale. Përveç kësaj, mundësitë janë duke humbur në thyerjen e cikleve të varshmërisë duke ndërlidhur ata që pranojnë përfitime me skemat e punëkërkimit dhe programeve të mësimi lehtësues për të rriturit.
- **Implemento ligje të reja mbi energjinë dhe mjedisin në një mënyrë më të fokusuar pjesëmarrëse dhe edukative:** Kosova ka disa ligje premtuese në librat e saj për përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe zvogëlimin e kostos për bizneset e Kosovës, e gjithashtu të promovimit të mirëqenies mje-disore të Kosovës. Këto ligje shohin një lidhje thelbësore ndërmjet sektorit të përgjegjshëm, lulëzues privat dhe një mjedisi të menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme. Megji-

thatë, implementimi vazhdon të jetë pikë e dobët e regjistrimit qeverisës të Kosovës, deri më sot. Përkundrejt një trashëgimie të tillë të gjatë të keqinformimit dhe praktikave të dobëta mjedisore, çelësi për implementim të suksesshëm do të jetë alokimi adekuat i burimeve njerëzore në edukim dhe pjesëmarrje në mesin e pronarëve të bizneseve. Ata do të duhej të binden për përfitimet sociale dhe ekonomike të përputhshmërisë mjedisore dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve, me vetë qeverinë që vendos shembuj. Përndryshe, këto ligje mund të mbesin vetëm premtime në letër, duke i bërë presion bizneseve të Kosovës pa ofruar përfitime mjedisore dhe përfitime që ndër-lidhen me zhvillimin njerëzor.

- **Bashko popullatën rurale-urbane për iniciativa mjedisore ndërmarrëse:** Tregu i “Ndërmarrjeve të gjelbërta” në Kosovë ka nevojë të jetë i rrënjosur në mënyrë kulturore më shumë se sa të jetë i administruar nga jashtë përmes partnerëve mirëkuptues ndërkombëtarë.

Një potencial i madh për promovimin e krijimit të vendeve të punës, kohezionit social dhe mirëqenies mjedisore është bashkimi i popullatës urbane që janë të zotë në teknologji dhe popullatave rurale të lidhura me mjedisin për qëllime të startimit të “iniciativave/ ndërmarrjeve të gjelbërta”. Programi i gjërë i Kosovës mund të nxitet përmes të rinjëve dhe universiteteve duke shfrytëzuar paratë nga qeveria dhe partnerët ndërkombëtarë. Iniciativa të tilla mund të krijojnë tradita të bashkëpunimit përgjatë ndasive të mëdha sociale, të nxisin inovacion dhe eventualisht të bëhen të qëndrueshme, me krijimin e vendeve të punës që rriten në mënyrë të qëndrueshme - megjithëse në nivele të ulëta për shumë vite. Skema e tillë ka potencial të vogël direkt për rritjen private të shkallës së madhe, dhe se mesiguri nuk do të transformojë tregun e punës. Megjithatë, duke marr një pamje afatgjate, e mbjell farën për modelet e ardhshme të bizneseve të cilat mund të jenë vetëm pozitive për zhvillimin e vazhdueshëm të Kosovës.

Përfundimi:

Që rritja të punojë për njerëzit

“Ky nuk do të jetë një vend i mirë për të jetuar për çdonjërin nga ne, përderisa nuk është vend i mirë për të gjithë ne për të jetuar në të.”

Teodor Ruzvelt (ish President i SHBA-ve)

“Njerëzit janë pasuria e vërtetë e kombeve.” Kjo deklaratë revolucionare, themeli i qasjes së zhvillimit njerëzor, ka qenë më e shquara që nga koha e saj. Rrjedh nga një dekadë që i është dedikuar, në shumë kombe të zhvilluara, artit të krijimit të pasurisë. Vitet 1980-ta kanë parë ngritjen e perandorive të reja financiare nëpër Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, rritjen e pasurisë spekulative nga tregtia me stoqe, aksione dhe derivate, dhe besimit të pasionuar në fuqinë e mundësisë dhe iniciativës personale për të formësuar jetëra. Kjo rritje e madhe e ndërmarrjeve të lira në disa pjesë të botës kishte zënë vend gjithandej nën hijen e urisë dhe luftës. Përderisa, mijëra filluan të bëhen milionerë, miliona – madje miliardë njerëz dukeshin të bllokuar në jetën e kapluar gjithnjë e më fortë nga varfëria dhe dëshpërimi. Bota asnjëherë nuk ka qenë më e pabarabartë.

Njerëzimi nuk është gjithnjë i shpejtë për të nxjerrë mësimet e rëndësishme. Megjithatë, në tre dekadat që nga publikimi i Raportit të parë mbi Zhvillimin Njerëzor në vitin 1990, shumë specialistë të zhvillimit, ekonomistë dhe udhëheqës janë duke rimenduar sesi krijimi i pasurisë kontribuon në lumturinë njerëzore dhe sigurinë globale. Në vend se të parashtrahet pyetja “se sa” pasuri mund të krijohet, këta vizionarë kishin filluar të shohin se si pasuria krijohet dhe kush përfiton nga ajo të cilat janë dhe brengat më kryesore për progresin njerëzor.

Qëllimet Zhvillimore të Mijëvjeçarit (QZHM), Samiti Botëror, Protokoli i Kiotës - dhe ai më i fundit – Strategjia 2020 e Evropës janë të gjitha manifestime të dukshme të këtij ndërrimi të paradigmes/modelit. Ato të gjitha vendosin së pari mirëqenien e njerëzve, përpara të gjitha qëllimeve tjera. Ato priorizojnë drejtësinë brenda strategjive për arritjen e objektivave të tyre dhe synojnë një shoqëri “gjithëpërfshirëse” ku të gjithë kanë një vend dhe mundësi për të përparuar.

Në ndërlidhjen e vizionit të saj me Evropën, Kosova, gjithashtu është zotuar ndaj këtyre qëllimeve. Megjithatë, ka një rrugë të gjatë për të përshkuar. Pas dekadave të varfërisë, represionit dhe konfliktit, nuk është për t'u habitur që rritja ekonomike me çdo mjet në dispozicion tani shihet si e vetmja zgjidhje për problemet e rrënjësura socio-ekonomike të Kosovës. Megjithatë, rritja e pabalancuar e cila dështon që të krijojë vende të denja pune, përjashton segmente të mëdha të shoqërisë, dhe dështon të ç'lirtojë kapacitetin e plotë të meshkujve dhe femrave, nuk është rezultati përfundimtar që Kosovarët realisht e kërkojnë.

Ky raport ka kërkuar që të kuptojë se si rritja e sektorit privat të Kosovës dhe objektivat e zhvillimit njerëzor mund të përforcojnë dhe fuqizojnë njëra-tjetrën. Raporti sugjeron që krijimi i pasurisë dhe barazia njerëzore në Kosovë, larg të qenurit në kundërvënien të njëres në tjetrën, dukshëm varen nga njëra tjetra. Kosovarët

- qofshin zyrtarë publik apo individë privat - kanë të drejtë të shohin zhvillimin e sektorit privat si motorin kryesor të mundësive. Sektori privat ka potencialin të drejtojë progresin drejt adresimit të disa sfidave më të mëdha të zhvillimit të Kosovës – mentaliteteve enklavore, ndasive gjinore dhe të një klime të nën-performancës ekonomike dhe individuale. Duke i'u ofruar pikës në mes të rrugës së dekadës së dytë pas konfliktit në Kosovë, Kosova ka nevojë të vazhdojë të bëjë progres kundër këtyre sfidave. Tani është koha për t'i dëshmuar njerëzve të Kosovës – veçanërisht rinisë së saj – se aspiratat e tyre janë më shumë se ëndrra.

Nuk ka ndonjë formulë të përsosur për pozicionimin e krijimit të pasurisë brenda paradigmës së zhvillimit njerëzor në Kosovë, apo gjetiu tjetër. Megjithatë, një gjë është e qartë: gjetja e formulës më të mirë të mundshme për Kosovën do të kërkojë një angazhim aktiv të qeverisë, pronarëve të biznesit dhe Kosovarëve nga të gjitha sferat e jetës. Ky raport shpreson të inspirojë një dialog në formimin e një angazhimi të tillë – dhe me këtë qëllim në mendje, paraqet një sintezë të gjetjeve të raportit dhe rekomandimeve mëposhtë:

Rezultatet kryesore

(i) Historia e Kosovës dhe trendet ekonomike të paskonfliktit kanë anuar në rritjen drejt një modeli të rritjes “përrjashtuese” dhe kryesisht drejt një modeli të rritjes së papunësisë:

- Kultura e ndërmarrjes private të Kosovës ka qenë e ngulfatur nga kombinimi i socializimit, represionit dhe strukturës së strategjive gjeneruese të të ardhurave të paskonfliktit. Për dekada, sektori privat i Kosovës ka qenë kryesisht i kufizuar në biznese të vogla dhe të drejtuara nga familja – një parakusht që mbetet madje edhe pasi Kosova kërkon të lëviz drejt një ekonomie të lirë të tregut. Sot, jobalanca tregtare e Kosovës është buri primar i pjesës më të madhe të të ardhurave të qeverisë – lehtësisht të mbledhura në kufi përmes taksave të importit, duke zvogëluar stimuli për të investuar në konkurrencën e Kosovës. Pasuria është ende e përqëndruar në duart e disave, në një ekonomi e kryesuar nga importi e cila fokusohet në shitjen me çmim të lartë të produkteve të huaja tek ata që mund t'i përballojnë ato (përfshirë një pjesë të madhe të të huajve të cilët ofrojnë përkrahje për zhvillim).
- Ky model i krijimit të pasurisë ka dështuar të ndikojë në varfëri, pavarësisht rritjes së GDP-së. Norma absolute e varfërisë në Kosovë, e matur nga Banka Botërore, ka mbetur relativisht e njëtrajtshme ndërmjet 40-50 përqind të popullatës që nga 2004-ta. GDP-ja e vendit, në përgjithësi, është rritur gjatë periudhës së njëjtë – duke treguar zgjerimin e pabarazive sociale.
- Si rezultat, tregu i Kosovës është bërë i pabalancuar. Sektori privat i Kosovës tani është i dominuar nga mikro-ndërmarrjet (96 përqind të të gjitha bizneseve) që punësojnë më pak se dhjetë njerëz secila. Shumë nga këto firma – një e treta, nga disa llogaritje – janë joformale dhe të paregjistruara; p.sh. mospaguesë të taksave dhe jo të përputhshëm me ligjet e mbrojtjes së punëtorit. Një pjesë e shumicës së të gjitha ndërmarrjeve private të Kosovës ekzistojnë në fundin e vlerës së ulët të sektorit terciar. Ky




Figura 5.1 Cikli i rritjes në Kosovë

sektor përfaqëson mbi 80 përqind të bizneseve të regjistruara në Kosovë, dhe llogarit dy të tretat e GDP-së së vendit. Sipas krahasimit, sektori primar (bujqësia) përfaqëson vetëm 2 përqind të bizneseve të regjistruara.

- Shumica e Kosovarëve nuk janë madje as të bashkuar me tregun: Mesatarisht, vetëm një në katër Kosovarë me moshë pune është i punësuar (një kombinim i pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe shkallëve të përgjithshme të papunësisë). Shumica e papunësive janë afatgjate. Përgjithësi është shumë më e lartë në mesin e femrave – me vetëm tri në 10 që marrin pjesë në fuqinë punëtore dhe mbi gjysma e tyre nuk janë në gjendje të gjejnë punë. Shkallët e papunësisë ofrohen në 73 përqind në mesin e të rinjve dhe 70 përqind në mesin e RAE.

- Stimuli mi i ndërmarrjes dhe krijimi i vendeve të punës nuk mund të zërthehet në mënyrë automatike në më pak varfëri dhe më shumë punë të denjë: Shumë të varfër të Kosovës veçse kanë vende pune. Një 30 përqind e llogarit e ekonomive familjare që nuk janë në gjendje për të takuar nevojat e tyre kritike kanë së paku një anëtar të punësuar. Ndërmarrjet e reja poashtu lindin me një normë të lartë – më shumë se 7,000 në vit (me norma të mbylljes shumë më të ngadalta, me përafërsisht 1,200 në vit). Përveç kësaj, sa më i madh të bëhet biznesi, aq më të mëdha janë hendeket e barazisë në profilet e tyre të punësimit. Për shembull, në raportin e punësimit të meshkujve dhe femrave më i keq është në kompanitë e shkallës së mesme se sa në firmat e vogla dhe mikro. Kjo sugjeron se ndërmarrja dhe krijimi i punës, siç janë të strukturuar aktualisht, nuk janë duke ofruar reduktim të konsiderueshëm të varfërisë dhe përfitime të zhvillimit njerëzor.

(ii) Analiza e barrierave të biznesit tregon më shumë në zgjidhjet për ndryshimin kulturor sesa atë legjislativ:

- Barrierat primare për rritje shtrihen në ndërlidhshmërinë mes qeverisë dhe bizneseve, e përjetësuar nga zbatimi i dobët. Në vend të infra-

strukturës, kufizimeve të vizave dhe tregtisë, shumica e bizneseve citojnë praktika të padrejta në mesin e kolegëve të tyre (joformaliteti, evazoni dhe korrupsioni) si sfidat kryesore ndaj operimeve dhe zgjerimit të tyre. Zbatimi i një grumbulli të madh të legjislacionit të përputhshëm me BE-në shihet si diskrecional, i shtyer nga nxitja (korrupsioni) dhe i dobët. Prandaj, bizneset ndihen në forcat e veta, dhe preferojnë të veprojnë sipas interesit të tyre më shumë sesa për të mirën e përbashkët.

- Nën-performanca dhe evazoni është bërë normë e biznesit, e kryesuar nga qeveria. Bizneset me vlerë të ulët të shtuar kërkojnë, për pjesën më të madhe, punëtorë me shkathtësi të ulëta. Ka pak nxitje për të ndërtuar shkathtësi të fuqisë punëtore, dhe shumica e vendeve të reja të krijuara të punës ka pak të ngjarë që të kërkojnë më shumë se arsimim primar apo sekondar. Nxitjet për të ndërtuar aftësitë njerëzore, janë kësajsoji të pakësuar. Evazoni fiskal dhe joformaliteti janë të përhapura gjerësisht (është llogaritur që përafërsisht 30-40 përqind të punës së përgjithshme të Kosovës është joformale dhe se niveli i evazionit fiskal është përafërsisht 40 përqind), duke pakësuar kapacitetin për rishpërndarje efektive të të ardhurave nga rritja e sektorit privat. Ka indikacione se mungesa e mirëbesimit në qeverisjen e Kosovës dhe proceset gjyqësore kontribuojnë shumë në këtë gjendje të punëve. Nën-performanca e qeverisë në ofrimin e shërbimeve thelbësore dhe shërbimet kyçe ndërmarrëse siç është zbatimi i kontratës përmes gjyqeve-mundëson dhe nxit mungesën e përputhshmërisë rregullative në mesin e firmave
- Dialogu dhe edukimi janë kyç për nxitjen e ndryshimit: Një klimë biznesi në favor të njerëzve duhet të stimulohet e poashtu të nxirret edhe me ligj. Joformaliteti, injorimi apo anashkalimi i ligjeve të punës dhe praktikave tjera kundër-zhvillimore janë rezultat i komunitetit biznesor të painformuar dhe të pastimular. Ka nevojë kritike për transparencë më të madhe dhe çiltërsi në marrëveshjet e qeverisë me ndërmarrjet private, dhe fokus më të madh mbi arsimimin dhe arritjen në mesin e pronarëve të biznesit dhe punëtorëve në nivel komunal.

(iii) Investimet dhe modelet e krijimit të vendeve të punës poashtu kërkojnë riorientim për të bashkuar njerëz me sektorët potencial rritës.

- Rregullimi i bazuar në paanshmëri është thelbësor për të larguar njëanshmërinë përkundrejt grupeve të caktuara: Ata që luftojnë të kenë sukses në kulturën aktuale të ndërmarrjes në Kosovë përfshijnë 1) bizneset e mesme, të cilat nuk mund të fshihen pas joformalitetit dhe evazionit fiskal për të mbajtur një vijë të shëndoshë të fitimit; 2) femrat dhe ndërmarrësit e rinjë, të cilët luftojnë që të kenë qasje në financim për ndërmarrjet/iniciativat biznesore të cilat në mënyrë kulturore janë të përjashtuara nga burimet e kolateralit të cilat mund të mbështesin ndërmarrjet e tyre; 3) të varfërit rural, të cilët jetojnë në zonat pa infrastrukturë të duhur dhe shërbime të edukimit, duke përjetësuar kapacitetin e ulët njerëzor dhe strategjive për mbijetesë; dhe 4) minoritetet etnike, që në rastin më të mirë nuk integrohen me tregun e gjërë të dominuar nga shqiptarët kosovarë dhe në rastin më të keq luftojnë të gjejnë punë, të marrin hua, të pranojnë një arsim adekuat dhe përfitime qoftë madje edhe nga shërbimet më bazike sociale.

- Strategjia ekonomike në favor të njerëzve do mund të ndihmonte në rirreshtimin e investimeve rritëse vendore dhe ndërkombëtare. Kosova ka nevojë për portofolio të balancuar ekonomike e cila zgjeron bazën aktive të saj ekonomike, sesa atë që thjesht shton të ardhurat dhe GDP-në. Modelet e ardhshme të rritjes duhet të përqëndrohen në zbutjen e varfërisë aty ku është thellësisht më e rrënjësura (në zonat rurale dhe në mesin e minoriteteve etnike), ndërtimin e aftësive njerëzore dhe ofrimi i punës së denjë për një linjë të gjërë të meshkujve dhe femrave. Kjo ka më shumë gjasa të ndërtohet mbi sektorin primar të ripërtërirë dhe formalizuar, në sektorin sekondar të tregtueshëm dhe të qëndrueshëm dhe sektorin terciar të vlerës së lartë të shtuar.
- Barrierat specifike të sektorit duhet të adresohen si pjesë e një strategjie ndër-qeveritare dhe gjithëpërfshirëse. Ekzistojnë tri kritere kyçe për identifikimin e sektorëve të gatshëm rritës gjithëpërfshirës: 1) tregtueshmëria (hapja e derës për ndër-fertilizimin ndërkombëtar të investimit, shkathtësive dhe inovacionit); 2) intenziteti i punës (pjesa më e madhe e punës së denjë të krijuar për meshkuj dhe femra); dhe 3) shtimi i vlerës (deri në masën ku shkathtësitë janë të nxitura në fuqinë punëtore, duke zgjeruar aftësitë dhe duke stimuluar përvetësimin e diturisë). Të gjitha konsideratat sektoriale duhet të shikohen përmes këndvështrimit të rëndësishëm të qëndrueshmërisë

(iv) Ciklet e varshmërisë duhet të thehen për një të ardhme ku pasuria rritet përkrah dinjitetit dhe lirisë njerëzore.

- Kosova ka nevojë të nxis një kulturë të mësimi. Shumë nga kosovarët janë të pakualifikuar (afërsisht dy të tretat e të rriturve). Me shumë shkollë të pajisura keq për një treg modern dhe konkurrues, më pak se një e treta e të rinjve mendojnë se edukimi është duke i përgatitur ata për jetë. Kultura e nepotizmit është duke e tharë vullnetin për të mësuar, dhe se kur mundësitë e edukimit humbin, atëherë paraqiten shumë pak raste për t'i arritur ato.
- Rishpërndarja e të ardhurave do mund të funksiononte më efektivisht për të thyer ciklet e varshmërisë dhe për të ndërlidhur njerëzit e rrezikuar me tregun e punës. Sistemi aktual i mirëqenies sociale ndalon së përkrahuri familjet pasi që fëmijët e tyre arrijnë moshën e shkollës. Mundësitë janë duke humbur në ndërlidhjen e të papunësuarit dhe të varfërit me programet zhvillimore, apo të drejtohet fluksi i madh i remitancave të Kosovës për investime në krijimin e vendeve të punës.
- Bizneset nuk i kuptojnë ndërlidhjet konceptuale ndërmjet rritjes së sektorit privat dhe qëndrueshmërisë mjedisore. Pa të dhëna është e pamundur të maten trendet qoftë në përputhshmëri me legjislacionin mjedisor apo me investimet për rritjen ekologjikisht miqësore. Ndërlidhjet ndërmjet rritjes së sektorit privat dhe qëndrueshmërisë mjedisore janë pak të kuptuara dhe vetëm një sasi minimale e politikave qeveritare (kur qeveria ndihmon kompanitë që ato të prodhojnë më shumë dhe kështu që të punësojnë më shumë njerëz dhe me paga të larta, ndërsa këta të fundit

kanë më shumë të ardhura për të shpenzuar në ekonomi) e cila afekton përparësitë në nivel komunal dhe në nivel të rrugës. Promovimi i përputhshmërisë dhe investimit do të thotë më shumë edukim dhe arritje, me potencialin për të sjell njerëzit së bashku përgjatë ndasive sociale në interes të përbashkët.

Rekomandimet

Të gjithë Kosovarët – të rinjë dhe të vjetër, meshkuj dhe femra dhe çdo etnicitet – kërkojnë jetë të dinjitetshme në të cilën nevojat e familjes mund të plotësohen dhe të ndjekin ambiciet. Për një të ardhme të tillë ja vlen të përpiqesh – e ardhme në të cilën njerëzit përfitojnë nga një sektor lulëzues privat, që sjell vende pune dhe mundësi mbi baza të barabarta. Kjo analizë sugjeron tre hapa kyç drejt shëndërrimit në realitet:

1. Ndërto vizionin për rritje gjithëpërfshirëse & punë intensive

1.1. Krijë një strategji ndërqeveritare të rritjes gjithëpërfshirëse, të lidhur me ciklin e Kornizës për Shpenzime Afat-Mesme (KSHAM) dhe me caqet e Evropës 2020 në mendje. Kjo strategji duhet të a) identifikojë sektorët ekonomik të gatshëm rritës; b) analizojë barrierat specifike të sektorit; dhe c) të paraqes reformat e bazuara në paanshmëri në shërbime të ndërlidhura publike siç janë arsimimi dhe ndihma sociale. Një strategji e tillë do të pranonte se një ndërmarrësi e shëndoshë private duhet të krijohet nëpër një portofolio të balancuar të sektorëve, dhe duhet të rrënjohet në kontekstin social të Kosovës. Disa strategji të stimuluar rritëse mund të jenë specifike për sektorë (siç është shkallëzimi i TVSH-së për bujqësi për të nxitur formalizimin e bizneseve, pagesat e taksave dhe mbrojtjes së fuqisë punëtore). Të tjerat, siç janë trajtimi i korrupsionit dhe përkrahja e femrave në fuqinë punëtore, shtrihen në gjithë sektorët dhe llojet e bizneseve. Cilësia e udhëheqësisë është po aq kritike, sa që është pjesëmarrja e ministrive kyçe përfshirë Ministrinë e Financave, Punës dhe Mirëqenies Sociale, Tregtisë dhe Industrisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Arsimit. Udhëheqësit duhet të caktojnë pika referimi për rritje dhe krijim të vendeve të punës, e gjithashtu për ndryshimet e sjelljes brenda kulturës së ndërmarrjes në Kosovë – të cilat ofrojnë më shumë dinjitet dhe mundësi për një bazë më të gjerë të pjesëmarrësve në fuqinë punëtore.

1.2. Fillo një dialog pjesëmarrës të kryesuar nga qeveria për rritjen ekonomike duke angazhuar si ata nga brenda e poashtu edhe ata që janë aktualisht të përjashtuar nga tregu. Ky dialog do të kërkojë të zvogëlojë distancën ndërmjet bizneseve dhe rregulloreve, dhe të përkrah miratimin e gatshëm të përparësive të mëdha të politikës (në ligjet për mjedis dhe punë) duke e lidhur rritjen me mirëqenien publike. Sektori privat i Kosovës ka nevojë për informata të shenjuara nga zyrtarët publikë, e gjithashtu transparencë të mbështetur nga veprimet. Këto janë qendrore për të përfunduar disa nga irritimet biznesore të Kosovës - industria joformale, evazioni, praktikat e padrejta biznesore, mungesa e përputhshmërisë dhe diksriminimi i fuqisë punëtore.

2. Krijë klimën e duhur për ndërmarrësi të drejtë dhe të qëndrueshme

2.1. Vendos cakun për rritje dhe zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si qëllim afatgjatë për krijimin e vendeve të punës. Kjo do të vendos rritjen e ndërmarrësisë dhe gjithashtu të krijimit të ndërmarrësisë në brendësi të strategjive ekonomike, duke u fokusuar mbi përkrahjen e bizneseve për të kaluar nga madhësia e vogël në atë të mesme. Në fund të fundit, dobitë nga puna e denjë dhe reduktimi i varfërisë do të bëheshin më shpejtë përmes bizneseve më të mëdha, mirë të rregulluara dhe me vlerë të lartë të shtuar në krahasim me mikro firmat familjare. Do duhej bërë përpjekje konkurruese për të rrënjosur një kulturë të praktikave të drejta të punësimit krahas rritjes së firmës, në veçanti për t'u siguruar që krijimi i vendeve të punës gjithashtu ofron më shumë mundësi për femra. Kjo më së miri bëhet përmes pajisjes së femrave me aftësi relevante dhe prurjes së bashku të punëkërkuarve femra me punëdhënësit, sesa zbatimit të kuotave.

2.2. Trajto klimën e praktikave të padrejta biznesore përmes tri strategjive:

a) shtimi i stimulimit për përputhshmëri tatimore dhe rregullatore, për shembull, duke reduktuar ngarkesën e punës me letra për përputhshmërinë tatimore (duke shtuar numrin e firmave të cilat janë të përputhshme me taksa, të vështirësuar nga kostoja e lartë dhe e pa-kompenzueshme e pajisjeve të nevojshme, gjithashtu cilësinë e përpjekjes intenzive të kërkesave për përputhshmërinë e taksave) dhe duke ofruar një kompenzim të qartë dhe proporcional tek bizneset në aspektin e shërbimeve të dhëna; **b)** rritja e betejës pjesëmarrëse kundër korrupsionit – për shembull, duke paraqitur konkurrencën në kontrata për ofrimin e shërbimeve qeveritare, duke vepruar shpejtë në përgjigje ndaj këshillave të dhëna dhe duke inkurajuar dhe mbrojtur informatorët që ekspozojnë keqërbërjen brenda organizatës me shpresën për t'a ndaluar atë; **c)** paraqet një skemë formalizimi, vullnetare dhe stimuluese e cila inkurajon sektorët specifik (duke filluar me bujqësinë), në regjistrimin e bizneseve përmes ofrimit të informatave të nevojshme dhe formave tjera të përkrahjes përmes zyreve komunale. Kjo skemë mund të përfshihet në planet zhvillimore komunale.

2.3. Reformo mekanizmat e rëndë apo rregullativ kundër-konkurrues që kufizojnë investimet në zhvillimin e tregjeve të Kosovës. Rregullat e mbi-ndërluara, shumë-transaksionale për regjistrimin e biznesit dhe përputhshmërisë me taksa ngulfasin ndërmarrësinë dhe inkurojnë shumë biznese që të operojnë në ekonomi joformale. Intervenimi është prioritet në dy fushat vijuese a) sistemi i Kosovës për mbledhjen e TVSH-së duhet të thjeshtësohet dhe të mbledhjes së ngritur brenda kufinjëve, për të shmangur lëniën jashtë tregut të mallrave të prodhuara vendore të Kosovës, që në veçanti dëmtojnë të varfërit ruralë; dhe b) proceset për licensimin e bizneseve duhet të thjeshtësohen, duke zvogëluar shumëllojshmërinë e pikave të transaksionit në mënyrë që të ulen kostot për startim të biznesit dhe zgjerim të tij, dhe për të zvogëluar mbështetjen e tepërt mbi diskrecionin e zyrtarëve publik. Kjo do të kishte efekt të dyfishtë të zvogëlimit të mundësive për korrupsion dhe të ngritjes së stimulimeve për formalizim.

2.4. Fokuso qasjen në financim dhe koston e financimit si motor kyç të zgjerimit të biznesit. Bankat duhet të jenë lehtësuese të bizneseve që kërkojnë të inovojnë, zgjerohen apo të paraqesin në treg grupet relativisht të përjashtuara. Në mënyrë kritike, niveli i asimetrisë së informatave ndërmjet bankës dhe konsumatorit ka nevojë të ulët. Pronarët e bizneseve dhe bizneset potenciale startuese

mund të përfitojnë nga arritja dhe programet tjera në përmirësimin e të kuptuarit të proceseve dhe kërkesave financiare. Gratë, të rinjtë dhe në veçanti minoritetet entike kanë nevojë për inkurajim, për t'i lëvizur këto grupe të përjashtuara përtej të mbështeturit në bamirësi dhe skema të mikro-kredive të mbështetura ndërkom-bëtarisht. Sfidat kolaterale të ballafaquara nga shumë meshkuj dhe femra mund poashtu të largohen përmes reformës së sistemit kadastral për të qenë më efekte dhe më pak të kushtueshme në regjistrimin e pronës. Përveç kësaj, kapaciteti gjyqësor ka nevojë të përforcohet për të menaxhuar raste të rëndomta dhe të tjera ekonomike dhe biznesore të cilat mbesin të pazgjidhura në gjykata. Normat e larta të interesit në Kosovë janë në mënyrë direkte proporcionale me shkallën e rrezikut me të cilën bankat ballafaqohen në një klimë të zbatimit të dobët dhe të stërzgatur të ligjit. Normat e zvogëluara të interesit dhe skemat e shënuara të informatave do të ofrojnë një litar shpëtimi për ata që nuk janë në gjendje për të financuar ndërmarrjet nga burimet e tyre individuale, të cilat veprojnë në procesin e ngushtimit të hendeikut të varfërisë dhe mundësive në Kosovë.

2.5.Shto kapacitetet për zbatim të përgjegjshëm dhe zbatim të ligjeve. Zbatimi i qëndrueshëm dhe në kohë të duhur është thelbësor për pro-rritjen dhe mjedisin e formalizuar biznesor si dhe poashtu për mbrojtjen esenciale për mirëqenien e punëdhënësve dhe punonjësve. Gjykatat, në veçanti, duhet të jenë më të shpejta, të procesojnë vëllimin e rasteve që kanë lidhje me kontrata që ndodhen aty. Krijimi i gjykatave ekonomike rajonale do të zvogëlonte dukshëm ngarkesën aktuale të punës. Përveç kësaj, ndarja e rasteve ekonomike dhe biznesore nga rastet tjera të përgjithshme gjyqësore është një domosdoshmëri për përmirësimin e marrëdhënies së dobët ndërmjet bizneseve dhe gjykatave në Kosovë. Në lidhje me evazionin fiskal, mekanizmat e suksesshëm parandalues kërkojnë së paku dyfishimin e kapaciteteve të administratës tatimore dhe zyrtarëve doganorë, të cilat aktualisht janë më të ulëtat në Evropë në njëmijë banorë. Kjo, në shkëmbim, do të zvogëlonte jobalancimin në përputhshmërinë e taksave të cilat rrjedhin nga mbi-fokusimi në bizneset që tashmë janë të përputhshme.

2.6.Ofro arsimim dhe gjithëpërfshirje mbi ligjet e punës për krijimin e kulturës së pranimit që ende nuk ekziston. Aktualisht, ligjet që janë në librat e statusit të Kosovës, të hartuara për të mbrojtur të varfërit dhe gratë, janë duke u interpretuar në mënyrë diskriminuese. Do të ishte një parodi poqëse këto ligje i'a mohojnë punën të varfërit, apo kontribuojnë në kufizimin e mëtutjeshme të grave jashtë punëve të sigurta dhe me kontrata të qëndrueshme. Çdo reformë apo shqyrtim i Ligjeve të Punës duhet t'u qaset pas një periudhe të dialogut me punëdhënësit dhe punonjësit. Pushimi i lehonisë, për shembull, nuk duhet të shihet si barrë të cilën duhet t'a mbajnë vetë bizneset. Mund të shërbejë poashtu si një mundësi për t'a promovuar përkohësisht brenda kompanisë, ndoshta edhe qeveria që kontribuon në një pjesë të kostos së shtuar, që mundëson përvetësim më të madh të diturisë brenda fuqisë punëtore.

2.7.Implemento ligjet mbi efikasitetin e energjisë në një mënyrë kryesuese të pjesëmarrjes dhe arsimimit. Kosova ka një mjedis të shkëlqyeshëm dhe ligje mbi energjinë në librat e saj të statusit. Edhe njëherë, sidoqoftë, sfida është në implementimin e efikasitetit dhe gjithëpërfshirjes. Kompanitë deri tani nuk e kuptojnë se pse margjinat tashmë të ngushta të fitimit duhet të ngushtohen edhe më tutje vetëm që ato të bartin barrën e mbrojtjes mjedisore, kur askush tjetër - përfshirë edhe qeveria - nuk duket se interesohet aq shumë. Gjithëpërfshirje në nivel të komunitetit, efikasitet në ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës tek zonat e

varfëra dhe të kontaminuara, dhe demonstrim i qartë i përfitimeve – për shembull – të qasjeve të efikasitetit të energjisë ndaj industrisë dhe bujqësisë – janë hapat e parë kritik drejt ndryshimit të brendësisë. Duhet, gjithashtu, të krijohet një qendër monitorimi për monitorimin e përputhshmërisë mjedisore, për përmirësimin e transparencës në këtë zonë, dhe gjrobat duhet të jenë të vëna shpejtë dhe proporcionalisht.

3. Integro më shumë meshkuj dhe femra në një treg të paanshëm

3.1. Cakto caqe të graduara/shkallëzuara për shkallët e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në mesin e meshkujve dhe femrave. Aktualisht, shkallët e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore të Kosovës, veçanërisht për femrat, janë mjerisht të ulëta. Ka shumë shkaqe – kulturore, praktike dhe ekonomike – se pse femrat nuk janë në përgjithësi aktive në fuqinë punëtore në Kosovë. Madje edhe aty ku mungesa e pjesëmarrjes duket të jetë zgjidhje, ajo shpesh del nga paaftësia për t'u përballur me sfidat e shoqëruara me gjetje të punës në kontekstin e detyrimeve të mëdha të familjes. Kjo "zgjidhje" është në të vërtetë një formë e shtrëngimit, dhe më shumë zgjidhje do të bëheshin të hapura për femrat nëse fusha e lojës është e nivelizuar. Konsiderata të ngjashme qëndrojnë për të varfërit e paedukuar rural, dhe minoritetet e përjashtuara. Në lidhje me këtë, programet gjithëpërfshirëse me barazi gjinore duhet të përfshihen në të gjitha planet zhvillimore komunale.

3.2. Bëhu partner me bizneset në përkrahjen e ndërmarrjeve të reja dhe inovacionin. Rinia e Kosovës ka aftësi të jashtëzakonshme, mirëpo aktualisht ka pak rrugëdalje për ta. Inovacioni rinor dhe programet e ndërmarrjes të përkrahura nga universitetet dhe bizneset mund të asistojnë në bashkimin e talentëve të rinj. Të rinjtë të lidhur me këto programe mund të përfitojnë nga to dhe mund të ofrojnë energjitë e tyre ndaj bizneseve lokale – duke fituar shkathtësi, përdorin ndihmën e kompanitë të mendojnë tejprtej dhe të zbatojnë idetë zgjeruese. Hyrja në skema të tilla mund të funksionojë në baza të meritave, duke ofruar "bursa shkollimi" për meshkujt dhe femrat e rinj të aftë dhe të zgjuar të të gjitha etniciteteve në bashkëpunimin me njëri tjetrin dhe me ndërmarrjen, duke ndërtuar shkathtësitë e individit dhe fuqisë punëtore të Kosovës

3.3. Krijo një kulturë të mësimi për tërë jetën përmes dy strategjive: a) paraqitjes së shkathtësive të gatshme të punës në kurrikulumin e shkollës – përfshirë thelbësoret bazike siç janë përgatitja e CV-së, teknikave të intervistës, menaxhimit të biznesit, paanshmërisë në vendin e punës, lidhjeve mjedisore dhe proceseve financiare; b) zhvillimit të një strategjie kuptimplotë të arsimimit për të rriturit, duke integruar iniciativat e shënjuara për baziket (mësimi për lehtësimin e leximit), dhe përvetësimit të shkathësive të nivelit mesatar dhe të sofistikuar. Shërbimet kyçe, siç janë trajnimet profesionale dhe të mësuarit për lehtësimin e leximit duhet të shenohen më mirë për grupet e përjashtuara siç janë gratë rurale dhe të papunët e një kohe të gjatë. Kjo është mënyra e vetme për të bërë ndonjë përparim domethënës në zvogëlimin e qendrave të rrënjësura të varfërisë së Kosovës dhe mungesës së mundësisë. Punëtoritë trajnuese për rritjen e shkathtësive të fuqisë punëtore dhe asaj jo-punëtore mund të operojnë dhe sponzorohen nga vet bizneset dhe të formohen për audiencën e shënjuar. Për shembull, trajnimi bazik mbi përpunimin e ushqimit do mund të sponzorohej nga prodhuesit vendor për gratë që jetojnë në zonat rurale. Iniciativat e tilla do të kërkonin bashkëpunim ndër-sektorial në nivel komunal.


3.4.Vendos Ligjin mbi Skemën e Ndhmës Sociale në rotacion vjetor për reformë Parlamentare. Kosova duhet të rreshtojë/drejttojë rishpërndarjen e të ar-dhurave të saj dhe strategjive të rritjes. Reformat aq të nevojshme dhe të parashi-kuara që një kohë të gjatë për legjislacionin e mirëqenies sociale të Kosovës nuk mund të paraqiten në mënyrë kuptimplotë pa buxhet shtesë për implementimin e tyre. Ligji aktual, madje edhe pas reformave të 2012-tës, punon kundër rritjes duke dështuar të mbroj më të varfërit dhe duke përforcuar ciklet e varfërisë, humbjes së aftësive dhe varshmërisë. Mbajtja e buxhetit neutral të Ligjit mbi Mirëqenien Sociale është duke i kushtuar Kosovës në periudhë afatgjatë. Ky ligj duhet të shqyrtohet në baza vjetore për të përputhur rritjen e GDP-së me mbrojtjen sociale dhe të çdo mundësie të ndërmarrë për të rreshtuar përfitimet me strategjitë për thyerjen e varshmërisë. Janë dy opsione a) largimi i kategorizimit që lidhet me moshën për fëmijët vartës, e që i mundëson familjeve me fëmijë të moshës së shkollës të marrin përfitime, mirëpo duke i lidhur ato përfitime me vijimin e shkollimit; dhe b) duke punuar aktivisht për të bashkuar përfituesit e papunë afatgjatë me skemat epunë-kërkimit, mësimi lehtësues/të vonuar dhe trajnimeve profesionale. Zbatimi i këtyre ndryshimeve varet në rritjen e kapacitetit dhe numrit të punonjësve social që administrojnë ligjin, për të ndihmuar ata të menaxhojnë ngarkesat tashmë të larta të punës.

3.5.Integro remitenat në strategjitë investive brenda planeve zhvillimore komunale. Komunitat mund të jenë më aktive gjatë cikleve të planifikimit për stimulimin e ndërmarrjeve të denja dhe të paanshme në lokalitetet e tyre. Nëse komunitat shihen se janë duke ofruar baza të shërbimeve dhe premtimeve, atëherë janë në pozitë më të mirë për t'u angazhuar me ndërmarrësit potencial dhe ofruesit e vendeve të punës në mënyrë transparente. Shërbimet që mund t'i ofrojë komuna përfshijnë të lidhurit e bizneseve me njëra-tjetrën për stimulimin e tregtisë vendore, duke inkurajuar bashkëpunim me ekonomitë e shkallëzuara dhe duke treguar rrugëdalje të investimeve të qëndrueshme për burime të cilat përndryshe do të drejtoheshin diku tjetër. Edhe pse qeveria e Kosovës nuk mund të i'u tregojë njerëzve se çka duhet bërë me paratë që mirren jashtë vendit, një strategji e tillë e hapur e angazhimit mund të jetë e dobishme për të drejtuar së paku një pjesë të fluksit të remitançave drejt investimeve të qëndrueshme, të orientuara drejt rritjes ekonomike dhe zvogëlimit të varfërisë.

3.6.Krijo një rezervat të financimit për ndërmarrjet rurale-urbane krijuese të vendeve të gjelbërta të punës. Brenda kontekstit të një strategjie të përgjithshme të zhvillimit të ndërmarrjes, një rezervat i veçantë financues i pjesës së shenjuar të tregut, fillimisht i vendosur në nivelet e mëparshme nga donatorët ndërkombëtar, mund të krijohet për promovimin e ndërmarrjeve që marrin parasysh mbrojtjen e mjedisit. Theks i veçantë duhet të vendoset mbi bizneset që bashkojnë popullatën urbane dhe rurale përmes teknologjisë në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta mjedisore. Për shembull, projektet janë aq shumë të nevojshme për të plotësuar shumë boshllëqe të dhënash mjedisore rreth bioshumëllojshmërisë, shkallës së ndotjes dhe trendeve në shkëlqimin e legjislacionit mjedisor. Këto ndërmarrje të gjelbërta/ekologjike kanë gjasa që të jenë të vogla në afat të shkurtër, të kontraktuara nga qeveria dhe të kufizuara në fitimet e tyre. Kosova, gjithashtu, është me plot rezervate të administruara keq të financimit. Megjithatë, një skemë e implementuar mirë, pragmatike dhe largpamëse mund të jetë stimulim i fuqishëm për ndërgjegjësim më të madh mjedisor, veprim dhe bashkëpunim që i sjell dobi Kosovës për një periudhë të gjatë në të ardhmen.

Shtojca statistike

Llogaritja e Indeksit të zhvillimit njerëzor sipas Raportit Global të Zhvillimit Njerëzor 2011 - Prezentim grafik



Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (IZHN) është masë përmbledhëse e zhvillimit njerëzor. Ajo mat aritjet mesatare në një vend në tri dimensionet bazike të zhvillimit njerëzor: një jetë të gjatë dhe të shëndoshë, qasje në njohuri dhe një standard i denjë i jetesës. IZHN-ja është një mesatare gjeometrike e indekseve të normalizuara e cila mat aritjet në secilin dimension.

Hapat në llogaritjen e Indeksit të zhvillimit Njerëzor

Ekzistojnë dy hapa për llogaritjen e IZHN-ë

Hapi i parë është krijimi i nënindekseve për secilin dimension. Vlerat minimale dhe maksimale (portat) duhet të vendosen në mënyrë që të transformohen indikatorët në indekse ndërmjet 0 dhe 1. Për shkak se mjeti gjeometrik është i përdorur për grumbullim, vlera maksimale nuk afekton krahasimin relativ (në aspekt të përqindjes) ndërmjet dy vendeve apo periudhave kohore. Vlerat maksimale janë të vendosura me vlerat aktuale maksimale të vëzhguara të indikatorëve nga vendet në seri kohore, e kjo është 1980–2010. Vlerat minimale do të afektojnë krahasimet, kështu që vlerat të cilat mund të konceptohen në mënyrë të përshtatshme si vlera e jetesës apo do përdoren zerotë "natyrore". Kështu progresi është i matur përkundrejt niveleve minimale që një shoqëri

Pasi të definohen vlerat minimale dhe maksimale, nënindekset janë të llogaritura si në vijim:

$$\text{Dimenzioni i indeksit} = \frac{\text{Vlera aktuale} - \text{Vlera minimale}}{\text{Vlera maksimale} - \text{Vlera minimale}} \quad (1)$$

Për edukimin, ekuacioni 1 është aplikuar për secilën nga dy nënkomponentet, pastaj mesatarja gjeometrike e indekseve rezultative është krijuar dhe përfundimisht, ekuacioni 1 është i riaplikuar ndaj mesatares gjeometrike të indekseve, duke përdorur o si minimum dhe mesataren më të lartë gjeometrike të indekseve rezultative për periudhën kohore nën konsiderimin si maksimum. Kjo është ekuivalente me aplikimin e ekuacionit 1 direkt në mesataren gjeometrike të dy nënkomponenteve. Për shkak se secili index i dimensionit është njëpërfaqësim për mundësitë në dimensionin korrespondues, funksioni i transformimit prej të ardhurave në mundësi, me gjasë do të jetë e formës konkave (Anand dhe Sen 2000c). Kështu, për të ardhura përdoret llogaritmi natyror ivlerave aktuale minimale dhe maksimale.

Hapi i dytë është grumbullimi i nënindekseve për të prodhuar Indeks të Zhvillimit Njerëzor

IZHN-ja është mesatare gjeometrike e tri indekseve të dimensioneve:

$$\left(I_{\text{jeta}}^{1/3} \cdot I_{\text{arsimimi}}^{1/3} \cdot I_{\text{të ardhurat}}^{1/3} \right). \quad (2)$$

ka nevojë për të mbijetuar me kalimin e kohës. Vlerat minimale janë të vendosura në 20 vite për jetëgjatësi, në 0 vite për variablat e edukim-

Caqet qëllimore për Indeksin e Zhvillimit Njerëzor në këtë Raport

Dimenzioni	Maksimumi i observuar	Minimumi
Pritshmëria jetësore	83.4 (Japonia, 2011)	20.0
Mesatarja e viteve të shkollimit	13.1 (Republika Çeke, 2005)	0
Pritshmëria e viteve të shkollimit	18.0 (mbuluar në)	0
Indeksi i arsimimit i kombinuar	0.978 (Zelanda e Re, 2010)	0
Të ardhurat për kokë banori (PPP \$)	107,721 (Katar, 2011)	100

it dhe në \$163 për të ardhurat shtetërore bruto (ASHB) për frymë banori. Minimumi i jetëgjatësisë është i bazuar në dëshminë historike afatgjate nga Maddison (2010) dhe Riley (2005). Shoqëritë mund të rrojnë pa edukim formal, duke justifikuar minimumin e arsimit. Niveli bazë i të ardhurave është i nevojshëm për të siguruar mbijetesën: \$163 është vlera më e ulët e arritur nga çfarëdo vendi e regjistruar

Kosovë

Indikatore	Vlera
Jetëgjatësia në lindje (vite)	70
Vitet mesatare të shkollimit (vite)	11.2
Vitet e pritura të shkollimit (vite)	11.3
GNI për frymë (PPP US\$)	7,410

Shënim: Vlerat janë të rrumbullaksuara.

$$\text{Indeksi i jetëgjatësisë} = \frac{70 - 20}{83.4 - 20} = 0.788$$

$$\text{Indeksi për vitet mesatare të shkollimit} = \frac{11.2 - 0}{13.1 - 0} = 0.855$$

$$\text{Indeksi për vitet e pritura të shkollimit} = \frac{11.3 - 0}{18 - 0} = 0.627$$

$$\text{Indeksi i edukimit} = \frac{\sqrt{0.855 \cdot 0.627} - 0}{0.978 - 0} = 0.748$$

$$\text{Indeksi i të ardhurave} = \frac{\ln(7,410) - \ln(100)}{\ln(107,721) - \ln(100)} = 0.616$$

$$\text{Indeksi i Zhvillimit Njerëzor} = \sqrt[3]{0.788 \cdot 0.748 \cdot 0.616} = 0.714$$

ndonjëherë në histori (në Zimbabve më 2008) dhe korrespondon me më pak se 45 centë në

ditë, pak më shumë se një e treta e vijës së varfërisë me \$1.25 në ditë sipas Bankës Botërore.

Burimet e të dhënave

Jetëgjatësia në lindje: UNDESA (2009d)

Vitet mesatare të shkollimit: Barro dhe Lee (2010)

Vitet e pritura të shkollimit: Instituti për Statistika UNESCO (2010A)

Të ardhurat shtetërore bruto (ASHB) për frymë banori: Banka Botërore (2010g) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (2010a)

Përmirësimet metodologjike në IZHN, duke përdorur indikatorë të rinjë dhe formë të re funksionale, rezultojnë në ndryshime thelbësore. Adoptimi i mesatares gjeometrike prodhon vlera më të ulëta të indeksit, me ndryshimet më të mëdha që ndodhin në vende/shtete me zhvillim të pabarabartë përgjatë dimensioneve. Mesatarja gjeometrike ka vetëm një ndikim mesatar në renditjen IZHN. Vendosija e kufirit të sipërm në vlerat aktuale maksimale ka më pak ndikim mbi vlerat e përgjithshme të indeksit dhe ka ndikim të pakët të mëtutjeshëm në renditje.

Shënime

Hyrje

- 1 Për informata më të detajuara ju lutem shikoni Shtojcën statistike: Kalkulimi i indeksit të zhvillimit njerëzor bazuar në raportin global të zhvillimit njerëzor 2011 (f. 167-217).
- 2 Të dhënat mbi varfërinë nga Vlerësimi i Bankës Botërore mbi Varfërinë, 2007 (kufiri i lartë i llogaritjes) dhe Studimet Demografik dhe Shëndetësor 2009. Zyra për Statistika e Kosovës (kufiri i ulët i llogaritjes). Llogaritjet e Bankës Botërore janë të bazuara në shifrat e 1.42 EURO për të rriturit në ditë për varfëri absolute dhe 0.92 EURO për varfëri të jashtëzakonshme në çmimin e 2002-tës. Llogaritjet e Zyrës për Statistika të Kosovës janë të bazuara mbi rritjen e inflacionit të rregulluar të 1.55 EURO në ditë, respektivisht 1.02 EURO në ditë.
- 3 Fleta e Fakteve MDG Kosovë 2010, Zyra për Statistika e Kosovës, Agjensionet e Kombeve të Bashkuara, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar. Të dhënat tregojnë një rritje prej 50 përqind në varfërinë rurale 2000 – 2004.
- 4 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Studimi i Fuqisë Punëtore 2009.
- 5 Studimi Mozaik i Kosovës, UNDP 2009. Ky studim është drejtuar me 6,400 ekonomi familjare nga 33 komunat, duke mbledhur të dhëna parësore përmes intervistave ballë-për-ballë. Për secilën nga 33 komunat e Kosovës është caktuar një numër proporcional i anketuesve bazuar në shifrat e popullatës dhe shembulli është ndarë barabar ndërmjet zonave urbane dhe rurale.
- 6 Studimi i Remitancave në Kosovë, UNDP 2010.
- 7 Raporti i Vendit të Kosovës, Programi Evropian Trajnues 2007; dhe Integrimi me Europën: Strategjia Mësimore për të Rriturit për Kosovën, Punësimi dhe Vëzhgimi i Shkathtësive të Kosovës 2004.
- 8 Pozita e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Kosovë, Studim bazë i drejtuar pas kërkesës dhe me financim nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur: COMPASS Hulumtimi & Kompani Konsulente. Prishtinë: KFOS – SOROS, 2009, dhe Raporti për Zhvillimin Njerëzor në Kosovë, UNDP 2010.
- 9 Studimi Mozaik i Kosovës, UNDP 2009.
- 10 Drejtësia e Mohuar: Gjendja e Edukimit të Fëmijëve me Nevoja Speciale në Kosovën e pas-konfliktit, UNICEF 2008.
- 11 Studimi i pozitës së gruas në Kosovë më 2009, UNIFEM dokument i brendshëm, fq. 3.
- 12 Vlerësimi Afatmesëm për Fëmijërinë e Hershme & Programi i Shkollimit të Grave, UNICEF 2004.
- 13 Ndërmarrje informale, përbëjnë sektorin informal të ekonomisë. I cili është një koncept që përdoret shumë herë në këtë raport. Sektori informal është përcaktuar nga aktiviteti ekonomik që nuk tatohet as monitorohet nga qeveria dhe nuk është i rregulluar dhe i mbrojtur nga institucionet formale.
- 14 Promovimi i Rritjes Pro-njerëzore – Varfërisë: Zhvillimi i Sektorit Privat, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) Dokument Veprimi, Francë 2006.
- 15 Vlerësimi i Programit të Tregut Aktiv të Punës për të rinj në Kosovë në qershor 2008.
- 16 Ç'limim Ndërmarrësisë—Bërja e Biznesit që të Punojë për të Varfërit, Komisioni mbi Sektorin Privat dhe Zhvillim 2004.
- 17 Zemrat e Buta dhe Kokat e Forta: Qendërzimi i Sektorit Privat ndaj Zvogëlimit të Varfërisë, Banka Aziatike e Zhvillimit (C.H. Wallich) 2004.
- 18 Sektori Privat dhe Zvogëlimi i Varfërisë, Oxfam International (Raworth K., S. Dhanarajan dhe L.W. Lewis), 2008.
- 19 Pjesa e Sektorit Privat në Paqe – Edukimi për të ofruar stabilitet social në shoqëritë e prekura nga konflikti, J.A. French 2005.

Kapitulli 1

- 20 “Ndërmarrje në pronësi shoqërore” do të thotë një ndërmarrje që është krijuar si pronësi shoqërore sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet, Ligjit mbi Punën e Bashkuar të Republikës Federative të Jugosllavisë apo çfarëdo ligji tjetër në fuqi, me kusht që çdo ndryshim i mëvonshëm për krijimin e ndërmarrjes së tillë të qeveriset nga seksionet 5.3 dhe 5.4. (RREGULLORJA Nr. 2002/12 UNMIK/REG/2002/12, 13 qershor 2002).
- 21 Gjatë periudhës së njëjtë, disa vende tjera të Europës Juglindore u zhvilluan shpejtë, kështu që hendeuku i të ardhurave është zgjeruar (Banka Botërore 2010).
- 22 Raporti i Progresit për Kosovën, Komisioni Evropian 2011.
- 23 Eksportet ranë ndjeshëm, por për shkak të peshës së vogël të GDP-së të konstatuar nga ekspertët, ndikimi ishte i kufizuar.
- 24 Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2011.
- 25 Treguesit e qeverisjes të Bankës Botërore përfshijnë: ngritjen e zërit dhe përgjegjshmërinë, stabilitetin politik, efikasitetin e qeverisë, cilësinë e rregullatore, sundimin e ligjit, si dhe kontrollin e korrupsionit.
- 26 Papunësia e regjistruar mund të jetë e mbi-vlerësuar nëse pjesë të të punësuarve në mënyrë joformale, apo ata që nuk janë të disponueshëm për punë apo nuk shikojnë për punë, janë të regjistruar si të papunë në mënyrë që të përfitojnë nga asistencë sociale, një limitacion që edhe vetë raporti e vërteton (MPMS 2010, fq. 39). Së

dyti, shifrat e regjistruara të papunësisë mund të jenë të njëanshme në drejtimin e kundërt poqëse një pjesë e popullatës nuk regjistrohet dhe si e tillë për shkak se ata janë dekurajuar dhe janë dorëzuar së kërkuari për një vend pune.

- 27 ASK (2009) Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2009.
- 28 SFP ASK 2009 përdor standardet e përkufizimit të papunësisë: një person i papunë është personi që nuk ka punë dhe është aktivisht duke kërkuar punë.
- 29 Raporti i Zhvillimi Njerëzor në Kosovë mbi Gjithëpërfshirjen Sociale, UNDP 2010. Raporti shfrytëzon të dhënat SFP të ASK-së nga viti 2008.
- 30 ONP (Organizata Ndërkombëtare e Punës) përcakton si punë të denjë produktive për burra dhe gra në kushtet e lirisë, barazisë, sigurisë dhe dinjitetit njerëzor.
- 31 Studimi i Rinisë dhe Ndërmarrjeve për Kosovën, Corbanese dhe Rosas 2007.
- 32 Vlerësimi i Programit të Tregut Aktiv të Punës për Rininë në Kosovë, qershor 2008.
- 33 Eurostat 2010.
- 34 Sektori primar mbulon ndarjet 01 deri 05, apo degët A (Bujqësi, gjueti dhe pylltari) dhe B (Peshkim). Sektori sekondar mbulon ndarjet 10 deri 45, apo degët C deri F (Miniera dhe Guroret, Industria Përpunuese, Rryma, Gazi dhe Furnizimi me Ujë; Ndërtimi). Sektori terciar përfshin pjesën e mbetur.
- 35 Gjetjet në këtë seksion janë të përbëra nga të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës dhe ASK-së.
- 36 ASK (bazuar në të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës).
- 37 ASK (bazuar në të dhënat nga Administrata Tatimore e Kosovës).
- 38 Shuarja e ndërmarrjes është e llogaritur nga numërimi i numrit të shuarjeve të ndërmarrjeve të regjistruara në regjistrin e bizneseve, e korrigjuar për gabimet, krahasuar me madhësinë e popullatës. Shuarja e ndërmarrjes është e përcaktuar si shpërbërje e një kombinimi të faktorëve prodhues me kufizimin se nuk është e përfshirë asnjë ndërmarrje tjetër në ngjarje. Shuarjet nuk përfshijnë daljet nga popullata për shkak të bashkimit të kompanive, sipërmarrjeve, ndarjeve apo ristrukturimit të një grupi të ndërmarrjeve. Shifra nuk përfshin daljet nga një nën-popullatë si rezultat vetëm i ndryshim të aktivitetit. Për më tej, statistikën e raportuar nuk e konsiderojnë ndërmarrjen të shuar nëse i nënshtrohet ndryshimit të formës juridike, apo poqëse riaktivizohet brenda dy viteve kalendarike.

Kapitulli 2

- 39 BEEPS është një iniciativë e përbashkët e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Bankës Botërore.
- 40 Llogaritja e intensitetit të pengesave: pyetësorët kanë renditur prej 1 deri në 5 ashpërsinë e pengesave (1, pa pengesa; 2 pengesa të vogla; 3, pengesa mesatare; 4, pengesa të mëdha; 5, pengesa shumë të ashpëra). Në këtë raport është llogaritur intensiteti i pengesave të ndryshme dhe ato janë renditur nga 20 deri 100 (100 e të qenurit pengesë shumë e ashpër).
- 41 E definuar se ka llogari bankare, dorëzimi i parave në bankë në fund të ditës dhe instalimi i aparaturave për tërheqje të hollave (POS) në dyqanet e tyre.
- 42 Kosova A (kapaciteti i instaluar i përafërt me 450MW) dhe Kosova B (kapaciteti i instaluar i përafërt me 580MW), të dyja të vendosura në Obiliq në veri-perëndim të Prishtinës.
- 43 Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes, Riinvest 2002.
- 44 Friedrich-Ebert-Stiftung është një organizatë gjermane jo-fitimprurëse politike, aktive në Kosovë dhe mbi 100 vende të tjera, me një mision për të promovuar demokracinë, drejtësinë sociale dhe reformat ekonomike përmes ngritjes së kapaciteteve, zhvillimit të politikbërjes dhe dialogut.
- 45 Transparency International është një organizatë jo-qeveritare me një mision për të krijuar ndryshim drejt një bote të lirë nga korrupsioni. Organizata monitoron dhe boton korrupsionin e korporatës dhe politik në zhvillimin ndërkombëtar, dhe boton një herë në vjet Indeks të Perceptuar të Korrupsionit, duke u fokusuar në nivelet e korrupsionit në mbarë botën.
- 46 Studimi mbi Barrierat e Ndërmarrjes Riinvest 2011.
- 47 Një "Problem kolektiv veprimi" përshkruan një situatë në të cilën individë të shumtë përfitojnë nga një veprim i caktuar, megjithatë, ky veprim ka një kosto shoqërore që e bënë të pabesueshme që çdonjëri nga këta individ mund të ndërmarrë apo zgjidhë atë vetëm. Zgjedhja racionale atëherë është për të ndërmarrë këtë si një veprim kolektiv kostoja e së cilës është e ndarë.
- 48 Plani i Përbashkët Zhvillimor i Kosovës, 2010-2015, Kombet e Bashkuara Ekipi i Kosovës.

Kapitulli 3




- 49 Rreth 90 përqind e bizneseve fillestare i takojnë sektorit terciar, 9.2 përqind sektorit sekondar dhe vetëm 0.8 përqind sektorit primar.
- 50 Niveli Shpirtëror: Pse Barazitë më të Mëdha i Bëjnë Shoqëritë më të Forta, Wilkinson, R. dhe Pickett, K. 2010.
- 51 Të dhënat financiare mbi gratë në Kosovë të marrura nga Raporti mbi Zhvillimin Njerëzor në Kosovë UNDP 2010, Zyra për Statistika e Kosovës 2008 dhe Studimi i Bankës ProCredit 2008.
- 52 Fëmijëria e Hershme & Programi për Shkollimin e Grave, Vlerësimi Afatmesëm, UNICEF 2004.
- 53 She_ERA, Grate Afariste në Kosovë.
- 54 Arritja në Lisbonë – Vlerësimi i nevojave trajnuese profesionale dhe krijimi i mundësive për vende pune për gratë rurale UNICEF 2008.
- 55 Sistemi preferus për Tregtinë në BE ofron një regjim preferencial tregtar në disa vende në zhvillim, ku ata paguajnë obligimet e tyre me vlera më të ulëta në disa ose në të gjitha vendet e BE-së ku ata eksportojnë. Sistemi është i projektuar për të dhënë akses të rëndësishëm në tregun e BE-së dhe të kontribuojë në rritjen e

ekonomive të vendeve në fjalë, mbështet integrimin ekonomik me BE-në dhe kështu nxitjen e stabilitetit politik dhe progresit ekonomik.

- 56 Sektori tregtar apo i tregtueshëm definohet normalisht në atë mënyrë që të përfshij ato industri në të cilat firmat shesin mallrat ose shërbimet e tyre në tregje kombëtare ose ndërkombëtare ku konkurrenca ekziston.
- 57 Puna në raport me kapitalin e një industrie apo sektori është llogaritur bazuar në raportin e kostos së punës, si një pjesë e kostos së kapitalit të përgjithshëm të prodhimit të mirë apo të shërbimit në fjalë. Puna në raport me kapitalin tregon intensitetin e punës së sektorit që konsiderohet: sa më i lartë raporti, aq më i lartë intensiteti i punës.

Kapitulli 4

- 58 Raporti i Zhvillimi Njerëzor në Kosovë mbi Gjithëpërfshirjen Sociale, UNDP 2010.
- 59 Definimi i niveleve të aftësive të ndryshme të punëtorëve: veprimi i një punëtori të pakualifikuar përfshinë kryerjen e detyrave të thjeshta me gjykimin pak ose aspak të pavarur nga dikush apo nga eksperiencia e mëparshme, përveç njohjes së mjedisit të punës. Veprimet e një punëmarrsit të gjysmë-kualifikuar janë në përgjithësi të natyrës rutinore të përcaktuar aty ku kërkesa e madhe nuk përbëhet aq shumë nga gjykimi dhe aftësia, por nga kryerja e detyrave të caktuara. Një punonjës është i aftë për të punuar në mënyrë efektive, duke ushtruar gjykimin e pavarur të konsiderueshëm, dhe duke marrë përgjegjësinë për detyrat e veta dhe duke pasur një njohuri të plotë në Artizanatin e tij, në tregti apo industri. Një punëtor me aftësi të larta është ai i cili në mënyrë efektive mbikëqyrë punën e punonjësve të tij.
- 60 Informatat mbi Tregun e Punës në Kosovë, MPMS 2007.
- 61 Kosova, të Hapurit e Potencialit të Rritjes: Strategjitë, Politikat, Veprimet, Banka Botërore 2010.
- 62 Të lëshuarit e hovshëm të Ndryshimit, Zërat e Rinisë së Kosovës, UNICEF dhe Iniciativa për Stabilitet e Kosovës 2010.
- 63 Ardhja në Lisbonë: Vlerësimi i Nevojave për Trajnimin Profesional dhe Mundësitë e Krijimit të Vendeve të Punës për Gratë Rurale, UNICEF 2008.
- 64 MPMS 2003.
- 65 Ligji mbi punën (Law No.03/L –212) - I fuqizuar më 2010. Gjeje tek: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-212-eng.pdf>
- 66 Këshilli Socio-Ekonomik i Kosovës është një komitet, i fokusuar në dialogun social dhe lidhur me marrëdhëniet e punës. Ai kryesohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe është i përbërë nga përfaqësuesit e punëdhënësve, sindikatave, dhe përfaqësuesve të ministrive përkatëse.
- 67 Ligji mbi aftësimin profesional, rehabilitimit dhe Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara (Ligji nr 03/L-019) - miratuar në vitin 2008. Gjetet në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L-019_en.pdf.
- 68 Studimi i Remitancave të Kosovës, UNDP 2010.
- 69 Studimi i Remitancave të Kosovës, UNDP 2011.
- 70 Një pasqyrë mbi Sistemin e Sigurisë Sociale në Kosovë, ILO 2010.
- 71 Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë, Banka Botërore 2008.
- 72 Barazia e të ardhurave është definuar si një masë e shkallës në të cilën ka një shpërndarje të barabartë të të ardhurave të të gjithë pjesëmarrësve të ndryshëm në një ekonomi. Barazia e të ardhurave është më e ulët, aq më e madhe që është përqindja e të ardhurave të një vendi i cili kontrollohet nga të pasurit krahasuar me popullsinë (për shembull, nëse 70% e të ardhurave të vendit janë të kontrolluara nga 20% të banorëve të atij vendi).
- 73 Politikat për Rishpërndarje: Shfrytëzimi i Taksave dhe Transfereve Sociale, Organizata Ndërkombëtare e Punës 2008 (N. Prasad).
- 74 Gjendja e Mjedisit në Kosovë, Misioni Ndihmës i Kombeve të Bashkuara në Kosovë 2003 (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësisor).
- 75 Plani për Efikasitet të Energjisë i Kosovës 2010-2018, Ministria e Energjisë.
- 76 Analizat dhe identifikimi i mundësive të programeve mbi promovimin e efikasitetit të energjisë dhe shfrytëzimit të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë, UNDP 2012.



Raporti Global i Zhvillimit Njerëzor është raport i pavarur dhe publikim i rëndësishëm i porositur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Ai është hartuar nga një ekip i studiuesve, pjesëmarrësve në zhvillim dhe anëtarëve të Zyrës për Raportin e Zhvillimit Njerëzor në Zyrën Qendrore të UNDP-së. Qëllimi parësor i tij është që të vlerësojë se sa janë duke përparuar shtetet dhe shoqëritë drejt objektivave të zhvillimit njerëzor, sa janë duke nxjerrë mësim nga përvojat e vendeve të ndryshme dhe duke bërë që zhvilluar dialogun global për një mirëqenieje më të mirë të njerëzimit.

Raportet Kombëtare të Zhvillimit Njerëzor (RKZHNJ) përpiqen të përsërisin po të njëjtin model por nga perspektiva e shteteve veçmas. Secili RKZHNJ përgatitet dhe është në pronësi të ekipeve vendore, të cilët me këtë fusin një koncept të zhvillimit njerëzor në dialogun për politikën shtetërore. Kjo nënkupton shumë më tepër se vetëm analizimin e indikatorëve të zhvillimit njerëzor dhe hartimit të rekomandimeve e politikave. RKZHNJ-ja është fryt i një procesi të konsultimit, studimeve dhe hartimit të raportit që është krejtësisht i udhëhequr dhe në pronësi kombëtare. RKZHNJ-të tradicionalisht nxisin debate të fuqishme dhe mobilizojnë mbështetjen për veprim dhe ndryshim.

Raporti i parë i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë, në vitin 2002, e vlerësonte progresin e Kosovës në raport me Indeksin e Zhvillimit Njerëzor, Indeksin e Zhvillimit Gjnor dhe Indeksin e Varfërisë Njerëzore. RKZHNJ-ja e dytë paraqiste të dhënat e zhvillimit njerëzor në nivelin komunal dhe Indeksin e parë të Pjesëmarrjes, dhe përshkruante nivelet e pjesëmarrjes qytetare dhe politike të grupeve etnike sipas komunës, si në mjediset urbane ashtu edhe në ato rurale. Raporti i tretë, RKZHNJ për vitin 2006, u fokusua në rininë e Kosovës dhe sfidat e saj pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999. RKZHNJ-ja e katërt, më 2007, analizonte raportin e rëndësishëm në mes të energjisë dhe zhvillimit njerëzor dhe ofronte rekomandime të politikave për sektorin e energjisë në Kosovë.

Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë (RZHNJK) 2008 i ishte dedikuar rolit të nënvlerësuar të shoqërisë civile në procesin demokratik të Kosovës, në forcimin e shoqërisë dhe institucioneve të Kosovës.

Raporti i fundit i Zhvillimit Njerëzor 2010 (RZHNJK 2010) shqyrtoj treguesit tradicional socio-ekonomik nga perspektiva e përfshirjes sociale prej varfërisë dhe papunësisë deri tek shëndeti dhe arsimimi. Ai eksploroj se si diskriminimi - i qëllimshëm apo jo - ndikon në bilancin socio-ekonomik të Kosovës, procesin politik dhe qëllimet e orientuara politike drejt BE-së. Ajo gjithashtu identifikoj grupet sociale që ndjenjë kafshimin e përjashtimit më thellësisht se të tjerët. Këto grupe rrezikojnë që të bëhen popullatë e padukshme e Kosovës, përpos se ata nuk lëvizin shpejt deri tek shkalla e prioritetëve të politikave dhe bëhen fokus kryesor të axhendës së zhvillimit në Kosovë: të papunët afat-gjatë, fëmijët dhe të rinjtë e pafavorizuar, gratë rurale, Roma, Askhali dhe Egjiptianët (RAE), personat me nevoja të veçanta. Në fund, raporti ofron disa rekomandime se si lëvizja drejt një shoqërie më përfshirëse mund të menaxhohet, si një pararendës themelor për progresin në fushat tjera siç janë ajo ekonomike dhe politike.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – Kosovë
Qyteza Pejton, Nr. 14, Prishtinë
Tel. +381 (0) 38 249 066
Fax. +381 (0) 38 249 065



*Empowered lives.
Resilient nations.*